PËR MËSUESIN/EN

dukagjini
shtëpia botuese publishing house

Merita Fejza, Arjanë Ferizi, Doruntina Rakaj,
Rajmonda Kurshumlia, Zana Temaj

MATEMATIKA

Për klasën e dytë të arsimit fillor

2

PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes 7
Hyrje 9
Planifikimi vjetor 20
Plani dymujor: shtator—tetor 21
Plani dymujor: nëntor—dhjetor 27
Plani tremujor: janar—shkurt—mars 32
Plani tremujor: prill—maj—qershor 38
Mësimi 1: Njohuri për numrat deri në 20 44
Mësimi 2: Leximi i numrave deri në 20. Numrat çift dhe numrat tek 46
Mësimi 3: Krahasimi i numrave. Paraardhësi dhe pasardhësi 48
Mësimi 4: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20 50
Mësimi 5: Mbledhja e numrave duke plotësuar 10 52
Mësimi 6: Zbritja e numrave duke veçuar 10 54
Mësimi 7: Zbritja e numrave duke veçuar 10 56
Mësimi 8: Përsërisim 58
Mësimi 9: Orientimi 60
Mësimi 10: Përsërisim 62
Mësimi 11: Grupimi i elementeve në bashkësi sipas vetive 64
Mësimi 12: Ushtrojmë 66
Mësimi 13: Elementet e bashkësive 68
Mësimi 14: Paraqitja e bashkësive me anë të diagramit 70
Mësimi 15: Krahasimi i bashkësive sipas numrit të elementeve 72
Mësimi 16: Elementet e përbashkëta të dy bashkësive 74
Mësimi 17: Ushtrojmë 76
Mësimi 18: Formimi i bashkësisë nga dy bashkësi të dhëna 78
Mësimi 19: Ushtrojmë 80
Mësimi 20: Formimi i nënbashkësisë sipas vetisë së elementeve 82
Mësimi 21: Ushtrojmë 84
Mësimi 22: Relacioni 86
Mësimi 23: Numrat deri në 30 88
Mësimi 24: Ushtrojmë 90
Mësimi 25: Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 30 92
Mësimi 26: Ushtrojmë 94
Mësimi 27: Mbledhja e numrave duke plotësuar 10 96
Mësimi 28: Ushtrojmë 98
Mësimi 29: Zbritja e numrave duke veçuar 10 100
Mësimi 30: Ushtrojmë 102
Mësimi 31: Vlerësojmë të kuptuarit 104
Mësimi 32: Vijat e lakuara dhe të drejta. Segmenti 106
Mësimi 33: Segmenti 108
Mësimi 34: Ushtrojmë 110
Mësimi 35: Matja e gjatësisë së segmenteve 112
Mësimi 36: Ushtrojmë 114
Mësimi 37: Numrat deri në 100 116
Mësimi 38: Numrat deri në 100 118
Mësimi 39: Ushtrojmë 120
Mësimi 40: Përsërisim 122

Mësimi 41: Mbledhja dhe zbritja me dhjetëshe të plota 124
Mësimi 42: Ushtrojmë 126
Mësimi 43: Mbledhja e numrave dyshifrorë me numër njëshifror pa kalim të 10 128
Mësimi 44: Ushtrojmë 130
Mësimi 45: Zbritja e numrit njëshifror nga numri dyshifror pa e prishur 10 132
Mësimi 46: Ushtrojmë 134
Mësimi 47: Vlerësojmë të kuptuarit 136
Mësimi 48: Mbledhja e numrave dyshifrorë me numër njëshifror me kalim të 10 138
Mësimi 49: Ushtrojmë 140
Mësimi 50: Mbledhja e numrave në shtylla 142
Mësimi 51: Zbritja e numrit njëshifror nga numri dyshifror, duke veçuar 10 144
Mësimi 52: Ushtrojmë 146
Mësimi 53: Zbritja e numrave në shtylla 148
Mësimi 54: Përsërisim 150
Mësimi 55: Zbatojmë 152
Mësimi 56: Matja e gjatësisë 154
Mësimi 57: Ushtrojmë 156
Mësimi 58: Njësitë matëse (metri) 158
Mësimi 59: Njësitë matëse (decimetri) 160
Mësimi 60: Ushtrojmë 162
Mësimi 61: Vlerësojmë të kuptuarit 164
Mësimi 62: Mbledhja e numrit dyshifror me dhjetëshe të plotë 166
Mësimi 63: Ushtrojmë 168
Mësimi 64: Zbritja e numrave dyshifrorë ku zbritësi është dhjetëshe e plotë 170
Mësimi 65: Ushtrojmë 172
Mësimi 66: Mbledhja e numrave dyshifrorë pa kalim të numrit 10 174
Mësimi 67: Ushtrojmë 176
Mësimi 68: Zbritja e numrave dyshifrorë duke veçuar dhjetëshen 178
Mësimi 69: Ushtrojmë 180
Mësimi 70: Përsërisim 182
Mësimi 71: Përsërisim 184
Mësimi 72: Mbledhja e numrit dyshifror me kalim të numrit 10 186
Mësimi 73: Ushtrojmë 188
Mësimi 74: Zbritja e numrit dyshifror pa prishje të numrit 10 190
Mësimi 75: Ushtrojmë 192
Mësimi 76: Përsërisim 194
Mësimi 77: Vlerësojmë të kuptuarit 196
Mësimi 78: Euro 198
Mësimi 79: Ushtrojmë 200
Mësimi 80: Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve 202
Mësimi 81: Ushtrojmë 204
Mësimi 82: Shoqërimi i mbledhorëve 206
Mësimi 83: Ushtrojmë 208
Mësimi 84: Detyra me dy veprime 210
Mësimi 85: Ushtrojmë 212
Mësimi 86: Zbritja e numrit nga shuma 214
Mësimi 87: Zbritja e shumës nga numri 216
Mësimi 88: Ushtrojmë 218
Mësimi 89: Lidhja e mbledhjes me zbritjen 220
Mësimi 90: Ushtrojmë 222

Mësimi 91: Detyra me dy veprime (+ dhe -) 224
Mësimi 92: Përsërisim 226
Mësimi 93: Zbatojmë 228
Mësimi 94: Vlerësojmë të kuptuarit 230
Mësimi 95: Kilogrami 232
Mësimi 96: Ushtrojmë 234
Mësimi 97: Gjejmë mbledhorin e panjohur 236
Mësimi 98: Ushtrojmë 238
Mësimi 99: Gjejmë të zbritshmin e panjohur 240
Mësimi 100: Ushtrojmë 242
Mësimi 101: Gjejmë zbritësin e panjohur 244
Mësimi 102: Ushtrojmë 246
Mësimi 103: Zgjidhja e jobarazimeve 248
Mësimi 104: Ushtrojmë 250
Mësimi 105: Përsërisim 252
Mësimi 106: Vlerësojmë të kuptuarit 254
Mësimi 107: Simetria ndaj drejtëzës 256
Mësimi 108: Drejtëza e simetrisë 258
Mësimi 109: Ushtrojmë 260
Mësimi 110: Përsërisim 262
Mësimi 111: Prodhimi si shumë e mbledhorëve të barabartë 264
Mësimi 112: Ushtrojmë 266
Mësimi 113: Ndërrimi i vendeve të faktorëve 268
Mësimi 114: Ushtrojmë 270
Mësimi 115: Shumëzimi me faktorin 2 272
Mësimi 116: Ushtrojmë 274
Mësimi 117: Shumëzimi me faktorin 3 276
Mësimi 118: Ushtrojmë 278
Mësimi 119: Shumëzimi me faktorin 4 280
Mësimi 120: Shumëzimi me faktorin 5 282
Mësimi 121: Ushtrojmë 284
Mësimi 122: Përsërisim 286
Mësimi 123: Vlerësojmë të kuptuarit 288
Mësimi 124: Shumëzimi me faktorin 10 290
Mësimi 125: Ushtrojmë 292
Mësimi 126: 0 dhe 1 si faktorë 294
Mësimi 127: Ushtrojmë 296
Mësimi 128: Shumëzimi me faktorin 6 298
Mësimi 129: Shumëzimi me faktorin 7 300
Mësimi 130: Ushtrojmë 302
Mësimi 131: Shumëzimi me faktorin 8 304
Mësimi 132: Shumëzimi me faktorin 9 306
Mësimi 133: Ushtrojmë 308
Mësimi 134: Përsërisim 310
Mësimi 135: Zbatojmë 312
Mësimi 136: Tabela e shumëzimit 314
Mësimi 137: Shumëfishi i një numri 316
Mësimi 138: Kuptimet: për sa më i madh dhe sa herë më i madh 318
Mësimi 139: Ushtrojmë 320

Mësimi 140: Vlerësojmë të kuptuarit 322
Mësimi 141: Shoqërimi i faktorëve (vetitë e shumëzimit) 324
Mësimi 142: Radha e veprimeve + dhe · 326
Mësimi 143: Ushtrojmë 328
Mësimi 144: Shumëzimi i shumës 330
Mësimi 145: Shumëzimi i ndryshimit 332
Mësimi 146: Ushtrojmë 334
Mësimi 147: Ushtrojmë 336
Mësimi 148: Zbatojmë 338
Mësimi 149: Vlerësojmë të kuptuarit 340
Mësimi 150: Disa lloje të figurave gjeometrike 342
Mësimi 151: Drejtkëndëshi dhe sipërfaqja drejtkëndëshe 344
Mësimi 152: Katrori dhe sipërfaqja katrore 346
Mësimi 153: Ushtrojmë 348
Mësimi 154: Trekëndëshi dhe sipërfaqja trekëndëshe 350
Mësimi 155: Rrethi dhe sipërfaqja rrethore 352
Mësimi 156: Ushtrojmë 354
Mësimi 157: Perimetri 356
Mësimi 158: Pozitat e pikës 358
Mësimi 159: Llogaritja e sipërfaqes katrore 360
Mësimi 160: Pjesëtimi si zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë 362
Mësimi 161: Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit 364
Mësimi 162: Ushtrojmë 366
Mësimi 163: Ushtrojmë 368
Mësimi 164: Përsërisim 370
Mësimi 165: Kuptimet: për sa më i vogël dhe sa herë më i vogël 372
Mësimi 166: Gjysma dhe çereku 374
Mësimi 167: Ushtrojmë 376
Mësimi 168: Numri 1 dhe 0 në pjesëtim 378
Mësimi 169: Ushtrojmë 380
Mësimi 170: Radha e veprimeve 382
Mësimi 171: Ushtrojmë 384
Mësimi 172: Zbatojmë 386
Mësimi 173: Vlerësojmë të kuptuarit 388
Mësimi 174: Shprehjet shkronjore 390
Mësimi 175: Barazimet me shumëzim dhe pjesëtim 392
Mësimi 176: Ushtrojmë 394
Mësimi 177: Kubi dhe kuboidi 396
Mësimi 178: Ushtrojmë 398
Mësimi 179: Piramida, koni, sfera dhe cilindri 400
Mësimi 180: Edhe matematika është zbavitje 402
Mësimi 181: Grumbullimi dhe paraqitja e të dhënave 404
Mësimi 182: Ushtrojmë 406
Mësimi 183: Probabiliteti 408
Mësimi 184: Përsërisim 410
Mësimi 185: Vlerësojmë të kuptuarit 412

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimi t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënit, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehi të të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.

Cilësia e re e të nxënit dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimet janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES

për konceptimin e mësimeve model

Faqja në të majtë

Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.

Rezultatet e të nxënit të temës janë në koherencë me ato të fushës.

Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.

Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.

Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Mësimi 5

ASPEKTE TE PËRGJITHSHME TE PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 Klasa: II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.3, 1.1.,2.4

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.2,1.3.1

ASPEKTE SPECIFIKE TE PLANIT TE ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20 (P)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan barazimin e kërkuar;
- Zgjidh saktë detyrat e dhëna;
- Krijon barazi për të dhënë barazi të saktë.

Kriteret e suksesit:
Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Libër, fletë, tabela etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe); Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet një aktivitet me nxënës të ndarë në grupe dhe kërkohet prej secilit nxënës të grupit të shkruajë dy mbledhjet që japin shumën 20, p.sh. 12+8=20. Më pas letra përcillet te nxënësi tjetër i grupit, në mënyrë që të gjithë të shkruajnë nga një barazim.

Hapi 2: Në tabelë shkruhen disa barazime.

17-2=□ 19-□=9 □-5=15

Kërkohet nga nxënësit t'i zgjidhin këto barazime në fletore.

Hapi 3: Plotësohet detyra e pestë në libër. Diskutohet me nxënësit kjo pyetje.

Për mësuesin

12

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Të gjitha mjetet dhe materialit që ndihmojnë në konkretizim.

Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera që evidentohen.

Metodologjia e mësimit ndërtohet në hapa, të cilët mund të jenë tre ose edhe më shumë. Tri figurat jepen së bashku, çka sugjeron që mësimi duhet të ndërtohet mbi të mëparshmen, për të vijuar më pas me dije e shkathtësi të reja.

Faqja në të djathtë

Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en gjatë përgatitjes.

Figurat, tabelat, diagramet etj., janë ndihmë për të gjithë mësimdhënësit në aspektin pamor, për sukses në zhvillimin e mësimit.

Për t'i përforcuar dijet dhe shkathtësitë, në fund të mësimit jepen detyra për t'u kryer në shtëpi.

Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arritjen e rezultateve të nxënësve.


Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për bashkëpunimin në grup, zgjidhjen e detyrave, përgjigjet e dhuara për pyetjet e drejtuara.

Detyrë:
Detyra 9 (faqe 10).

Reflektim për rezultatin e orës mësimore

Për mësuesin

13

Pas pjesës hyrëse, vijon hapi tjetër për pjesën kryesore të mësimit, ku, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, të nxënët bëhet më tërheqës dhe nxënësit bëhen aktivë, duke u përfshirë në veprimtari të ndryshme.

Veprimtaritë në këtë hap a këta hapa të mësimit udhëhiqen nga mësuesi/ja dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve apo duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Hapi i fundit është praktikë e pavarur ku nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur, dhe inkurajohen duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

Rezultatet e të nxënit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënit për këtë temë. Në këtë rast, mund merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me kurrikulën bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënit të lëndës mësimore, mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zbërthehen në rezultate të të nxënit. Ato janë pjesë e kurrikulës bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënit: Rezultatet specifike të të nxënit janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimit, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënit të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zbërthim i rezultateve të të nxënit sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënës - hapat e zhvillimit të mësimit: Meqenëse nxënësit e klasës së parë dhe të dytë mësojnë konceptet dhe shkathtësitë fillestare, në këtë fazë të zhvillimit ata përparojnë në drejtim të zotërimit të tyre, por nuk i zotërojnë operacionet mendore, prandaj edhe të menduarit e tyre është paraoperacional, kështu që mësimi kalon përmes hapave.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit?

Mbillet një farë, në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera.

Këto tri figura, jepen së bashku, njëra pas tjetrës, çka sugjeron që mësuesit duhet të ndërtojnë mësimin mbi të mëparshmen dhe të kenë parasysh se çfarë mund të vijojë. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të ecur vazhduar më tej.

Në këto klasa mësimi zhvillohet në hapa, të cilët sipas lëndës dhe veçorisë, mund të jenë tre ose edhe më shumë, por gjithsesi mësimi do të ndjekë këtë ecuri.

Hyrje: Identifikohen njohuritë dhe shprehitë fillestare të nxënësve që të nxitet interesi i tyre për mësimin. Pjesa kryesore e mësimit. Mësuesi, përmes përdorimit të teknikave të ndryshme, synon ta bëjë tërheqës të nxënit e mësimit përmes veprimtarive të ndryshme, duke përdorur mjete të larmishme konkretizuese, figura, tabela, foto, video dhe të tjera.

Praktikë e udhëhequr: Veprimtaritë në këtë etapë të mësimit kërkojnë që të udhëhiqen nga mësuesi dhe nxënësit i kryejnë ato sipas udhëzimeve a duke ndjekur modelin gjysmë të përgatitur.

Praktikë e pavarur: Nxënësit inkurajohen që t'i vazhdojnë veprimtaritë, por tashmë të pavarur dhe nxiten duke u dhënë sugjerime kur është e nevojshme.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin/en

MATEMATIKA 2

Fusha e matematikës ka si qëllim t'i pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë për strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë për llogaritje dhe zgjidhje të problemeve në jetën e përditshme. Matematika promovon përvetësimin themelor të koncepteve matematike, përforcim dhe zhvillim, në identifikimin e simboleve, kryerjen e veprimeve themelore, matje me instrumente jostandarde dhe standarde, formën e figurave dhe trupave gjeometrikë, grumbullimin e të dhënave, leximin dhe paraqitjen e grafikëve të thjeshtë, si dhe vendosjen e një baze të njohjes dhe qëndrimeve pozitive ndaj matematikës.

Fusha e matematikës, gjithashtu, ka si qëllim zhvillimin e aftësive, të shkathtësive dhe të shprehive të nxë-nësve për të menduar në mënyrë kritike, zhvillimin e personalitetit të tyre, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe sistematike, nxitjen dhe inkurajimin e ndërtimit të njohurive të reja me qëllim të zbatimit dhe integrimit të tyre në fushat e tjera dhe zgjidhjen e situatave problemore në jetën e përditshme.
Po ashtu, edhe një nga qëllimet e fushës së matematikës është funksionalizimi i dijeve përmes integrimit të saj me të gjitha fushat, lidhjen ndërkurrikulare dhe arsimimit të qëndrueshëm, përmes të cilave zotërohen kompetencat kryesore.

Udhëzime metodologjike

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të fushës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes tematike mësimore dhe të rezultateve të kompetencave për shkallën e parë kurrikulare, me bazën didaktike dhe me nivelin e formimit të nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë maksimumin e potencialit që zotëron brenda vetes.

Mësimdhënësi është i lirë të përdorë metoda mësimore bashkëkohore ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash. Këto metoda duhet të jenë në funksion të nxitjes së mendimit të pavarur, kritik e krijues. Metodat dhe teknikat e punës me nxënës lipset të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, në funksion të arritjeve të rezultateve të të nxënit dhe të zbatimit në jetën e përditshme.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënët

Ky libër është hartuar për t'ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje "Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës" (2016), si dhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënit të fushës, rezultatet specifike të të nxënit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecurinë metodologjike të orës së mësimit e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*.
Qëllimi i kësaj rubrike është që t'ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe atëherë kur nuk arrihen ato, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënit - proce-

durave të mësimdhënies dhe të nxënit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet 'trekëndëshi magjik'. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënit dhe vlerësimin. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Burimi: Metodologji e mësimdhënies, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE

Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Musai. B. (2014) Metodologji e mësimdhënies.Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta keni pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijues, është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e zhvillimit proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës, sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve, apo në bashkëpunim me bashkëmoshatarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshatar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.

Zgjeroni dhe thelloni dijet
Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 47-51.

Burimi: Psikologji edukimi, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE

Sipas Piazhesë, fëmijët e klasës së parë dhe të dytë bëjnë pjesë në stadin paraoperacional dhe proceset kryesore të të menduarit tek ata bazohen kryesisht në vëzhgimin. Në këtë mënyrë, është e mundur të kultivohen elementet dhe shprehitë e para të të menduarit kritik; por edukimi në mënyrë sistematike i tyre, që bëhet më pas shprehi e rëndësishme e të menduarit e nivelit të lartë, fillon në klasën e tretë. Për këtë arsye, mësimet janë të strukturuara në disa hapa të thjeshtë, të cilët me kujdes dhe në mënyrë të përshkallëzuar kontribuojnë, japin ndihmesën e tyre në ndërtimin dhe krijimin e dijeve, si dhe formimin e shprehive.

Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi.Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 1

I	Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku prej një gjysmë faqeje, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
2.	Shkruan një tekst të shkurtër (rreth një gjysmë faqeje - rreth 250 fjalë) për një temë të caktuar.
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.
4.	Ritregon ngjarjen e një teksti të dëgjuar (nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësimdhënësi), përmbajtja e të cilit nuk përmban më shumë se një faqe tekst të shtypur.
5.	Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit - luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje, që është e përshtatshme për moshën dhe performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarët.
7.	Përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve.
8.	Shpreh për 3-5 minuta para moshatarëve dhe të tjerëve përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari (të përshtatshëm për moshën e vet), dëgjimi të një tregimi, shikimi apo performimi të një vallëzimi, dëgjimi apo performimi të një kënge apo melodie, në njërën nga format shprehëse.
9.	Emërton në gjuhën e huaj objekte, veprime ose dukuri dhe i përkthen në gjuhën amtare fjalët që i dëgjon nga gjuha e huaj, të dhëna në detyrë.

II.	Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
5.	Veçon shenjat e rrezikut të komunikacionit apo të rreziqeve të tjera nga shenjat e tjera informuese, të dhëna si detyrë, dhe tregon domethënien e njërës prej tyre në njërën nga format shprehëse, duke elaboruar me shembuj që tregojnë se si duhet të sillet në rast rreziku.
6.	Gjen dhe ndan në grup veçoritë e përbashkëta dhe veçoritë dalluese ndërmjet gjallesave, ndërmjet ngjarjeve apo ndërmjet dukurive të njohura për të, shkruan për këto të paktën në një gjysmë faqeje të fletores (rreth 250 fjalë) apo i paraqet në njërën nga format shprehëse.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III.	Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV.	Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv
1.	Përgatit një plan të thjeshtë ditor, me shkrim, me vizatim, me shenja apo me simbole, me dy-tri aktivitete ditore të veta, duke pasur parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre.
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
3.	Diskuton me moshatarët për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë apo për një grup të caktuar njerëzish në raport me të tjerët apo me mjedisin që e rrethon gjatë realizimit të një aktiviteti të caktuar.
4.	Gjen të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet ndonjë aktiviteti që bëhet në shkollë me atë në shtëpi, i përshkruan në mënyrë individuale përmes njërës nga format e të shprehurit dhe më pas i diskuton në grup.
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.
6.	Diskuton në grup për hapësirat e pastra, të sigurta (të shëndetshme) dhe anasjelltas në mjedisin që e rrethon dhe tregon të paktën një mënyrë të veprimit për mbikëqyrje apo për përmirësim të gjendjes.

V.	Kompetenca personale – Individ i shëndoshë
1.	Prezanton para të tjerëve rregullat themelore të higjienës personale (p.sh., fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit të vet në të cilin jeton dhe vepron.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
3.	Bën një listë (me njërën nga format shprehëse, si, shkrim vizatim etj.) me ushqimet që i konsumon dhe i rendit ato sipas rëndësisë që kanë për shëndetin dhe mirëqenien e vet dhe ndërmerr masa preventive për t'u mbrojtur nga sëmundjet që shkaktohen nga përdorimi i tepruar dhe i papastër i tyre.
4.	Tregon mënyrën e shfrytëzimit dhe të menaxhimit të kohës së lirë në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies së vet, ndan përvojat me të tjerët.
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta, për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.
6.	Tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti me të cilin është ballafaquar apo të ndonjë konflikti në rrethin e tij, ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajte të rregullt të sendeve që e rrethojnë etj.).

VI	Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm
1.	Prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi në të cilin është pjesëmarrës (grup loje, aktiviteti), me theks në detyrat e veta, dhe i diskuton me bashkëmoshatarë.
2.	Diskuton në grup dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
3.	Arsyeton nevojën e zbatimit të rregullave në lojë, në klasë/shkollë, në rrugë apo në familje dhe paraqet pasojat e moszbatimit të ndonjë rregulle në shembullin e caktuar.
4.	Identifikon vlera shoqërore që kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (p.sh., besimin e ndërsjellë, tolerancën, solidaritetin, respektin, mirësjelljen etj.).
5.	Veçon ndonjë organizim në familje, në klasë apo në lagje dhe i përshkruan përmes formave të ndryshme të shprehjes së kontributit individual të anëtarëve për realizimin e përbashkët të tij.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.
7.	Identifikon personat dhe shërbimet e nevojshme nga të cilët kërkohet ndihma në situata të rrezikut për shëndetin e vet, fizik apo mendor, të shkaktuara nga natyra apo nga njeriu (një ngjarje e dhënë nga mësuesi apo e marrë nga jeta e përditshme), më pas për këtë diskuton në grup.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS SË MATEMATIKËS Shkalla 1

I.	**NJOHURITË, TË KUPTUARIT DHE SHKATHTËSITË** që zhvillohen te nxënësi/ja përmes përvojave mësimore që ndërlidhen me:
1.	Zgjidhjen e problemeve,
2.	Arsyetimet dhe vërtetimet matematike,
3.	Komunikimin në/përmes matematikë/s,
4.	Lidhjet matematike,
5.	Përfaqësimin matematik,
6.	Promovimin e modelimit matematik,
7.	Strukturimin e të menduarit matematik,
8.	Përdorimin e TIK-ut në/për matematikë.

1.	**Zgjidhja e problemeve:**
	Zgjidhja e problemeve është një proces që zhvillon njohuritë e nxënësve në matematikë përmes detyrave, ku rezultati dhe procedura e zgjidhjes nuk janë njohur më parë. Nxënësi ndërton njohuri, përshkruan dhe zgjidh situata problemore që krijohen brenda matematikës dhe në kontekste nga fushat e tjera, si dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme. Nxënësit i mundësohet që të zbatojë dhe të përshtatë një shumëllojshmëri të strategjive për të zgjidhur problemet.
	Nxënësi/ja:
1.	Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta.
2.	Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme.
3.	Kryen veprimet themelore matematikore me numra.
4.	Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave.
5.	Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.

2.	**Arsyetimet dhe vërtetimet matematike:**
	Arsyetimi është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësve në matematikë përmes konjukturave matematike, nxjerrjes së konkluzioneve logjike, hipotezave dhe të menduarit të tyre kritik, justifikimit të ideve, analizimit të provave dhe ndërtimit të argumenteve. Nxënësve u mundësohet përdorimi për arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës.
	Nxënësi/ja:
1.	Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve.
2.	Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësime.
3.	Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

3. Komunikimi në/përmes matematikë/s

Komunikimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t`i shprehur idetë matematike me rrjedhje logjike, që i justifikon ato në audiencë dhe në shoqëri, përmes të folurit dhe të shkruarit për atë që e bëjnë me simbole, terma, grafikë, modele dhe shprehje matematikore.

Nxënësve u mundësohet përdorimi i komunikimit nëpërmjet shenjave, të folurit të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik.

Nxënësi/ja:

1.	Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore.
2.	Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor.
3.	Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme.
4.	Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.
5.	Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash.
6.	Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune.

4. Lidhjet në matematikë

Lidhja matematike është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për t`i lidhur idetë dhe njohuritë matematike, brenda fushës së matematikës dhe jashtë saj. Nxënësve u mundësohet për të njohur dhe të përdorur lidhjet e ideve matematikore, për të kuptuar se si idetë matematikore ndërtohen njëra mbi tjetrën dhe për të prodhuar një tërësi koherente si dhe zbatimi i matematikës në kontekste brenda dhe jashtë fushës së matematikës.

Nxënësi/ja:

1.	Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve.
2.	Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme.

5. Përfaqësimet matematike

Përfaqësimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të përfaqësuar objektet matematikore dhe veprimeve, duke përfshirë numra, forma dhe marrëdhëniet. Përfaqëson dhe analizon situata dhe strukturat matematikore. Nxënësve u mundësohet krijimi dhe përdorimi i përfaqësive, për të organizuar, regjistruar dhe komunikuar idetë matematikore, zgjidhur, përkthyer dhe zbatuar përfaqësimet që kanë të bëjnë me zgjidhje e probleme matematikore, duke përdorur përfaqësimet për modele dhe interpretime të fenomeneve sociale, natyrore dhe matematikore.

Nxënësi/ja:

1.	Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore, duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

6.	Modelimi matematik
	Modelimi matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të kuptuar format, modelet në kontekste të ndryshme, marrëdhëniet dhe funksionet, paraqitjen dhe analizimin e strukturave matematikore. Nxënësve u mundësohet që të krijojnë dhe përdorin modele të ndryshme, t'i paraqesin modelet dhe rolin e tyre në kontekst, t'i përdorin modelet për të përfaqësuar dhe për të kuptuar marrëdhëniet sasiore, interpretuar me modele fenomenet, sociale natyrore dhe matematikore.
	Nxënësi/ja:
1.	Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme.
2.	Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive.
3.	Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, format dhe objektet nga klasa dhe nga jeta e përditshme.
4.	Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore, duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

7.	Strukturimi i të menduarit matematik
	Të menduarit matematik është një proces që zhvillon aftësitë e nxënësit për të parashtruar pyetje dhe pritjet nga përgjigjet e mundshme. Nxënësve u mundësohet ndërgjegjësimi për mënyrën, formën, qasjen dhe për llojet e pyetjeve që e karakterizojnë matematikën, si dhe llojet e përgjigjeve të pritshme.
	Nxënësi/ja:
1.	Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtë shkollor.

8.	Përdorimi i TIK-ut në/për matematikë
	Përdorimi i teknologjisë është një proces që zhvillon njohuritë dhe aftësitë e nxënësve për të përmbushur rezultatet e të nxënit të fushës së matematikës dhe t'i bëjë të suksesshëm edhe përtej shkollës. Nxënësve u mundësohet përdorimi i teknologjisë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet, si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.
	Nxënësi/ja:
1.	Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore;
2.	Përdor kalkulatorin për të verifikiuar saktësinë e zgjidhjes së problemit.

II.	**VLERAT DHE QËNDRIMET** që zhvillohen
	Qëndrimet e individit, bindjet dhe emocionet luajnë një rol të rëndësishëm në interesimin e tij, përgjigjen ndaj matematikës dhe përdorimin e saj në jetën e tij. Qëndrimet e nxënësve ndaj matematikës i vendosin ata drejt angazhimit produktiv të tyre në matematikë, si: 1. Interesimi për matematikën - nëse ata e shohin atë si të dobishme në jetën reale. 2. Gatishmëria për t'u angazhuar në matematikë - ka të bëjë me qëndrimet emocionale dhe besimin personal që e shpie nxënësin drejt përfitimit.
	Formimet relevante në këtë fushë janë:
a.	Kurioziteti,
b.	Motivimi për mësim,
c.	Imagjinata në kreativitetin për zgjidhjen e problemeve,
d.	Insistimi, këmbëngulja dhe fuqia në fokusimin e problemeve,
e.	Pavarësia në mendime dhe veprime,
f.	Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme,
g.	Organizimi i të menduarit,
h.	Besimi në forcat vetjake,
i.	Besimi në përdorimin e teknologjisë,
j.	Dëshira për njohuri matetematike,
k.	Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit,
l.	Kritikat konstruktive,
m.	Pavarësia në mendime,
n.	Gatishmëria për bashkëpunim,
o.	Prania e kritikave dhe gatishmëria për kritika konstruktive,
p.	Gatishmëria për gara të ndershme,
q.	Kuraja për të kërkuar përkrahje/ndihmë,
r.	Qëndrimi i hapur ndaj përkrahjes së të tjerëve,
s.	Qëndrimi ndaj pyetjeve dhe kërkesave,
t.	Vullneti,
u.	Toleranca,
v.	Respekti për saktësinë, përpjekjet personale dhe ato në grup.

III.	**AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË** që zhvillohen
1.	Identifikimi,
2.	Përshkrimi,
3.	Zbatimi,
4.	Njehsimi,
5.	Matja,
6.	Vlerësimi,
7.	Skicimi,
8.	Krijimi i modeleve,
9.	Qasja në probleme nga perspektiva të ndryshme.

IV.	**KONCEPTET SPECIFIKE DHE NJOHURITË**
	Numrat, algjebra dhe funksioni, forma, hapësira, matja dhe gjeometria, përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti
1.	Numrat natyrorë dhe të plotë,
2.	Veprimet themelore me numra,
3.	Ekuacionet, inekuacionet dhe funksionet,
4.	Forma e figurave të rregullta (trekëndëshi, katrori, drejtkëndëshi dhe rrethi),
5.	Hapësira – objektet gjeometrike dhe trupat e rregullt gjeometrikë (kubi, kuboidi, piramida, prizma dhe sfera),
6.	Matjet (e gjatësisë, perimetri dhe syprina) e figurave të rrafshta,
7.	Të dhënat (elemente themelore të statistikës), grumbullimi i shënimeve, mostra, prova, mesi aritmetik.

Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Matematikë Klasa II

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE				Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)
	Gjysmëvjetori I		Gjysmëvjetori II		
	Shtator—tetor	Nëntor—dhjetor	Janar—shkurt—mars	Prill—maj—qershor	
SHKATHTËSI PËR JETË	Numrat natyrorë Orientimi Bashkësitë dhe relacionet Figurat gjeometrike	Numrat natyrorë Njësitë matëse Figurat gjeometrike	Numrat natyrorë Njësitë matëse Ekuacionet dhe inekuacionet lineare Figurat gjeometrike	Numrat natyrorë Figurat gjeometrike Modelet Puna me të dhëna Probabiliteti	I.1, I.3 II.1, II.2, II.3, II.4, II.7, II.8 III.1, III.2, III.3, III.4, III.5, III.6, III.7 IV.2, IV.5 V.2, V.5 VI.2, VI.6

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Matematikë

Fusha e kurrikulës: Matematikë **Klasa:** II

Tema mësimore: Numrat natyrorë
Orientimi
Bashkësitë dhe relacionet
Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi, duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera, në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan drejt, si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
2.	Diskuton në grup dhe, në bashkëpunim me anëtarët e grupit, vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.1	Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;
1.2	Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;
1.3	Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;
1.4	Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;
1.5	Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;
2.1	Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;
2.2	Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësime;
2.3	Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;
3.1	Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;
3.2	Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëshkollor;
3.3	Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme;
3.4	Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;
3.5	Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;
3.6	Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;
4.1	Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve;
4.2	Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme;
5.1	Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
6.1	Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme;
6.2	Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive;
6.3	Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;
6.4	Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
7.1	Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor;
8.1	Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat natyrorë **Orientimi** **Bashkësitë dhe relacionet** **Figurat gjeometrike**	- Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; - Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe), si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri; - Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100; - Zbaton rregulla për të identifikuar numrat çift dhe tek; - Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura; - Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave; - Përcakton vendin e objekteve, para, prapa, poshtë, lart, djathtas, majtas, brenda, jashtë, nën, mbi;	1. Njohuri për numrat deri në 20 – faqe 5, 6 2. Leximi i numrave deri në 20. Numrat çift dhe numrat tek – faqe 7 3. Krahasimi i numrave. Paraardhësi dhe pasardhësi – faqe 8 4. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20 – faqe 9, 10 5. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20 – faqe 11 6. Zbritja e numrave duke veçuar 10 – faqe 12 7. Zbritja e numrave duke veçuar 10 – faqe 13, 14 8. Përsërisim – faqe 15, 16, 17 9. Orientimi – faqe 18, 19 10. Përsërisim – faqe 20 11. Grupimi i elementeve në bashkësi sipas vetive – faqe 21 12. Grupimi i elementeve në bashkësi sipas vetive – faqe 22 13. Elementet e bashkësive – faqe 23 14. Paraqitja e bashkësive me anë të diagramit – faqe 24 15. Krahasimi i bashkësive sipas numrit të elementeve – faqe 25 16. Elementet e përbashkëta të dy bashkësive – faqe 26 17. Ushtrojmë – faqe 27 18. Formimi i bashkësive nga dy bashkësi të dhëna – faqe 28 19. Ushtrojmë – faqe 29	43	Bashkëbisedimi Ilustrimi Demonstrimi Lojëra matematikore Puna e pavarur Të nxënit në bashkëpunim Mësimdhënia e ndërsjellë Situata problemore	Lista kontrolli Vlerësim i ndërsjellë Informata kthyese Semafori Dy yje një dëshirë Portofoli i nxënësit	Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna	"Matematika 2a", shtëpia botuese "Dukagjini"

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	- Zgjidh labirinte të ndryshme; - Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme; - Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh që mund të jenë afër/larg njëri-tjetrit; - Formon bashkësi sipas vetive të elementeve; - Identifikon elementet që i takojnë/nuk i takojnë bashkësisë dhe paraqet bashkësinë përmes Diagramit të Venit; - Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve (më pak, më shumë, aq sa); - Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive; - Shoqëron objektet (elementet) e bashkësisë së dhënë me një objekt (element) të një bashkësie tjetër; - Zgjidh labirinte të ndryshme; - Gjeneron pyetje për situata praktike nga jeta e përditshme. - Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh që mund të jenë afër/larg njëri-tjetrit; - Formon bashkësi sipas vetive të elementeve.	20. Formimi i nënbashkësisë sipas vetisë së elementeve – faqe 30 21. Ushtrojmë – faqe 31 22. Relacioni – faqe 32, 33 23. Numrat deri në 30 – faqe 34, 35 24. Numrat deri në 30 – Ushtrojmë – faqe 36 25. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 30 – faqe 37 26. Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 30 – Ushtrojmë – faqe 38 27. Mbledhja e numrave duke plotësuar 10 – faqe 39 28. Mbledhja e numrave duke plotësuar 10 – Ushtrojmë – faqe 40 29. Zbritja e numrave duke veçuar 10 – faqe 41 30. Ushtrojmë – faqe 42, 43 31. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 45 (faqe 44) 32. Vijat e lakuara dhe të drejta. Segmenti – faqe 46 33. Segmenti – faqe 47 34. Ushtrojmë – faqe 48, 49 35. Matja e gjatësisë së segmenteve – faqe 50 36. Matja e gjatësisë së segmenteve – Ushtrojmë – faqe 51, 52 37. Numrat deri në 100 – faqe 53 38. Numrat deri në 100 – faqe 54, 55 39. Ushtrojmë – faqe 56, 57 40. Përsërisim – faqe 58 41. Mbledhja dhe zbritja me dhjetëshe të plota – faqe 59 42. Ushtrojmë – faqe 60, 61 43. Mbledhja e numrave dyshifrorë me numër njëshifror pa kalim të 10 – faqe 62					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metod-ologjia e mësim-dhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurriku-lare dhe situa-tat jetësore	Burimet
	- Identifikon elementet që i tako-jnë/nuk i takojnë bashkësisë dhe paraqet bashkësinë përmes Dia-gramit të Venit; - Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve (më pak, më shumë, aq sa); - Gjen elementet e përbashkëta të dy bashkësive; - Shoqëron objektet (elementet) e bashkësisë së dhënë me një objekt (element) të një bashkësie tjetër; - Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna; - Formon nënbashkësi nga bashkësia e dhënë. - Përcakton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura; - Përkufizon segmentin duke për-dorur vizoren/ trekëndëshin për të caktuar gjatësinë e segmentit; - Mbledh, zbret dhe krahason gjatësitë e segmenteve të ndryshme, duke përdorur njësitë matëse standarde (cm, m);						

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Matematikë

Fusha e kurrikulës: Matematikë **Klasa:** II
Temat mësimore: Numrat natyrorë
Njësitë me figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës;
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese, duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës, në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/ shkollë apo jashtë saj).
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan drejt, si dhe menaxhon emocionet e veta në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
2.	Diskuton në grup dhe, në bashkëpunim me anëtarët e grupit, vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.1	Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;
1.2	Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;
1.3	Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;
1.4	Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;
1.5	Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike.
2.1	Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;
2.2	Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësime;
2.3	Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.
3.1	Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;
3.2	Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëshkollor;
3.3	Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme;
3.4	Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;
3.5	Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;
3.6	Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;
4.1	Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve;
4.2	Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme;
5.1	Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
6.1	Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme;
6.2	Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive;
6.3	Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;
6.4	Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
7.1	Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor;
8.1	Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat natyrorë **Njësitë matëse** **Figurat gjeometrike**	- Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre; - Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe), si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri; - Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100; - Zbaton rregulla për të identifikuar numrat çift dhe tek; - Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura; - Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave; - Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme; - Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde;	44. Ushtrojmë – faqe 63 45. Zbritja e numrit njëshifror nga numri dyshifror pa prishje të 10 – faqe 64 46. Ushtrojmë – faqe 65 47. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 66 48. Mbledhja e numrave dyshifrorë me numër njëshifror me kalim të 10 – faqe 67 49. Ushtrojmë – faqe 68 50. Mbledhja e numrave në shtylla – faqe 69, 70 51. Zbritja e numrit njëshifror nga numri dyshifror duke veçuar 10 – faqe 71 52. Ushtrojmë – faqe 72 53. Zbritja e numrave në shtylla – faqe 73, 74 54. Përsërisim – faqe 75, 76 55. Zbatojmë – faqe 77 56. Matja e gjatësisë – faqe 78 57. Ushtrojmë – faqe 79 58. Njësitë matëse – faqe 80 59. Mësojmë – faqe 81, 82 60. Ushtrojmë – faqe 83, 84 61. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 85 62. Mbledhja e numrit dyshifror me dhjetëshe të plotë – faqe 86 63. Ushtrojmë – faqe 87 64. Zbritja e numrave dyshifrorë, ku zbritësi është dhjetëshe e plotë – faqe 88	38	Bashkëbisedimi Ilustrimi Demonstrimi Lojëra matematikore Puna e pavarur Të nxënit në bashkëpunim Mësimdhënia e ndërsjellë Situata problemore	Lista kontrolli Vlerësim i ndërsjellë Informata kthyese Semafori Dy yje një dëshirë Portofolio e nxënësit	Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna	"Matematika 2a", shtëpia botuese "Dukagjini"

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	- Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq; - Bën lidhje ndërmjet numrave dhe matjeve; - Vlerëson dhe rendit objektet sipas madhësive; - Përdor metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde; - Zgjidh problema me fjalë nga jeta e përditshme; - Mbledh, zbret krahason gjatësitë e segmenteve të ndryshme duke përdorur njësitë matëse standarde (cm, m);	65. Përsërisim – faqe 89, 90 66. Mbledhja e numrave dyshifrorë pa kalim të numrit 10 – faqe 91 67. Ushtrojmë – faqe 92 68. Zbritja e numrave dyshifrorë duke veçuar dhjetëshen – faqe 93 69. Ushtrojmë – faqe 94, 95 70. Përsërisim – faqe 96 71. Përsërisim – faqe 97, 98 72. Mbledhja e numrit dyshifror me kalim të numrit 10 – faqe 99, 100 73. Ushtrojmë – faqe 101 74. Zbritja e numrit dyshifror pa prishje të numrit 10 – faqe 102 75. Ushtrojmë – faqe 103, 104 76. Përsërisim – faqe 105, 106 77. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 107 78. Paraja – faqe 108 79. Ushtrojmë – faqe 109, 110 80. Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve – faqe 111 81. Ushtrojmë – faqe 112 82. Shoqërimi i mbledhorëve – faqe 113					

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Matematikë

Fusha e kurrikulës: Matematikë **Klasa:** II

Temat mësimore: Numrat natyrorë
Njësitë matëse
Ekuacionet dhe inekuacionet lineare
Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës.
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minuta.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
5.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet ...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan drejt si dhe menaxhon emocionet e veta në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
2.	Diskuton në grup dhe, në bashkëpunim me anëtarët e grupit, vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.1	Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;
1.2	Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;
1.3	Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;
1.4	Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;
1.5	Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;
2.1	Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;
2.2	Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësime;
2.3	Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.
3.1	Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;
3.2	Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtëshkollor;
3.3	Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme;
3.4	Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;
3.5	Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;
3.6	Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;
4.1	Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve;
4.2	Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme;
5.1	Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
6.1	Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme;
6.2	Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive;
6.3	Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, format dhe objektet nga klasa dhe nga jeta e përditshme;
6.4	Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
7.1	Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor;
8.1	Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore;
8.2	Përdor kalkulatorin për të verifikuar saktësinë e zgjidhjes së problemit.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat natyrorë **Njësitë matëse** **Ekuacionet dhe inekuacionet lineare** **Figurat gjeometrike**	- Përdor vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave; - Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime); - Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura; - Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100; - Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50); - Demonstron peshimin me anë të balancës duke përdorur sende të ndryshme; - Përdor shenjat: <, >, =, për peshat e objekteve. - Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100); - Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri 100; - Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve (numra deri në 100); - Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie; - Vizaton drejtëzën/drejtëzat e simetrisë, si dhe përcakton sa drejtëza simetrie ka figura;	83. Ushtrojmë – faqe 114 84. Detyra me dy veprime – faqe 115 85. Ushtrojmë – faqe 116 86. Zbritja e numrit nga shuma – faqe 117 87. Zbritja e shumës nga numri – faqe 118 88. Ushtrojmë – faqe 119, 120 89. Lidhja e mbledhjes me zbritjen – faqe 5, 6 90. Ushtrojmë – faqe 7 91. Detyra me dy veprime (+ dhe -) – faqe 8 92. Përsërisim – faqe 9, 10 93. Zbatojmë – faqe 11, 12 94. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 13, 14 95. Kilogrami – faqe 15, 16 96. Ushtrojmë – faqe 17, 18 97. Gjejmë mbledhorin e panjohur – faqe 19, 20 98. Ushtrojmë – faqe 21 99. Gjejmë të zbritshmin e panjohur – faqe 22 100. Ushtrojmë – faqe 23	58	Bashkëbisedimi Ilustrimi Demonstrimi Lojëra matematikore Puna e pavarur Të nxënit në bashkëpunim Mësimdhënia e ndërsjellë Situata problemore	Lista kontrolli Vlerësim i ndërsjellë Informata kthyese Semafori Dy yje një dëshirë Portofolio e nxënësit	Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna	"Matematika 2a" shtëpia botuese "Dukagjini" "Matematika 2b", shtëpia botuese "Dukagjini"

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
		101. Gjejmë zbritësin e panjohur – faqe 24 102. Ushtrojmë – faqe 25 103. Zgjidhja e jobarazimeve – faqe 26 104. Ushtrojmë – faqe 27 105. Përsërisim – faqe 28, 29 106. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 30 107. Simetria ndaj drejtëzës – faqe 31 108. Drejtëza e simetrisë – faqe 32 109. Ushtrojmë – faqe 33, 34 110. Përsërisim – faqe 35 111. Prodhimi si shumë e mbledhorëve të barabartë – faqe 36, 37 112. Ushtrojmë – faqe 38 113. Ndërrimi i vendeve të faktorëve – faqe 39 114. Ushtrojmë – faqe 40, 41 115. Shumëzimi me faktorin 2 – faqe 42 116. Ushtrojmë – faqe 43 117. Shumëzimi me faktorin 3 – faqe 44 118. Ushtrojmë – faqe 45 119. Shumëzimi me faktorin 4 – faqe 46 120. Shumëzimi me faktorin 5 – faqe 47					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
		121. Ushtrojmë – faqe 48, 49 122. Përsërisim – faqe 50 123. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 51, 52 124. Shumëzimi me faktorin 10 – faqe 53 125. Ushtrojmë – faqe 54 126. 0 dhe 1 si faktorë – faqe 55 127. Ushtrojmë – faqe 56 128. Shumëzimi me faktorin 6 – faqe 57 129. Shumëzimi me faktorin 7 – faqe 58 130. Ushtrojmë – faqe 59 131. Shumëzimi me faktorin 8 – faqe 60 132. Shumëzimi me faktorin 9 – faqe 61 133. Ushtrojmë – faqe 62 134. Përsërisim – faqe 63, 64 135. Zbatojmë – faqe 65 136. Tabela e shumëzimit – faqe 66 137. Shumëfishi i një numri – faqe 67 138. Kuptimet: për sa më i madh dhe sa herë më i madh – faqe 68 139. Ushtrojmë – faqe 69					

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Matematikë

Fusha e kurrikulës: Matematikë **Klasa:** II

Temat mësimore:

Numrat natyrorë	Modelet
Figurat gjeometrike	Puna me të dhëna
Trupat gjeometrikë	Probabiliteti

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*	
1.	Lexon me zë një tekst të palexuar më parë, së paku një gjysmë faqe, që ka të bëjë me një temë që i përshtatet moshës
3.	Paraqet të paktën një mendim për një temë të caktuar gjatë diskutimit në grup në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Gjen veçoritë (në njërin nga aspektet: matematikore, të shkencave të natyrës apo të fushave të tjera) e një objekti, dukurie apo ngjarjeje të dhënë në detyrë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta.
2.	Sqaron me anë të të folurit procedurën e zgjidhjes së një problemi matematikor (me veprimet themelore matematikore) me të cilin është ballafaquar apo ballafaqohet në një situatë jetësore.
3.	Ndërton trupa të ndryshëm gjeometrikë dhe figura të ndryshme nga kartoni, plastelina, argjila dhe nga materialet e ndryshme ricikluese duke u mbështetur në imagjinatën e vet.
4.	Krahason objektet, lëndët e ndryshme të paraqitura nga mësimdhënësi duke i klasifikuar ato sipas formave, madhësive, ngjyrave, përbërjes, vjetërsisë apo sipas ndonjë elementi tjetër, i përshkruan pozitat që i zënë në natyrë apo në shoqëri (në mjedisin që e rrethon) dhe tregon ndërvarësinë midis tyre.
7.	Ndërton tekste, objekte apo animacione sipas imagjinatës në bazë të elementeve apo materialeve të dhëna.
8.	Arsyeton para grupit mënyrën e zgjidhjes së një problemi nga gjuha, matematika, shkencat e natyrës, shoqëria, shëndeti apo nga fusha të tjera në kohëzgjatje prej 3-5 minutash.

III. Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm	
1.	Përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numëratoren, etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë.
2.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në material tjetër për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë që kërkohet prej tij/saj.
3.	Parashtron pyetje dhe u përgjigjet pyetjeve për temën/problemin/detyrën e dhënë në njërën nga format e të shprehurit.
4.	Zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes.
7.	Mbikëqyr në mënyrë të pavarur përparimin e vet në një detyrë, aktivitet duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve (si shenjim të gabimeve - vështirësive) dhe i korrigjon ato derisa kërkon zgjidhjen e problemit të dhënë.
6.	Grumbullon dhe klasifikon materialet e performancës së vet për përgatitjen apo pasurimin e dosjes personale.
7.	Identifikon njohuritë e veta që i ka e të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo aktivitetet të caktuar dhe kërkon këshilla, informata gjatë hasjes së vështirësive.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
2.	Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
5.	Identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak apo në lagje/komunitet.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike (si: rreshtime, grupime, ecje, orientim në hapësirë etj.) dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan drejt, si dhe menaxhon emocionet e veta si në rastet e fitores apo të humbjes (pranon humbjen apo feston fitoren me dinjitet).
5.	Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitet në klasë/shkollë apo jashtë saj.

VI. Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
2.	Diskuton në grup dhe, në bashkëpunim me anëtarët e grupit, vendos rregullat e brendshme në grup, në klasë, si rregullat e realizimit të aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj.
6.	Shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi, respekton mendimin e secilit anëtar të grupit duke i dëgjuar në mënyrë aktive, vendos duke bashkëpunuar me të gjithë anëtarët për mënyrat që çojnë drejt përfundimit të një aktiviteti të caktuar.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:	
1.1	Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta;
1.2	Përdor mjete dhe metoda themelore për arritje të rezultateve gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;
1.3	Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë;
1.4	Zbaton strategji të zgjidhjes së problemave;
1.5	Bën vrojtime dhe hetime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike;
2.1	Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, formave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve;
2.2	Zbaton shprehi të arsyetimit për të bërë hamendësime;
2.3	Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët;
3.1	Përdor gjuhën natyrore dhe simbolet e thjeshta matematikore për marrjen dhe interpretimin e informacioneve, për përshkrimin e fakteve të thjeshta dhe veprimeve matematikore;
3.2	Ndërton struktura themelore të përshtatshme për matematikën duke grumbulluar informacione nga shkolla dhe mjedisi jashtë shkollor;
3.3	Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme;
3.4	Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme;
3.5	Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me mjete konkrete, lëvizje fizike, vizatime, numra, simbole dhe i zbaton në zgjidhje problemash;
3.6	Demonstron të menduar të pavarur dhe shprehi pune;
4.1	Bën lidhje të thjeshta mes numërimit dhe koncepteve themelore të gjeometrisë dhe të matjeve;
4.2	Bën lidhje ndërmjet njohurive dhe shprehive matematikore me situata nga jeta e përditshme;
5.1	Paraqet numrat, format dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
6.1	Identifikon vetitë e figurave dhe formave të objekteve të ndryshme;
6.2	Klasifikon figurat dhe objektet sipas vetive;
6.3	Krijon modele të thjeshta duke përdorur numrat dyshifrorë, forma dhe objekte nga klasa dhe nga jeta e përditshme;
6.4	Paraqet numrat, figurat dhe konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete;
7.1	Ndërton strukturat themelore relevante për matematikën duke filluar nga grumbullimi i informatave nga shkolla dhe nga mjedisi jashtëshkollor;
8.1	Përdor mjete të thjeshta për kalkulime dhe matje në mënyrë që të zgjidhë probleme të ndryshme matematikore;
8.2	Përdor kalkulatorin për të verifikuar saktësinë e zgjidhjes së problemit.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Numrat natyrorë **Figurat gjeometrike** **Modelet** **Puna me të dhëna** **Probabiliteti** **Trupat gjeometrik**	- Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50); - Shumëfishon numrat njëshifrorë dhe krijon vargje numerike (≤ 50); - Identifikon në shprehje; faktorët, prodhimin, të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin e numrave natyrorë deri 100; - Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50); - Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime); - Përdor vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave; - Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave, si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri 100; - Emërton figurat gjeometrike , siç është katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi; - Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit; - Vizaton figura të ndryshme gjeometrike; - Krahason figurat gjeometrike,	140. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 70 141. Shoqërimi i faktorëve (vetitë e shumëzimit) – faqe 71 142. Radha e veprimeve + dhe · – faqe 72 143. Ushtrojmë – faqe 73 144. Shumëzimi i shumës – faqe 74, 75 145. Shumëzimi i ndryshimit – faqe 76 146. Ushtrojmë – faqe 77, 78 147. Ushtrojmë – faqe 79, 80 148. Zbatojmë – faqe 81 149. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 82, 83 150. Disa lloje të figurave gjeometrike – faqe 84, 85 151. Drejtkëndëshi dhe sipërfaqja drejtkëndëshe – faqe 86 152. Katrori dhe sipërfaqja katrore – faqe 87 153. Ushtrojmë – faqe 88, 89 154. Trekëndëshi dhe sipërfaqja trekëndëshe – faqe 90 155. Rrethi dhe sipërfaqja rrethore – faqe 91 156. Ushtrojmë – faqe 92 157. Perimetri – faqe 93, 94 158. Pozitat e pikës – faqe 95 159. Llogaritja e sipërfaqes katrore – faqe 96	46	Bashkëbisedimi Ilustrimi Demonstrimi Lojëra matematikore Puna e pavarur Të nxënit në bashkëpunim Mësimdhënia e ndërsjellë Situata problemore	Lista kontrolli Vlerësim i ndërsjellë Informata kthyese Semafori Dy yje një dëshirë Portofolio e nxënësit	Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkencat e natyrës Shoqëria dhe mjedisi Jeta dhe puna	"Matematika 2b", shtëpia botuese "Dukagjini"

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
	- Gjen shumën e brinjëve të katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit; - Dallon objekte që asociojnë me katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin dhe rrethin; - Dallon gjysmën e numrave çift; - Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë; - Tregon shembuj nga jeta për gjysmën dhe çerekun dhe bën lidhjen me pjesëtimin; - Zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta. - Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida); - Gjen faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë; - Krahason trupat gjeometrikë (përmasat e tyre); - Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë; - Tregon dallimet ndërmjet trupave gjeometrikë (me qoshe dhe të rrumbullak). - Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe paraqet në tabelë; - Analizon të dhënat e grumbulluara nga tabela dhe i paraqet në grafik; - Interpreton të dhënat e grumbulluara dhe i krahason ato; - Përdor piktogramet.	160. Pjesëtimi si zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë – faqe 97 161. Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit – faqe 98 162. Ushtrojmë – faqe 99, 100 163. Ushtrojmë – faqe 101, 102 164. Përsërisim – faqe 103, 104 165. Kuptimet: për sa më i vogël dhe sa herë më i vogël – faqe 105 166. Gjysma dhe çereku – faqe 106 167. Ushtrojmë – faqe 107, 108 168. Numri 1 dhe 0 në pjesëtim – faqe 109 169. Ushtrojmë – faqe 110 170. Radha e veprimeve – faqe 111 171. Ushtrojmë – faqe 112 172. Zbatojmë – faqe 113, 114 173. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 115, 116 174. Shprehjet shkronjore – faqe 117 175. Barazimet me shumëzim dhe pjesëtim – faqe 118, 119 176. Ushtrojmë – faqe 120 177. Kubi dhe kuboidi – faqe 121					

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
		178. Ushtrojmë – faqe 122 179. Piramida, koni, sfera dhe cilindri – faqe 123, 124 180. Edhe matematika është zbavitje – faqe 125 181. Grumbullimi dhe paraqitja e të dhënave – faqe 126, 127, 128 182. Ushtrojmë – faqe 129, 130 183. Probabiliteti – faqe 131, 132 184. Përsërisim – faqe 133, 134 185. Vlerësojmë të kuptuarit – faqe 135, 136					

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Njohuri për numrat deri në 20

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Lexon numrat deri në 20;
- Shkruan numrat deri në 20.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletëza enigmë (puzzle).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Klasa ndahet në katër ose pesë grupe me numër të barabartë të nxënësve. Atyre u shpërndahen fletëzat enigmatike, të përgatitura më parë, me numrat nga 1 - 20. Nxënësit udhëzohen që në grup të bëjnë renditjen e numrave nga 1 - 20.



Hapi 2: Në vazhdim nxënësit udhëzohen të hapin librat në faqen 5 dhe u kërkohet të lexojnë numrat e dhënë. Pyeten ata:

- Sa katrorë e formojnë numrin 1?
- Po numrin 2, 3… 20?

Pas diskutimeve, nxënësve u sqarohet në tabelë vendvlera e njësheve dhe dhjetësheve te numrat 11-20. Po ashtu, tregohet se 10 Nj = 1 Dh, 2 Dh = 20 Nj dhe 2 Dh = 20.

Më pas, nxënësit i punojnë individualisht detyrat e dhëna në tekst, sipas udhëzimeve të marra paraprakisht nga mësuesja.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen që në fletoret e tyre të shkruajnë numrat nga 1 - 20.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e të lexuarit dhe të shkruarit të numrave deri në 20.

Detyrë:

Modelimi i tre numrave nga 1 - 20, duke përdorur forma dhe materiale të ndryshme në shtëpi ose në natyrë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Lexon dhe shkruan numrat nga 1 deri në 20;
- Identifikon numrat çift dhe tek nga 1 deri në 20.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III. 2, V.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Leximi i numrave deri në 20. Numrat çift dhe numrat tek

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Lexon numrat nga 1 deri në 20 dhe anasjellas;
- Dallon numrat çift dhe tek;
- Klasifikon numrat çift dhe tek.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra deri në 20, objekte të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahet nga një etiketë që mban një numër të caktuar nga 1 deri në 20. Kërkohet prej tyre ta lexojnë numrin që kanë në etiketë dhe të renditen sipas numrit që kanë.



Hapi 2: Nga nxënësit që e kanë numrin çift, kërkohet të lëvizin një hap para, kurse nga nxënësit që kanë numrin tek, të lëvizin dy hapa para. Ndërkohë ata pyeten:

- Përse lëvizët?
- Kur është një numër tek? Po çift?

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen ta vëzhgojnë figurën në detyrën 1 dhe t'i lexojnë:

- numrat nga 1 deri në 20;
- numrat nga 20 deri në 1;
- numrat e shkruar (me zë) në rrathët e kaltër;
- numrat e shkruar (me zë) në rrathët e klatër.

Hapi 4: Nga nxënësit kërkohet të plotësojnë vargun e numrave çift dhe vargun e numrave tek, duke njehsuar +2.

Hapi 5: Nxënësit i plotësojnë katrorët me numra që ndodhen në mes të numrave: 8 dhe 15; 11 dhe 19; 14 dhe 20.

Hapi 6: Nxënësit udhëzohen t'i vëzhgojnë numrat dhe të bëjnë në njëshe njëshe dhe dhjetëshe duke i plotësuar figurat e paraqitura.

Hapi 7: Nga nxënësit kërkohet të klasifikojnë numrat çift dhe tek si në figurë.

VEPRIMTARI SHTESË

Nxënësit gjejnë objekte në klasë që janë në numër çift dhe tek.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit dhe klasifikimit të numrave çift dhe tek.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 3

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Krahason numrat natyrorë;
- Cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.1, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Krahasimi i numrave. Paraardhësi dhe pasardhësi



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen paraardhësin dhe pasardhësin e numrave të dhënë;
- Krahason numrat 1 deri 20;
- Dallon se për sa është një numër më i madh a më i vogël se numri tjetër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet në tabelë etiketa me numrin 8.
Elina ka ditëlindjen.

- Sa vjet i bën Elina?
- Sa vjet kishte vitin e kaluar?
- Sa vjet do t'i bëjë vitin e ardhshëm?
- Vëllai i Elinës ka 11 vjet. Cili është më i madh? (11 > 8);
- Cili është më i vogël? (8 < 11);
- Për sa është më i madh vëllai i Elinës se Elina? (3 vjet);
- Po ti, sa vjet i ke? Je më i madh, më i vogël apo e ke moshën e njëjtë me Elinën? (8 = 8, 7 < 8, 9 > 8).



Hapi 2: Nxënësit udhëhiqen t'i vëzhgojnë figurat e paraqitura dhe t'i shqyrtojnë kërkesat e detyrave.

Detyra 1 – Lexohen dhe krahasohen numrat e dhënë 15 > 12, 17 = 17 dhe 14 < 18.
Detyra 2 – Nxënësit vendosin njërën nga shenjat <, =, > te detyra e dhënë.
Detyra 3 – Nxënësit gjejnë paraardhësin dhe pasardhësin e numrave të dhënë.

Hapi 3: Detyra 3 – Ta plotësojmë tabelën. Nxënësit gjejnë paraardhësin dhe pasardhësin e numrave të dhënë.

paraardhësi	numri	pasardhësi
14	15	16
16	17	18
9	10	11
17	18	19
13	14	15
12	13	14

Hapi 4: Shkruaj 3 numra. Gjej paraardhësin dhe pasardhësin e tyre.

Vendos shenjën <, =, >.
11 ___ 14 9 ___ 6 12 ___ 15

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e paraardhësit dhe pasardhësit të numrave dhe krahasimin e tyre.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 8).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 4

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 20

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 20.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Me nxënësit zhvillohet lojë matematikore. U përcaktohet nga një numër prej 1-10 dhe u vendoset në krah me letërngjitëse. Secili nxënës duhet të ketë nga një numër.
Nxënësit udhëzohen që të lëvizin në klasë. Në tabelë paraqitet një numër dyshifror. Kërkohet prej tyre që, kur ta shikojnë në tabelë numrin, të bashkohen nga dy për të dhënë shumën në bazë të numrit që shikojnë. P.sh., nëse shikojnë numrin 10, bashkohen nxënësit që kanë numrin 4 dhe 6; 7 dhe 3 etj.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurën në detyrën 1. Shtrohen pyetjet:
- Sa rrethorë të kuq janë në figurë?
- Po rrethorë të verdhë?
- Sa është shuma e të gjithë rrethorëve?
- Sa rrethorë të gjelbër janë gjithsej?
- Sa rrethorë janë larguar?
- Sa rrethorë kanë mbetur?

Nxënësve u kërkohet të shkruajnë barazimet për dy figurat në detyrën 1.



5 Njehsojmë dhe plotësojmë:

4 + ☐ = 11 ☐ + 4 = 14 ☐ + 2 = 17
8 + ☐ = 18 ☐ + 8 = 11 12 + ☐ = 15
5 + ☐ = 13 ☐ + 9 = 17 13 + ☐ = 16
7 + ☐ = 14 ☐ + 3 = 12 ☐ + 4 = 19

6 Në festën për ditëlindjen e Norës morën pjesë 19 nxënës nga shkolla e saj. Prej tyre 12 ishin vajza. Sa djem ishin për ditëlindjen e Norës?

Njehsojmë: ___ – ___ = ___.

Pra, për ditëlindjen e Norës ishin ___ djem.

7 Në një pemë ishin 9 zogj. Pas pak erdhën edhe 6 dhe ikën 4 zogj. Sa zogj mbetën në pemë?

Njehsojmë: ___ + ___ – ___ = ___ – ___ = ___.

Pra, në pemë mbetën ___ zogj.

8 Duke njehsuar, plotësojmë:

15 + 1 = 16 15 – 2 = ☐ 12 + 6 = ☐
16 – 3 = 13 ☐ + 4 = ☐ ☐ – 5 = ☐
13 + 5 = 18 ☐ – 6 = ☐ ☐ + 6 = ☐
18 – 7 = 11 ☐ + 8 = ☐ ☐ – 5 = ☐
11 + 9 = 20 ☐ – 9 = ☐ ☐ + 6 = ☐

9 Njehsojmë dhe barazitë e fituara i interpretojmë në boshtin numerik.

14 + 5 = ☐ 19 – 11 = ☐

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19

PËRSËRISIM

10

Hapi 3: Bisedohet me nxënësit rreth figurës së paraqitur në detyrën 2. Pyetjet bëhen për nu-mrin e rrethorëve në figurë. Sqarohet një shembull nga detyra 2 i njehsimit të shumës:
3+2=5 dhe 13+2 =15.

Në mënyrë të njëjtë vijon bashkëbisedimi me nxënësit rreth figurës së paraqitur në detyrën 3 dhe sqarohet një shembull i njehsimit të ndryshimit:
3-2=1 dhe 13-2=11.

U kërkohet që në mënyrë të pavarur të vazhdojnë të njehsojnë shumën dhe ndryshimin e numrave në shembujt nga detyrat 2 dhe 3.

Hapi 4: Plotësohet detyra e pestë në libër. Diskutohet me nxënësit kjo pyetje:
Si mund ta gjejmë mbledhorin që mungon?
4 + __ = 11 __ + 4 = 14.
Paqartësitë sqarohen me nxënësit. Në formë të njëjtë plotësohen edhe detyrat e njëjta.

Hapi 5: Së bashku me nxënësit, zgjidhen detyrat 6 dhe 7.
Lexohet teksti. Më pas, përgjigjen në këto pyetje:

- Sa nxënës ishin në festën e ditëlindjes së Norës? (19);
- Po vajza, sa ishin? (12);
- Sa djem ishin? (7) - (19-12=7);
- Sa zogj ishin në pemë? (9);
- Sa zogj erdhën? (6);
- Sa zogj shkuan? (4);
- Sa zogj mbetën? (11)-(9+6-4=15-4=11).

Hapi 6: Jepet sqarimi për zgjidhjen e detyrës 8 dhe kërkohet nga nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur.

Hapi 7: Nxënësve u caktohet nga një etiketë ku është shënuar një numër (p.sh., 5, 8, 10 etj.). Nxënësit udhëzohen që, sipas numrit të caktuar në etiketë, të gjejnë dhe të shkruajnë barazime të mbledhjes dhe të zbritjes, shuma apo ndry-shimi i të cilave barazime paraqet numrin në etiketën e dhënë. Nëse numri i përcaktuar është 8, disa barazime të mundshme mund të jenë: 4+4=8; 10-2=8; 18-10=8.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shumës dhe ndryshimit të numrave deri në 20.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 9), detyra 9 (faqe 10).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 5

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Mbledhja e numrave duke plotësuar 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Shpjegon zgjidhjen e detyrave me veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë pune, tabelë me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Secila dyshe nxënësish ka tabelën me 10 numra. Në dyshe udhëzohen të qarkojnë dy numra që kanë shumën 10. Nxënësit nxiten që të gjejnë sa më shumë barazime, rezultati i të cilave është 10. Këta numra shkruhen në tabelë.





Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë shumën e numrave duke plotësuar 10, në detyrën e parë në faqen 11.

Drejtohen pyetjet:

- Cilët janë mbledhorët?
- Cili është mbledhori i parë?
- Cili është mbledhori i dytë?
- Sa duhet të shtoni në numrin 9 që të bëhen 10?
- Sa duhet të shtoni në numrin 8 që të bëhen 10?

Pas përgjigjeve të marra dhe diskutimeve, nxënësit vazhdojnë me punë të pavarur individuale me detyrat dy dhe tre.

Paraprakisht shpjegohet se detyrat njehsohen duke ndarë mbledhorin e dytë në dy mbledhorë, njëri prej të cilëve formon dhjetëshen me mbledhorin e parë (8+5=8+2+3) dhe më pas gjejmë shumën (8+2+3=13).

Hapi 3: Në fazën e fundit të orës mësimore, nxënësit shkëmbejnë librat me detyrat e përfunduara. Dyshet e nxënësve diskutojnë detyrat e zgjidhura dhe më pas i krahasojnë rezultatet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit e shumës dhe të ndryshimit të numrave, si dhe për shpjegimin e zgjidhjes së detyrave.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 11).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përcakton zbritësin dhe ndryshimin e numrave nga 1 deri në 20;
- Kryen veprimin e zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1, 4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave duke veçuar 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson ndryshimin e numrave duke veçuar 10.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa dhe kubëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen etiketa: grupit të parë 16 etiketa, të dytit 19 të tilla, grupit të tretë 12 etiketa dhe kështu vazhdohet varësisht nga numri i grupeve që janë në klasë.

Numri i etiketave për grup duhet të jetë nga 11 deri në 19. Nga nxënësit kërkohet të veçojnë etiketat dhe të mbesin nga 10 etiketa në secilin grup.

Diskutohet me nxënësit përgjigjja e pyetjes:
Si e keni bërë ndarjen e etiketave?



Hapi 2: Nga nxënësit kërkohet të plotësojnë detyrën 1 në tekst, duke veçuar numrin 10 nga numri i dhënë.

Hapi 3: Udhëzohen të njehsojnë detyrat duke veçuar numrin 10 dhe pyeten:

- Cili është i zbritshmi?
- Cili është zbritësi?
- Sa duhet veçuar nga numri 12 që të mbesin 10?
- Nga cili numër marrim 2 që të veçojmë numrin 10?
- Sa ka mbetur tani zbritësi?
- Gjeni ndryshimin 10-5?

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe me dy detyrat e tjera.

Hapi 4: Nga nxënësit kërkohet të njehsojnë detyrat duke veçuar numrin 10 dhe të lexojnë barazimet.

15 - 6
15 - 5 - 1 =

Hapi 5: Udhëzohen të plotësojnë drejtkëndëshat e zbrazët në detyrën e fundit në mënyrë që të përftojnë barazime të sakta.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të ndryshimit të numrave duke veçuar 10.

Detyrë:
Të shkruajë tri barazime me zbritjen e numrave duke veçuar 10.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 7

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Zbritja e numrave duke veçuar 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave duke veçuar 10;
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave 1 deri në 20.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra nga 11 deri 20.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me numrat nga 11 – 20, të përziera, jo me renditje.
Nxënësit pyeten:
Sa duhet zbritur nga numri në etiketë që të përftojmë ndryshimin 10?
(19 – 9 = 10, 18 – 8 =10, 17 – 7 = 10, 16 – 6 = 10, 15 – 5 = 10 ...)

Hapi 2: *Detyra 1* – Nxënësit udhëzohen që ta shikojnë mënyrën e zgjidhjes së barazimit:
15 – 8 = 7 ose 15 – 5 – 3 = 7.
Njëjtë veprohet edhe me dy barazimet e tjera:
18 – 9 = 9 ose 18 – 8 – 1 = 9; 13 – 5 = 8 ose 13 – 3 – 2 = 8.



Detyrat 2 dhe 3 – Njehso ndryshimin e numrave duke veçuar 10.

13 – 3 – 6 = 4	18 – 3 – 8 = 7	11 – 2 – 1 = 8
14 – 3 – 4 = 7	12 – 2 – 5 = 10	19 – 9 – 7 = 3

Detyra 4 – Njehso ndryshimin e numrave në tabelë.

Detyra 5 – Njehso shumën dhe ndryshimin e numrave.
Rezultatet e barabarta ngjyrosi me ngjyrë të njëjtë.
(12 – 8 = 13 – 9; 4 + 7 = 6 + 5; 13 – 5 = 11 – 3; 9 + 5 = 7 + 7).

Hapi 3: Nxënësit ndahen në pesë grupe, ku do të punojnë detyrën 3, në faqen 14.
Detyra mund të punohet në libër, ose të përgatitet në fletë për secilin grup.

Grupi I – Shuma 15 (2 + 10 + 3; 3 + 11 + 1; 1 + 12 + 2);

Grupi II – Shuma 20 (4 + 11 + 5; 5 + 12 + 3; 3 + 13 + 4);

Grupi III – Shuma 19 (9 + 2 + 8; 8 + 4 + 7; 7 + 3 + 9);

Grupi IV – Shuma 15 (4 + 3 + 8; 8 + 2 + 5; 5 + 6 + 4);

Grupi V – Shuma 12 (3 + 2 + 7; 7 + 1 + 4; 4 + 5 + 3).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e llogaritjes së shumës dhe të ndryshimit të numrave.

Detyrë:
Detyrat 1 dhe 2 (faqe 14).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 8

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprime të mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 20;
- Identifikon numrat që mungojnë në barazime;
- Llogarit rezultatet e detyrave me dy veprime;
- Ngjyros figurën sipas numrave të identifikuar.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten në projektor ose në tabelë barazime të mbledhjes në të cilat mungon njëri nga mbledhorët, si dhe barazime të zbritjes ku mungon i zbritshmi ose zbritësi.

Nga nxënësit kërkohet të gjejnë numrin që mungon.
Disa nga barazimet që mund të paraqiten: __ + 3=16; 14-__= 10...

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen ta plotësojnë detyrën 1 (faqe 15) duke njehsuar shumën dhe ndryshimin, duke gjetur mbledhorin dhe të zbritshmin që mungon.



Hapi 3:
Detyra 2 (faqe 15) - Nxënësit udhëzohen të njehsojnë duke përdorur dy veprime: mbledhjen dhe zbritjen.

Detyra 3 (faqe 15) – Kërkohet të gjejnë numrin që mungon për të dhënë shumën ose ndryshimin e përcaktuar.

14+3=17
19-2=17
11+6=17

Detyra 1 (faqe 16) - Nxënësit udhëzohen të analizojnë modelin e dhënë në libër dhe të plotësojnë sipas modelit: 2 më shumë; 3 më shumë; 3 më pak.

Detyra 2 (faqe 16) - Nxënësit njehsojnë detyra me dy veprime:

19+1-9 = 11

Hapi 4: Nxënësit plotësojnë të pavarur.

Detyra 4 (faqe 15) Njehso shumën dhe ndryshimin e numrave, gjej mbledhorin dhe zbritësin që mungon.

Në bazë të rezultateve ngjyrosin figurën e dhënë në detyrë.

Detyra 3 (faqe 16) - Njehso shumën duke plotësuar 10.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës, ndryshimit, gjetjen e numrit që mungon dhe estetikën në ngjyrosje.

Detyrë:
Plotësohen detyrat në faqen 17.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 9

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Orientimi

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton vendin e objekteve, poshtë, lart, majtas, djathtas.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, 7, II.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1, 3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Orientimi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton pozicionin e objekteve lart, poshtë, majtas, djathtas;
- Përdor shprehjet majtas, djathas, lart, poshtë.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen fletët e përgatitura, ku në mes është paraqitur një bankë. Udhëzohen të vizatojnë:
- një rreth në anën e djathtë të bankës;
- një katror në anën e majtë të bankës;
- një lule mbi (lart) bankë;
- një laps poshtë bankës.

Hapi 2: Detyra 1 punohet së bashku me nxënësit. Jepen sqarime si duhet ta gjejnë dreri dhe lepuri ushqimin.



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 2 duke e ndihmuar Altinin të arrijë deri te topi.

Sqarohet drejtimi i shigjetave: lart ⇧, poshtë ⇩, majtas ⇦, djathtas ⇨ .
Numri 2 ⇨ tregon që duhet të bëhen 2 lëvizje në anën e djathtë, 1 ⇧ tregon që duhet të bëhet një lëvizje lart etj.

Hapi 4: Nxënësit punojnë të pavarur detyrat 3, 4, 5 dhe 6.
Ata u përgjigjen pyetjeve lidhur me detyrat, për të kuptuar më mirë kahjet e lëvizjes.

Hapi 5: Disa nxënës rreshtohen para tabelës dhe udhëzohen që të shikojnë fletët e përgatitura nga mësimdhënësi, ku janë vizatuar drejtimet e shigjetave. (⇩, ⇦ , → , ↑).

Në momentin që fletëza ngrihet lart, nxënësit duhet të fillojnë të lëvizin. Veprimtaria vazhdon edhe me grupet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e përcaktimit të pozicioneve të objektit.

Detyrë:
Përshkruan rrugën nga shkolla për në shtëpi, duke përdorur kahjet e lëvizjes.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 10

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton radhën (numri rendor).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.4, III.2, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 4, 4.2, 5.1, 6.2, 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton radhën e objekteve.
- Radhit objektet sipas lartësisë.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit ftohen të bëjnë rreshtin sipas radhës alfabetike. (p.sh. Arbëri, Blendi, Diella, Era). Më pas, parashtrohen pyetjet:
Cili është i pari?
I sati është Blendi?
E sata është Era?
Parashtrohen disa pyetje, duke u fokusuar te numrat: i pari, i dyti, i treti, i katërti, i pesti, i gjashti, i shtati, i teti, i nënti, i dhjeti.



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të lexojnë numrat rendorë të dhënë në detyrën 1.

Detyra 2: Duke analizuar fotografinë e dhënë në libër, plotësohen fjalitë.
(i pari – tigri; i dyti – njeriu; i treti – lepuri; e katërta – breshka)

Detyra 3: Objektet e dhëna të trashëgimisë botërore radhiten sipas lartësisë.

Hapi 3: Në tabelë vendosen figura të ndryshme gjeometrike.

Nxënësit plotësojnë fjalitë:
Katrori i gjelbër është *i nënti.*
Trekëndëshi i kuq është *i dyti.*
Rrethi i kaltër është *i pesti.*

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e radhës së objekteve dhe radhitjen e objekteve sipas lartësisë.

Detyrë:
Vizaton pesë kafshë dhe i radhit ato sipas lartësisë (e para, e dyta, e treta, e katërta, e pesta).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 11

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull objektesh.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, III.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Grupimi i elementeve në bashkësi sipas vetive

BASHKËSITË

1 Le t'i analizojmë vetitë e objekteve (elementeve) të dhëna.

Objektet e dhëna i grumbullojmë sipas një vetie të përbashkët të tyre. Përshkruajmë këtë veti.

fruta | pajisje për kuzhinë | lloj peshku

mjete mësimore | lule | mjete trafiku

Bashkësia formohet nga një grumbull i objekteve me veti të përbashkëta. Objektet që e formojnë bashkësinë quhen elemente të bashkësisë.

GRUPIMI I ELEMENTEVE NË BASHKËSI SIPAS VETIVE

MËSOJMË

21

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vetinë e përbashkët të elementeve të bashkësive;
- Formon bashkësi bazuar në veti të përbashkëta të elementeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe) Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Karriget në klasë vendosen në formë rrethore. Numri i tyre është një më pak sesa numri i nxënësve të pranishëm në klasë, në mënyrë që nxënësi që ngelet në këmbë të thotë një veti të përbashkët, e cila vlen për disa nxënës apo për tërë nxënësit që qëndrojnë ulur në karriget e vendosura. Nxënësi që qëndron në këmbë mund të kërkojë, për shembull, që, nxënësit që kanë të veshur diçka të bardhë të lëvizin në një karrige tjetër; ose nxënësit, emri i të cilëve fillon me shkronjën A, të lëvizin në një karrige tjetër. Andaj, nxënësi që ka një veti të caktuar duhet të lëvizë dhe të gjejë një karrige tjetër.
Kësisoj, edhe nxënësi që qëndron në mes përpiqet të zërë një karrige, pra përsëri do të ketë nxënës të rinj në mes. Loja zgjat gjersa të përmenden 4-5 veti, me anë të të cilave formohen bashkësi. Në fund diskutohet mënyra e formimit të këtyre bashkësive.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen që të vështrojnë elementet e dhëna në faqen 20 të librit. Së bashku diskutohet për grumbullimin e këtyre elementeve në disa grupe, duke ardhur kështu në përfundim se elementet

BASHKËSITË

GRUPIMI I ELEMENTEVE NË BASHKËSI SIPAS VETIVE

MËSOJMË

1 Le t'i analizojmë vetitë e objekteve (elementeve) të dhëna.

Objektet e dhëna i grumbullojmë sipas një vetie të përbashkët të tyre. Përshkruajmë këtë veti.

fruta | pajisje për kuzhinë | lloj peshku

mjete mësimore | lule | mjete trafiku

Bashkësia formohet nga një grumbull i objekteve me veti të përbashkëta. Objektet që e formojnë bashkësinë quhen elemente të bashkësisë.

21

janë grumbulluar sipas një vetie të përbashkët, me ç'rast kanë formuar bashkësi. Pastaj u sqarohet nxënësve se çfarë është bashkësia dhe çfarë janë elementet e bashkësisë. Kërkohet nga ta të gjejnë shembuj të bashkësive nga jeta e përditshme dhe bashkësi të objekteve të ndryshme në klasë.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të paraqesin në fletore nga një bashkësi me elemente dhe të tregojnë vetinë e përbashkët të elementeve. Në përfundim të punës, diskutohen në nivel klase bashkësitë e formuara nga nxënësit në mënyrë individuale.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në formimin e bashkësive, bazuar në veti të përbashkëta të elementeve të tyre.

Detyrë:
Formon tri bashkësi sipas një vetie të përbashkët të tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 12

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përshkruan bashkësinë si një grumbull elementesh që mund të jenë afër/larg njëri-tjetrit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, 6; III.1, 2; V. 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 4.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Grumbullon elementet sipas një vetie të përbashkët;
- Përshkruan vetinë e përbashkët të elementeve;
- Krijon bashkësi me elemente sipas një vetie të përbashkët.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shkronja të prera, pemë, perime, shporta, petëza, figura gjeometrike etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Njeriu dhe natyra, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Para nxënësve paraqiten disa shkronja të prera, të cilat duhet të grumbullohen në dy bashkësi (shkronja njëshe dhe dyshe).
Diskutohet bashkërisht.

- Si formohet bashkësia?
- Po elementet që e formojnë bashkësinë, si quhen?
- Çfarë kanë të përbashkëta elementet e paraqitura?
- A mund të bëjmë grupime të tjera me elementet e këtyre bashkësive?



Hapi 2: Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë në detyrën e parë në libër.

Po ashtu, ata marrin pemë dhe perime të stinës, të cilat duhet t'i ndajnë në dy shporta (në shportën e parë pemët dhe në shportën e dytë perimet), duke i grupuar ato sipas vetive të përbashkëta të tyre.

Hapi 3: Japin përgjigje për këto pyetje:

- Pse janë të rëndësishme pemët dhe perimet?
- Si janë grupuar ato?
- Çfarë kanë të përbashkët elementet e shportës së parë?
- Po ato në shportën e dytë?

Hapi 4: Nxënësit, të ndarë në grupe, udhëzohen të krijojnë bashkësi të ndryshme sipas një vetie të përbashkët të tyre. Për secilën bashkësi të krijuar, përshkruajnë vetinë e përbashkët.

VEPRIMTARI SHTESË

Nxënësve u shpërndahen materiale të ndryshme: petëza, kapakë plastike, figura gjeometrike, mjete mësimore dhe u kërkohet të formojnë bashkësi me elemente sipas një vetie të përbashkët.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në grumbullimin e bashkësive sipas një vetie të përbashkët.

Detyrë:

Krijo një bashkësi sipas një vetie të përbashkët.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 13

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Identifikon objektet që janë brenda ose jashtë bashkësisë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Elementet e bashkësive

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon elementet që i takojnë dhe nuk i takojnë bashkësisë;
- Shkruan elementet që i takojnë bashkësisë dhe nuk i takojnë bashkësisë.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me shkronja, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë vendosen etiketa me shkronjat B, I, E, A, L, F, M, N. Nxënësit pyeten:
- Sa shkronja janë në tabelë?
- A mund të formojmë fjalë me to? Cilat?
- Cilat shkronja nevojiten për ta shkruar emrin ELINA?
- Cilat shkronja nuk nevojiten për ta shkruar emrin ELINA?

Shkronjat e duhura për ta shkruar emrin ELINA vendosen brenda diagramit, të tjerat vendosen jashtë diagramit.



Hapi 2: Nxënësit lexojnë kërkesat e detyrave 1 dhe 2 dhe plotësojnë ato.
Detyra 1: Ngjyros elementet që i takojnë bashkësisë dhe ngjyros elementet që nuk i takojnë bashkësisë.
- Cilat figura gjeometrike janë brenda vijës së kuqe/të kaltër?
- Cilat figura gjeometrike janë jashtë vijës së kuqe/të kaltër?

Detyra 2: Shqyrtohen diagramet e dhëna, përcaktohen dhe shkruhen elementet që i takojnë bashkësisë



A dhe elementet që nuk i takojnë bashkësisë A.

- Cilat janë elementet që i takojnë bashkësisë A?
- Cilat janë elementet që nuk i takojnë bashkësisë A?

Njëjtë veprohet edhe me bashkësinë B.

Hapi 3: Nxënësve u shpërndahen fletë me detyrën e dhënë (apo shënohet në tabelë). Detyra punohet në mënyrë individuale.

	Shkruaj elementet e bashkësisë	Shkruaj elementet që nuk janë pjesë e bashkësisë
12  18 4 2 15	N = { _____ }	_____

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e elementeve që i takojnë një bashkësie.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 23).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 14

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Paraqet bashkësinë përmes Diagramit të Venit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.4, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 6.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Paraqitja e bashkësive me anë të diagramit



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Formon bashkësi me elemente që kanë veti të përbashkëta;
- Përdor diagramin për të formuar bashkësi.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Spango.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahet nga një fije spango ose peri dhe u kërkohet që të formojnë brenda spangos një bashkësi me elemente që kanë një veti të përbashkët (fletore, libra, ngjyra...).

Nxënësve u parashtrohen pyetje:

- Çfarë bashkësi krijove? (p.sh. bashkësia e librave, e fletoreve etj.)
- Cila është vetia e përbashkët e elementeve të bashkësisë? (p.sh. fletore me vija, me katrorë etj.)

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen që të vëzhgojnë detyrën 1.

Nxënësit pyeten:
- Cilat janë figurat e dhëna?

1 Duke i grumbulluar (me anën e diagramit) elementet e njëjta, formojmë bashkësi. Elementet e bashkësive i ngjyrosim me ngjyrat që u përgjigjen.



2 Me anën e diagramit formojmë bashkësinë e katrorëve të kuq dhe bashkësinë e katrorëve të kaltër.



- Si mund t'i grupojmë ato?
- Sa bashkësi me elemente të njëjta formohen?

Detyra 2 – Nxënësit pyeten:
- Cila figurë gjeometrike është dhënë?
- Çfarë ngjyra kanë katrorët?
- Sa bashkësi mund të formohen nëse i ndajmë sipas ngjyrave?

Hapi 3: Nxënësit në mënyrë individuale paraqesin në fletore dy bashkësi me anë të diagramit – bashkësinë e numrave tek dhe bashkësinë e zanoreve.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e paraqitjes së bashkësive me diagram.

Detyrë:
Paraqit me diagram dy bashkësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 15

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Krahason bashkësitë sipas numrit të elementeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II1.2.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Krahasimi i bashkësive sipas numrit të elementeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon bashkësinë dhe elementet përbërëse;
- Gjen se cila bashkësi ka më shumë dhe më pak;
- Krijon bashkësi dhe bën krahasimin mes tyre.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë muzikore, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Pasi u tregohet nxënësve grumbulli i lapsave, diskutohet me ata rreth këtyre pyetjeve:

1. Çka quajmë bashkësi?
2. Si quhen objektet që e formojnë bashkësinë? (Objektet që e formojnë bashkësinë quhen elemente.) Me çka i emërtojmë bashkësitë? (Bashkësitë i emërtojmë me shkronja të mëdha të shtypit.)

Në tabelë vizatohet një bashkësi dhe shtrohet pyetja:
3. Si quhet vija që e rrethon bashkësinë? (Vija që e rrethon bashkësinë quhet Diagram i Venit.)

Hapi 2: Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë në libër, detyrën 1. Japin përgjigje për këto pyetje:



1. Sa kompjutera janë në bashkësinë e parë?
2. Sa nxënës janë në bashkësinë e dytë?
3. Çfarë ka më shumë (kompjutera apo nxënës)?
4. Çfarë ka më pak (nxënës apo kompjutera)?

Nxënësit punojnë të pavarur, në libër, detyrën 3.

1. Cilën bashkësi e tregon ngjyra e kuqe?
2. Cilën bashkësi e tregon ngjyra e kaltër?
3. Cilat janë elementet e bashkësisë A?
4. Cilat janë elementet e bashkësisë B?
5. Cila bashkësi ka më pak elemente (bashkësia A apo bashkësia B)?
6. Cila bashkësi ka më shumë elemente (bashkësia B apo bashkësia A)?

Nxënësit, të ndarë në grupe, udhëzohen të krijojnë nga dy bashkësi të ndryshme dhe të bëjnë krahasimin mes tyre (veglat muzikore, lojërat sportive, programet televizive etj).

Hapi 3: Pasi të jetë përfunduar puna në grupe, nxënësit paraqesin punën e dy bashkësive që ata kanë krijuar, analizojnë elementet që ndodhen brenda bashkësive dhe bëjnë krahasimin e tyre se cila bashkësi ka më shumë elemente dhe cila më pak.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e krahasimit të bashkësive.

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 25).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 16

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Gjen elementet e përbashkëta të bashkësive.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.3, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 2.1.


ELEMENTET E PËRBASHKËTA TË DY BASHKËSIVE

1 Shkruajmë elementet e bashkësisë A, ato të bashkësisë B si dhe elementet e përbashkëta të tyre.

- Elementet e bashkësisë A janë: ___, ___, ___, ___, ___ dhe ___.
- Elementet e bashkësisë B janë: ___, ___, ___, ___, ___ dhe ___.
- Elementet e bashkësisë C janë: ___, ___ dhe ___.

Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B janë: ___, ___ dhe ___.

2 T'i gjejmë elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B.

$A = \{__, __, __, __, __, __, __\}$.
$B = \{__, __, __, __, __, __\}$.
Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B janë: ___, ___, ___ dhe ___.

3 T'i shkruajmë elementet e përbashkëta të bashkësive:

$A = \{__, __, __, __, __, __, __\}$.
$B = \{__, __, __\}$.
Elementet e përbashkëta të bashkësive A dhe B janë: ___, ___ dhe ___.

$C = \{__, __, __, __, __, __, __\}$.
$D = \{__, __, __, __, __, __, __, __\}$.
Elementet e përbashkëta të bashkësive C dhe D janë: ___, ___, ___ dhe ___.

MËSOJMË

26

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Elementet e përbashkëta të dy bashkësive

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen elementet e përbashkëta të bashkësive të dhëna në libër;
- Shkruan elementet e përbashkëta të dy bashkësive.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Punë në dyshe
Nxënësit udhëzohen që në fletore të vizatojnë një diagram, brenda të cilit shkruajnë shkronjat e emrit të tyre. Pastaj me shokun/shoqen që kanë afër gjejnë shkronjat e përbashkëta të emrave të tyre.

Shembull:

Emrat Eliza dhe Mali kanë tri shkronja të përbashkëta, shkronjat L, I dhe A.

Pasi ta kenë përfunduar detyrën e dhënë, u bëhet me dije nxënësve se elementet e përbashkëta të këtyre bashkësive paraqesin prerjen e atyre dy bashkësive.

Hapi 2: Në saje të paraqitjeve vizuale në tekst të elementeve të përbashkëta të dy bashkësive të tjera, nxë-



nësve do t'u kërkohet që në mënyrë të pavarur dhe individuale të fillojnë plotësimin e kërkesës një në faqen 25. Nxënësit do të shkruajnë elementet e bashkësive A dhe B të dhëna dhe më pas gjejnë elementet e përbashkëta të tyre.

Tashmë kur janë qartësuar elementet e përbashkëta, nxënësit i udhëzojmë që të plotësojnë edhe kërkesat dy e tre në libër.

Detyrat e përfunduara diskutohen në klasë.

Hapi 3: Në mënyrë individuale, nxënësit udhëzohen të gjejnë dhe më pas të paraqesin në fletore nga dy shembuj të bashkësive që kanë elemente të pëbashkëta. Më pas, diskutohen ato.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit dhe shkrimit të elementeve të përbashkëta të bashkësive të dhëna.

Detyrë:
Gjej elementet e përbashkëta të emrave Shqipëria dhe Kosova.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 17

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Paraqet bashkësinë përmes Diagramit të Venit;
- Krijon bashkësi bazuar në cilësitë e objekteve (elementeve).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2, 6; III. 1, 2; IV. 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 2; 3. 5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Formon bashkësi me anë të diagramit;
- Tregon elementet e përbashkëta të dy bashkësive.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Objekte të ndryshme që gjenden në klasë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të formojnë dy bashkësi me materialet e tyre shkollore (lapsa, ngjyra, goma, kapakë plastike, fasule, shkopinj etj.) që kanë në klasë dhe të tregojnë elementet e përbashkëta të këtyre bashkësive.



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë elementet e dy bashkësive të paraqitura në detyrën 1 në libër dhe të shkruajnë elementet e bashkësisë A, të bashkësisë B dhe elementet e përbashkëta të dy bashkësive.

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të plotësojnë detyrën 3 duke shkruar elementet e përbashkëta të dy bashkësive.

Hapi 4: Nxënësit paraqesin në fletore dy bashkësi me anë të Diagramit të Venit dhe shkruajnë elementet e tyre të përbashkëta.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e paraqitjes së bashkësive me anë të diagramit dhe tregimin e elementeve të përbashkëta të dy bashkësive.

Detyrë:
Krijo dy bashkësi dhe gjej elementet e tyre të përbashkëta.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 18

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2, 6.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Formimi i bashkësisë nga dy bashkësi të dhëna

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon elementet e bashkësisë;
- Grupon elementet në bashkësi sipas një vetie;
- Formon një bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Lojë:
Nxënësit lëvizin në klasë dhe nën komandën e mësimdhënësit NDALO – ata duhet të ndalen në vend, LËVIZ – ata janë të lirë të lëvizin dhe GRUPOHU – mësimdhënësi zgjedh një veti të grupimit (sipas ngjyrës së veshjes: të kuqe, të bardhë, të kaltër...; sipas shkronjës së parë të emrit: A, E, M...; sipas numrit të shkronjave të emrit: 3, 4, 5 ..., sipas gjinisë: vajzë – djalë).
Të gjithë së bashku formojmë bashkësinë e klasës së parë.

Hapi 2: Detyra 1 – Nxënësit udhëzohen të vështrojnë figurën.

- Çfarë ka të paraqitur në figura?
- Sa ngjyra janë trekëndëshat?
- Sa bashkësi mund t'i formojmë? (2).



- Cilat bashkësi? (Bashkësia e trekëndëshave të kuq dhe bashkësia e trekëndëshave të kaltër);
- A mund të formojmë një bashkësi? Cilën? (Bashkësia e trekëndëshave).

Detyra 2 - Nxënësit udhëzohen të vështrojnë figurën. Pyeten:

- Cilat janë elementet e bashkësisë A?
- Cilat janë elementet e bashkësisë B?
- Formojmë një bashkësi të re, me elemente të bashkësive A dhe B (Bashkim i bashkësive A dhe B).

Hapi 3: Nxënësit në mënyrë të pavarur e plotësojnë detyrën 3, ku me elementet e bashkësisë A (figura gjeometrike me ngjyrë të kaltër) dhe me elementet e bashkësisë B (figura gjeometrike me ngjyrë të kuqe), formojnë bashkësi të re (figura gjeometrike me ngjyrë të kuqe dhe të kaltër).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit të elementeve të bashkësive dhe formimin e bashkësive nga dy bashkësi të dhëna.

Detyrë:
Vizaton dy bashkësi; formon një bashkësi të re me elementet e dy bashkësive.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 19

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1.III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 4.2; 6.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vetinë e përbashkët të elementeve të
- bashkësive;
- Formon bashkësi nga dy bashkësi të dhëna.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura gjeometrike ose petëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të formojnë bashkësi me forma gjeometrike dhe të tregojnë vetinë e përbashkët të elementeve të bashkësisë (bashkësi me trekëndorë, bashkësi me katrorë…).

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë bashkësinë dhe elementet. U kërkohet të gjejnë vetinë e përbashkët, sipas së cilës është bërë grumbullimi i elementeve në bashkësi. (Vetia: janë shpendë).

Bisedohet me nxënës: - Cilat elemente të tjera nga detyra 1 e kanë këtë veti? Udhëzohen ata t'i vendosin



elementet e tjera me veti të përbashkët brenda bashkësisë.

Detyra 2: Cila është vetia e përbashkët e elementeve të bashkësisë? (Vetia: janë fruta).
Cilat elemente të tjera jashtë bashkësisë e kanë këtë veti?

Hapi 3: Nxënësit paraqesin nga dy bashkësi me elemente sipas dëshirës, të cilat mund të bashkohen në një bashkësi sipas një vetie të përbashkët (mund të paraqesin bashkësinë e lapsave dhe të fletoreve, si dhe të formojnë një bashkësi nga këto dy bashkësi me vetinë bashkësia e mjeteve mësimore).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e vetisë së përbashkët të elementeve të bashkësive dhe formimin e një bashkësie nga dy bashkësi të dhëna.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 29).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 20

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Formon bashkësi sipas vetive të elementeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2, 3, II.1, 4, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 5, 2.1, 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Formimi i nënbashkësisë sipas vetisë së elementeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Formon nënbashkësi sipas vetive të elementeve;
- Shkruan elementet e nënbashkësisë;
- Krijon nënbashkësi sipas një vetie të përbashkët.



Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Goma, lapsa, plastelina, penj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në secilën bankë të nxënësve shpërndahet një grumbull i disa elementeve (goma, lapsa, plastelina etj).

Hapi 2: Kërkohet të formojnë bashkësitë me grumbullin e elementeve të dhëna me anë të perit.
Diskutohen pyetjet:
1. Çfarë formuat? (Bashkësi) 2.Sa bashkësi formuat? (Një bashkësi).

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet që brenda bashkësisë së formuar t'i ndajnë elementet me veti të përbashkëta me anë të perit. (Aktiviteti realizohet në dyshe). Diskutohen pyetjet: 1.Sa bashkësi formuat brenda bashkësisë së dhënë? (Brenda bashkësisë janë formuar 2-3 bashkësi).

Hapi 4: Nxënësve u tregohet që bashkësitë e formuara me veti të përbashkëta brenda bashkësisë së dhënë quhen nënbashkësi.



Hapi 5: Nxënësit së bashku me mësimdhënësin punojnë detyrën 1 në libër. Diskutohet bashkërisht.

1. Nga elementet e dhëna, cilat nënbashkësi janë formuar?
2. Si formohet nënbashkësia e një bashkësie?

Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 2 në libër.

1. Çfarë kanë të përbashkët elementet e bashkësisë? (Janë figura gjeometrike);
2. Çfarë kanë si veti të përbashkët? (Si veti të përbashkët kanë ngjyrën).

Atëherë, në bazë të ngjyrës ata formojnë nënbashkësi.

Hapi 6: Detyra 3 punohet në libër bashkë me mësimdhënësin. Japin këto përgjigje për këto pyetje:

1. Cila është nënbashkësia e bashkësisë A? (B është nënbashkësi e bashkësisë A)
2. Cilat janë elementet e bashkësisë B? (B={1,4,5,7})
3. Cila është nënbashkësia e bashkësisë A? (B është nënbashkësi e bashkësisë A)
4. Cilat janë elementet e bashkësisë B? (B={d,h,k,s,t})

Hapi 7: Nxënësit udhëzohen të vizatojnë në fletore nënbashkësi, duke marrë si veti të përbashkët ngjyrën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në formimin e nënbashkësive sipas një vetie të përbashkët.

Detyrë:
Formon nga një nënbashkësi sipas një vetie të përbashkët.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 21

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Shoqëron objektet (elementet) e një bashkësie të dhënë me objektet (elementet) e një bashkësie tjetër.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, II.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.6, 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Tregon me fjalë kuptimin e nënbashkësisë së një bashkësie;
- Gjen nënbashkësitë në bashkësinë e dhënë në libër;
- Shkruan elementet e nënbashkësive të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kapakë plastike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në klasën e ndarë në tri grupe me numër të barabartë nxënësish, zhvillohet loja me kapakë plastike. Grupeve të nxënësve u shpëndahen numër i njëjtë kapakësh plastike, por me ngjyrë dhe madhësi të ndryshme. Grupet e nxënësve do të garojnë mes vete për të bërë nënbashkësi me kapakë plastike në kohë sa më të shkurtër.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen t'i hapin librat në faqen 30. U jepen udhëzime për plotësimin e kërkesës së detyrës së parë dhe në mënyrë të pavarur formojnë nënbashkësi brenda bashkësisë së madhe e më pas i emërtojnë ato.

Ashtu veprohet me detyrën 2, ku nxënësit shkruajnë elementet e nënbashkësisë, e cila është e ngjyrosur.



Detyra 3: Formohen nënbashkësitë nga bashkësia e dhënë, (nënbashkësia e katrorëve, nënbashkësia e kubeve, nënbashkësia e sferave, nënbashkësia e trekëndëshave).

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të paraqesin në fletore nga dy bashkësi me elemente dhe të tregojnë vetinë e përbashkët të elementeve. Në përfundim të punës, diskutohen në nivel klase bashkësitë e formuara nga nxënësit në mënyrë individuale.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin e nënbashkësive dhe identifikimin e elementeve të nënbashkësive.

Detyrë:
Formon tri bashkësi sipas një vetie të përbashkët të tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 22

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Bashkësitë dhe relacionet

Rezultatet e të nxënit të temës:
Shoqëron objektet (elementet) e një bashkësie të dhënë me objektet (elementet) e një bashkësie tjetër.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, 2, 4, III. 2, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3. 3; 6. 2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Relacioni

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon relacionin ndërmjet elementeve të bashkësive;
- Bën lidhjen e elementeve të dy bashkësive sipas relacionit të përcaktuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten në tabelë dy bashkësi me elemente. Bashkësia A ka elemente zanoret e alfabetit me shkronja të mëdha të shtypit, ndërsa bashkësia B ka elemente zanoret e alfabetit me shkronja të vogla të shtypit.

a ⟷ A

Hapi 2: Diskutohet me nxënës.

A mund të jenë në lidhje elementet e bashkësisë A me elementet e bashkësisë B?	Cila është lidhja ndërmjet elementeve të bashkësisë A dhe elementeve të bashkësisë B?

Për mësuesin/en



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë bashkësitë e paraqitura në detyrën 1. Tregoni se bashkësitë A dhe B mund të jenë në lidhje njëra me tjetrën dhe kjo lidhje quhet relacion.

Ndërkohë u parashtrohen këto pyetje nxënësve:

- Cili është relacioni ndërmjet bashkësisë A dhe B?
- Si do të bëni lidhjen e elementeve nga bashkësia A me elementet nga bashkësia B?
- Kotelja e cilës kafshë është në bashkësinë B?

Veprohet në të njëjtën mënyrë edhe me detyrën e dytë.

Hapi 4: Nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur detyrën 3.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin dhe realacionin ndërmjet elementeve të dy bashkësive.

Detyrë:

Detyra 1 dhe 2 (faqe 33).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 23

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Lexon dhe shkruan numrat deri në 100;

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2; III. 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1; 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Numrat deri në 30

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Lexon numrat deri në 30;
- Shkruan numrat deri në 30;
- Tregon dhjetëshet dhe njëshet te numrat deri në 30.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura gjeometrike ose petëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet bisedë me nxënësit për të nxitur tek ata numërime në klasë. Parashtrohen pyetje: Sa nxënës jeni në klasë? Sa prej jush jeni djem dhe sa vajza? Sa banka janë gjithsej? Vazhdohet biseda për të nxitur numërime të tjera deri në 30.
Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë edhe në tabelë numrat që tregojnë.

Hapi 2: Bisedohet me nxënësit për figurën në detyrën 1: Çfarë shihni në figurë? (Teatër); Për të shkuar në teatër çka duhet të kemi? (Biletën); Çfarë shkruan në biletë?; Cilët numra të ulëseve duhet shkruar në vendet që mungojnë?

Nxënësit udhëzohen të shkruajnë numrat që mungojnë në hapësirat e zbrazëta.

Në detyrën 2 vëzhgojnë figurat me gjallesa dhe numra dhe, duke numëruar, tregojnë dhe shkruajnë numrin për secilën gjallesë.



Nxënësit udhëzohen që duke numëruar të plotësojnë kutizat në detyrën 3.

Në detyrën 4, u kërkohet të bëjnë radhitjen e numrave të paraqitur.

Nxënësit udhëzohen të numërojnë gjësendet e paraqitura në ilustrime dhe të plotësojnë kutizat duke treguar sa dhjetëshe dhe njëshe ka në secilin grup të gjësendeve.

Hapi 3: Nxënësve u shpërndahen tabelat e përgatitura me numra, ku në bazë të numrit të dhënë do të tregojnë sa ka dhjetëshe dhe njëshe dhe do të shkruajnë me fjalë numrin.

Numri	Dhjetëshe	Njëshe	Shkruaj me fjalë
21	2	3	Njëzet e një
25			
29			
30			

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë për të lexuarit dhe shkruarit e numrave deri në 30 dhe ndarjen në dhjetëshe dhe njëshe.

Detyrë:
Detyrat 5 dhe 7 (faqe 35).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 24

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri;
- Krahason numrat natyrorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1; 3.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan numrin paraardhës dhe pasardhës për një numër të dhënë;
- Krahason numrat deri në 30.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Balona.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u jepet nga një balonë, ku secila prej tyre ka nga një numër nga 1-30. Kërkohet nga secili që të tregojë numrin paraardhës dhe numrin pasardhës për numrin që e ka në balonë.

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të shkruajnë numrin paraardhës dhe pasardhës për numrat e dhënë në detyrën 1, dhe të tregojnë numrat që kanë shkruar.

Për detyrën 2 nxënësit udhëzohen të krahasojnë numrat e dhënë dhe të vendosin shenjën e duhur: <, >, =.

Nxënësit mund të bashkëpunojnë në dyshe për të kontrolluar detyrën e njëri-tjetrit.
Para se të plotësohet detyra 3, kërkohet nga ta të tregojnë dhjetëshet dhe njëshet te numrat: 19, 21, 25, 29, 30.



Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurën në detyrën 3 dhe më pas të gjejnë dhjetëshet dhe njëshet në dy detyrat e tjera, si dhe të shkruajnë vlerën e tyre.

Hapi 3: Paraqiten në tabelë ose projektor numrat: 12, 27, 18, 16, 21, 25, 22, 24, 23, 29.

Nxënësve u kërkohet të gjejnë pararadhësin dhe pasardhësin për secilin nga këta numra dhe të krahasojnë disa nga numrat e dhënë duke përdorur shenjat: >, < dhe =.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shkrimin e numrit paraardhës dhe pasardhës dhe krahasimin e numrave.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 36).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 25

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.1, III.1,3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,3; 3,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 30

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Tregon veprimet matematikore;
- Zgjidh saktë barazimet e dhëna;
- Plotëson vargun e numrave.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutohet me nxënësit lidhur me këto pyetje:
1. Cilat veprime matematikore i kemi mësuar?
2. Si i emërtojmë numrat te mbledhja ? Mbledhori i parë ←3+5=8 → shuma
   mbledhori i dytë
3. Si i emërtojmë numrat te zbritja? I zbritshmi←8-5=3→ndryshimi
   zbritësi
4. Cilët numra i kemi mësuar deri më tani?

Hapi 2: Së bashku me nxënësit punohet në libër detyra 1. Ata japin përgjigje për këto pyetje:

1. Sa rrethorë janë të kaltër? Sa janë të kuq? (6 rrethorë të kaltër dhe 2 rrethorë të kuq.) 6+2=8;
2. Sa rrethorë janë të kaltër? Sa janë të kuq? (16 rrethorë të kaltër dhe 2 rrethorë të kuq.) 16+2=18;

Për mësuesin/en



3. Sa rrethorë janë të kaltër? Sa janë të kuq? (26 rrethorë të kaltër dhe 2 rrethorë të kuq.) 26+2=28;
4. Gjatë këtyre mbledhjeve çfarë ndryshoi? (dhjetëshja).

Hapi 3: Të njëjtat pyetje bëhen edhe për veprimin e zbritjes.

Hapi 4: Shkruhet detyra 3 në tabelë dhe zgjidhet së bashku me nxënësit, ku zbulohet dhe plotësohet vargu i numrave.

Hapi 5: Jepen udhëzime për detyrën 2, ku nxënësit punojnë në libër në mënyrë të pavarur. Diskutohen këto pyetje:

1. Te numri 20, shifra 2 çfarë tregon? (dhjetëshen); shifra 0 çfarë tregon? (njëshet); po shifra 8, çfarë tregon? (njëshet) (20+8=28);
2. Cili veprim matematikor ndodh? (mbledhja);
3. Si duhet t'i mbledhim ? (Së pari mblidhen njëshet, ndërsa shifra e dhjetëshes përshkruhet);
4. Te numri 23, shifra 2 çfarë tregon? (dhjetëshe); shifra 3 çfarë tregon? (njëshet); po shifra 2, çfarë tregon? (njëshet);
5. Cili veprim matematikor ndodh? (zbritja);
6. Si duhet t'i zbresim? (Së pari zbriten njëshet, ndërsa shifra e dhjetëshes përshkruhet).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit deri në 30.

Detyrë:
Shkruan pesë shembuj me mbledhje dhe zbritje të numrave deri në 30.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 26

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, II.8,III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4, 6.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 30;
- Krahason rezultatet e fituara nga mbledhja dhe zbritja e numrave të dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në klasën e ndarë në katër ose pesë grupe me numër të barabartë të nxënësve vendoset një shportë e vogël brenda së cilës ka etiketa me detyra të zgjidhura. Detyrat kanë të bëjnë me mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 30. Grupet marrin nga shtatë-tetë etiketa me detyra dhe kontrollojnë saktësinë e detyrave. Në rast se grupi vlerëson se rezultati i ndonjë detyre është jo i saktë, ata duhet ta korrigjojnë atë. Secili grup argumenton veprimet e tyre.

Hapi 2: Pasi të jenë diskutuar rezultatet e detyrave të punuara nga grupet, nxënësit udhëzohen t'i hapin librat në faqen 37. U jepen udhëzime për mënyrën e zgjidhjes së detyrave 1, 2 dhe 3. Pastaj në mënyrë individuale i plotësojnë detyrat, konkretisht barazimet, kur një mbledhor mungon apo në rastin tjetër kur mungon i zbritshmi a zbritësi. Më pas, referuar modelit të paraqitur në detyrën 2, nxënësit shkruajnë barazime të mbledhjes dhe të zbritjes me numrat e dhënë. Me përfundimin e punës së nxë-nësve,



diskutohen në nivel klase rezultatet e fituara nga nxënësit.

Hapi 3: Pasi të jetë zgjidhur detyra e katërt në mënyrë të pavaruar nga nxënësit, udhëzohen që të kontrollojnë rezultatet e shokut/shoqes që kanë afër. Më tej, dyshet i shkëmbejnë mendimet e tyre nëpërmjet diskutimit nëse krahasimi i numrave është zgjidhur saktë ose jo. Diskutimi i dysheve mund të bëhet edhe në nivel klase.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen që të vazhdojnë punën në bashkëpunim me shokun/shoqen që kanë afër për të ndërtuar sa më shumë barazime në lidhje me mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 30.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave deri në 30, krahasimin e rezultateve.

Detyrë:
Ndërton dhjetë barazime në lidhje me mbledhjen dhe zbritjen e numrave deri në 30.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 27

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes;
- Përdor vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2, 6; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 3. 4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Mbledhja e numrave duke plotësuar 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën e numrave duke plotësuar dhjetëshen;
- Plotëson detyrat dhe ushtrimet duke njehsuar shumën.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë të përgatitura nga mësuesja.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që barazimet e dhëna në fletën e punuar nga mësuesja t'i plotësojnë sipas këtij modeli:

$9 + 8 = 17$ $\quad\quad$ $\underline{10} + \underline{7} = 17$
$\swarrow\ \searrow$
$1 + 7$

Për mësuesin/en



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë skemat në detyrën 1, duke plotësuar dhjetëshen e plotë.
Njëjtë veprohet edhe me detyrën e dytë duke u bazuar në boshtin numerik. Nxënësit pyeten:

- Cilët janë mbledhorët?
- Si është ndarë mbledhori i dytë? Përse?
- Sa është shuma?

Në këtë mënyrë vazhdon ecuria edhe me shembujt e tjerë.

Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet të përgjigjen në këto pyetje:

- Cili numër është për 5 më i madh se 18?
- Cili numër është për 7 më i madh se 16?

Hapi 4: Nxënësit njehsojnë shumën e numrave në detyrën 4.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shumës së numrave me 10.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 28

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 2, II.2, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit shumën e numrave duke veçuar 10;
- Zgjidh probleme me fjalë;
- Formulon probleme me fjalë.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra 1 – 9.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me numrat nga 1 deri në 9. Ata gjejnë shokun me të cilin formojnë numrin 10 (1 + 9; 2 + 8; 3 + 7; 4 + 6; 5 + 5; 6 + 4; 7 + 3; 8 + 2; 9 + 1). Etiketat vendosen në një kënd të klasës.

Hapi 2: Detyra 1 – Llogaritet shuma e numrave të dhënë duke plotësuar 10.

18 + 7 =

- Cili është mbledhori i parë? (18);
- Cili është mbledhori i dytë? (7);
- Sa duhet t'i shtojmë mbledhorit të parë që të formojmë 10 të plotë? (18 + 2);



1 Duke plotësuar dhjetëshen, njehsojmë shumën:

18 + 7 = 18 + (2 + 5) = (18 + 2) + 5 = 20 + 5 = 25

2 + 5

19 + 4 = 19 + (__ + __) = (__ + __) + __ = __ + __ = □

1 □

16 + 6 = 16 + (__ + __) = (__ + __) + __ = __ + __ = □

□ 2

2 Njehsojmë edhe në këtë mënyrë:

16 + 12 → 10 + 6 + 10 + 2 → □ + □ → □

17 + 12 → □ + □ + □ + □ → □ + □ → □

3 Njehsojmë dhe plotësojmë:

18 + □ = 22 | 15 + □ = 25 | □ + 7 = 25 | 11 + □ = 2

□ + 16 = 20 | 18 + □ = 28 | □ + 17 = 29 | 18 + □ = 3

4 Anjeza i ngjyrosi 18 katrorë në fletoren e saj, kurse shoqja e saj Blerta 8 katrorë më shumë. Sa katrorë i ngjyrosi Blerta?

Njehsojmë: 18 + 8 = __ + __ + __ = (__ + __) + __ = __ + __ = □

Pra, Blerta i ngjyrosi ____ katrorë.

USHTROJMË

40

- Si e shënojmë si shumë të dy mbledhorëve mbledhorin e dytë? (7 = 2 + 5).

18 + 7 = 18 + (2 + 5) = (18 +2) + 5 = 20 + 5 = 25.
Njëjtë veprohet edhe me barazimet 19 + 4 dhe 16 + 6.

Detyra 2 – Njehsohet shuma e numrave të dhënë duke ndarë dhjetëshet dhe njëshet.
16 + 12 = (10 + 6) + (10 + 2) = (10 + 10) + (6 +2) = 20 + 8 = 28
Njëjtë veprohet edhe me barazimin 17 + 12.

Hapi 3: Detyra 4 - Lexohet kërkesa e detyrës. Qartësohet se çfarë dihet (Anjeza ngjyrosi 18 katrorë, Blerta 8 katrorë më shumë) dhe çfarë kërkohet të gjejmë (shuma e katrorëve që ngjyrosi Blerta).

Hapi 4: Nxënësit në mënyrë individuale formulojnë një problem me fjalë me veprimin e mbledhjes.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe formulimin e problemeve me fjalë.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 40).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 29

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3;3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Zbritja e numrave duke veçuar 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson ndryshimin e numrave duke veçuar 10.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet aktiviteti me nxënës duke kërkuar që numrat e paraqitur në projektor (ose tabelë) t'i ndajnë në dhjetëshe dhe njëshe në fletoret e tyre. Numrat mund të jenë nga 11-30 (12, 13... 24, 25...). Ndarja në dhjetëshe dhe njëshe bëhet në këtë mënyrë: 25=2Dh +5Nj; 18= 1Dh+8 Nj;...

Hapi 2: Sqarohet skema e plotësuar në detyrën 1. Parashtrohen pyetje për nxënës: Sa është i zbritshmi? (26); Sa është zbritësi ? (8); Sa do të veçoni nga i zbritshmi që të fitoni dhjetëshe të plotë? (6, sepse 26-6=20). Si do të vazhdoni detyrën që të njehsoni ndryshimin? (20-2=18). Vazhdohet njëjtë me skemën tjetër të detyrës 1.

Nxënësit udhëzohen të njehsojnë ndryshimin duke veçuar 10, duke përdorur boshtin numerik sipas shembullit në detyrën 2 në libër.

U kërkohet atyre të gjejnë numrin në detyrën e shprehur me fjalë në detyrën 3 duke veçuar dhjetëshen.



Sa duhet veçuar nga numri 27 për të veçuar dhjetëshen? (7); Edhe sa kanë mbetur për t'u zbritur? (20-1); Cili numër është për 8 më i vogël se 27? (27-7-1=19).

Hapi 3: Nxënësit njehsojnë në mënyrë të pavarur detyrat nga tabela e parë dhe e dytë në detyrën 4 në libër. Ata njehsojnë ndryshimin e numrave duke veçuar 10.

Detyrat i njehsojnë në fletore, kurse në tabelat në libër në detyrën 4 i paraqesin rezultatet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të ndryshimit të numrave duke veçuar 10.

Detyrë:
Tabela e tretë dhe e katërt nga detyra 4 (faqe 41).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 30

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Duke veçuar dhjetëshen, njehson ndryshimin e numrave deri në 30.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3 II.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave deri në 30;
- Krahason numrat deri në 30;
- Krijon barazime duke veçuar dhjetëshen.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë me ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukate fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Numrat (1-30) e përgatitur në fletë me ngjyra vendosen në dysheme. Një nxënës përzgjidhet që të dalë dhe të qëndrojë mbi numrin 27, më pas të lëvizë 8 hapa pas.
Diskutohen me nxënësit këto pyetje:
1.Te cili numër ishte nxënësi në fillim? (27); 2.Sa hapa lëvizi? (8); 3.Te cili numër arriti? (19).
Barazimi shënohet në tabelë. Aktiviteti vazhdon edhe me disa nxënës të tjerë. (27-8=19).

Hapi 2: Vizatohet boshti numerik në tabelë dhe njehsohet ky ndryshim (27-9 = ☐). I kërkohet një nxënësi të dalë në tabelë. Nxënësit pyeten:
1.Sa është i zbritshmi? (27); 2. Sa është zbritësi? (9); 3. Si do të veproni: sa duhet të veçoni nga i zbritshmi që të fitoni dhjetëshe të plota?



1 Duke u bazuar në boshtin numerik, njehsojmë ndryshimin:

27 – 9 = ☐

0 5 10 15 20 25 30

27 – 9 = 27 – 7 – 2 = 18 22 – 5 = 22 – ☐ – ☐ = ☐

25 – 8 = 25 – ☐ – ☐ = ☐ 26 – 7 = 26 – ☐ – ☐ = ☐

2 Plotësojmë drejtkëndëshat me numra, në mënyrë që të fitojmë barazi të sakta.

30 – ☐ = 29 26 – ☐ = 11 20 – ☐ = 12

23 – ☐ = 17 30 – ☐ = 28 29 – ☐ = 21

3 < = > ?

12 – 3 ◯ 8 11 – 4 ◯ 6 12 – 5 ◯ 7 8 ◯ 20 – 8

4 Detyra të shprehura me fjalë:

1. Në një autobus ishin 26 udhëtarë. Në stacionin e parë zbritën 7 udhëtarë, kurse hynë 9 udhëtarë. Sa udhëtarë janë në autobus?

Në autobus janë: (__ – __) + __ = __ + __ = __ udhëtarë.

2. Në një rrugë janë 29 shtëpi, prej së cilave 14 janë në anën e majtë. Sa shtëpi janë në anën e djathtë të rrugës?

5 Kthimi në fillim.

20: +8, 20, +4, +3, −6, −2, +7, −5, −9

30: +8, 30, −7, −5, +8, −9, −6, +9, +2

USHTROJMË

42

(7, sepse 27-7=20).
Sa kanë mbetur te zbritësi kur i kemi marrë 7? (2) . (27-9=(27-7)-2=20-2=18).
7 2

Hapi 3: Nxënësit punojnë në libër detyrën 4 së bashku me mësimdhënësin. Duke lexuar tekstin me kujdes, diskutohen këto pyetje:
1. Sa udhëtarë ishin në autobus? (26);
2. Sa zbritën në stacionin e parë? (7); 3.Sa udhëtarë hynë? (9) (26-7)+9=19+9=28

Hapi 4: Nxënësit punojnë dhe vëzhgojnë me mësimdhënësin detyrën 5.

Hapi 5: Nxënësit punojnë të pavarur, në libër, detyrën 2. (Ata duhet ë plotësojnë drejtëkëndëshat që të fitojnë barazi të sakta).
1.30 - ☐ =29

Hapi 6: Nxënësit punojnë të pavarur, në libër, detyrën 3.
12 - 3 ◯ 8
1. Çfarë duhet të bëjmë në këtë detyrë? Cilën shenjë duhet vendosur në rrethin e zbrazët?

Hapi 7: Nxënësit, të ndarë në grupe, udhëzohen të krijojnë 2 barazime duke njehsuar ndryshmin e numrave dhe duke veçuar dhjetëshen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e ndryshimit të numrave, duke veçuar dhjetëshen.

Detyrë:
Të plotësohet faqja 43.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 31

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 30;
- Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.8, III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave deri në 30;
- Zgjidh problemat e dhëna në libër bazuar në modelet e paraqitura;
- Gjen të panjohurën në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Gjëegjëzë: Jam njëshifror, nëse më shton 15, bëhem 20. Cili numër jam unë?

Kërkohet mendimi i nxënësve për mënyrën e zgjidhjes së gjëegjëzës së dhënë. Pastaj paraqitet zgjidhja e saktë në tabelë, duke treguar se numri që mungon është numri 5. Shkruhet:

? + 15 = 20, sepse 5+15=20

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit në mënyrë të pavarur njehsojnë shumën e numrave të dhënë.



VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

1 Njehsojmë shumën:

16 + 7 = ☐ 14 + 9 = ☐ 19 + 8 = ☐

18 + 9 = ☐ 15 + 7 = ☐ 17 + 9 = ☐

2 Njehsojmë ndryshimin:

25 – 8 = ☐ 26 – 7 = ☐ 24 – 9 = ☐

30 – 8 = ☐ 29 – 7 = ☐ 25 – 5 = ☐

3 Duke njehsuar do të zbulojmë sa vjet mund të jetojë kaprolli.

9 + 6 → + 3 → + 5 → – 8 → + 4

4 Plotësojmë fushat e zbrazëta me numra, në mënyrë që të fitojmë barazi të sakta.

5 + ☐ = 8 9 – ☐ = 3 27 – ☐ = 23

☐ + 5 = 18 ☐ – 5 = 13 ☐ – 3 = 13

25 + ☐ = 28 29 – ☐ = 23 7 – ☐ = 3

5 Njehsojmë ndryshimet:

18 – 7 – 8 = (___ – ___) – ___ = ___ – ___ = ___.

26 – 4 – 6 = _____.

27 – 5 – 2 = _____.

6 Zbulojmë rregullën dhe plotësojmë fushat me numrat e duhur.

2 14 4 24 12

VLERËSOJMË

45

Detyra 2: Ata gjejnë ndryshimin e numrave të dhënë.

Detyra 3: Duke njehsuar me shprehjet e dhëna, nxënësit gjejnë sa mund të jetojë një kaproll.

Detyra 5: Në dyshe nxënësit gjejnë ndryshimet e numrave të dhënë duke veçuar 10. P.sh. tek shprehja:

18 - 7 - 8 = (18 - 8) - 7 = 10 - 7 = 3

Hapi 3: Detyra 4: Në dyshe nxënësit gjejnë numrin që mungon në barazimet e dhëna, në mënyrë që të fitohet barazim i saktë. Nxënësve u parashtrohen pyetje:

- Si quhen numrat që marrin pjesë në mbledhje? Po në veprimin e zbritjes?
- Cili mbledhor mungon në barazimin 5 + ...= 8?
- Si e gjejmë mbledhorin e panjohur?
- Po në barazimin 9 - ..... =3? Si mund ta gjejmë zbritësin?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave të dhënë, për identifikimin e numrit të panjohur në barazimet e dhëna.

Detyrë:
Të plotësohet faqja 44.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 32

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përcakton vijat e drejta, të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, 3, 4; III.1, 2, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2; 6.1,2.


VIJAT E LAKUARA DHE TË DREJTA. SEGMENTI

VIJAT E LAKUARA DHE ATO TË DREJTA

1 Si t'i kuptojmë vijat e lakuara dhe vijat e drejta?

Kur vizatojmë një vijë me dorë të lirë, ajo gjithmonë do të dallojë nga vija që e vizatojmë duke e përdorur vizoren.

Kështu, një vijë e vizatuar me dorë të lirë është vijë e lakuar, kurse vija e vizatuar me vizore është vijë e drejtë.

2 Në figurë janë vizatuar disa vija të lakuara dhe të hapura.

Këto vija të lakuara i mbyllim me vijë të kuqe. Vijat e fituara quhen vija të lakuara dhe të mbyllura.

3 Në figurë janë vizatuar disa vija të drejta.

A B 1 2 3 4

MËSOJMË

Vija me numër ① është vijë e drejtë e pakufizuar.
Vija me numër ② është vijë e drejtë e kufizuar me pikat A dhe B.
Vija me numër ③ është vijë e thyer dhe e hapur.
Vija me numër ④ është vijë e thyer dhe e mbyllur.

46

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Vijat e lakuara dhe të drejta. Segmenti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton vija të drejta dhe të lakuara, të hapura dhe të mbyllura;
- Krahason vijat e drejta dhe të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Vizore, spango.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhët dhe komunikimi, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë vizatohet një vijë e lakuar dhe një vijë e drejtë. Diskutohet me nxënësit:

Çfarë vëreni?

Çfarë lloje vijash janë paraqitur?

Ku dallojnë këto vija njëra me tjetrën?

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë vizatimin në detyrën 1 në libër. U tregohet se vijat e lakuara vizatohen me dorë të lirë, kurse vijat e drejta vizatohen me vizore.



VIJAT E LAKUARA DHE TË DREJTA. SEGMENTI

VIJAT E LAKUARA DHE ATO TË DREJTA

MËSOJMË

1 Si t'i kuptojmë vijat e lakuara dhe vijat e drejta?

Kur vizatojmë një vijë me dorë të lirë, ajo gjithmonë do të dallojë nga vija që e vizatojmë duke e përdorur vizoren.

Kështu, një vijë e vizatuar me dorë të lirë është vijë e lakuar, kurse vija e vizatuar me vizore është vijë e drejtë.

2 Në figurë janë vizatuar disa vija të lakuara dhe të hapura.

Këto vija të lakuara i mbyllim me vijë të kuqe. Vijat e fituara quhen vija të lakuara dhe të mbyllura.

3 Në figurë janë vizatuar disa vija të drejta.

Vija me numër ① është vijë e drejtë e pakufizuar.
Vija me numër ② është vijë e drejtë e kufizuar me pikat A dhe B.
Vija me numër ③ është vijë e thyer dhe e hapur.
Vija me numër ④ është vijë e thyer dhe e mbyllur.

46

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë vijat e paraqitura në detyrën 2. U tregohet se vijat e lakuara të hapura nëse mbyllen formojnë vija të lakuara të mbyllura.

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë vijat e paraqitura në detyrën 3 dhe të tregojnë për secilën vijë çfarë lloj vije është.

Hapi 5: Nga nxënësit kërkohet të vizatojnë në fletore vija të drejta dhe vija të lakuara.

VEPRIMTARI
Nxënësve u shpërndahen spango dhe kërkohet nga ata të formojnë vija të lakuara, të hapura dhe të mbyllura dhe vija të drejta.

Që ora mësimore të bëhet edhe më atraktive dhe nxënësit ta kenë më të lehtë t'i kuptojnë dhe t'i dallojnë vijat e mësuara, mund të shikohet videoja në linkun:

https://www.youtube.com/watch?v=d-FeQp-T0OAg.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin dhe krahasimin e vijave të drejta dhe të lakuara, të hapura dhe të mbyllura.

Detyrë:

Vizaton në fletore vija të lakuara, të hapura dhe të mbyllura, si dhe vija të drejta të hapura dhe të mbyllura.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 33

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përkufizon segmentin dhe përdor vizoren/ trekëndëshin për të caktuar gjatësinë e segmentit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1, 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Segmenti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon segmentin nga vija;
- Përcakton numrin e segmenteve në një figurë;
- Vizaton me vizore segmente.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen fletë, ku ata do të vizatojnë dy pika, kudo në hapësirën e fletës. Më pas bashkojnë me vizore pikat, duke formuar segment, emërtohen pikat (AB, EF).

Hapi 2: Detyra 1 - Vështrohen figurat e dhëna, segmenti AB dhe pikat C dhe D.

- Çfarë vije është vija që bashkon pikat AB? (segment);
- Çka janë pikat A dhe B? (skajet e segmentit).

Bashkohen pikat C dhe D.



Hapi 3: Detyra 2 - Vështrohet vija e dhënë me pikat, dhe përcaktohen segmentet (AB, AC, AD, BC, BD, CD).

Detyra 3 – Përcaktohet numri i segmenteve në figurat e dhëna.
Vija e thyer e hapur – AB, BC, CD, DE, EF.
Vija e thyer e mbyllur – AB, BC, CD, DE, EA.

Hapi 4: Nxënësit në mënyrë individuale punojnë ushtrimin.

Vizato vijën e thyer të mbyllur me tri segmente.	Vizato vijën e thyer të mbyllur me katër segmente.	Vizato vijën e thyer të mbyllur me pesë segmente.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin dhe vizatimin e segmenteve, përcaktimin e segmenteve në një vijë figurë të dhënë.

Detyrë:

Vizaton 3 segmente.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 34

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përkufizon segmentin dhe përdor vizoren për të caktuar gjatësinë e segmentit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1,2, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vijat nga segmenti;
- Bën matjen e segmenteve;
- Krijon segmente dhe bën krahasimin e tyre.


USHTROJMË

1 Analizojmë figurat dhe plotësojmë fjalitë.

Në figurë është vizatuar një vijë e _____, e cila përbëhet prej _____ segmenteve.

Segmentet që e formojnë vijën janë:

___, ___.

Në figurë është vizatuar një vijë e _____, e cila përbëhet prej _____ segmenteve.

Segmentet që e formojnë vijën janë:

___, ___, ___, ___, ___, ST.

2 Analizojmë figurat dhe plotësojmë fjalitë.

Në figurë është vizatuar një vijë e _____, e cila përbëhet prej _____ segmenteve.

Segmentet që e formojnë vijën janë:

___, ___, ___.

Në figurë është vizatuar një vijë e _____, e cila përbëhet prej _____ segmenteve.

Segmentet që e formojnë vijën janë:

___, ___, ___, ___, ___, SM.

48

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vijat nga segmenti;
- Bën matjen e segmenteve;
- Krijon segmente dhe bën krahasimin e tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Spango, fije shkrepëse, fije peri, shkopinj, litar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit t'i përmendin llojet e vijave që kanë mësuar (të mbyllura, të drejta, të hapura, të lakuara).

Hapi 2: U kërkohet dy nxënësve të dalin para klasës (nx.A dhe nx.B). Në duar ata mbajnë një litar. Nxënësit që mbajnë litarin në duar nuk duhet të lëvizin nga vendi.
Pyeten nxënësit:
- Çfarë vije kanë formuar me litar? (vijë të drejtë); Ku ndodhet nx.A? (në fillim); Ku ndodhet nx.B? (në fund);
- Çfarë formuan nxënësit me litar? (segment);
- Si quhen pikat A dhe B? (skajet e segmentit).



3 T'i krahasojmë segmentet e dhëna sipas gjatësive të tyre:

A B
C D
E F

Segmentet ____ dhe ____ kanë gjatësi të barabarta.

Segmenti *CD* është më i gjatë se segmentet ____ dhe ____ .

4 Duke bërë matjen me vizore ose trekëndësh, krahasojmë segmentet e dhëna në figurë.

AB < *CD*
___ > ___
___ ☐ ___

5 Duke i bashkuar pikat *A, B* dhe *C* me vizore, fitojmë tri segmente. I shkruajmë segmentet dhe duke matur tregojmë se cili prej tyre është më i gjatë dhe cili më i shkurtër.

Segmenti më i gjatë është segmenti _____.

Segmenti më i shkurtër është segmenti _____.

6 Analizojmë figurën dhe tregojmë se sa segmente përmban ajo.

Figura përmban _____ segmente. Ato janë:

___ , ___ , ___ , ___ , ___ , ___ , ___ .

Hapi 3: Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë detyrën 1, së bashku me mësimdhënësin. Diskutohen këto pyetje:
1.Çfarë vije është vizatuar në figurë? (vijë e drejtë); 2.Prej sa segmentesh përbëhet?; 3. Cilat segmente e formuan vijën?
Parashtrohen pyetje edhe për figurën e dytë.

Hapi 4: Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 2 në libër.

Hapi 5: Udhëzohen të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën. Japin përgjigje për këto pyetje:

1. Çfarë përdorim për t'i matur segmentet? (vizoren ku matet gjatësia dhe bëhet krahasimi i segmenteve);
2. Cilat segmente kanë gjatësi të barabarta?
3. Cili segment është më i gjatë?

Hapi 6: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën, duke ua kujtuar që ashtu siç krahasohen numrat me shenjat e krahasimit (<,>,=), ashtu të krahasohen edhe segmentet duke e bërë matjen e tyre, bazuar në gjatësinë e tyre.
Diskutohen këto pyetje:

1. Segmenti AB a është më i madh a më i vogël se segmenti CD? (AB<CD)?
2. Segmenti CD a është më i madh a më i vogël se segmenti EF? (CD>EF)?

Hapi 7: Nxënësve të ndarë në grupe u shpëndahen spango, fije shkrepëse, fije peri, shkopinj etj. Ata duhet të krijojnë segmente me gjatësi të ndryshme dhe të bëjnë krahasimin mes tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në mes duke bërë dallimin mes vijave dhe segmenteve, matjen dhe krahasimin e segmenteve.

Detyrë:

Detyrat 3 dhe 4 (faqe 49).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 35

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përkufizon segmentin dhe përdor vizoren/trekëndëshin për të caktuar gjatësinë e segmentit;
Mbledh, zbret dhe krahason gjatësitë e segmenteve të ndryshme, duke përdorur njësitë matëse standarde (*cm, m*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.2; 3.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Matja e gjatësisë së segmenteve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton gjatësitë e segmenteve;
- Krahason segmentet sipas gjatësisë së tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: TV, internet.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që të bëjnë matjen e gjatësisë së lapsit të tyre, gjatësisë së fletores apo ndonjë mjeti tjetër mësimor. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë gjatësitë e objekteve të matura.



Hapi 2: Paraqitet para nxënësve videoja (linku në vijim) me shembuj të matjeve të gjatësive me vizore:

https://www.pinterest.compin/438678819953797591/



Jepen sqarime për përdorimin e duhur të vizores gjatë matjeve.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të bëjnë matjen e segmenteve të dhëna në detyrën 1 dhe 2 dhe të përcaktojnë gjatësitë e tyre. Pasi të bëjnë matjet në detyrën 2, ata përcaktojnë renditjen e segmenteve në bazë të gjatësisë së tyre. Renditja bëhet duke filluar nga segmenti që ka gjatësinë më të shkurtër që shënohet me numrin 1 për të vazhduar me renditjen e segmenteve të tjera. Nxënësit udhëzohen të bëjnë matjen e gjatësive të segmenteve të vijës së thyer në detyrën 3 dhe të gjejnë gjatësinë e vijës së thyer. Kërkohet t'i komentojnë gjatësitë e segmenteve të matura në detyra.

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet të bëjnë matjen e lapsave me ngjyra dhe të përcaktojnë gjatësinë e secilit dhe më pas të bëjnë renditjen sipas madhësisë së tyre.

Hapi 5: Nxënësit vizatojnë në fletore 3-4 segmente dhe përcaktojnë gjatësitë e segmenteve të paraqitura në fletore.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në matjen e gjatësisë së segmenteve dhe krahasimin e gjatësive.

Detyrë:

Bën matjen e gjatësive të disa segmenteve në shtëpi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 36

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përkufizon segmentin dhe përdor vizoren/ trekëndëshin për të caktuar gjatësinë e segmentit;
- Mbledh, zbret dhe krahason gjatësitë e segmenteve të ndryshme, duke përdorur njësitë matëse standarde (*cm, m*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.8, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton gjatësinë e segmenteve të dhëna në libër;
- Krahason segmentet sipas gjatësisë së tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: TV, internet.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të vizatojnë tri segmente të ndryshme në fletoret e tyre. Pasi t'i kenë përfunduar matjet e segmenteve me vizore, u parashtrohen pyetje të tilla:

- Sa është gjatësia e segmenteve që keni vizatuar?
- Cili nga segmentet e vizatuara është më i madh? Pse?
- Po cili nga ta është më i vogël? Pse?

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit përcaktojnë gjatësinë e segmenteve të dhëna në libër.
Detyra 2: Udhëzohen që pasi ta kenë përcaktuar gjatësinë e segmenteve AB, CD, EF dhe GF, t'i krahasojnë ato segmente. Pyeten:



- Cili segment është më i gjatë?
- Cili segment është më i shkurtër?
- Cilat segmente janë të barabarta?
- Për sa është më i madh segmenti EF se segmenti AB dhe CD?
- Për sa është më i vogël segmenti GH se segmenti EF? Po se segmentet AB dhe CD?

Njëjtë veprohet edhe me detyrën 3.

Hapi 3: Detyra 4: Nxënësit, pasi ta kenë përcaktuar gjatësinë e segmenteve AB, BC dhe CD, kryejnë mbledhjen e segmenteve ndërmjet vete: AB + BC, BC + CD, AB + BC + CD. Njësoj veprohet edhe me detyrën 4.

Hapi 4: Detyra 5: Rrugët a, b dhe c, të dhëna në detyrë, nuk janë gjë tjetër përpos një grup segmentesh të madhësive të ndryshme. Andaj nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavarur të kryejnë matjen e gjatësive të secilës rrugë veçmas, më pas të përcaktojnë rrugën më të shkurtër nga lepuri te lakra.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në matjen e gjatësisë së segmenteve dhe për krahasimin e segmenteve të dhëna.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 52).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 37

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; III. 1, 2, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1; 5.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Numrat deri në 100

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Radhit dhjetëshet e numrave nga 1 – 100;
- Emërton njëshet dhe dhjetëshet e numrave të dhënë;
- Shkruan vargun e numrave me nga 10, nga 1 – 100.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lapsa, ngjyra, etiketa me numra, shufra, kube.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Para nxënësve paraqiten dhjetë objekte të njëjta (lapsa, ngjyra, kube, goma, magnetë, topa etj.) dhe u tregohet që 10 njëshe janë të barabarta me 1 dhjetëshe.

10 njëshe = 1 dhjetëshe
10 Nj = 1 Dh



Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të numërojnë në mënyrë zinxhirore nga 10 – 100 me dhjetëshe të plota. Shkruhet vargu i numrave 1 – 10 dhe poshtë tyre vargu i numrave 10 – 100.

Me nxënësit bisedohet për dallimin mes këtyre vargjeve të numrave.

Paraqiten para tyre: një kub i vogël, shufër dhe pllakë. Flasin për vlerën që tregojnë ato.

Hapi 3: Në grupe shpërndahen shufra e kube dhe u kërkohet nxënësve të paraqesin numra nga 1 – 100 dhe të tregojnë për secilin sa shufra e kube ka.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen fletë me katrorë, 10 rreshta me nga 10. Kërkohet nga ata të ngjyrosin secilin rresht me ngjyra të ndryshme. Me shokun në bankë caktojnë numra të ndryshëm dhe tregojnë sa dhjetëshe ka.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në renditjen, shkruarjen dhe emërtimin e numrave nga 10 - 100.

Detyrë:

Shkruan numrat nga 1 – 100.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 38

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;
- Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe), si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.4, 5.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Numrat deri në 100

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan numrat 1 – 100 sipas një rregulle të dhënë;
- Krahason numrat deri në 100;
- Gjen paraardhësin dhe pasardhësin e numrave të dhënë;
- Radhit numrat në rendin rritës dhe zbritës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra (1-100).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit ndahen në katër grupe. Secili grup ka etiketa me numra, ku duhet t'i radhitin numrat me radhë.
Grupi I: Numrat 1-25;
Grupi II: Numrat 26-50;

Etiketat me numrat 1 -100 mund të vendosen në një kënd të klasës.



Grupi III: Numrat 51-75;
Grupi IV: Numrat 76-100.

Hapi 2: Detyra 1 – Lexohen fjalitë dhe shënohet numri: 30, 61, 96 dhe 36.

Detyra 2 – Lexohen kërkesat: 1-11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20; 2-70, 69, 68, 67, 66, 65, 64, 63, 62,61.

Hapi 3: Detyra 4 – Krahasohen numrat e dhënë <, >.

Hapi 4: Detyra 5 – Numrat e dhënë radhiten sipas kërkesës.

12, 13, 24, 37, 56, 73	89, 83, 56, 45, 7, 0

Detyra 6 -

48, 61, 81	39, 43, 46, 53

Hapi 5: Detyra 7 – Gjejmë paraardhësin dhe pasardhësin e numrave.

Hapi 6: Shënojnë dy numra nga 1 – 100. Nxënësit i krahasojnë ata, gjejnë para-ardhësin dhe pasardhësin.

35 , 78
35 < 78
34 – 35 – 36
77 – 78 – 79

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shkrimin e numrave sipas një rregulle, krahasimin dhe gjetjen e paraardhësit dhe pasardhësit.

Detyrë:

Shënon dhjetëshen e katërt të numrave, me numër dhe fjalë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 39

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Numëron dhe rendit numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2,8, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2, 2.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Radhit numrat nga 1-100;
- Emërton njëshet dhe dhjetëshet në numrat e dhënë;
- Shkruan vargun e numrave sipas një rregulle të caktuar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahet nga një fletë. Në tabelën e paraqitur mungojnë numrat. U kërkohet t'i plotësojnë duke i radhitur nga numri 1 deri ne 100.



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen që së bashku me mësimdhënësin të plotësojnë detyrën 2. (U shpjegohet që zgjidhjet i gjejmë duke shtuar horizontalisht → +1 dhe vertikalisht ↑ +10).

Hapi 3: Nxënësit punojnë të pavarur, në libër, detyrën 3.

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 4 në libër. Detyra shënohet në tabelë, ku u tregohet se duhet plotësuar vargun e numrave, duke shtuar horizontalisht (+2, +5, -1 dhe -5).

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 7. U shpjegohet se si zgjidhjet e katrorëve i gjejmë duke shtuar vertikalisht nga 10 dhe horizontalisht nga 1. (Zgjidhjet e katrorëve janë 64, 46, 35, 25, 93, 35, 5).

Hapi 6: Nxënësit në grupe duhet të shkruajnë nga pesë numra dyshifrorë, të cilët duhet t'i ndajnë në njëshe dhe dhjetëshe (detyrat janë të përgatitura në fletë).

4Dh	2Nj	42	katërdhjetë e dy

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zbërthimin e numrave në njëshe dhe dhjetëshe, si dhe për shkrimin e numrave sipas një rregulle.

Detyrë:

Detyrat 5 dhe 6 (faqe 57).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 40

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Numëron në rendin rritës dhe zbritës me numrat deri në 100 (me njëshe dhe dhjetëshe), si dhe cakton paraardhësin dhe pasardhësin e çdo numri.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1;2.1;6.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton njëshet dhe dhjetëshet e numrave të dhënë;
- Rendit numrat sipas madhësisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra 1-100.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me numra dhe kërkohet nga ata që të bëjnë renditjen e atyre numrave. Numrat në etiketa mund të jenë nga 1-100.



Hapi 2: Zhvillohen aktivitete me nxënës për numrat deri në 100, të cilët mund të përzgjidhen në linkun në vijim:

https://www.youtube.com/watch?v=AKX-VziZ-kdw.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të ploësojnë detyrat në libër:

Detyra 1. Formojnë dhjetëshet dhe numërojnë njëshet.

Detyra 2. Nxënësit udhëzohen të shkruajnë të gjithë numrat dyshifrorë me numrat 5, 2, 3, 4. Numrat nuk përsëriten. Më pas radhitin numrat e formuar sipas madhësisë.

Në detyrën 4, nxënësit duhet të gjejnë rregullat e plotësimit të fushave me numra. Rregulla është që horizontalisht numrat rriten ose zvogëlohen për 1, kurse vertikalisht rriten ose zvogëlohen për 10.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen disa numra dyshifrorë (mund të shfrytëzohen etiketat me numra) dhe kërkohet nga ata që për numrat e dhënë të tregojnë dhjetëshet dhe njëshet dhe të bëjnë renditjen e tyre sipas madhësisë. Renditja e numrave mund të jetë nga numri më i vogël te më i madhi apo anasjelltas.

P.sh.: numri 58:

Dh	Nj
5	8

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin e dhjetësheve dhe njësheve dhe renditjen e numrave.

Detyrë:

Detyra 3 (faqe 58).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 41

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, II.8, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Mbledhja dhe zbritja me dhjetëshe të plota

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e dhjetësheve të plota.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kub.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Edukatë figurative.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Loja me zar
Paraprakisht përgatitet një kub që do të përdoret si zar për të luajtur. Në faqet e kubit shkruhen dhjetëshet e plota 10, 20 deri në 60. Ftohen dy nxënës të zgjedhur në mënyrë të rastësishme të dalin para klasës. Njëri nga ta e hedh zarin dy herë, ndërsa tjetri shkruan barazimet e fituara në tabelë. Në rast se numri i parë është më i madh sesa i dyti, atëherë numrat e fituar zbriten, në të kundërtën kur numri i parë është më i vogël sesa i dyti, numrat e fituar mblidhen. P.sh., nëse 70 është numri i fituar në hedhjen e parë dhe 40 numri i fituar në hedhjen e dytë, shkruhet barazimi 70-40=30. Kjo veprimtari vazhdon me disa nxënës.

Hapi 2: Detyra 1: Njehsohet shuma dhe ndryshimi i dhjetësheve të plota të dhëna në detyrë. Pastaj pyeten nxënësit:
- Si i emërtojmë numrat që marrin pjesë në mbledhje? (Mbledhori i parë, mbledhori i dytë;)



- Si i emërtojmë numrat që marrin pjesë në zbritje? (I zbritshmi, zbritësi).

Hapi 3: Detyra 2: Nxënësit në mënyrë të pavarur llogarisin shumën dhe ndryshimin e dhjetësheve të plota. Pas llogaritjes, diskutohen zgjidhjet e detyrës.

Hapi 4: Nxënësve u sqarohet se llogaritja e shumës dhe ndryshimit të dhjetësheve të plota në detyrën e dhënë bëhet duke e përcjellë drejtimin e shigjetës. Pas udhëzimeve të marra, nxënësit punojnë në mënyrë individuale detyrën.

Hapi 5: Problemë – "Mira ka 100 figura lulesh. Ajo do t'i ndajë ato në dy grupe.
Shkruaj pesë barazime që mendon se mund t'i ndajë Mira lulet." (Kriter: grupet të jenë dhjetëshe të plota.)

10 + 90 = 100, 20 + 80 = 100, 30 + 70 = 100, 40 + 60 = 100, 50 + 50 = 100

Nxënësit i lexojnë barazimet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të dhjetësheve të plota.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 59).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 42

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100;
- Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2, 8; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3; 3.1, 6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën dhe ndryshimin e numrave në barazimet e dhëna;
- Njehson mbledhjen dhe zbritjen e numrave me figura;
- Krijon situata të thjeshta problemore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Top, zar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Loja me top: Një grup prej 4-5 nxënësish luajnë me top duke ia gjuajtur topin njëri-tjetrit.

Nxënësi që ka topin thotë numrin 10 dhe ia gjuan topin tjetrit, i cili i shton 30, pra thotë 40, tjetri thotë 70, tjetri 100. Më pas fillojnë nga 100 duke hequr numra.

Kjo veprimtari vazhdon me disa grupe, duke caktuar mësuesi paraprakisht rregullën e shtimit dhe heqjes së numrave.



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë dhe të plotësojnë katrorët e zbrazët me numrat që duhet në detyrat 1, 2 dhe 3 dhe më pas të lexohen zgjidhjet e të bëhen korrigjimet e nevojshme.

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet që të njehsojnë dhe të vendosin shenjat <, =, >.

Hapi 4: Kërkohet që në detyrat 2 dhe 4 në faqen 60 të njehsohet me anë të figuarve.

□ → 30
△ → 20

□ + △ = ___

Hapi 5: Loja me zare

Përgatitet një kub që do të përdoret si zar për të luajtur. Në faqet e kubit shkruhen numrat nga 10 deri në 60. Ftohet një nxënës të hedhë kubin (zarin) dy herë dhe një nxënës tjetër t'i shkruajë barazimet në tabelë.

P.sh., 30 + 50 = 80.



Kjo veprimtari vazhdon me disa nxënës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në mbledhjen, zbritjen dhe krijimin e barazimeve me dhjetëshe të plota.

Detyrë:

Detyrat 1 dhe 3 (faqe 61).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 43

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrave dyshifrorë me numër njëshifror pa kalim të 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën e numrave dyshifrorë me numër njëshifror;
- Formon brazime me mbledhjen e numrave pa kaluar 10.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në dy kuti ka etiketa me numra: në kutinë 1 – numra dyshifrorë (32, 54, 61, 83) dhe në kutinë 2 – numra njëshifrorë (4, 5, 2, 3). Tërhiqen numrat nga kutia 1 dhe nga kutia 2. Formohen barazime:
32 + 4 = 36
54 + 5 = 59
61 + 3 = 64
83 + 3 = 86

Hapi 2: Detyra 1 – Nxënësit vështrojnë figurat e dhëna duke llogaritur shumën e numrave.
Detyra 2 – Nxënësit llogaritin shumën e numrave të dhënë.

Hapi 3: Detyra 3 – Nxënësit në dyshe vështrojnë tabelat e dhëna në libër dhe në fletore shënojnë barazitë për të gjetur shumën e numrave. Njëri nxënës shënon barazimet në tabelën e parë, nxënësi tjetër

1 Njehsojmë:



4 + 3 = ☐ 34 + 3 = ☐ 44 + 3 = ☐ 54 + 3 = ☐

2 Njehsojmë shumën.

70	71	72	73	74	75	76	77	78	79	80

90	91	92	93	94	95	96	97	98	99	100

71 + 4 = ☐	74 + 4 = ☐	91 + 4 = ☐	94 + 4 = ☐
75 + 3 = ☐	72 + 5 = ☐	95 + 2 = ☐	92 + 6 = ☐
71 + 5 = ☐	73 + 6 = ☐	91 + 5 = ☐	93 + 6 = ☐
72 + 2 = ☐	78 + 2 = ☐	92 + 2 = ☐	98 + 2 = ☐

3 Plotësojmë tabelat.

	70	71	72	73	74	75
+2						
+3						

	90	91	92	93	94	95
+4						
+5						

4 Ta njehsojmë shumën:

81 + 4 = ☐	93 + 7 = ☐	65 + 4 = ☐	72 + 7 = ☐
16 + 3 = ☐	44 + 5 = ☐	81 + 7 = ☐	34 + 2 = ☐
78 + 0 = ☐	63 + 6 = ☐	56 + 2 = ☐	91 + 8 = ☐

shënon barazimet në tabelën e dytë.

70 + 2 = 72	90 + 4 = 94
70 + 3 = 73	90 + 5 = 95
71 + 2 = 73	91 + 4 = 95
...	....
75 + 3 = 78	95 + 5 = 100

Më pas nxënësit ndërrojnë fletoret me shokun dhe kontrollojnë barazimet.

Hapi 4: Nxënësit në mënyrë individuale formojnë pesë barazime me mbledhjen e numrave dyshifrorë me numër njëshifror pa kalim të numrit 10.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës së numrave dhe formimin e barazimeve pa kalim të 10.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 62).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 44

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1;1.3;3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën e numrave dyshifrorë me numër njëshifror pa kalim të 10.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Blloqet e Dienes (shufrat dhe kubet).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet lojë matematikore me nxënësit. Kërkohet nga ata të lëvizin nëpër klasë derisa dëgjojnë muzikë. Në momentin që muzika ndalet, ndalen edhe nxënësit dhe kapen për dore me shokun ose shoqen që kanë afër dhe tregojnë shumën për mbledhorët që dëgjojnë (ose shikojnë në projektor), p.sh., 45+3. Nxënësit, siç janë në dyshe dorë për dore, i tregojnë njëri-tjetrit shumën. Loja përsëritet disa herë.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të bëjnë mbledhjen e numrave dyshifrorë me një numër dyshifror duke përdorur shufrat dhe kubet (Blloqet e Dienes). Për të mbledhur numrin 34 + 5, përdoren tri shufra dhe 4 kube dhe më pas shtohen + 5 kube. Sqarohet se numri 35 ka 3 dhjetëshe dhe 5 njëshe. Bëhet mbledhja e njësheve 4+5 =9; vijon mbledhja 34+5=39.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë shumën e numrave në detyrat 1 dhe 2.
Para se të plotësohet detyra 3, sqarohet mble-



dhja kur mungon mbledhori përmes boshtit numerik sipas modelit në libër.
Nxënësit udhëzohen të gjejnë mbledhorin që mungon në detyrën 3. Mund të parashtrohen pyetje: Sa është mbledhori i parë? (44); Sa është numri i njësheve te mbledhori i parë (4); Sa është shuma? (46); Sa është numri i njësheve te shuma? (6); Sa njëshe duhet shtuar te numri 4 për të fituar numrin 6? (2); Sa është mbledhori që mungon? (2).

Hapi 4: Shpërndahen etiketa me detyra për nxënësit dhe kërkohet nga ata të gjejnë shumën e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror pa kalim të 10.
Etiketat mund të përmbajnë detyra sipas shembujve:

42 + 7 51 + 6 76 + 3

83 + 5 22 + 4

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shumës së numrave dyshifrorë me një numër njëshifror pa kalim të 10.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 63).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 45

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.3, V.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2;3.3,5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrit njëshifror nga numri dyshifror pa e prishur 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton kufizat e zbritjes;
- Gjen ndryshimin e numrave dyshifrorë pa e prishur 10;
- Krijon situata të ndryshme duke përdorur zbritjen e numrave pa e prishur 10.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Top.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Eduaktë fizike, sportet dhe shëndeti.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet t'i përmendin se cilat veprime matematikore janë mësuar? (mbledhjen dhe zbritjen). Si quhet numri i parë te zbritja? (i zbritshmi); Numri i dytë? (zbritësi); Kur zbresim çka fitojmë? (ndryshimin).
Diskutohet:

Arta ka 7 lapsa, por 2 i humbi. Sa lapsa i mbetën? (7-2=5). Por, nëse Arta ka 37 lapsa dhe 2 i humbën, sa lapsa i mbetën (37-2= 35).

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë në libër detyrën 1. Diskutohen këto pyetje:

- Gjithsej sa rrathë të kuq janë? (7); Sa i kemi hequr me vijë?(4); Sa mbetën? (3) (7-4=3).
- Gjithsej sa rrathë të kuq janë? (37); Sa i kemi hequr me vijë?(4); Sa mbetën? (33) (37-4=3).



Hapi 3: Nxënësit punojnë detyrën 2, në libër, në mënyrë të pavarur. Pas përfundimit të detyrave i shkëmbejnë librat me shokun e bankës, duke shikuar se a janë të sakta zgjidhjet e barazimeve.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë tabelat në detyrën 3. Nuk duhet harruar që veprimi i zbritjes fillon nga njëshet.

Hapi 5: Kërkohet nga nxënësit të formojnë një rreth. Në qendër të rrethit është një nxënës me një top në dorë. Ai duhet t'ia hedhë topin një shoku dhe të thotë një barazim, p.sh.18-4, nxënësi që merr topin duhet të përgjigjet saktë. Nxënësi që thotë barazimin e gabuar duhet të dalë nga rrethi. Fitues është ai që mbetet i fundit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në për zbritjen e numrave njëshifrorë nga një numër dyshifror.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 64).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 46

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3, 1.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson ndryshimin e numrave të dhënë në tekst.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve në dyshe u shpërndahen etiketa me detyra dhe zgjidhjet e tyre veçmas. Kërkohet nga dyshet e nxënësve që të bashkojnë detyrën me zgjidhjen e duhur. P.sh.:

69 – 5	54 – 2	68 – 4	33	52	71
37 – 4	76 – 5	78 – 5	64	64	73

Hapi 2: Në tabelë paraqitet shprehja numerike 85 – 3. Nxënësve u sqarohet se veprimi i zbritjes fillon nga njëshet. 5NJ - 3NJ = 2Nj, ndërsa numri i dytë nuk ka dhjetëshe, andaj kalohen dhjetëshet e numrit të parë ashtu si janë, pra 8 Dh. Lexohet: 85 – 3 = 82.
Pyeten nxënësit:
- Si i emërtojmë kufizat/numrat që marrin pjesë në këtë veprim? (85– i zbritshmi, 3-zbritësi, 82– ndryshimi);
- Numri 82, është numër dyshifror? Pse?



1 Njehsojmë:

6 – 4 = ☐ 7 – 3 = ☐ 8 – 5 = ☐ 9 – 7 = ☐
46 – 4 = ☐ 37 – 3 = ☐ 58 – 5 = ☐ 49 – 7 = ☐
96 – 4 = ☐ 87 – 3 = ☐ 78 – 5 = ☐ 99 – 7 = ☐

2 Shprehjet numerike i bashkojmë me vlerat e tyre.

85 – 4 • • 82
87 – 5 • • 81
89 – 6 • • 83
69 – 4 • • 62
67 – 5 • • 60
65 – 5 • • 65
99 – 6 • • 94
96 – 2 • • 96
99 – 3 • • 93

3 Njehsojmë dhe paraqesim në boshtin numerik.

67 – ☐ = 61

79 – ☐ = 72

4 Njehsojmë dhe plotësojmë:

64 – ☐ = 61 33 – ☐ = 32 84 – ☐ = 82
65 – ☐ = 63 37 – ☐ = 32 86 – ☐ = 85
63 – ☐ = 62 36 – ☐ = 34 86 – ☐ = 86

USHTROJMË

65

- Sa është shifra e njësheve te numri 82?
- Sa është shifra e dhjetësheve te numri 82?

Hapi 3: Detyra 1: Nxënësit llogarisin ndryshimin e numrave njëshifrorë nga numrat dyshifrorë. Njëjtë veprohet me detyrën e dytë. Pasi të kenë llogaritur ndryshimin e numrave, shprehjet numerike i bashkojnë me vlerat e tyre përkatëse.

Hapi 4: Detyra 3: Njehsohet e panjohura në detyrën e dhënë. Pyeten nxënësit:

- Cila kufizë/numër mungon?
- Si mund ta gjejmë atë?

Pastaj numrat e fituar paraqiten në bosht numerik.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e ndryshimit të numrave të dhënë.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 65).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 47

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes;
- Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2; III.2, 3, 4; IV.2, 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4; 3.4; 6.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave dyshifrorë pa e prishur numrin dhjetë;
- Krijon situata të thjeshta ku përdor zbritjen pa prishur numrin 10.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gota të plastikës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që të njehsojnë dhe të plotësojnë katrorët e zbrazët me numrat që duhen. Bisedohet me nxënësit:

40 – 20 – 10 = ☐ → Cila nga kufizat mungon?
→ Si mund ta gjejmë atë?

Më pas kërkohet të lexojnë zgjidhjet dhe të bëjnë korrigjimet e nevojshme.

Hapi 2: Në detyrën 2, nxënësit udhëzohen që përmes mbledhjes dhe zbritjes të gjejnë numrin që mungon, kurse vendvlera e katrorëve të gjelbër në detyrën 3 gjendet përmes këtyre pyetjeve gjatë diskutimit me nxënës:



- Ku gjendet katrori me ngjyrë të gjelbër?
- Për sa katrorë është e larguar shigjeta?
- Cili numër duhet të shkruhet në katror?

Hapi 3: Zgjidhen 2 nxënës që mbledhjen dhe zbritjen ta bëjnë në role. Njëri bëhet shitësi dhe tjetri blerësi. Nxënësit mund t'i përdorin gjërat që gjenden në klasë dhe t'i bëjnë njëri-tjetrit këto pyetje:
Sa kushton ky libër?
A mund ta kryej pagesën me 2 € dhe 1 €? Pse?

Hapi 4: Në gota të plastikës shkruhet i zbritshmi (98) dhe zbritësi (7, 3, 4, 6). Ndahen nxënësit në grupe dhe u kërkohet që të njehsojnë dhe t'i bashkojnë gotat me rezultatet që duhet. Grupi që kryen detyrën me sukses, fiton.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e ndryshimit të numrave dyshifrorë pa prishur numrin 10.

Detyrë:

Shkruan 5 problema me veprimin e zbritjes.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 48

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.3, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3; 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrave dyshifrorë me numër njëshifror me kalim të 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën e numrave dyshifrorë me numrat njëshifrorë duke plotësuar 10;
- Zbërthen mbledhorin si shumë të dy numrave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me detyrë me fjalë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Babai pa arkën e kursimeve të Artit. Ai kishte 67 euro. Babai vendosi që ta shpërblejë edhe me 7 euro për mësimet dhe sjelljen e mirë. Ai kërkoi nga Arti që së pari në arkë të fuste aq para sa të plotësonte dhjetëshen e më pas edhe paratë e tjera.
Sa para ka Arti?
67 + 7 = 67 + (3 + 4) = (67 + 3) + 4 = 70 + 4 = 74.

Hapi 2: Detyra 1 – Vështrohen numrat e dhënë në tekst dhe llogaritet shuma e tyre.
69 + 6 = 69 + 1 = 70 + 5 = 75
1 + 5
58 + 7 = 58 + 2 = 60 + 5 = 65
2 + 5
87 + 9 = 87 + 3 = 90 + 6 = 96
3 + 6



Detyra 2 – Në boshtin numerik llogaritet shuma e numrave 67 dhe 8.
67 + 8 = 67 + 3 = 70 + 5 = 75

Detyra 3 – Nxënësit llogaritin shumën e numrave të dhënë, duke zbërthyer mbledhorin e dytë në dy mbledhorë.

Hapi 3: Nxënësit zgjedhin 6 nga 12 barazimet në detyrën 4, që të llogaritin shumën e tyre duke kaluar numrin 10, në fletore.
35 + 9 = 35 + (5 + 4) = (35 + 5) + 4 = 40 + 4 = 44

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës së numrave duke kaluar 10.

Detyrë:

Detyra 4 në faqen 67 (6 barazimet e mbetura).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 49

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën e numrave dyshifrorë me numër njëshifror me kalim të 10.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet aktiviteti me nxënësit të ndarë në dyshe. Secilës dyshe u përcaktohen nga 4 numra. Kërkohet që për numrat e dhënë të tregojnë se sa duhet shtuar te secili numër për ta formar dhjetëshen e plotë. P.sh., nëse numri i caktuar është 37, cili numër duhet shtuar që të formohet 40? (3).
Numra të mundshëm që mund t'u shpërndahen nxënësve janë: 25, 46, 72, 84, 36 etj.

Hapi 2: Nxënësve u rikujtohet mbledhja e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror me kalim të dhjetës përmes paraqitjes së videos në linkun në vijim: https://www.youtube.com/watch?v=fFQrEHr4lPw. Gjatë shikimit të videos, jepen sqarime për nxënës.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 1 në libër, duke njehsuar shumën në bazë të modelit të dhënë. Fillimisht duke plotësuar 10, për ta gjetur shumën.
Sqarohen modelet në detyrën 2 dhe nxënësit të pavarur vazhdojnë plotësimin e detyrës. Cilët janë mbledhorët? (85+7); Edhe sa i duhet shtuar numrit 85 që të bëhen 90? (5); Sa mbesin te numri 7? (2); Sa



USHTROJMË

1 Duke njehsuar, plotësojmë:

64 +6 70 +5 +6 +7
67 +3 +4
66

85 +5 86 +4 88 +2 +3 +7 +4

2 Njehsojmë edhe në këtë mënyrë.

85 + 7 = ☐
85 + 5 + 2 = 92

49 + 8 = ☐
49 + 1 + 7 = ☐

34 + 9 = ☐
34 + 6 + 3 = ☐

58 + 6 = ☐
77 + 8 = ☐
84 + 9 = ☐
28 + 8 = ☐

90 + 4 = ☐
68 + 5 = ☐
32 + 9 = ☐
47 + 6 = ☐

84 + 7 = ☐
47 + 4 = ☐
36 + 5 = ☐
76 + 7 = ☐

3 Njehsojmë dhe i shënojmë zgjidhjet.

+7	
26	
	56
83	
	95

+8	
45	
	73
39	
	84

+9	
74	
	100
89	
	63

4 Në një vitrinë në klasë, librat janë vendosur në dy rafte. Në raftin e parë janë 45 libra, kurse në raftin e dytë janë 8 libra më shumë. Sa libra janë në raftin e dytë?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

68

është shuma? (92). Pra, 85+5+2=92

Hapi 4: Lexohet problema me fjalë, e paraqitur në detyrën 4. Udhëzohen nxënësit të gjejnë zgjidhjen duke njehsuar shumën me kalim të numrit 10.

45+8= 45 +5+3=53

Në raftin e dytë janë 53 libra.

Hapi 5: Nxënësve u kërkohet të gjejnë shumën me kalim të 10. Disa nga detyrat për nxënësit mund të jenë: 39 + 7= 67+5= 38+9= 44+ 8=

Detyrat e njehsuara kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë për njehsimin e shumës së numrave dyshifrorë me një numër njëshifror me kalim të 10.

Detyrë:

Detyra 3 (faqe 68).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 50

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrave në shtylla

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan numrat në shtylla sipas njësheve dhe dhjetësheve;
- Gjen shumën e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror;
- Arsyeton rezultatet e fituara në detyrat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë paraqiten dy fletë ku janë të vendosura dy shtylla. Njëra shtyllë është me ngjyrë të kuqe dhe tjera shtyllë me ngjyrë të kaltër. Në qendër të shtyllave është vendosur numri 14. Shigjeta në anën e djathtë tregon njëshet (numrin 4), ndërsa shigjeta në anën e majtë tregon dhjetëshet (numrin 1). Ndërsa në rastin e dytë nuk kemi dhjetëshe, por kemi vetëm 2 njëshe.

Hapi 2: Nxënësit vëzhgojnë detyrën 1. Jepen sqarime rreth detyrës 34+5 = ☐ (detyra shënohet në tabelë). U tregohet që mbledhorët e njëjtë mund të shënohen edhe në shtyllë (të mos harrohet që njëshet duhet shënuar përfundi njësheve dhe dhjetëshet përshkruhen).
Diskutohen këto pyetje:



Për mësuesin/en



1. Numri 34 sa njëshe dhe sa dhjetëshe ka? (4 Nj dhe 3 Dh);
2. Numri 5 sa njëshe dhe sa dhjetëshe ka? (5 Nj dhe 0 Dh).

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 2. Në tabelë paraqiten dy etiketa, një me ngjyrë të kuqe (tregohen njëshet) dhe një me ngjyrë të kaltër (tregohen dhjetëshet). Shënohet barazimi në tabelë:
67+3 = 70 .
Në etiketë me ngjyrë të kuqe janë shënuar numrat (7+3) dhe në etiketën e kaltër është shënuar numri 6. Tregohet (7+3=10), që 0 shënohet te njëshet, ndërsa 1 bartet te dhjetëshet dhe mblidhet me dhjetëshen tjetër që është numri 6.

Dh	Nj
6	7
+	3
1 ←	10
7	0

Hapi 4: Nxënësit punojnë të pavarur detyrat 1, 2 dhe 3. Udhëzohen që në fillim duhet të mblidhen njëshet dhe më pas dhjetëshet. Pas plotësimit të detyrave lexohen zgjidhjet në mënyrë zinxhirore duke i shpjeguar ato.

Hapi 5: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen fletë të përgatitura nga mësimdhënësi. Ata do ta bëjnë mbledhjen e numrave në shtylla, duke mos e kalur dhjetëshen, si dhe mbledhjen e numrave në shtylla me kalim të dhjetëshes, si dhe ta bëjnë bartjen e dhjetësheve.

$$\begin{array}{r} 41 \\ +\ 5 \\ \hline \end{array} \qquad \begin{array}{r} 58 \\ +\ 4 \\ \hline \end{array}$$

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në mbledhjen e numrave në shtylla pa kalim të dhjetëshes dhe mbledhjen e numrave duke bërë bartjen e dhjetësheve.

Detyrë:

Detyrat 4 dhe 5 (faqe 70).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 51

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen zbritjen e numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 1.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Zbritja e numrit njëshifror nga numri dyshifror, duke veçuar 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrit njëshifror nga numri dyshifror duke veçuar dhjetëshen;
- Zbërthen zbritësin si shumë të dy mbledhorëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit ndahen në grupe dhe u shpërndahen etiketa, p.sh., grupit të parë 15 etiketa, të dytit 18 etiketa, grupit të tretë 13 etiketa. Numri i etiketave për grup duhet të jetë prej 11 deri në 19. Kërkohet nga nxënësit të veçojnë etiketat dhe të mbesin nga 10 etiketa në secilin grup. Pyeten grupet e nxënësve:

- Si e keni bërë ndarjen e etiketave?

Hapi 2: Në tabelë paraqitet shprehja 12 – 5. U rikujtohet se kur zbriten dy numra fitohet ndryshimi. Tregohet se numri i parë në veprimin e zbritjes quhet i zbritshmi dhe numri i dytë quhet zbritësi. Gjithashtu, sqarohet me shembuj konkretë: Marrim gjithsej 12 lapsa, nga ta duhet të heqim 5. Për të veçuar një dhjetëshe, zbritësin, pra numrin 5, duhet të ndajmë në shumë të dy numrave, si 2 dhe 3. Pra, numrit 12 i heqim dy njëshe, ashtu që të veçojmë dhjetëshen. Shkruhet në tabelë:



12 - 5 =12 - (2 + 3) = (12 - 2) – 3 = 10 – 3 = 7

Hapi 3: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që ta plotësojnë detyrën një, shprehjen 71 - 8. Pastaj pyeten:

- Cilat janë kufizat në shprehjen e dhënë?
- Sa duhet t'ia heqim numrit 71 që të bëhet 70?
- Sa mbesin te numri 8?
- Pse zbritësi ndahet në dy mbledhorë? (Për të veçuar dhjetëshen.)

Hapi 4: Detyra 2: Në tabelë vizatohet boshti numerik i dhënë në libër. Shpjegohet zbritja e shprehjes 75-8 në bosht numerik, duke veçuar dhjetëshen.

Detyra 3: Nxënësit gjejnë ndryshimin e numrave të dhënë, duke veçuar dhjetëshen sipas udhëzimeve dhe shpjegimit të bërë në detyrat e mësipërme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zbritjen e numrave të dhënë dhe në zbërthimin e zbritësit si shumë e dy mbledhorëve.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 71).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 52

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes;
- Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
- Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.2; III.2, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3; 3.1, 3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave dyshifrorë duke veçuar dhjetëshen;
- Zbërthen zbritësin si shumë e dy mbledhorëve;
- Arsyeton mënyrën e zgjidhjes së detyrës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me barazime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1:

75 - 8 =
67

Nxënësve u shpërndahen etiketa me barazime (p.sh., 75 - 8 = __). Në njërën anë të etiketës shkruhet barazimi, ndërsa në anën tjetër shkruhet zgjidhja. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë zgjidhjen dhe ta krahasojnë atë me zgjidhjen që është në anën e kundërt të etiketës. Nxënësit që e kanë zgjidhjen e njëjtë diskutojnë mes vete dhe tregojnë për mënyrën e zgjidhjes së detyrës.



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë dhe të plotësojnë ushtrimin 1. Në detyrën e parë, nga numri 80 duhet të zbresin numrat 2, 3 dhe 4, ndërsa në detyrën e dytë duhet të gjejnë numrin që mungon dhe nga ai të zbresin të njëjtët numra si në detyrën e parë.

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të plotësojnë detyrën 2. Nxiten të tregojnë se përse zbritësi paraqitet i zbërthyer si shumë e dy mbledhorëve.

72 - 8 = □ 72 - □ =62

Hapi 4: Nxënësit bashkëpunojnë me shokun/shoqen e bankës dhe njehsojnë e plotësojnë detyrën 3 në këtë formë: njëri gjen shumën e numrave, kurse tjetri gjen ndryshimin e tyre.

✓ Pastaj bëhet korrigjimi dhe leximi radhazi i rezultateve.

VEPRIMTARI
Kërkohet nga nxënësit të krijojnë detyra të ngjashme si në libër për shokun/shoqen dhe të gjejnë zgjidhjen e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të ndryshimit të numrave dyshifrorë, duke veçuar dhjetëshen dhe duke zbërthyer zbritësin.

Detyrë:

Krijon 5 barazime të njëjta si në detyrën 2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 53

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e zbritjes

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Zbritja e numrave në shtylla

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan numrat në shtyllë sipas vendvlerave të shifrave njëshe dhe dhjetëshe;
- Gjen ndryshimin e numrave dyshifrorë me numër njëshifror në shtyllë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me numrat (76, 67, 83, 45), ku ata do të gjejnë sa dhjetëshe dhe sa njëshe ka numri i përzgjedhur.

Dh	Nj

Dh	Nj

Dh	Nj

Dh	Nj

Hapi 2: Pasi vendosen numrat në vendvlerat e tyre (Dh dhe Nj), shënohet shenja e zbritjes dhe gjendet ndryshimi i numrave.

- Nga cilin rend fillon zbritja? (NJ)

Dh	Nj
7	6
-	4
7	2



1 Njehsojmë:

	Dh	Nj
−	5	6
		4
	5	2

	Dh	Nj
−	6	8
		7

	Dh	Nj
−	3	5
		2

	Dh	Nj
−	7	4
		4

	Dh	Nj
−	2	9
		6

2 Njehsojmë:

−	1 8	
	6	

−	2 9	
	7	

−	4 4	
	1	

−	5 6	
	3	

−	7 7	
	5	

−	4 6	
	2	

3 Njehsojmë:

	Dh	Nj
	4	16
−	5	6
		8
	4	8

−	3 4	
	7	

−	6 2	
	5	

−	6 2	
	9	

−	8 3	
	5	

	Dh	Nj
−		
	7	3
		8

4 Duke njehsuar, do të zbulojmë një thënie popullore.

− 7 5	
8	
	A

− 9 1	
8	
	Ë

− 8 4	
5	
	S

− 2 2	
7	
	D

− 8 2	
8	
	U

− 5 1	
3	
	R

− 6 4	
8	
	SH

− 3 3	
4	
	T

− 9 4	
8	
	P

− 6 2	
5	
	I

| | | |

Mësimi 54

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.1; 3.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave dyshifrorë me një numër njëshifror.
- Përdor modele të ndryshme për njehsimin e shumës dhe ndryshimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Blloqet e Dienes (shufrat dhe kubet), TV, internet, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen shufra dhe kube dhe u kërkohet që fillimisht të paraqesin me shufra dhe kube (shufrat paraqesin dhjetëshet dhe kubet njëshet) mbledhorët në barazimet e mbledhjes dhe të zbritshmin dhe zbritësin në barazimet e zbritjes. Më pas kërkohet nga nxënësit të gjejnë shumën, përkatësisht ndryshimin, dhe t'i paraqesin me shufra dhe kube. Disa detyra të mundshme:
25+6= ; 33+9= ; 76+7= ; 43-8= ; 36-9= ; 55-7= .
Mund të zhvillohen edhe lojëra interaktive matematikore në linqet:
https://www.iknowit.com/lessons/b-adding-2-digit-plus-1-digit.html
https://www.iknowit.com/lessons/b-2-digit-minus-1-digit.html

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat në libër.
Detyra 1. Nxënësit vëzhgojnë figurën dhe numërojnë shufrat dhe kubet, si dhe shkruajnë numrat në kutiza.



Detyra 2. Nxënësit udhëzohen të njehsojnë shumën e një numri dyshifror me një numër njëshifror: P.sh., 58+2=60.

Detyra 3. Bëhet krahasimi i numrave, së pari njehsohet shuma dhe më pas krahasohen shumat duke vendosur shenjën: >,< ose =. P.sh.:73+8 > 71+9.

Detyra 4. Nxënësit udhëzohen ta lexojnë dhe ta kuptojnë problemin e shprehur me fjalë dhe të gjejnë numrin.

Detyra 6. Nxënësit udhëzohen të gjejnë shumën dhe ndryshimin, duke u bazuar në boshtin numerik.

Detyrat 7 dhe 8. Nxënësit udhëzohen të njehsojnë shumën dhe ndryshimin dhe më pas në dyshe të bashkëpunojnë dhe të kontrollojnë detyrat e njëri-tjetrit.

Hapi 3: Në projektor (TV ose tabelë) shfaqen para nxënësve detyra të mbledhjes dhe zbritjes së një numri dyshifror me një numër njëshifror. Kërkohet nga nxënësit që të zgjedhin 6 nga barazimet e paraqitura dhe t'i njehsojnë ato në fletore.

Disa nga detyrat që mund të paraqiten para nxënësve janë:

74+ 6= 85+7= 29+5= 66+8=

61-3= 34=9= 93-5= 52-3=

Detyrat e njehsuara kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë për njehsimin e shumës dhe ndryshimit të numrave dyshifrorë me një numër njëshifror.

Detyrë:

Detyra 5 (faqe 75), detyra 9 (faqe 76).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 55

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modele.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3;III.4,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1, 3.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbatojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan mënyrën e blerjes me monedha;
- Dallon monedhat metalike nga kartëmonedhat;
- Shkruan numrat në vend të figurave.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Monedha metalike, kartëmonedha, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit luajnë në dyshe. U shpërndahen fletë të përgatitura paraprakisht, dhe u sqarohet mënyra e lojës. Njëri nxënës është shitësi dhe tjetri blerësi. Së pari, jepen sqarime për kartëmonedha dhe monedha metalike.

- Blerësi ka 15 euro, ariu kushton 10 euro. Nëse blerësi blen ariun, sa para duhet kthyer shitësi? (5).
- Njëri prej nxënësve pyet: *Kam 10 euro kartëmonedha dhe 2 euro monedhë metalike. Sa euro kam gjithsej?* Nxënësi tjetër i shënon dhe e tregon rezultatin. (12 euro).

Hapi 2: Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë në libër, së bashku me mësimdhënësin, detyrën 1. Diskutohen



këto pyetje:

- Sa duhet të jetë vlera e gjashtëkëndëshit, që kur të mblidhet me rrethin duhet të fitohet numri 36.
  ▢ → 27
- Sa duhet të jetë vlera e rrethit, që kur të zbritet me gjashtëkëndëshin fitohet numri 18.
  ◯ → 9
- Sa duhet të jetë vlera e hënës, që kur të mblidhen në mes vete fitohet numri 100?
- Sa duhet të jetë vlera e diellit, që kur të mblidhen në mes vete fitohet numri 50?

Hapi 3: Nxënësit punojnë të pavarur, në libër, detyrën 2. Diskutohen këto pyetje: Sa monedha metalike kemi? (7 euro); Sa janë me vlerën 2 euro? (2); Sa janë me vlerën 1 euro (3); Sa kartëmonedha kemi? (40 euro); Po, sa monedha? (4 cent).

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të punojnë në libër detyrën 3. Jepen disa sqarime (Numri 1 te rrethi tregon që ka përfunduar veprimi 1).
Në veprimin 1 është shënuar 10+10=20. Nëse shikohen gjallesat, kuptohet që bretkosa ka numrin 1 dhe peshku ka numrin 0, ndërsa breshka ka numrin 2.

- Në veprimin 2 si duhet vepruar? (Breshkës dhe zogut ia dimë numrat, sa duhet t'ia heqim kërmillit që të fitohet si ndryshim kërmilli?) Kërmilli ka numrin 5.



Hapi 5: Nxënësit të ndarë në dyshe do t'i plotësojnë detyrat që janë përgatitur në fletë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e monedhave metalike nga kartëmonedhat, si dhe duke bërë zëvendësimin e figurave me numra.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 56

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde;
- Krahason objekte sipas gjatësisë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Matja e gjatësisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Mat gjatësinë e segmenteve duke përdorur vizoren;
- Krahason segmentet sipas gjatësisë së tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Vizore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që, duke përdorur vizore, të paraqesin një segment në fletoren e tyre. Pasi ta kenë vizatur, u shpjegohet edhe fakti se matjen e gjatësisë së segmentit e fillojmë nga numri 0, pra nga fillimi i vizores. Për ta përcaktuar gjatësinë e segmentit të dhënë, lexohet vlera në vizore, vlerë kjo e cila tregon përfundimin e segmentit.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që ta gjejnë gjatësinë e shkopinjve të dhënë në detyrë. Pastaj u drejtohen këto pyetje:

- Sa është gjatësia e shkopinjve të dhënë?
- Cili nga ta është më i madh? Pse?


MATJA E GJATËSISË

MATJET

1 → njësi matëse për gjatësi.

Shkopin e dhënë më poshtë e krahasojmë me njësinë matëse.

Themi:

Shkopi i dhënë është më i shkurtër se ___ shkopinj njësi.
Shkopi i dhënë është më i gjatë se ___ shkopinj njësi.
Shkopi i dhënë është afërsisht sa ___ shkopinj njësi.

2 Nëse segmentin ⟷ e marrim për njësi gjatësie, për segmentin AB themi:

A B

Segmenti AB është më i shkurtër se ___ segmente njësi.
Segmenti AB është më i gjatë se ___ segmente njësi.
Segmenti AB është afërsisht sa ___ segmente njësi.

3 Ta gjejmë gjatësinë e lapsit.

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13

Njësia matëse:

0 1 cm 1

Lapsi është më i shkurtër se ___ *cm.*
Lapsi është më i gjatë se ___ *cm.*
Lapsi është i gjatë afërsisht ___ *cm.*

4 Duke i matur me vizore, gjejmë gjatësitë e segmenteve.

A B ___ cm
C D ___ cm
E F ___ cm
G H ___ cm
I J ___ cm
K L ___ cm

MËSOJMË

78

- Për sa shkopi i dytë është më i madh sesa shkopi i parë?

- Cila është njësia matëse për gjatësinë e shkopinjve të dhënë?

Njësoj veprohet edhe me detyrën e dytë, përveç se tani njësi gjatësie merret segmenti i dhënë me ngjyrë të kaltër në tekst.

Hapi 3: Detyra 3: Nxënësit udhëzohen të gjejnë gjatësinë e lapsit të dhënë.

Detyra 4: Nxënësit, në mënyrë individuale, masin gjatësinë e segmenteve AB, CD, EF, GH, IJ dhe KL.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në matjen e segmenteve dhe krahasimin e gjatësisë së tyre.

Detyrë:
Vizaton 5 segmente të madhësive të ndryshme.

Përcakton gjatësinë e secilit prej tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 57

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi standarde;
- Përdor centimetrin (cm) si njësi matëse standarde;
- Krahason objekte sipas gjatësisë duke përdorur shprehjet: më i gjatë, më i shkurtër, po aq.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; II.4; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 3.3; 4.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton gjatësinë e objekteve;
- Njehson gjatësinë e objekteve;
- Vizaton segmente me gjatësi të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Lapsa, ngjyra, vizore, figura gjeometrike të prera.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të zgjedhin një laps ose një ngjyrë dhe t'i lënë mbi bankën e tyre. Me sy mbyllur zgjedhin disa nga këta lapsa ose ngjyra dhe, duke i matur me vizore, gjejnë gjatësinë e tyre.



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të veprojnë njëjtë si mësimdhënësi dhe, duke i matur me vizore, të gjejnë gjatësinë e lapsave në detyrën 1. Diskutohet se cili nga lapsat është më i gjatë dhe cili më i shkurtër. Pse?

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen që në detyrën 2 me vizore të vizatojnë segmente me këto gjatësi: 5 cm, 10 cm, 7 cm, 13 cm, 9cm.

A B

Hapi 4: Në detyrën 3 nga nxënësit kërkohet që të përcaktojnë gjatësinë e brinjëve të trekëndëshit dhe të drejtkëndëshit dhe të plotësojnë tabelën. Pyeten nxënësit:

- Sa cm është gjatësia e brinjës a?
- Sa cm është gjatësia e brinjës b?
- Sa cm është gjatësia e brinjës c?
- Sa është gjatësia e të gjitha brinjëve të trekëndëshit?

Në të njëjtën formë veprohet edhe me matjen e gjatësive të drejtkëndëshit.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përgjigjet e dhëna dhe gjetjen e gjatësive të objekteve.

Detyrë:
Gjen gjatësinë e librit të matematikës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 58

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Njësitë matëse – Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përdor metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde;
- Mbledh dhe zbret gjatësinë e segmenteve duke përdorur njësitë matëse standarde (cm, m).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.4, 4.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Njësitë matëse (metri)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon metrin si njësi matëse;
- Shndërron njësitë matëse nga cm në m dhe anasjellas;
- Mbledh dhe zbret me njësitë matëse.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Metër, shami.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Aktivitet: Hidhe shaminë sa më larg
Vendoset një vijë prej ku nxënësit duhet ta hedhin shaminë sa më larg. Hedhja e shamisë shenjohet me pikë.

- Kush e ka hedhur shaminë më larg?
- Si mund ta gjejmë sa është gjatësia? (Me hapa, me shkopinj...)
- Me çka mund ta matim gjatësinë? (Me metër.)

Matet gjatësia me metër:
- Më e gjata
- Më e shkurta



Hapi 2: Metri, me gjatësi 1 metër, vendoset në tabelë (ose në një kënd në klasë) dhe shikohet ndarja e tij në cm.



1 m = 100 cm
100 cm = 1m

Hapi 3: Vështrohen figurat e dhëna në detyrën 2 dhe llogaritet shuma dhe ndryshimi i gjatësive të objekteve të dhëna.

Hapi 4: Detyra 3 – Nxënësit gjejnë numrin që duhet shtuar cm të dhënë për të fituar 1 m.

30 cm + 70 cm = 1m	92 cm + 8 cm = 1m
80 cm + 20 cm = 1m	75 cm + 25 cm = 1m
100 cm + 0 cm = 1m	54 cm + 46 cm = 1m

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e dallimit të metrit si njësi matëse, shndërrimin e tyre (cm - m dhe m - cm).

Detyrë:
Mat 3 objekte më të mëdha se 1 m dhe 3 objekte më të vogla se 1 m. I shënon ato në fletore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 59

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përdor metrin (m) dhe centimetrin (cm) si njësi matëse standarde.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Njësitë matëse (decimetri)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon dm si njësi matëse të gjatësisë.
- Shndërron njësitë matëse nga m dhe dm në cm dhe anasjellas.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor (TV), internet.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve videoja nga linku në vijim: https://www.youtube.com/watch?v=4sBC3ojd6CE.

Zhvillohet bisedë me nxënësit: Çfarë është metri? Cilat gjëra mund të maten me metër? Çfarë njësie është centimetri? Sa centimetra ka një metër? Cilat gjëra maten me centimetër? Tregoni cilat objekte në klasë maten me metër dhe cilat me cenimetër.

Hapi 2: Nxënësve u shpërndahen në grupe shirita letre me gjatësi 1dm. Kërkohet nga ata të bëjnë matjen e shiritit dhe të tregojnë gjatësinë e tij (10 cm).
Vizatohet në tabelë një shirit me gjatësi 1m. Lipset nga nxënësit të vendosin nën shiritin (1 m) në tabelë shiritat që kanë. Sa shirita e plotësuan metrin? (10). Tregohet se një shirit i tillë më gjatësi 10 cm është



1 Janë dhënë pikat e skajshme të segmenteve AB, BC, CD, DE dhe AE. Vizatojmë segmentet dhe caktojmë gjatësitë e tyre.

D • • C

• E

A • • B

Me të dhënat e fituara, plotësojmë tabelën:

Segmenti	AB	BC	CD	DE	AE	Gjatësia e vijës
Gjatësia në centimetra						

2 Në ilustrimin e dhënë, cila është rruga më e shkurtër për të shkuar në kala?

1 2 3 4 5

rruga 1: ☐ cm + ☐ cm + ☐ cm = ☐ cm

rruga 2: ☐ cm + ☐ cm + ☐ cm = ☐ cm

rruga 3: ☐ cm + ☐ cm + ☐ cm = ☐ cm

rruga 4: ☐ cm + ☐ cm + ☐ cm = ☐ cm

rruga 5: ☐ cm + ☐ cm + ☐ cm = ☐ cm

USHTROJMË

82

1 decimetër (1 dm) dhe se 1 m ka 10 dm dhe 1 dm ka 10 cm.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen ta vëzhgojnë detyrën 1 dhe më pas ta plotësojnë detyrën 2, duke shndërrur njësitë e paraqitura me dm në cm dhe anasjellas.
P.sh.: 2 dm =20 cm; 30 cm = 3 dm.
Në detyrën 3, nxënësit udhëzohen të masin gjatësinë e lapsit, të shkruajnë gjatësinë në dm dhe më pas ta shprehin me dm dhe cm.
Në detyrën 4, ata duhet të shndërrojnë njësitë e shprehura me metra në decimetra dhe anasjellas.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të bëjnë matjen e disa gjatësive të objekteve në klasë: të librit, fletores, bankës, lapsit, kutisë së lapsave dhe objekteve të tjera, si dhe t'i shkruajnë në fletore ato gjatësi, duke i shënuar më njësitë matëse.
Kërkohet të bëjnë edhe shndërrime të njësive matëse që kanë shënuar në fletore, p.sh., dm në cm apo anasjellas.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e dm si njësi matëse dhe shndërrimin e njësive matëse nga m dhe dm.

Detyrë:

Bën matje të disa gjatësive dhe mban shënime në fletore për ato gjatësi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 60

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Mbledh dhe zbret, duke përdorur njësitë matëse (m, cm).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.1,2,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2;3,1,4.


3 Ta përcaktojmë gjatësinë e litarit.
25 m
4 m
Gjatësia e litarit është: ☐ m + ☐ m = ☐ m
32 m + ☐ m = 50 m
37 m − ☐ m = 20 m
18 m + 4 m = ☐ m
26 m + 4 m = ☐ m
4 Ta përcaktojmë gjatësinë e murit.
4 m
10 m
3 m
Gjatësia e murit është:
☐ m + ☐ m + ☐ m = ☐ m
26 m + 4 m + 5 m = ☐ m
36 m + 8 m + 4 m = ☐ m
35 m + ☐ m + 8 m = 48 m
28 m + ☐ m + 12 m = 49 m
5 Të njehsojmë:
27 m
5 m
Njehsojmë:
☐ m − ☐ m = ☐ m.
38 m − 4 m = ☐ m
49 m − 6 m = ☐ m
53 m − ☐ m = 40 m
63 m − ☐ m = 40 m
6 Vizatojmë segmentin AB me gjatësi 5 cm, pastaj vizatojmë segmentin CD për 4 cm më të gjatë se segmenti AB.
A
C
USHTROJMË
83

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan objekte që maten me vizore dhe metër;
- Kryen veprime matematikore me njësitë matëse;
- Bën matjen e sendeve të ndryshme me metër dhe vizore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletëza, metër, vizore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve, të ndarë në grupe, u shpërndahen fletët në të cilat janë të vizatuara metër shiriti, metri metalik, si dhe vizorja. Kërkohet nga ata të shkruajnë sende (objekte) që mund të maten me njësitë e shënuara.

Hapi 2: Në tabelë vizatohen shkallët me njësitë matëse (jepen këto shpjegime: nëse shkojmë nga njësia më e madhe te më e vogla shtohen zerot, nëse vazhdojmë prej njësisë më të vogël te njësia më e madhe hiqen zerot).



1 Njehsojmë dhe fushat ku ndodhen rezultatet i ngjyrosim sipas dëshirës.

36 *cm* + 6 *cm* = ___ *cm*
58 *cm* + 7 *cm* = ___ *cm*
87 *cm* + 5 *cm* = ___ *cm*
45 *cm* + 8 *cm* = ___ *cm*
79 *cm* + 4 *cm* = ___ *cm*
87 *cm* + 7 *cm* = ___ *cm*
77 *cm* + 7 *cm* = ___ *cm*

33 *dm* − 6 *dm* = ___ *cm*
92 *dm* − 4 *dm* = ___ *cm*
24 *dm* − 8 *dm* = ___ *cm*
46 *dm* − 8 *dm* = ___ *cm*
71 *dm* − 3 *dm* = ___ *cm*
53 *dm* − 5 *dm* = ___ *cm*
44 *dm* − 9 *dm* = ___ *cm*

14 *m* + 8 *m* = ___ *m*
19 *m* − 8 *m* = ___ *m*
34 *m* + 9 *m* = ___ *m*

82 *m* − 9 *m* = ___ *m*
25 *m* + 7 *m* = ___ *m*
64 *m* + 8 *m* = ___ *m*

PËRSËRISIM

84



Hapi 3: Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë së bashku me mësimdhënësin detyrën 1 në libër. Jepen përgjigje për këto pyetje:
1. Çfarë figure është paraqitur? (një litar);
2. Çfarë duhet të gjejmë? (gjatësinë); 3. Sa është metri i litarit të lidhur? (25m); 4. Sa metra të litarit i kemi tërhequr? (4m); Atëherë, sa është gjatësia e litarit? (25m+4m=29m).

Hapi 4: Kërkohet nga nxënësit të punojnë detyrën 2. Diskutohen këto pyetje: 1.Në sa pjesë është i ndarë muri? (3); 2.Sa është gjatësia e murit të parë (4m); 3.Sa është gjatësia e murit të dytë? (10m); 4.Sa është gjatësia e murit të tretë? (3m); 5. Sa është gjatësia e gjithë murit? (4m+10m+3m=17m).

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 3, së bashku me mësimdhënësin. Diskutohen pyetjet: 1. Sa është gjatësia e copës? (27m); 2. Sa metra ia kemi marrë? (5m); 3. Sa metra kanë mbetur? (27m-5m=22m).

Hapi 6: Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 4. Me anë të vizores, ata duhet të vizatojnë segmentin AB=5cm, ndërsa segmentin CD për 4 cm më të gjatë se AB, atëherë CD=9cm.

Hapi 7: Nxënësve, të ndarë në grupe, do t'u kërkohet që me anë të vizores dhe metrit t'i masin objektet që ndodhen në klasë (fletoren, bankën, lapsin, gomën, derën, tabelën, dritaren etj., ku gjatësinë duhet ta shënojnë në fletë).

fletore	bankë	laps	gomë	tabelë	dritare	derë

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e njësive matëse dhe në matjen e objekteve të ndryshme.

Detyrë:
Detyra 1 (faqe 84).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 61

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Mat gjatësi të ndryshme duke përdorur njësi jostandarde dhe standarde.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.8, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 1.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen gjatësinë e segmenteve;
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Vizore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që detyrat e dhëna në tekst t'i plotësojnë në mënyrë të pavarur, meqënëse planifikohet vlerësimi i të kuptuarit.

Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të gjejnë gjatësinë e segmentit të dhënë, më pas vizatojnë segmentet AB dhe MN sipas kërkesës së dhënë në detyrë.

Hapi 2: Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që fillimisht të masin gjatësinë e segmenteve të dhëna. Pas matjes së gjatësisë së segmenteve AB, BC, CD dhe DE, nxënësit gjejnë gjatësinë e vijës së thyer.

Detyra 3: Tregohen njësitë matëse për secilën figurë të dhënë.
Detyra 4: Llogarisin shumën dhe ndryshimin e numrave njëshifrorë nga numrat dyshifrorë.



Hapi 3: Detyrat e përfunduara nga nxënësit në mënyrë individuale vlerësohen dhe diskutohet zgjidhja e tyre në nivel klase.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në matjen e gjatësisë së segmenteve dhe në gjetjen e shumës dhe ndryshimit të numrave të dhënë në tekst.

Detyrë:

_____

_____

_____

_____

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

_____

_____

Mësimi 62

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes;
- Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, 8; III.2, 3, 4; IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.3, 6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrit dyshifror me dhjetëshe të plotë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson mbledhjen e numrave dyshifrorë me dhjetëshe të plota;
- Shkruan barazimin e kërkuar;
- Zgjidh saktë detyrat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shufra, kubëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1:

Para nxënësve paraqiten disa shufra dhe kubëza. Shufrat përdoren për të treguar dhjetëshet, ndërsa kubëzat përdoren për të treguar njëshet. Diskutohet bashkë me ata:
- Sa shufra kam në dorë?
- Sa shufra po i shtoj tani? Po kubëza?
- Çfarë barazimi formojnë?
- Sa është rezultati i barazimit?



Hapi 2: Nxënësve u kërkohet që në detyrën 1 të shkruajnë barazimet duke u bazuar në modelin në libër dhe të gjejnë shumën e atyre barazimeve.

Hapi 3: Nxënësit ndahen në çifte dhe plotësojnë së bashku detyrën 2 dhe 3.

$40 + 34 =$ ☐

Në këto detyra nga nxënësit kërkohet të njehsojnë dhe të plotësojnë katrorët e zbrazët me rezultatet që duhet.

✓ Lexohen barazimet dhe korrigjohen detyrat.

Hapi 4: Punohet së bashku me nxënësit detyra 4. Ata mbledhin numrat në shtyllë dhe u përgjigjen këtyre pyetjeve:

- Sa njëshe ka numri 68? Po dhjetëshe?
- Sa njëshe ka numri 30? Po dhjetëshe?
- Sa bëjnë 8 + 0?
- Po 6 + 3 = ?
- Sa është shuma e numrave 68 + 30?

Dh	Nj
6	8
+ 3	8
9	8

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e detyrave, bashkëpunimin në çift dhe përgjigjet e duhura në pyetjet e drejtuara.

Detyrë:
Barazimet e detyrës 3 të mblidhen në shtyllë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 63

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 2.1, 3.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën e numrave ku njëri prej mbledhorëve është dhjetëshe e plotë.
- Gjen vendndodhjen e numrit në boshtin numerik.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet që në fletore të shënojnë numrat njëshifrorë.

1	2	3	4	5	6	7	8	9

Numrave njëshifrorë t'u shtohet nga një zero.

10	20	30	40	50	60	70	80	90

Kështu fitohen dhjetëshet e plota.
(Numërohen me duartrokitje dhjetëshet e plota)

Për mësuesin/en



55 + 40 = 95 ■ 31 + 50 = 81 ■
24 + 10 = 34 ■ 3 + 10 = 13 ■
11 + 10 = 21 ■

Nxënësit në dyshe diskutojnë rezultatet dhe ngjyrat.

Hapi 2: Detyra 1 – Nxënësit i vështrojnë figurat e dhëna.

- Sa shufra të kaltra janë? (1)
- Sa është vlera e një shufre? (10)
- Sa rrathë të kaltër janë? (3)
- Sa është vlera e një rrethi? (1)
- Sa shufra të kuqe janë? (1)
- Sa është vlera e një shufre? (1)
- Cili është mbledhori i parë? (13)
- Cili është mbledhori i dytë? (10)
- Sa është shuma? (23)
  13 + 10 = 23

Në të njëjtën mënyrë vazhdohet me figurat e tjera të dhëna.
(17 + 20 = 37,
32 + 30 = 62,
29 + 60 = 89)

Hapi 3: Detyra 2 – Nxënësit gjejnë shumën e numrave në shtyllë. Më pas lexohen rezultatet.

Hapi 4: Detyra 3 – Nxënësit gjejnë shumën e numrave të dhënë dhe gjejnë vendndodhjen e rezultatit në boshtin numerik.

48 + 30 = 78 ■ 37 + 20 = 57 ■
15 + 50 = 65 ■ 25 + 20 = 45 ■

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës së numrave dhe gjetjen e numrave në boshtin numerik.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 87).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 64

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprime të mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1.III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.1;3.5.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave dyshifrorë ku zbritësi është dhjetëshe e plotë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave ku zbritësi është dhjetëshe e plotë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Blloqet e Dienes.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet që t'i paraqesin me shufra dhe kube (modeli në foto) disa numra dyshifrorë: 85, 30, 16, 24, 37, 92, 40 etj.



Hapi 2: Sqarohet zbritja e numrave dyshifrorë ku zbritësi është dhjetëshe e plotë. P.sh., 54 - 20 = Sa është i zbritshmi? (54). Sa është zbritësi? (20). Cili prej tyre është dhjetëshe e plotë? (Zbritësi). Tregohet se 54 -20 = 34.



ZBRITJA E NUMRAVE DYSHIFRORË, KU ZBRITËSI ËSHTË DHJETËSHE E PLOTË

MËSOJMË

1 Analizojmë figurat dhe i përshkruajmë ato me numra.

66 – 30 = 66 – 20 = 66 – 40 = 66 – 50 =

2 Njehsojmë:

16 – 10 = 99 – 60 = 81 – 50 = (51 - 10) - 10 =
36 – 10 = 87 – 50 = 24 – 20 = (64 - 20) - 30 =
76 – 10 = 64 – 40 = 96 – 80 = (99 - 40) - 20 =

3 Njehsojmë:

	Dh	Nj
–	6	8
	3	0
	3	8

– 65 20 – 44 30 – 52 40 – 85 60

4 Duke njehsuar, plotësojmë tabelat e zbritjes:

–	40	30	50
94	54		
89			

–	20	40	30
74			
57			

–	10	30	60
77			
67			

5 Plotësojmë katrorët e zbrazët me numra që të fitojmë barazi të sakta.

76 – 20 = 56 42 – = 12 – 10 = 29 63 – = 23
76 – 40 = 36 67 – = 7 – 20 = 49 – 10 = 59
76 – = 46 83 – = 43 – 30 = 59 97 – = 57

88

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat në libër.

Detyra 1. Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë figurat dhe të tregojnë dhjetëshet dhe njëshet, si dhe të gjejnë ndryshimin duke vëzhguar kubet dhe shufrat e paraqitura në figura.

Detyra 2. Nxënësit udhëzohen të njehsojnë ndryshimin e numrave: 16-10=6.

Detyra 3. Nxënësit udhëzohen të njehsojnë ndryshimin sipas modelit të zbritjes në shtylla. Në detyrën 4, nxënësit përveç ndryshimit duhet të gjejnë edhe të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen etiketa me detyra dhe kërkohet nga ta që të njehsojnë ndryshimin e numrave dyshifrorë, ku zbritësi është dhjetëshe e plotë.

27 - 10 = 45 - 10 =

58 - 40 = 73 - 20 =

Varësisht nga koha e lirë, mund të zhvilllohet lojë matematikore duke parë në linkun: https://www.splashlearn.com/math-skills/second-grade/subtract-within-100/subtract-tens-from-a-2-digit-number.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e ndryshimit të numrave, ku zbritësi është dhjetëshe e plotë.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 88).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 65

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes, si dhe krahason numrat natyrorë deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3, II,2, III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshmin e numrave ku zbritësi është dhjetëshe e plotë;
- Plotëson tabelat ku zbritësi është dhjetëshe e plotë;
- Tregon mënyrën e zgjidhjes së detyrës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shporta me numra, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet që t'i përmendin se cilët numra janë mësuar dhe cilat janë dhjetëshet e plota. Përgatiten dy shporta, vendosen fleta me numra. Në njërën shportë vendosen dhjetëshet e plota (10, 20...) dhe në shportën tjetër numrat dyshifrorë (numra që nuk janë dhjetëshe të plota). Një nxënës do ta tërheqë një numër të plotë, ndërsa tjetri do ta tërheqë një numër që nuk është dhjetëshe e plotë. Barazimet shënohen në tabelë.
(54-50=☐, 67-20=☐). Aktiviteti vazhdon edhe me nxënësit e tjerë.

Hapi 2: Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë së bashku me mësimdhënësin detyrën 1 në libër. Diskutohen këto pyetje:
Sa shufra dhe sa kube janë? (6 shufra dhe 6 kube); Cili numër fitohet? (66); Sa shufra janë hequr? (3);



Një shufër sa kube i ka? (10); Atëherë, cili numër fitohet, kur hiqen 3 shufra? (30 (66-30=36).

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të punojnë në libër detyrën 2. Boshti numerik të vizatohet në tabelë. Parashtrohen këto pyetje: Numri 67 cilën dhjetëshe e ka më afër?; Gjeni numrin 67 tek boshti; Nga numri 67 numëroni 20 hapa, te cili numër jeni? (47).

Hapi 4: Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 3. Udhëzohen që pasi ta gjejnë ndryshimin, t'i ngjyrosin katrorët që ndodhen afër. P.sh., barazimi 77-10=67, numri 67 në mes të cilave dhjetëshe ndodhet (60-70), atëherë numri 67 ka ngjyrë të kuqe.

Hapi 5: Kërkohet nga nxënësit të punojnë të pavarur detyrën 4. Pas plotësimit të tabelave, ata i shkëmbejnë librat njëri-tjetrit, ku kontrollojnë punën e bërë.

Hapi 6: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahet nga një fletë. Në fletë janë shënuar detyra, ku zbritësi është dhjetëshe e plotë (p.sh., 56-30= __). Në tabelë ngjiten rezulatet e barazimeve. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë zgjidhjen dhe të afrohen në tabelë te numri që tregon zgjidhjen e barazimeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në ndryshimin e numrave, ku zbritësi është dhjetëshe e plotë.

Detyrë:
Detyra 2 dhe 4 (faqe 90).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 66

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen mbledhjen e numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.8, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Mbledhja e numrave dyshifrorë pa kalim të numrit 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit shumën e numrave dyshifrorë;
- Zbërthen mbledhorët në dhjetëshe dhe njëshe.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shkruhet në tabelë barazimi 52 + 47 = 99. Nxënësve u drejtohen pyetje të tilla, si:

- Cili është mbledhori i parë? Po i dyti?
- Sa dhjetëshe kemi te numri 52? Po njëshe?
- Sa dhjetëshe kemi te numri 47? Po njëshe?
- Kur mbledhëm njëshet, a kaloi dhjetëshja?

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësve u sqarohet se në barazimin 52 + 47 = 99, mbledhori i dytë zbërthehet në dhjetëshe dhe njëshe. Ndaj dhe shprehja 52+47 është e barabartë me shprehjen 52+40+7.

Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që të llogarisin shumën e numrave të dhënë në detyrë. U ritregohet se mbledhja e numrave dyshifrorë, çdoherë bëhet duke mbledhur njëshet me njëshe dhe dhjetëshet me



dhjetëshe.

Detyra 3: Llogarisin shumën e numrave në shtyllë.

Hapi 3: Detyra 4: Llogaritja e shumës së numrave të dhënë bëhet duke zbërthyer mbledhorin e dytë si shumë e dy numrave të tjerë.

Sqarohet në tabelë detyra: 62 + 34

62 + 34 = 62 + (30 + 4) = (62 + 30) + 4 =
(62 + 30) + 4 = 92 + 4 = 96

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës së numrave dhe në zbërthimin e numrave në dhjetëshe dhe njëshe.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 91).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 67

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes;
- Zbaton mbledhjen në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; II.2, 8; III.2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 5; 3.5; 4.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën e numrave pa kalim të numrit 10;
- Plotëson detyrat dhe ushtrimet duke njehsuar shumën.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Punohet bashkë me nxënësit detyra 1. Nxënësit vëzhgojnë boshtin numerik, njehsojnë dhe japin përgjigje për këto pyetje:

12 + 25 = 12 + (20 + 5) = (12 + 20) + 5 = 32 + 5 = 37

- Sa është shuma e numrave 12 + 25?
- Si është i ndarë mbledhori i dytë (25) ?
- Pse është i ndarë në këtë mënyrë?

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të plotësojnë në mënyrë të pavarur detyrën 2, duke njehsuar dhe plotësuar me numrat që duhet rrathët e zbrazët. Gjithashtu, ata tregojnë si është i ndarë mbledhori i dytë.



1 Njehsojmë:

12 + 25 = ☐ 53 + 36 = ☐

12 + 25 = ☐ 53 + 36 = ☐
12 + 20 = 32 53 + 30 = ☐
32 + 5 = 37 83 + 6 = ☐

43 + 35 = 43 + (30 + 5) = (43 + ___) + ___ = ___ + ___ = ☐
26 + 53 = 26 + (___ + ___) = (26 + ___) + ___ = ___ + ___ = ☐

2 Njehsojmë dhe plotësojmë:

3 Plotësojmë tabelën.

Mbledhori i parë	60	36	80	52	86	27	51	66
Mbledhori i dytë	8	43	20	28	13	43	23	33
Shuma								

4 Në njërën paralele të klasave të dyta janë 32 nxënës, kurse në tjetrën 4 nxënës më shumë. Sa nxënës janë në të dyja paralelet?

Në të dyja paralelet e klasës së dytë janë: 32 + (32 + 4) = ___ + ___ = ___ nxënës.

5 Plotësojmë piramidën.

USHTROJMË

92

Hapi 3: Bashkë me nxënësit plotësohet detyra 3, duke shkruar barazimet e detyrës në tabelë.

Mbledhori i parë	**60**	**36**	**80**	**52**	**86**
Mbledhori i dytë	8	43	20	28	28
Shuma					

60 + 8 = 6 + 43 = 80 + 20 =

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen ta lexojnë detyrën me fjalë dhe të gjejnë se sa është numri i nxënësve në të dyja paralelet.

Diskutohet bashkërisht:

- Sa është numri i nxënësve në njërën klasë?
- Sa është numri i nxënësve në klasën tjetër?
- Sa është mbledhori i parë? Po mbledhori i dytë?
- Sa është shuma e mbledhorëve?
- Sa është numri i nxënësve në të dyja paralelet?

32 + (32 + 4) = _____ + _____
= _____ nxënës

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës së numrave dyshifrorë pa kalim të numrit 10.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 92).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 68

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e zbritjes;
- Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.3, II.2, III.2, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e numrave dyshifrorë duke veçuar dhjetëshen

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave duke veçuar dhjetëshen ;
- Zbërthen zbritësin në dhjetëshe dhe njëshe;
- Arsyeton mënyrën e zgjidhjes së detyrës;
- Formulon një problem me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë shënohen numrat 40 dhe 24. Nxënësit udhëzohen që të gjejnë nga tri barazime me veprimin e zbritjes duke qenë rezultati 40, si dhe 24.

60 – 20 = 40	30 – 6 = 24
100 – 60 = 40	44 – 20 = 24
40 – 0 = 40	25 – 1 = 24



Hapi 2: Nxënësit vështrojnë detyrën 1, ku gjejnë ndryshimin e numrave, duke zbërthyer zbritësin në dhjetëshe dhe njëshe.

- Në barazimin 78 – 25 emërtohen kufizat e zbritjes
  78 – i zbritshmi
  25 – zbritësi – (ndaj në Dh dhe Nj: 20 dhe 5)

78 – 25 = 78 – 20 – 5 = 53

Njëjtë vazhdohet edhe me barazimet e tjera të dhëna te detyra 1. Barazimet shënohen në fletore (44 – 23 = 44 – 20 – 3 = 21).

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen ta lexojnë detyrën 3 me kujdes dhe ta gjejnë zgjidhjen e problemit. (21 + 22 + 23) – 9 = 66 – 9 = 57.

Hapi 4: Nxënësit në dyshe udhëzohen të formulojnë një problem me fjalë, sikur shembulli i dhënë në detyrën 3.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e ndryshimit të numrave, zgjidhjen dhe formulimin e problemave me fjalë.

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 93).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 69

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprime të mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III. 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave dyshifrorë duke veçuar dhjetëshen.
- Njehson shumën e numrave dyshifrorë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kalendar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve një detyrë: 67-24= .
Kërkohet nga ata që individualisht të njehsojnë detyrën dhe të gjitha mënyrat e zgjidhjeve të dhëna nga nxënësit, shënohen në tabelë. Nxënësit sqarojnë mënyrën e njehsimit të detyrës.

Hapi 2: Bisedohet me nxënës rreth detyrës në hapin 1.
Sa dhjetëshe e njëshe ka numri 67? Po numri 24? Kërkohet nga ata të zbërthejnë zbritësin si shumë e dy mbledhorëve. Pse bëhet një zbërthim i tillë? (Për të zbritur të zbritshmin me dhjetëshe e më pas edhe me njëshe.) Shkruhet barazimi në tabelë: 67 - 24 = 67 – 20– 4 = (67 – 20) – 4 = 47 – 4 = 43. Paraqitet barazimi edhe në boshtin numerik (vizatohet bosht në tabelë). Nxiten nxënësit të tregojnë se zbritësi paraqitet i zbërthyer si shumë e dy mbledhorëve.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë detyrat në libër.



5 Njehsojmë:

24 + 21 = 45	51 + 28 = ☐	45 + 43 = ☐
45 − 13 = 32	☐ − 23 = ☐	☐ − 54 = ☐
32 + 34 = ☐	☐ + 43 = ☐	☐ + 35 = ☐
☐ − 51 = ☐	☐ − 67 = ☐	☐ − 27 = ☐
☐ + 24 = ☐	☐ + 15 = ☐	☐ + 18 = ☐
☐ − 19 = 20	☐ − 27 = 20	☐ − 60 = 0

6 Njehsojmë:

46 + 53 = 99	44 + 44 = ☐	42 + 34 = ☐
24 + 23 = ☐	42 + 43 = ☐	31 + 37 = ☐
37 + 33 = ☐	31 + 25 = ☐	52 + 45 = ☐
57 − 36 = 21	76 − 35 = ☐	100 − 36 = ☐
96 − 53 = ☐	70 − 36 = ☐	100 − 45 = ☐
69 − 25 = ☐	69 − 37 = ☐	100 − 51 = ☐
100 − 17 = ☐	68 − 38 = ☐	100 − 75 = ☐

7 Duke njehsuar, plotësojmë:

USHTROJMË

95

Detyra 1. Plotësohet sipas shembullit paraprak, duke përdorur boshtin numerik.

Detyrat 2 dhe 3. Nxënësit udhëzohen të gjejnë ndryshimin sipas modeleve të dhëna.

Detyra 4. Nxënësit udhëzohen të njehsojnë detyrat me fjalë dhe të përgjigjen në pyetjet e parashtruara.

Në detyrën 5, nxënësit udhëzohen të njehsojnë detyrat, ku shuma ose ndryshimi i njehsuar shënohet në detyrën në vijim sipas ngjyrave përkatëse. Pas plotësimit, bëhet leximi i detyrës, njëri pas tjetrit, dhe korrigjimi i nevojshëm.

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet të njehsojnë të pavarur detyrat me mbledhje dhe zbritje me numra dyshifrorë në detyrën 6 në libër.

Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë për gjetjen e ndryshimit të numrave dyshifrorë duke veçuar dhjetëshen, si dhe të shumës së numrave.

Detyrë:
Detyra 7 (faqe 95).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 70

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zbaton mbledhjen dhe zbritjen.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,2 II.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2;2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen ndryshimin e numrave dyshifrorë;
- Shkruan numrat në shtylla;
- Zgjidh problemet me fjalë.


PËRSËRISIM

1 Njehsojmë dhe ngjyrosim.

71 + 6 = 77 | 85 + 3 = | 81 + 6 = | 82 + 6 =
83 + 4 = | 92 + 5 = | 87 + 3 = | 96 + 3 =
94 + 2 = | 95 + 4 = | 93 + 4 = | 81 + 7 =

95 – 3 = 92 | 85 – 1 =
86 – 4 = | 98 – 6 =
73 – 3 = | 87 – 7 =

96 – 5 = | 84 – 2 =
88 – 7 = | 99 – 5 =
79 – 8 = | 78 – 6 =

2 1. Shumën e numrave 56 dhe 43 e zvogëlojmë për ndryshimin e tyre.
Njehsojmë: (___ + ___) – (___ – ___) = ___ – ___ = ___.

2. Para se të shkonte në treg për blerje, Fjolla i kishte 97 euro. Pas kthimit, asaj i mbetën 35 euro. Sa euro i shpenzoi Fjolla në treg?
Njehsojmë: ___ – ___ = ___.
Pra, në treg, Fjolla shpenzoi ___ euro.

3 Njehsojmë:

$\begin{array}{r} 51 \\ +\ 34 \\ \hline \square\square \end{array}$ $\begin{array}{r} 77 \\ +\ 12 \\ \hline \square\square \end{array}$ $\begin{array}{r} 85 \\ +\ 13 \\ \hline \square\square \end{array}$ $\begin{array}{r} 68 \\ -\ 32 \\ \hline \square\square \end{array}$ $\begin{array}{r} 85 \\ -\ 52 \\ \hline \square\square \end{array}$ $\begin{array}{r} 95 \\ -\ 71 \\ \hline \square\square \end{array}$

4 Plotësojmë tabelat.

+	51	38	53	26	67	21
30						

+	51	38	53	26	57	21
40						

96

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të shikojnë në tabelë ku është shkruar një barazi, të cilën duhet zgjidhur në disa forma.

a) 78-15= b) 78-15=(78-10)-5=68-5=63 c) $\begin{array}{r} 78 \\ -\ 15 \\ \hline 63 \end{array}$

Hapi 2: Nxënësit punojnë së bashku me mësimdhënësin detyrën 1 në libër. Diskutohen këto pyetje: Në katrorët me ngjyrë të verdhë, cili veprim matematikor ndodh? (mbledhja); Si duhet të mblidhen 83+4=☐ (si fillim mblidhen njëshet, ndërsa dhjetëshet përshkruhen); Te katrorët me ngjyrë të kaltër, cili veprim matematikor ndodh? (zbritja);
Si duhet zbritur 86-4=☐



1 Njehsojmë dhe ngjyrosim.

71 + 6 = 77 | 85 + 3 = | 81 + 6 = | 82 + 6 =
83 + 4 = | 92 + 5 = | 87 + 3 = | 96 + 3 =
94 + 2 = | 95 + 4 = | 93 + 4 = | 81 + 7 =

95 – 3 = 92 | 85 – 1 =
86 – 4 = | 98 – 6 =
73 – 3 = | 87 – 7 =
96 – 5 = | 84 – 2 =
88 – 7 = | 99 – 5 =
79 – 8 = | 78 – 6 =

2 1. Shumën e numrave 56 dhe 43 e zvogëlojmë për ndryshimin e tyre.

Njehsojmë: (___ + ___) – (___ – ___) = ___ – ___ = ___.

2. Para se të shkonte në treg për blerje, Fjolla i kishte 97 euro. Pas kthimit, asaj i mbetën 35 euro. Sa euro i shpenzoi Fjolla në treg?

Njehsojmë: ___ – ___ = ___.

Pra, në treg, Fjolla shpenzoi ___ euro.

3 Njehsojmë:

+ 5 1 / 3 4 | + 7 7 / 1 2 | + 8 5 / 1 3 | – 6 8 / 3 2 | – 8 5 / 5 2 | – 9 5 / 7 1

4 Plotësojmë tabelat.

+	51	38	53	26	67	21
30						

+	51	38	53	26	57	21
40						

PËRSËRITJE

96

(si fillim zbriten njëshet, ndërsa dhjetëshet përshkruhen).

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë në libër detyrën 2. Japin përgjigje për këto pyetje:

1. Kur themi shumën e numrave 56 dhe 43, cili veprim duhet shënuar? (Mbledhja.); Kur themi e zvogëlojmë për ndryshimin e tyre, cila shenjë duhet shënuar? (Zbritja.) (56+43)-(56-43)=99-13=86.

2. Sa euro i kishte Fjolla, para se të shkonte në treg? (97 euro); Kur është kthyer, sa euro i mbetën? (35 euro); Sa euro i shpenzoi Fjolla? (97-35=62).

Hapi 4: Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, në libër, detyrën 3. (Rikujto që gjatë mbledhjes dhe zbritjes në shtylla, së pari kryhet mbledhja dhe zbritja e njësheve dhe pastaj mbledhja dhe zbritja e dhjetësheve).

Hapi 5: Nxënësit janë të ndarë në grupe. Në tabelë janë vizatuar disa rrathë. Në secilin rreth janë të shënuar dy mbledhorë. Ftohet një nxënës nga një grup, i mbyllen sytë, dhe nxënësi duhet të shënojë një pikë në rreth. I hapen sytë dhe ai bën llogaritjen duke zgjidhur barazimin. Kështu vazhdohet dhe me grupe të tjera.

P.sh., Arta → 81+6=87

Petriti → 85-1=84

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të numrave dyshifrorë në shtylla.

Detyrë:

Detyra 4 (faqe 96).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 71

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprime të mbledhjes dhe zbritjes së numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3,1.4.



5 Njehsojmë:

26 + 32 = 58	34 + 53 = ☐	☐ – 16 = 84
58 – 32 = 26	☐ – 53 = ☐	☐ + 16 = ☐
26 + 16 = ☐	62 + 27 = ☐	98 – 62 = ☐
☐ – 16 = ☐	☐ – 27 = ☐	☐ + 62 = ☐

6 Njehsojmë:

34 + 12 = 46	53 + ☐ = 89	38 – 14 = 24	68 – ☐ = 36
23 + ☐ = 59	65 + ☐ = 99	46 – ☐ = 25	74 – ☐ = 41
42 + ☐ = 78	41 + ☐ = 86	29 – ☐ = 11	97 – ☐ = 63
15 + ☐ = 39	26 + ☐ = 79	57 – ☐ = 32	89 – ☐ = 47

7 Plotësojmë tabelën.

1 € = 100 c	1 €	1 € = 100 c	1 €
35 c + ☐ c	39 c + ☐ c	71 c + ☐ c	15 c + ☐ c
75 c + ☐ c	38 c + ☐ c	94 c + ☐ c	25 c + ☐ c
55 c + ☐ c	52 c + ☐ c	17 c + ☐ c	85 c + ☐ c

8 Plotësojmë fushat e zbrazëta me mbledhorët që mungojnë.

PËRSËRISIM

97

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit ndryshimin dhe shumën e numrave të dhënë në libër;
- Gjen numrin e panjohur që mungon në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u drejtohen pyetje:

- Çfarë ju bie ndërmend kur përmendet fjala mbledhje? Po zbritje?
- A mund të jepni një shembull të mbledhjes/zbritjes nga përditshmëria?
- Si emërtohen numrat që marrin pjesë në mbledhje? Po në zbritje?
- Me çfarë simbole i paraqesim këto veprime?

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit llogarisin shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë. Gjejnë numrin e panjohur që mungon në barazimet e dhëna.
Njëjtë veprohet edhe me detyrën e dytë.

Detyra 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelën me numrat që mungojnë. Paraprakisht u shpjegohet



mënyra e plotësimit të tabelës së mëposhtme. Pjesa tjetër plotësohet nga nxënësit.

1€ = 100 c
35 c + 65 c
75 c + 25 c

Hapi 3: Detyra 4: Nxënësit plotësojnë në dyshe, fushat e zbrazëta me mbledhorët që mungojnë, duke zbatuar strategji të mbledhjes dhe zbritjes së numrave.

Detyra 5: Nxënësve u sqarohet se gjetjen e numrave që mungojnë në piramidë dhe fillojnë duke zbritur numrat 35 – 12 = 13, 12 -9, 13-3 e kështu me radhë.

35			
12		13	
9		3	10
8	1	2	8

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave të dhënë, për gjetjen e së panjohurës në barazimet e dhëna.

Detyrë:
Detyrat 2 dhe 3 (faqe 98).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 72

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes;
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
- Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II. 2, 8; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4; 3.3, 4, 6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Mbledhja e numrit dyshifror me kalim të numrit 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën e numrave dyshifrorë me kalim të numrit 10;
- Përdor mënyra të ndryshme gjatë njehsimit të shumës;
- Zgjidh saktë detyrat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Një fotografi e bibliotekës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë shkruhet një barazim (p.sh.: 24 + 7 =) dhe pastaj pyeten nxënësit se si mund ta gjejnë shumën e tij. Në tabelë gjithashtu shkruhen zgjidhjet që tregojnë nxënësit.



Për mësuesin/en



Hapi 2: Diskutimi dhe zgjidhja e detyrës vazhdon me këto pyetje:

- Edhe sa i shtojmë numrit 34, që të bëhet 40?
- Çfarë bëmë tani?
- Cili numër i dhuroi numrit 34 numrin 6?
- Edhe sa mbetën nga numri 7?
- I shtojmë numrit 40 edhe numrin 1.
- Si u nda numri 7?
- Pse u bë kjo ndarje?

Të shkruhet barazimi në tabelë:

24+17 = 24+10+7 = (24+10) + 6 +1 = (34+6)+1 = 40+1 = 41

Nxënësve u sqarohet që të mbledhin së pari mbledhorin e parë me dhjetëshet e mbledhorit të dytë, pastaj njëshet e mbledhorit të dytë t'i ndajnë ashtu që të plotësohet dhjetëshja dhe në fund t'ia shtojnë pjesën e mbetur të njësheve.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën 1 në libër dhe të vëzhgojnë figurën e paraqitur. Diskutohet me ta:
Sa libra ka në njërin raft të vitrinës? Sa libra ka në raftin tjetër? Si është njehsuar detyra?

Hapi 4: Nxënësit nxiten të vrojtojnë boshtin numerik në detyrën 2 dhe të përcjellin shigjetat e të plotësojnë barazimet. Parashtrohen pyetje të tilla, si:

- Cilët janë mbledhorët?
- Përcill shigjetën në boshtin numerik, cili numër i shtohet numrit 35?
- Nga cili numër e morëm 10?
- Edhe sa ia shtojmë? Sa është shuma?

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë të pavarur detyrën 3 në libër dhe të bëjnë mbledhjen e numrave në shtyllë.

Hapi 6: Nxënësit vëzhgojnë skemat e paraqitura në detyrën 4 dhe njehsojnë detyrat sipas modelit të paraqitur me skema.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit dhe përdorimit të formave të ndryshme në gjetjen e shumës së numrave dyshifrorë me kalim të numrit 10.

Detyrë:
Detyra 5 dhe 6 (faqe 100).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 73

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.4.


1 Duke paraqitur në boshtin numerik, njehsojmë.

17 + 25 = 58 + 36 =

0 10 20 30 40 50 60 70 80 90 100

17 + 25 =
17 + 20 = 37
37 + 5 =

58 + 36 =
58 + 30 =
88 + 6 =

2 Njehsojmë:

53 + 18 = 53 + 10 + 8 — mbledhori i dytë është shkruar si shumë e dy mbledhorëve
= (53 + 10) + 8 — është zbatuar vetia e shoqërimit të mbledhorëve
= 63 + 8 — janë mbledhur numrat brenda kllapave
= 63 + 7 + 1 — mbledhori i dytë është shkruar si shumë e dy mbledhorëve
= (63 + 7) + 1 — është zbatuar vetia e shoqërimit të mbledhorëve
= 70 + 1 — janë mbledhur numrat brenda kllapave
= 71

62 + 17 = 16 + 27 = 46 + 22 = 47 + 21 =
74 + 23 = 28 + 56 = 18 + 55 = 38 + 62 =

3 Njehsojmë:

45 + 26 =
40 + 20 + 5 + 5 + 1 = (___ + ___) + (___ + ___) + 1 = ___ + ___ + ___ = .

37 + 26 = 67 + 28 = 77 + 15 =
17 + 36 = 15 + 38 = 39 + 57 =

USHTROJMË

101

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën e numrave dyshifrorë me kalim të numrit 10;
- Zbërthen njërin nga mbledhorët në dy mbledhorë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet boshti numerik dhe barazimi 25 + 48. Nxënësit pyeten:
- Cili është mbledhori i parë (25) dhe cili është mbledhori i dytë (48)?
- Si mund të zbërthehet në dy mbledhorë mbledhori i dytë? (40 + 8)



25 + 48 = 73
25 + 40 = 65
65 + 8 = 73

Hapi 2: Detyra 1 – Nxënësit udhëzohen të vështrojnë boshtin numerik dhe të njehsojnë shumën e numrave të dhënë, duke zbërthyer mbledhorin e dytë si shumë të dy mbledhorëve.



1 Duke paraqitur në boshtin numerik, njehsojmë.

17 + 25 = ☐ 58 + 36 = ☐

17 + 25 = ☐ 58 + 36 = ☐
17 + 20 = 37 58 + 30 = ☐
37 + 5 = ☐ 88 + 6 = ☐

2 Njehsojmë:

53 + 18 = 53 + 10 + 8 — mbledhori i dytë është shkruar si shumë e dy mbledhorëve
= (53 + 10) + 8 — është zbatuar vetia e shoqërimit të mbledhorëve
= 63 + 8 — janë mbledhur numrat brenda kllapave
= 63 + 7 + 1 — mbledhori i dytë është shkruar si shumë e dy mbledhorëve
= (63 + 7) + 1 — është zbatuar vetia e shoqërimit të mbledhorëve
= 70 + 1 — janë mbledhur numrat brenda kllapave
= 71

62 + 17 = ☐ 16 + 27 = ☐ 46 + 22 = ☐ 47 + 21 = ☐
74 + 23 = ☐ 28 + 56 = ☐ 18 + 55 = ☐ 38 + 62 = ☐

3 Njehsojmë:

45 + 26 = ☐
40 + 20 + 5 + 5 + 1 = (__ + __) + (__ + __) + 1 = __ + __ + __ = ☐.

37 + 26 = ☐ 67 + 28 = ☐ 77 + 15 = ☐
17 + 36 = ☐ 15 + 38 = ☐ 39 + 57 = ☐

USHTRIMË
101

Hapi 3: Detyra 2 – Vështrohet shembulli i dhënë. Nxënësit në fletore njehsojnë shumën e numrave të dhënë, duke e zbërthyer mbledhorin e dytë në dy mbledhorë dhe duke plotësuar 10.

62 + 17 = 62 + 10 + 7
= (62 + 10) + 7
= 72 + 7
= 79

16 + 27 = 16 + 20 + 7
= (16 + 20) + 7
= 36 + 7
= (36 + 4) + 3
= 40 + 3
= 43

Hapi 4: Shkruan 3 barazime me mbledhjen e numrave dyshifrorë për shokun, diskutohen rezultatet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shumës së numrave dyshifrorë.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 101).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 74

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprime të mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Zbritja e numrit dyshifror pa prishje të numrit 10

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson saktë ndryshimin e numrave dyshifrorë;
- Përdor mënyra të ndryshme gjatë njehsimit të ndryshimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: TV, internet, shufra, kube.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe) , Njeriu dhe natyra.


ZBRITJA E NUMRIT DYSHIFROR PA PRISHJE TË NUMRIT 10

MËSOJMË

1 Në autobus ishin 43 udhëtarë. Në stacionin e parë zbritën 28 udhëtarë. Sa udhëtarë mbetën në autobus?

Në autobus mbetën 43 - 28 udhëtarë.
Njehsojmë:
43 – 28 = 43 – 20 – 8 = (43 – 20) – 8
= 23 – 3 – 5 = (23 – 3) – 5
= 20 – 5 = 15
Pra, në autobus mbetën 15 udhëtarë.

2 Njehsojmë:
55 – 27 =
95 – 19 =
55 – 20 =
– 7 =
95 – 10 =
– 9 =
34 – 16 =
47 – 28 =
61 – 26 =
51 – 23 =
67 – 24 =
76 – 16 =

3 Njehsojmë:
52 – 27 =

	Dh	Nj
	4	12
–	5	2
	2	7
	2	5

83 – 24 = 71 – 39 = 45 – 18 = 64 – 29 =
74 – 38 = 54 – 28 = 52 – 49 = 65 – 27 =

102

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve situata problemore: Në korridorin e shkollës kanë qenë 34 vazo me lule. Prej këtyre vazove me lule, 18 janë vyshkur gjatë stinës së dimrit. Sa vazo me lule kanë mbetur pa u vyshkur? Si mund të njehsojmë?

Përgjigjet që japin nxënësit me mënyrat e zgjidhjes shënohen në tabelë.

Hapi 2: Sqarohet detyra 1 e njehsuar në libër. Parashtrohen pyetje për diskutim:
Sa udhëtarë kanë qenë në autobus? (43); Sa udhëtarë kanë zbritur në stacionin e parë? (28); Sa udhëtarë kanë mbetur? Për të njehsuar detyrën, udhëzohen nxënësit të tregojnë dhjetëshet dhe njëshet te i zbritshmi dhe zbritësi. Sa është numri i njësheve që duhet zbritur? Sqarohet mënyra e njehsimit. Mund të përdoren edhe shufrat dhe kubet.
Shfaqet videoja në linkun në vijim:



https://www.mathplayground.com/video_subtraction_regrouping.html.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë ndryshimin e numrave në detyrën 2, duke përdorur boshtin numerik.

Në detyrën 3, ata njehsojnë ndryshimin e numrave në shtylla (4 detyrat e rreshtit të parë).

83	71	45	64
- 24	- 39	- 18	- 29

Hapi 4: Paraqiten disa detyra para nxënësve dhe u kërkohet që të njehsojnë ndryshimin e numrave dyshifrorë në mënyra të ndryshme (me shufra dhe kube, bosht numerik, në shtyllë).
Disa detyra të mundshme:

66- 25= 34-28=
75-16= 63-28=

Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë për njehsimin e ndryshimit të numrave dyshifrorë në mënyra të ndryshme.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 102, 4 detyrat e rreshtit të dytë).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 75

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (shumën, ndryshimin) e shprehjeve numerike të përbëra nga dy veprime.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3 II.2 III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën dhe ndryshimin e numrave dyshifrorë;
- Plotëson saktë detyrat;
- Zgjidh problemat me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa, projektor, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me ngjyrë të kuqe, ku janë të shënuara detyra të ndryshme, dhe në etiketat me ngjyrë të kaltër janë të shënuara zgjidhjet. Kërkohet nga nxënësit t'i bashkojnë detyrat me zgjidhjet e tyre.



Hapi 2: Me anë të projektorit, paraqitet detyra 1. Nxënësit vëzhgojnë dhe e punojnë atë (25+17=__0). Diskutohen këto pyetje: -Cilët janë mbledhorët? (25 dhe 17);
Sa njëshe dhe dhjetëshe ka numri 25? (2 Dh, 5 Nj); Sa njëshe dhe dhjetëshe ka numri 17? (1 Dh, 7 Nj);
Si mund ta ndajmë numrin 17?



25+17=42

25+10=35
35+7=42

Hapi 3: Kërkohet nga një nxënës të lexojë detyrën 2. Diskutohen këto pyetje: Sa topa janë në kuti?(85); Sa topa janë me ngjyrë të kuqe? (29); Po me ngjyrë të kaltër? (28); Sa topa janë me ngjyrë të bardhë? (28)
85-29-28=(85-29)-28=56-28=28

Hapi 4: Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 3. Jepen këto udhëzime: Numri që fitohet te barazimi shënohet në katrorin e zbrazët. Më pas, numri që u shënua te katrori përshkruhet dhe zbritet me numrin e radhës.

Hapi 5: Nxënësit punojnë detyrat e radhës, në libër. Japin përgjigje për këto pyetje: a) Si duhet shënuar ndryshimi i numrave 65 dhe 43? (65-43); Po ndryshimi i numrave 69 dhe 45? (69-45).
Fjala rritemi, cilën shenjë e tregon? (mbledhjen) (65-43)+(69-45)=_____ b) Si duhet shënuar shumën e numrave 21 dhe 65? (21+65); Po shumën e numrave 52 dhe 23 (52+23);
Fjala zvogëlojmë, cilën shenjë e tregon? (Zbritjen.) (21+65)-(52+23)=_____

Hapi 6: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen fletët dhe udhëzohen të punojnë detyrat duke njehsuar shumën dhe ndryshimin. Zgjidhjet, më pas, do t'i shënojnë në fletore.

Gr.1: (39+24; 59+16; 81-28; 61-26)
Gr.2: (82-12; 98-74; 18+17; 25+28)

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në plotësimin gjetjen, plotësimin dhe zgjidhjen e saktë të shumës dhe të ndryshimit të numrave dyshifrorë.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 103).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 76

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Lexon dhe shkruan numrat deri në 100 dhe përcakton vlerën e çdo shifre;
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.3, 1.4, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan numrat që mungojnë në tabelën me 100 numra;
- Ngjyros katrorët me numra sipas kërkesës së detyrave;
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.



1 Kjo tabelë duhet t'i përmbajë të gjithë numrat nga 1 deri në 100:

1									
11									
	22								
		33							
			44						
				55					
					66				
						77			
							88		
								99	

1. Në tabelë shkruajmë numrat që mungojnë.
2. Ngjyrosim me të kaltër katrorët me numra më të mëdhenj se 48 e më të vegjël se 55.
3. Ngjyrosim me të verdhë katrorët me numra më të vegjël se 45 e më të mëdhenj se 30.
4. Ngjyrosim me të kuqe katrorët me numra më të mëdhenj se 60, të cilët përmbajnë shifrën 9.
5. Ngjyrosim me të gjelbër katrorët me numra, shifra e dhjetësheve të të cilëve është 2.
6. Rrumbullakojmë të gjithë numrat më të mëdhenj se 45 e më të vegjël se 70, shuma e shifrave të të cilëve është 8.

2 Njehsojmë dhe i shenjojmë zgjidhjet.

PËRSËRISIM

105

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të mendojnë dhe më pas të shkruajnë në fletore një numër nga numri 1-100. Pastaj shkruhet në tabelë një nga numrat e menduar nga nxënësit. Diskutohet për ndërtimin e numrit të shkruar, shifrën që përfaqëson njëshen/dhjetëshen apo qindëshen. Nxënësit, më pas, formojnë një varg numrash në fletore, duke filluar prej numrit të përzgjedhur. Vargu duhet të ketë 6-7 numra. Vargjet mund të formohen duke ndjekur rregulla, siç është rritja apo zvogëlimi për nga një për secilin anëtar të radhës në varg, rritja apo zvogëlimi për dhjetë etj.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë tabelën me 100 numra, me numrat që mungojnë. Më pas ngjyrosin katrorët me numra sipas kërkësave të dhëna. Pyeten ata:



- Cilët numra janë më të mëdhenj se 48 e më të vegjël se 55? (49, 50, 51...54)
- Cilët numra janë më të vegjël se 45 e më të mëdhenj se 30? (31, 32, 33... 44);
- Cilët numra janë më të mëdhenj se 60 të cilët përmbajnë shifrën 9? (69, 79, 89,90, 91...99);
- Cilët numra kanë shifrën e dhjetësheve 2? (20, 21, 22, 23 ... 29);
- Cilët numra janë më të mëdhenj se 45 e më të vegjël se 70, shuma e shifrave të të cilëve është 8? (53, 62, 71 dhe 80).

Hapi 3: Detyra 2: Llogarisin shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë.

Detyra 3: Pasi të kenë llogaritur shumën dhe ndryshimin e numrave, rezultatet i ngjyrosin sipas udhëzimeve të marra në libër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shkrimin e numrave deri në 100, llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave.

Detyrë:
Detyrat 4 dhe 5 (faqe 106).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 77

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes;
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
- Zbaton mbledhjen, zbritjen në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; II.2, 8; III.3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 4; 3. 1, 3, 4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën dhe zbritjen e numrave dyshifrorë me një numër tjetër dyshifror;
- Përdor mënyra të ndryshme gjatë njehsimit të numrave;
- Plotëson saktë detyrat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë në mënyrë individuale detyrën e parë. Në këtë detyrë, ata duhet të gjejnë mbledhorin që mungon, në mënyrë që, kur mbledhorët të mblidhen, shuma e tyre të jetë e barabartë me 100.

$33 + \square = 100$

$17 + \square = 100$



Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të shikojnë trekëndëshat në detyrën e dytë dhe të zbulojnë se me çfarë numra duhet të plotësohen ata, në mënyrë që të fitohen barazi të sakta.
Diskutohet bashkë me nxënësit:

- Sa mbledhorë janë në trekëndëshin e parë?
- Cili numër me cilin numër duhet të mblidhet që të fitohet numri 18 që gjendet jashtë trekëndëshit?
- Po numrat 18 dhe 30, si fitohen? Cilët numra janë mbledhur?
- Cilët numra duhet të shkruhen në katrorët e zbrazët me ngjyrë rozë?

Hapi 3:

Bisedohet bashkë me nxënësit dhe pyeten ata se kur e kanë ditëlindjen dhe sa vjeçarë janë. Pastaj u kërkohet të vëzhgojnë detyrën dhe të gjejnë duke njehsuar se sa vjeçarë janë Fjolla dhe Guri.

✓ Rezultatet e detyrave lexohen radhazi dhe korrigjohen njëkohësisht.
✓ Nxënësit, duke mbledhur dhe zbritur numrat, zbulojnë se Fjolla është 8-vjeçare dhe Guri është 9-vjeçar.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen, plotësimin dhe zgjidhjen e detyrave.

Detyrë:
Shkruan në fletore barazimet e detyrës së tretë dhe vizaton një ëmbëlsirë ditëlindjeje.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 78

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Mbledh dhe zbret paratë (euro).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 4.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Euro

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vlerat e monedhave dhe të kartëmonedhave euro;
- Bën llogaritje me para.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto (monedha, kartëmonedha euro), TV, internet, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet bisedë me nxënësit. Çfarë janë paratë? Për çfarë i shfrytëzojmë ato? A i njihni paratë? Për çka i përdorni ju paratë? Cilat janë disa nga gjërat që ju i blini dhe sa është çmimi i tyre?
Paraqitet para nxënësve videoja nga linku në vijim:
https://www.youtube.com/watch?v=m9ZKfhQ2HY8

Diskutohet rreth përmbajtjes së videos. Cilat monedha euro u paraqitën në video?

Hapi 2: Paraqiten në projektor ose në video, foto të ndryshme të monedhave dhe kartëmonedhave euro. Jepen sqarime për vlerat e monedhave dhe të kartëmonedhave euro.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat 1 dhe 2 në libër. Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë

fotot dhe të tregojnë vlerat e parave të paraqitura aty.

Detyra 3. Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë shumën e parave në foto.

Detyra 4. Nxënësve u kërkohet të caktojnë shumën e parave, më pas të llogaritin ndryshimin, duke u bazuar në fotografitë e dhëna.
Detyra 5. Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë shumën e eurove dhe centëve në fotografitë e dhëna.

Hapi 4: Zhvillohen ushtrime me nxënës për përcaktimin e vlerave dhe llogaritjeve me para. Mund të shfrytëzohen fletë pune sipas modeleve.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e vlerave të monedhave dhe kartëmonedhave, si dhe llogaritjeve me para.

Detyrë:
Shkruan çmimet e katër mjeteve shkollore (laps, gomë, fletore, vizore). Llogarit shumën e tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 79

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Mbledh dhe zbret paratë (euro).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1,2,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vlerën e monedhave dhe të kartëmonedhave;
- Bën llogaritje me para;
- Përcakton vlerën monetare të gjësendeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, monedha, kartëmonedha, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuha amtare (shqipe), Edukatë figurative.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Me anë të projektorit vendosen monedhat dhe kartëmonedhat. Diskutohet rreth këtyre pyetjeve: Çfarë janë këto? I dalloni ato që janë ndryshe nga njëra-tjetra? (Nga ngjyra dhe përbërja e tyre.) Disa nga këto kanë përbërje metalike dhe formë rrethi, të cilat quhen monedha. (Disa nga monedhat janë 1c, 2c, 3c, 20c, 50, 1€,2€); Po paratë e tjera, çfarë përbërje kanë? (letra). Paratë që përdoren nga letrat quhen kartëmonedha. (Disa nga kartëmonedhat janë 5€, 10€, 20€, 100€, 200€.)



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 1. Diskutohen këto pyetje: Sa është shuma e kartëmonedhave nëse i mbledhim 50€+10€+5€?(65€); Sa është shuma e monedhave nëse i mbledhim 2€+1€+50c=20c+20c+10c? (4€); Sa do të jetë shuma, nëse i mbledhim kartëmonedhat dhe monedhat? (65€+4€=69€).

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të punojnë detyrën 2. Japin përgjigje për këto pyetje: Nëse janë 100c, me sa euro është e barabartë? (100c=1€); Janë 50c, sa duhet t'i shtojmë që të fitojmë 1€? (50c); Po nëse janë 72c, sa duhet t'i shtojmë që të fitojmë 1€? (28c).

Hapi 4: Tabela me monedha dhe kartëmonedha vizatohet në dërrasë. Nxënësit do të numërojnë dhe do të plotësojnë detyrën 6 (faqe 110).
Në figurë janë të paraqitura monedhat (euro) që janë të vendosura në mënyrë vertikale 50€, 20€, 10€, 5€ dhe monedhat 2€, 1€, 50c, 20, 10, 5, 2c, 1c. Ndërsa në mënyrë horizontale është e vendosur shuma e monedhave. (47€ 86c, këtu merren 2 kartëmonedha nga 20€ dhe fitohet shuma 40€, më pas na duhet dhe një kartëmonedhë me 5€, që të fitohet numri 45€). Duhet të fitojmë numrin 47€, pra duhet marrë dhe një monedhë 2€ (tani fitohet 47€). Duhet të fitojmë dhe 86c (marrim një monedhë 50c, një monedhë 20c dhe një monedhë 10c, deri më tani shuma është 80c, duhet të marrim dhe një monedhë 5c, dhe një monedhë 1c).

Hapi 5: Detyra 4 plotësohet në mënyrë individuale. Udhëzohen që të bëjnë mbledhjen dhe zbritjen e numrave me cent.

Hapi 6: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen fletët e përgatitura. Jepen këto udhëzime: Ju duhet t'i zgjidhni disa produkte që dëshironi t'i blini. Pasi ta bëni zgjedhjen e produktit dhe ta bëni blerjen, në kolonën e tretë duhet ta bëni llogaritjen.

Produktet	Blerja	Shuma në euro
5 € 2 € 6 €	2 € 6 €	2 € + 6 € = 8 €

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin e vlerave të parave, si dhe për llogaritjen e tyre.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 110).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 80

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes së numrave deri në 100;
- Përdor vetinë komutative për të gjetur shumën e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2; III. 2, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 3, 5; 3. 1,3, 4, 6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ndërrimi i vendeve të mbledhorëve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën duke bërë ndërrimin e vendeve të mbledhorëve;
- Tregon mënyrën e zgjidhjes së detyrës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shufra dhe kubëza.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten në tabelë problemat dhe kërkohet nga nxënësit që gjysma e tyre të njehsojnë problemin e parë dhe gjysma tjetër problemin e dytë.

Miri lexon një libër. Ditën e parë ai lexoi 35 faqe, kurse ditën e dytë ai lexoi 27 faqe. Sa faqe lexoi Miri gjithsej?

Era lexon një libër. Ditën e parë ajo lexoi 27 faqe, kurse ditën e dytë ajo lexoi 35 faqe. Sa faqe lexoi Era gjithsej?



VETI TË VEPRIMEVE ME NUMRA

NDËRRIMI I VENDEVE TË MBLEDHORËVE

1 Vetia e ndërrimit të vendeve të mbledhorëve.

45 + 37 = ☐ 37 + 45 = ☐

36 + 28 = ☐ 63 + 37 = ☐ 69 + 23 = ☐

28 + 36 = ☐ 37 + 63 = ☐ 23 + 69 = ☐

Nëse mbledhorët i ndërrojnë vendet, shuma e tyre nuk ndryshon.

2 Më herët kemi mësuar se anët e barazisë mund t'i ndërrojnë vendet. Pra:

35 + 20 = 55 ose 55 = 35 + 20

35 + 20 = 55

ana e majtë e barazisë; ana e djathtë e barazisë

Pra, mund të shkruajmë:

35 + ☐ = ☐ 55 = ☐ + ☐

20 + ☐ = ☐ 55 = ☐ + ☐

3 Njehsojmë shumën dhe barazinë e fituar e shkruajmë edhe në tri forma të tjera:

37 + 54 = ☐ ☐ + ☐ = ☐ ☐ = ☐ + ☐ ☐ = ☐ + ☐

34 + 47 = ☐ ☐ + ☐ = ☐ ☐ = ☐ + ☐ ☐ = ☐ + ☐

MËSOJMË

111

Nxënësve u kërkohet të lexojnë barazimet dhe t'i shkruajnë në tabelë:

35 + 24 = 62 27 + 35 = 62

Bisedohet me ta:

- Sa faqe lexoi Miri? (62);
- Sa faqe lexoi Era? (62);
- Për çfarë dallojnë këto dy barazime? (ndërrohen mbledhorët)
- A ndryshon shuma? (jo).

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të shikojnë shufrat dhe kubëzat në detyrën 1 dhe bisedohet me ta:

- Cilët numra janë në detyrën në anën e majtë të barazimit? (45+37);
- Cilët numra janë në detyrën në anën e djathtë të barazimit? (37+45);
- A ndryshoi shuma në të dy barazimet? (jo).

Nxënësve u sqarohet se nëse ndërrohen vendet e mbledhorëve, shuma e tyre nuk ndryshon.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë ushtrimet e tjera në detyrën 1.

Hapi 4: Shkruhet në tabelë barazimi: 35 + 20 = 55 dhe diskutohet me ta:

- Cili është mbledhori i parë? (35); Cili është mbledhori i dytë? (20);
- Sa është shuma? (55);
- A mund t'i ndërrojmë vendet e mbledhorëve?
- Si? (20 +35=55);
- Cila është ana e majtë e barazimit? (35 + 20);
- Cila është ana e djathtë e barazimit? (55); A mund t'i ndërrojmë anët e barazimit? Si?

- Nxënësve u tregohet se mund të veprohet edhe kështu: 35 + 20=55, 55 = 35 + 20 dhe 55 = 20 + 35;
- Nga nxënësit kërkohet të plotësojnë barazimet e tjera në detyrën 2 në libër.

Hapi 5: Nxënësit plotësojnë të pavarur detyrën 3 në libër dhe i shkruajnë barazimet edhe në tri forma të tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin dhe zbatimin e vetisë së ndërrimit të vendeve të mbledhorëve.

Detyrë:

Formon katër barazime që shprehin shumën e dy numrave dhe e ndërron vendin e tyre.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 81

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes me numrat natyrorë deri në 100;
- Përdor vetinë komutative për të gjetur shumën e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 3.4.


USHTROJMË

1 Për të fituar vetinë e ndërrimit të vendeve të mbledhorëve, i bashkojmë shprehjet.

12 + 0 · 41 + 30 · 29 + 17 · 0 + 12 · 35 + 22 · 30 + 41 · 54 + 36 · 22 + 35 · 36 + 54 · 17 + 29 · 90 + 4 · 4 + 90

2 Pa njehsuar, plotësojmë drejtkëndëshat me numra dhe fitojmë barazi të sakta.

18 + 5 = □ + 18 43 + □ = 24 + □ □ + 19 = □ + 36

3 Duke grupuar mbledhorët, njehsojmë shumën.

27 + 46 + 13 = 27 + 13 + 46
= (27 + 13) + 46
= 40 + 46
= 86

43 + 35 + 7 = □ 37 + 12 + 23 = □ 27 + 35 + 13 = □
39 + 42 + 11 = □ 59 + 12 + 21 = □ 38 + 18 + 42 = □

4 Njehsojmë dhe plotësojmë:

26, 53, 23 → +8 → 3 → −6

112

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën duke ua ndërruar vendin mbledhorëve;
- Njehson shumën duke i grupuar mbledhorët.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me mbledhorë. Ata duhet të gjejnë etiketat që kanë mbledhorët e njëjtë, më pas të gjejnë shumën e dy mbledhorëve.

8 + 30	28 + 43	71 + 18	43 + 28	34 + 41	18 + 71	41 + 31	30 + 8

Hapi 2: Nxënësit vështrojnë barazimet e dhëna në detyrën 1, dhe bashkojnë shprehjet me ndërrimin e vendeve të mbledhorëve.

USHTROJMË

1 Për të fituar vetinë e ndërrimit të vendeve të mbledhorëve, i bashkojmë shprehjet.



2 Pa njehsuar, plotësojmë drejtkëndëshat me numra dhe fitojmë barazi të sakta.

18 + 5 = ☐ + 18 43 + ☐ = 24 + ☐ ☐ + 19 = ☐ + 36

3 Duke grupuar mbledhorët, njehsojmë shumën.

27 + 46 + 13 = 27 + 13 + 46
= (27 + 13) + 46
= 40 + 46
= 86

43 + 35 + 7 = ☐ 37 + 12 + 23 = ☐ 27 + 35 + 13 = ☐
39 + 42 + 11 = ☐ 59 + 12 + 21 = ☐ 38 + 18 + 42 = ☐

4 Njehsojmë dhe plotësojmë:



112

Hapi 3: Detyra 2 - Gjej mbledhorin që mungon në barazitë e dhëna.

18 + 5 = 5 + 18	43 + 24 = 24 + 43	36 + 19 = 19 + 36

Hapi 4: Detyra 3 – Njehsohet shuma e numrave të dhënë, duke grupuar mbledhorët.

43 + 35 + 7 = (43 + 7) + 35 = 50 + 35 = 85
39 + 42 + 11 = (39 + 11) + 42 = 40 + 42 = 82

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës së numrave, duke zbatuar vetinë e ndërrimit të mbledhorëve.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 112).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 82

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.1; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shoqërimi i mbledhorëve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën duke shoqëruar mbledhorët.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


SHOQËRIMI I MBLEDHORËVE

1 Duke bërë grupimin e mbledhorëve, shumën 17 + 35 + 23 mund ta njehsojmë në tri mënyra:

Mënyra e parë: 17 + 35 + 23 = (17 +35) + 23 = ___ + ___ = ☐.

Mënyra e dytë: 17 + 35 + 23 = 17 + (35 + 23) = ___ + ___ = ☐.

Mënyra e tretë: 17 + 35 + 23 = 17 + 23 + 35 = (17 + 23) + 35
= ___ + ___ = ☐.

Grupimi i mbledhorëve bëhet për ta gjetur më lehtë shumën e numrave.

2 Duke bërë grupimin e mbledhorëve, njehsojmë shumën.

16 + 29 + 34 = _____
16 + 29 + 34 = _____
16 + 29 + 34 = _____

3 Grupojmë mbledhorët dhe e lehtësojmë njehsimin e shumës.

27 + 46 + 13 = _____
53 + 34 + 7 = _____
39 + 43 + 11 = _____

4 Shprehjet e dhëna me fjalë i shkruajmë si shprehje numerike dhe e njehsojmë vlerën e tyre:

1. Shumën e numrave 23 dhe 38 e rritim për numrin 17.
Njehsojmë: (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = ___.

2. Numrin 47 e rritim për shumën e numrave 23 dhe 19:
Njehsojmë: ___ + (___ + ___) = ___ + ___ = ___.

5 Sara i ka kursyer 37 euro, kurse vëllai i saj Luli 25 euro. Duke i vlerësuar ata për kursimin, nëna u dha atyre edhe 33 euro. Sa euro kanë ata së bashku?
Njehsojmë: ___ + (___ + ___) = ___ + ___ = ___.
Përgjigjja: _____

MËSOJMË
113

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me numrat: 17, 35 dhe 23. Kërkohet nga ata që në dyshe të bashkëpunojnë dhe të njehsojnë shumën e numrave në etiketa. Mënyrat e njehsimit që tregonë nxënësit shënohen në tabelë dhe diskutohet se cila ishte mënyra më e lehtë për të gjetur shumën.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë shoqërimin e mbledhorëve në detyrën 1 në libër. Tregohet se mbledhorët janë shoqëruar në tri mënyra:
17+35+23= (17+35) +23=
17+35+23=17+(35+23)=
17+35+23=17+23+35=(17+23)+35=
Nxënësit e vazhdojnë njehsimin e shumës. Parashtrohet pyetja: Cila ishte mënyra më e lehtë për të njehsuar shumën? Tregohet se shoqërimi i mbledhorëve bëhet për të gjetur më lehtë shumën.
Nxënësit udhëzohen të njehsojnë shumën në detyrën 2 duke shoqëruar mbledhorët.



1 Duke bërë grupimin e mbledhorëve, shumën 17 + 35 + 23 mund ta njehsojmë në tri mënyra:

Mënyra e parë: 17 + 35 + 23 = (17 +35) + 23 = ___ + ___ = ☐.

Mënyra e dytë: 17 + 35 + 23 = 17 + (35 + 23) = ___ + ___ = ☐.

Mënyra e tretë: 17 + 35 + 23 = 17 + 23 + 35 = (17 + 23) + 35
= ___ + ___ = ☐.

Grupimi i mbledhorëve bëhet për ta gjetur më lehtë shumën e numrave.

2 Duke bërë grupimin e mbledhorëve, njehsojmë shumën.

16 + 29 + 34 = _____
16 + 29 + 34 = _____
16 + 29 + 34 = _____

3 Grupojmë mbledhorët dhe e lehtësojmë njehsimin e shumës.

27 + 46 + 13 = _____
53 + 34 + 7 = _____
39 + 43 + 11 = _____

4 Shprehjet e dhëna me fjalë i shkruajmë si shprehje numerike dhe e njehsojmë vlerën e tyre:

1. Shumën e numrave 23 dhe 38 e rritim për numrin 17.
Njehsojmë: (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = ___.

2. Numrin 47 e rritim për shumën e numrave 23 dhe 19:
Njehsojmë: ___ + (___ + ___) = ___ + ___ = ___.

5 Sara i ka kursyer 37 euro, kurse vëllai i saj Luli 25 euro. Duke i vlerësuar ata për kursimin, nëna u dha atyre edhe 33 euro. Sa euro kanë ata së bashku?
Njehsojmë: ___ + (___ + ___) = ___ + ___ = ___.
Përgjigjja: _____

Në detyrën 4, udhëzohen që shprehjet e dhëna me fjalë t'i shkruajnë si shprehje numerike dhe të gjejnë shumën.
Detyra 5. Nxënësit lexojnë problemin me fjalë dhe gjejnë zgjidhjen. Kërkohet nga ata të arsyetojnë zgjidhjen e problemit.

Hapi 3: Nxënësve u caktohen detyra me nga tre mbledhorë dhe u kërkohet të njehsojnë shumën duke shoqëruar mbledhorët.

Disa detyra për nxënësit mund të jenë:

24+38+16= 29+32+11=
15+28+42= 14+22+36=

Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shumës duke shoqëruar mbledhorët.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 113).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 83

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3;II.2,8; III.1,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,4; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën e tre mbledhorëve;
- Zgjidh problemet me fjalë;
- Njehson shumën duke grupuar mbledhorët.


USHTROJMË

1 Duke ndërruar dhe shoqëruar mbledhorët, njehsojmë shumën.

18 + 37 + 22 = 18 + 22 + 37 = (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = 77.

43 + 24 + 27 = ___ + ___ + 24 = (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = ___.

49 + 33 + 11 = ___ + ___ + 33 = (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = ___.

2 Analizojmë figurat dhe plotësojmë fushat e zbrazëta.

28, 19, 12 → 59
33, 17, 12 → ___
11, 49, 13 → ___
25, 37, 23 → ___

28 + 12 + 19 = 40 + 19 = 59.

3 Shumën e numrave 34 dhe 19 e rritim për ndryshimin e numrave 83 dhe 60. Cili numër fitohet?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

4 Në autobusin e shkollës ishin 33 nxënës. Në stacionin e parë zbritën 20, ndërsa në autobus hynë edhe 27 nxënës të tjerë. Sa nxënës janë në autobus?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

5 Duke shoqëruar mbledhorët, njehsojmë shumën.

27 + 3 + 8 = ☐	63 + 8 + 7 = ☐	7 + 51 + 9 = ☐
34 + 6 + 2 = ☐	5 + 85 + 6 = ☐	76 + 4 + 4 = ☐
48 + 5 + 2 = ☐	13 + 7 + 1 = ☐	82 + 3 + 8 = ☐

114

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shkruhen në tabelë tre numra: 22, 15 dhe 38. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë si mund të gjejnë shumën e këtyre tre mbledhorëve. Diskutohen këto pyetje: Sa mbledhorë kemi? (3); Çfarë duhet të bëjmë që t'i mbledhim tre mbledhorë? (Dy mbledhorë i fusim në kllapa dhe një mbledhor qëndron jashtë kllapave.) Në sa mënyra mund t'i shënojmë këto barazi? (3).
Mënyra e parë: 22+15+38= (22+15)+38=37+38=75
Mënyra e dytë: 22+15+38= (22+38)+15=60+15=75
Mënyra e tretë: 22+15+38= 22+(15+38)=22+53=75

Hapi 2: Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë dhe të punojnë në libër detyrën 1. Diskutohen këto pyetje: -Sa mbledhorë kemi? (3); –Cilët janë? (18+37+22=18+22+37. Mbledhorëve 37 dhe 22 ua kemi ndërruar



1 Duke ndërruar dhe shoqëruar mbledhorët, njehsojmë shumën.

18 + 37 + 22 = 18 + 22 + 37 = (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = 77.

43 + 24 + 27 = ___ + ___ + 24 = (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = ___.

49 + 33 + 11 = ___ + ___ + 33 = (___ + ___) + ___ = ___ + ___ = ___.

2 Analizojmë figurat dhe plotësojmë fushat e zbrazëta.

28 + 12 + 19 = 40 + 19 = 59.

3 Shumën e numrave 34 dhe 19 e rritim për ndryshimin e numrave 83 dhe 60. Cili numër fitohet?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

4 Në autobusin e shkollës ishin 33 nxënës. Në stacionin e parë zbritën 20, ndërsa në autobus hynë edhe 27 nxënës të tjerë. Sa nxënës janë në autobus?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

5 Duke shoqëruar mbledhorët, njehsojmë shumën.

27 + 3 + 8 = ☐	63 + 8 + 7 = ☐	7 + 51 + 9 = ☐
34 + 6 + 2 = ☐	5 + 85 + 6 = ☐	76 + 4 + 4 = ☐
48 + 5 + 2 = ☐	13 + 7 + 1 = ☐	82 + 3 + 8 = ☐

USHTROJMË

114

vendet, pse? (Sepse është më lehtë të mblidhen numrat që na japin dhjetëshen e plotë). Po në rastin e dytë, cilëve mbledhorë u duhet ndërruar vendet? (24 me 27). Në rastin e fundit, cilëve mbledhorë u duhet ndërruar vendet? (33 me 11).

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur, detyrën 2, në libër. Jepen këto sqarime: Në secilin trekëndësh janë të shënuar nga tre mbledhorë. Duhet nisur nga numrat që kur të mblidhen mes vete duhet të fitohet numri i plotë (17+33)+12=50+12=62.

Hapi 4: Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë detyrën 3. Parashtrohen këto pyetje: Si duhet të shënohet shuma e numrave 34 dhe 19? (34+19); Kur themi e rritim, cila shenjë duhet shënuar? (+); Si duhet shënuar ndryshimi i numrave 83 dhe 60? (83-60).
(34+19)+(83-60)=53+23=76

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 4. Sa nxënës ishin në autobusin e shkollës? (33); Sa zbritën në stacionin e parë? (20); Edhe sa nxënës hynë në autobus? (27); Sa nxënës janë në autobus?
33-20+27=13+27=40.

Hapi 6: Kërkohet nga nxënësit të punojnë detyrën 5. Shënohet detyra në tabelë: 27+3+8. Si duhet t'i mbledhim mbledhorët? (Së pari i mbledhim ata dy numra që na japin dhjetëshen e plotë, pasi të fitohet dhjetëshja e plotë mblidhet me mbledhorin tjetër.)

Hapi 7: Nxënësve, të ndarë në çifte, u shpërndahen nga tri etiketa dhe u kërkohet të gjejnë shumën e tre numrave duke bërë grupimin (shoqërimin) e mbledhorëve.

31 15 19

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shoqërimin (grupimin) e tre mbledhorëve dhe në zgjidhjen e detyrave me fjalë.

Detyrë:
Formon nga dy barazime me nga tre mbledhorë dhe shoqëron mbledhorët për të njehsuar më lehtë shumën.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 84

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe zbritjes;
- Zgjidh problema të thjeshta.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.8, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 1.4, 2.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Detyra me dy veprime

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Zgjidh problemat e dhëna me fjalë;
- Llogarit shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), TIK.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në projektor paraqitet kjo problemë: Shumën e numrave 15 dhe 5 e zvogëlojmë për 8. Nxënësve u lihet hapësirë të mendojnë dhe ta gjejnë zgjidhjen e detyrës. Më pas u sqarohet mënyra e zgjidhjes së detyrës duke paraqitur zgjidhjen si vijon:
(15 + 5) – 8 = 20 – 8 = 12.
Nxënësit pyeten se ç'kuptojnë ata me fjalët "veprime të përziera". Përmes diskutimit, konkludohet se veprimet e përziera nënkuptojnë pjesëmarrjen e dy a më shumë veprimeve matematikore në të njëjtën shprehje numerike apo barazim.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësve u kërkohet që të zgjidhin problemën në mënyrë të pavarur, në të tria format.
Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që pasi t'i kenë mbledhur numrat 39 dhe 15, shumën e fituar e zbresin

1 Në shitore ishin 38 këmishë për të rritur dhe 57 këmishë për fëmijë. Gjatë ditës u shitën 34 këmishë. Sa këmishë mbetën në shitore?

Janë të mundshme këto raste:

Rasti i parë: Të gjitha këmishët e shitura janë për fëmijë. Në këtë rast njehsojmë kështu:

38 + (57 – ___) = ___ + ___ = ___.

Rasti i dytë: Të gjitha këmishët e shitura janë për të rritur. Në këtë rast njehsojmë kështu:

(___ – ___) + 57 = ___ + ___ = ___.

(___ + 57) – ___ = ___ – ___ = ___.

Rasti i tretë: Këmishët e shitura janë nga dy llojet. Në këtë rast llogarisim kështu:

Pra, në shitore mbetën edhe ___ këmishë.

2 Nga shuma e numrave 39 dhe 15, zbresim numrin 17. Cili numër fitohet?

Njehsojmë: (39 + 15) – 17 = ___ – ___ = 37.

Përgjigjja: _____

3 Dioni i kishte 100 euro. Në njërën shitore harxhoi 18 euro, ndërsa në shitoren tjetër 25 euro. Sa euro i mbetën Dionit?

Njehsojmë: ___ – (___ + ___) = ___ – ___ = 57 euro.

Përgjigjja: _____

4 Njehsojmë:

	+15	–18
22		
44		
35		
52		

	+30	–40
36		
48		
69		
58		

me numrin 17, në mënyrë që të fitohet numri i kërkuar në detyrë.

Hapi 3: Detyra 4: Nxënësit në mënyrë të pavarur llogarisin shumën dhe ndyshimin e numrave të dhënë. Udhëzohen që për zgjidhjen e kërkesës të orientohen me drejtimin e shigjetave të dhëna. Shembull:

	+15	-18
22	37	19
44	59	41

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e problemeve me fjalë dhe llogaritjen e shumës dhe ndryshimit të numrave.

Detyrë:

Detyra 3 (faqe 115).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 85

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
- Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave;
- Zbaton mbledhjen dhe zbritjen, në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2; III. 2, 3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 3, 5; 3. 1,3, 4, 6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson detyra me dy veprime;
- Zgjidh problemat me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Shkencat e natyrës.


USHTROJMË

1 Në njërën paralele të klasave të dyta janë 32 nxënës, kurse në tjetrën 3 nxënës më pak. Sa nxënës janë në të dyja paralelet?
Njehsojmë: 32 + (___ – 3) = ___ + ___ = ___.
Pra, në të dyja paralelet janë ___ nxënës.

2 Figurat zëvendësojnë numra. Cilët numra i zëvendësojnë ato?
+ = 16 → ▭
+ = 22 → ▭
+ = 21 → ▭
+ = 18 → ▭

3 Mbledhori i parë është 27, kurse i dyti për 12 më i madh se mbledhori i parë. Sa është shuma?
Njehsojmë: 27 + (___ + ___) = ___ + ___ = ___.
Përgjigjja: _____

4 Vala i kishte 95 centë dhe me ato para ajo bleu një fletore për 47 centë dhe një laps për 18 centë. Sa para i mbetën Valës?
Njehsojmë: 95 – (___ + ___) = ___ – ___ = ___.
Përgjigjja: _____

5 Nxënësit e klasave të dyta kanë organizuar një ekskursion. Për udhëtim ata kanë marrë tre autobusë. Në autobusin e parë ishin 28 nxënës, në të dytin 12 nxënës më shumë se në autobusin e parë dhe në të tretin 3 nxënës më shumë se në autobusin e parë. Sa nxënës kanë shkuar në ekskursion?
Njehsojmë: 28 + (___ + 12) + (___ + 3) = ___ + ___ + ___ = ___.
Përgjigjja: _____

6 Kopjojmë dhe njehsojmë:
+12
12
24

116

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të lexojnë kërkesën e problemit me fjalë në detyrën 1 dhe të gjejnë zgjidhjen.

Në njërën paralele të klasave të dyta janë 32 nxënës, kurse në tjetrën 3 nxënës më pak. Sa nxënës janë në të dyja paralelet?

Njehsojmë: 32 + (___ - 3) = ___ + ___ = ___



USHTROJMË

1 Në njërën paralele të klasave të dyta janë 32 nxënës, kurse në tjetrën 3 nxënës më pak. Sa nxënës janë në të dyja paralelet?

Njehsojmë: 32 + (___ – 3) = ___ + ___ = ___ .

Pra, në të dyja paralelet janë ___ nxënës.

2 Figurat zëvendësojnë numra. Cilët numra i zëvendësojnë ato?

+ = 16 → □ + = 22 → □

+ = 21 → □ + = 18 → □

3 Mbledhori i parë është 27, kurse i dyti për 12 më i madh se mbledhori i parë. Sa është shuma?

Njehsojmë: 27 + (___ + ___) = ___ + ___ = ___ .

Përgjigjja: _____

4 Vala i kishte 95 centë dhe me ato para ajo bleu një fletore për 47 centë dhe një laps për 18 centë. Sa para i mbetën Valës?

Njehsojmë: 95 – (___ + ___) = ___ – ___ = ___ .

Përgjigjja: _____

5 Nxënësit e klasave të dyta kanë organizuar një ekskursion. Për udhëtim ata kanë marrë tre autobusë. Në autobusin e parë ishin 28 nxënës, në të dytin 12 nxënës më shumë se në autobusin e parë dhe në të tretin 3 nxënës më shumë se në autobusin e parë. Sa nxënës kanë shkuar në ekskursion?

Njehsojmë: 28 + (___ + 12) + (___ + 3) = ___ + ___ + ___ = ___.

Përgjigjja: _____

6 Kopjojmë dhe njehsojmë:

+12

12 24

116

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të lexojnë kërkesën dhe të analizojnë detyrën 2, ku duhet të njehsojnë në bazë të simboleve. Bisedohet me ata:



- Cilin numër paraqet ylli i verdhë?
- Si e gjetët?
- Po simbolet e tjera, çfarë vlera kanë?

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të punojnë në çifte dhe të gjejnë zgjidhjet e problemeve me fjalë në detyrat 3 dhe 4 në libër.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të mbyllin sytë dhe të imagjinojnë se po nisen për në ekskursion. Më pas pyeten se ku do të donin të shkonin.
Pastaj u kërkohet të lexojnë kërkesën e detyrës së pestë dhe ta gjejnë duke njehsuar se sa nxënës kanë shkuar në ekskursion.
Disa nga nxënësit tregojnë përgjigjen e detyrës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e problemave me fjalë.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 116).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 86

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimin e mbledhjes dhe zbritjes;
- Gjen vlerën e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.2, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Zbritja e numrit nga shuma


ZBRITJA E NUMRIT NGA SHUMA

1 Në parkun e qytetit duhet të mbillen 47 fidanë të drurëve gjetherënës dhe 38 të drurëve gjethembajtës. Gjatë ditës së parë u mbollën 28 fidanë. Sa fidanë mbetën pa u mbjellë?

Janë të mundshme këto raste:

Rasti i parë: Të gjithë fidanët e mbjellë janë gjetherënës. Në këtë rast llogarisim kështu:

(47 – ___) + ___ = ___ + 38 = ___.

Rasti i dytë: Të gjithë fidanët e mbjellë janë gjethembajtës. Në këtë rast llogarisim kështu:

47 + (___ – 28) = ___ + ___ = ___.

Rasti i tretë: Fidanët e mbjellë janë nga të dyja llojet. Në këtë rast llogarisim kështu:

(47 + 38) – ___ = ___ – 28 = ___.

Pra, pas ditës së parë, kanë mbetur pa u mbjellë edhe ___ fidanë.

2 Njehsojmë dhe plotësojmë drejtkëndëshat e zbrazët:

44	38
	38 - 22 = 22
44 + (38 - 22) =	

3 Njehsojmë:

17 – 25 + 33 = (___ + ___) – ___ = ___ – ___ = 25.

43 + 37 – 38 = _____

35 + 17 – 18 = _____

4 Njehsojmë:

52		15	48		37	74		18
64	–	16	36	+	19	56	–	36
95		28	78		15	67		27

MËSOJMË

117

Njësia mësimore:
Zbritja e numrit nga shuma

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën dhe ndryshimin e numrave të dhënë;
- Formon barazi me dy veprime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Letra drejtkëndëshe me ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të vështrojnë drejtkëndëshat dhe të gjejnë vlerën e tyre.



Për mësuesin/en



ZBRITJA E NUMRIT NGA SHUMA

1 Në parkun e qytetit duhet të mbillen 47 fidanë të drurëve gjetherënës dhe 38 të drurëve gjethembajtës. Gjatë ditës së parë u mbollën 28 fidanë. Sa fidanë mbetën pa u mbjellë?

Janë të mundshme këto raste:

Rasti i parë: Të gjithë fidanët e mbjellë janë gjetherënës. Në këtë rast llogarisim kështu:

(47 – ___) + ___ = ___ + 38 = ___.

Rasti i dytë: Të gjithë fidanët e mbjellë janë gjethembajtës. Në këtë rast llogarisim kështu:

47 + (___ – 28) = ___ + ___ = ___.

Rasti i tretë: Fidanët e mbjellë janë nga të dyja llojet. Në këtë rast llogarisim kështu:

(47 + 38) – ___ = ___ – 28 = ___.

Pra, pas ditës së parë, kanë mbetur pa u mbjellë edhe ___ fidanë.

2 Njehsojmë dhe plotësojmë drejtkëndëshat e zbrazët:

44	38
	38 - 22 = 22
44 + (38 - 22) =	

3 Njehsojmë:

17 – 25 + 33 = (___ + ___) – ___ = ___ – ___ = 25.

43 + 37 – 38 = _____

35 + 17 – 18 = _____

4 Njehsojmë:

52		15	48		37	74		18
64	–	16	36	+	19	56	–	36
95		28	78		15	67		27

MËSOJMË

117

Hapi 2: Lexohet detyra e dhënë në libër.

Çfarë të dhëna kemi?	Çka duhet të gjejmë?
Duhet të mbillen: ◂ 47 drurë gjetherënës ◂ 38 drurë gjethembajtës Janë mbjellë: ◂ 28 drurë	Edhe sa drunj duhet të mbillen?

Diskutohen të tria rastet e mundshme të njehsimit të rezultatit.

I – (47 – 28) + 38 = 19 + 38 = 57

II – 47 + (38 – 28) = 47 + 10 = 57

III – (47 + 38) – 28 = 85 – 28 = 57

Hapi 3: Detyra 3 – Nxënësit njehsojnë rezultatin e numrave të dhënë duke grupuar mbledhorët dhe duke zbritur numrin nga shuma.

17 – 25 + 33 = (17 + 33) – 25 = 50 – 25 = 25

43 + 37 – 38 = (43 + 37) – 38 = 80 – 38 = 42

35 + 17 – 18 = (35 + 17) – 18 = 52 – 18 = 34

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të formojnë dy barazime sikur në detyrën 3.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin dhe formulimin e detyrave me dy veprime.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 117).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 87

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (*shumën, ndryshimin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3; 6.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbritja e shumës nga numri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson barazimet me zbritje të shumës nga numri.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.


ZBRITJA E SHUMËS NGA NUMRI

1 Blendi kishte 100 €. Në shitoren e parë ai bleu një pallto për 44 €, kurse në shitoren e dytë bleu një palë këpucë për 25 €. Sa euro i mbetën Blendit?

Llogaria mund të bëhet në dy mënyra:

Mënyra e parë: Nëse Blendi ka bërë llogarinë pas çdo blerjeje, atëherë:

100 – 44 = ☐ dhe 56 – 25 = ☐

Pra, Blendit i kanë mbetur edhe ____ €.

Mënyra e dytë: Nëse Blendi llogarinë e ka bërë në fund (pas dy blerjeve), atëherë:

100 – (44 + 25) = 100 – ☐ = ☐

Pra, Blendit i kanë mbetur edhe ____ €.

2 Duke shoqëruar numrat (në mënyrën më të përshtatshme), njehsojmë:

83 – 26 + 43 = _____
78 – 23 + 38 = _____
98 – 46 – 24 = _____

3 Të njehsojmë:

83 – (37 + 16) = _____
67 – (35 + 18) = _____
100 – (36 + 17) = _____

4 Joni kishte 52 €. Nëna ia dha edhe 12 €, kurse babai edhe 36 € të tjera. Sa euro ka tash Joni?

Njehsojmë: ____ + ____ + 36 = ____ + ____ = ____.

Përgjigjja: _____

5 Në arkën e kursimeve Arta kishte 27 €. Nga kursimet e këtij muaji, ajo në arkë futi edhe 56 €. Sa euro i nevojiten asaj që në arkë të ketë 100 €?

Njehsojmë: _____

_____

Përgjigjja: _____.

MËSOJMË

118

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve situata problemore.
Në një autobus ishin 46 udhëtarë. Në stacionin e parë zbritën 18 udhëtarë, kurse në stacionin e dytë zbritën edhe 11 udhëtarë. Sa udhëtarë mbetën në autobus?
Kërkohet nga nxënësit të mendojnë zgjidhjen për situatën e paraqitur. Mënyrat e zgjidhjes paraqiten në tabelë. Në rast se nxënësit kanë vështirësi të gjejnë zgjidhjen, parashtrohen pyetje për nxënës për të kuptuarit e situatës së paraqitur apo orientimin drejt zgjidhjes.

Hapi 2: Lexohet problemi në detyrën 1 në libër dhe parashtrohen pyetje për nxënësit për dy mënyrat e njehsuara.
Mënyra e parë: Sa para kishte Blendi? (100 €.) Sa para pagoi për pallto? (44 €.) Sa para i mbetën? (56 €.) Sa para pagoi ai për këpucë? (25 €.) Sa para i mbetën? (31 €.)
Mënyra e dytë: Sa para kishte Blendi? (100 €.) Sa para pagoi për këpucë dhe pallto? (44 € +25 €=69 €.) Sa para i mbetën? (31€.) Si e gjetëm? (100 € - 69 €=31 €.)



ZBRITJA E SHUMËS NGA NUMRI

1 Blendi kishte 100 €. Në shitoren e parë ai bleu një pallto për 44 €, kurse në shitoren e dytë bleu një palë këpucë për 25 €. Sa euro i mbetën Blendit?

Llogaria mund të bëhet në dy mënyra:

Mënyra e parë: Nëse Blendi ka bërë llogarinë pas çdo blerjeje, atëherë:

100 – 44 = ☐ dhe 56 – 25 = ☐

Pra, Blendit i kanë mbetur edhe ____ €.

Mënyra e dytë: Nëse Blendi llogarinë e ka bërë në fund (pas dy blerjeve), atëherë:

100 – (44 + 25) = 100 – ☐ = ☐

Pra, Blendit i kanë mbetur edhe ____ €.

2 Duke shoqëruar numrat (në mënyrën më të përshtatshme), njehsojmë:

83 – 26 + 43 = _____

78 – 23 + 38 = _____

98 – 46 – 24 = _____

3 Të njehsojmë:

83 – (37 + 16) = _____

67 – (35 + 18) = _____

100 – (36 + 17) = _____

4 Joni kishte 52 €. Nëna ia dha edhe 12 €, kurse babai edhe 36 € të tjera. Sa euro ka tash Joni?

Njehsojmë: ___ + ___ + 36 = ___ + ___ = ___.

Përgjigjja: _____

5 Në arkën e kursimeve Arta kishte 27 €. Nga kursimet e këtij muaji, ajo në arkë futi edhe 56 €. Sa euro i nevojiten asaj që në arkë të ketë 100 €?

Njehsojmë: _____

_____

Përgjigjja: _____.

MËSOJMË

118

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat 2 dhe 3 në libër. Bisedohet: Cilin veprim e përfunduat në fillim? (Mbledhjen.) Përse? (Sepse së pari kryhet veprimi në kllapa.) Cila është shuma e numrave 26+43? (69.)

Sa është rezultati? 83-(26+43) = 83-69 = 14

Hapi 3: Lexohet problema në detyrën 4 dhe parashtrohen pyetjet për mënyrën e njehsimit dhe gjetjen e rezultatit.
Sa para kishte Joni? (52 €)
Sa para i dha nëna? (12 €)
Sa para ka tani Joni? (52 € + 12 € = 64 €)
Sa para i dha babai? (36 €)
Sa para ka Joni tani? (64 € + 36 € = 100 €)
(52 € + 12 € + 36 € = 64 € + 36 € = 100 €).

Hapi 4: Nxënësve u përcaktohen nga tre numra dyshifrorë dhe u kërkohet që të formojnë një barazim të njehsimit të zbritjes së shumës nga numri dhe të njehsojnë.

Numra të mundshëm për nxënësit mund të jenë:

31, 19, 89	22, 29, 78
85, 32,14	99, 23, 38

P.sh.: 31, 19, 89
89 – (31+19)= 89- 50=39

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zbritjen e shumës nga numri.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 118).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 88

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3;II.2,8; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,4; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan probleme të thjeshta;
- Plotëson barazimet me zbritje të shumës nga numri;
- Krijon barazime në tri mënyra.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.


1 Ta njehsojmë vlerën e shprehjes (47 + 18) - 26:
Mënyra e parë: Në fillim njehsojmë shumën e pastaj nga ajo zbresim zbritësin:
(47 + 18) – 26 = ___ – ___ = ___.
Mënyra e dytë: Zbritësi zbritet nga mbledhori i parë i shumës:
(47 + 18) – 26 = (47 – 26) + ___ = ___ + ___ = ___.
Mënyra e tretë: Zbritësi zbritet nga mbledhori i dytë i shumës:
47 + (18 - 26) = e pamundshme
Mënyra e tretë është e pamundshme, sepse te ndryshimi 18 - 26, i zbritshmi është më i vogël se zbritësi.
2 Njehsoni vlerën e shprehjes 84 – (26 + 44).
Mënyra e parë: Në fillim njehsojmë shumën e pastaj atë e zbresim nga i zbritshmi:
84 – (26 + 44) = _____
Mënyra e dytë: Mbledhorin e parë të shumës e zbresim nga i zbritshmi:
(84 – 26) – 44 = _____
Mënyra e tretë: Mbledhorin e dytë të shumës e zbresim nga i zbritshmi:
(84 – 44) – 26 = _____
3 Për sa është shuma e numrave 45 dhe 52 më e madhe se numri 37?
Njehsojmë: (___ + ___) – 37 = ___ – ___ = ___.
Pra, shuma e numrave 45 dhe 52 është për ____ më e madhe se numri 37.
4 Duke njehsuar, plotësojmë fushat e zbrazëta me numrat e duhur.
46 38 17
97 28 46
USHTROJMË
119

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shkruhen në tabelë disa fjalë. Kërkohet nga nxënësit që me këto fjalë dhe me fjalë të tjera që do të shtohen të shkruajnë dhe të zgjidhin një problem. Pasi t'i përfundojnë, i lexojnë disa problema. Puna është individuale.

Ana ka 95€	një pallto	35€	dhe	12€

Të gjitha mënyrat e problemeve shënohen në tabelë. 95-35=60 dhe 60-12=48

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë dhe ta punojnë detyrën 1. Parashtrohen këto pyetje: Mënyra e parë: Cilët numra janë të shënuar në kllapa? (47+18.) Cili numër është jashtë kllapave? (26.)
Nëse i mbledhim numrat (47+18), çka fitojmë? (Shumën.) Cilën shenjë e kemi pas kllapave? (Zbritjen.)



1 Duke i grumbulluar mbledhorët, njehsojmë shumën.

53 + 6 + 7 + 2 → 53 + 7 + 6 + 2 =
72 + 4 + 8 + 2 → =
87 + 3 + 8 + 2 → =
67 + 2 + 3 + 7 → =

2 Njehsojmë:

25 − 15 + 43 = 10 + □ = □
64 + 10 − 34 = □ − □ = □
28 − 14 − 14 = □ − □ = □
52 − 10 − 18 = □ − □ = □

38 − (85 − 82) = 38 − □ = □
(67 + 12) − 40 = □ − □ = □
(39 − 15) + 23 = □ + □ = □
27 + (82 − 10) = □ + □ = □

3 Njehsojmë dhe plotësojmë:

10 +27 □ +15 □ −13 □ −9 □ +39 □ −11 □ +22 □ +20 100

4 Njehsojmë:

PËRSËRISIM

120

Atëherë, shuma me cilin numër zbritet? (26.)
Mënyra e dytë: Sa është mbledhori i parë? (47.) Sa është zbritësi?(26.) Po mbledhori i dytë sa është? (18.) Zbriteni zbritësin nga mbledhori i parë i shumës (47-26)+18=
Mënyra e tretë: A mund ta zbresim zbritësin me mbledhorin e dytë? (Jo, sepse numri 18 është më i vogël se numri 26.)

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 3. Pyeten: Si duhet shënuar shuma e numrave 47 dhe 52? (47+52.) Më e madhe se numri 37? (- 37). (47+52)-37=99-37=62.

Hapi 4: Kërkohet nga nxënësit të punojnë detyrën 4. Diskutohen këto pyetje:

- Cilët numra na janë dhënë? (46,38,17.)
- Çfarë duhet të bëjmë për ta gjetur katrorin me ngjyrë rozë? (Zbritet 38-17=21.)
- Drejtkëndëshi me ngjyrë të gjelbër dhe drejtkëndëshi me ngjyrë rozë, a e kanë madhësinë e njëjtë? (Po.)
- Atëherë, cili numër duhet shënuar poshtë drejtëkëndëshit me ngjyrë të gjelbër? (46.)
- Te drejtkëndëshi i fundit, cilët numra duhet të mblidhen që ta gjejmë rezultatin e saktë? (46+21=67.)

Hapi 5: Nxënësve u kërkohet të punojnë të pavarur detyrën 1, faqe 121. (Jepni disa sqarime, duhet t'i gruponi mbledhorët që na japin dhjetëshen e plotë, p.sh.: 53+6+7+2= 53+7+6+2=68.)

Hapi 6: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 2. Diskutohen rreth këtyre pyetjeve: Cilët numra janë shënuar? (25,15,43.) Çfarë duhet të bëjmë (25-15+43)? (Së pari zbresim numrin 25-15=10 dhe më pas numri 10 mblidhet me numrin 43=53.)

Hapi 7: Kërkohet nga nxënësit që me numrat 67, 24, 14 të krijojnë barazime në tri mënyrat e grupimit me veprimin e zbritjes.
(67+24)-14=91-14=77 (67-14)+24=53+24=77 67+(24-14)=67+10=77

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në saktësinë në plotësimin e detyrave me dy veprime duke zbritur shumën nga numri.

Detyrë:
Detyrat 3 dhe 4 (faqe 120).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 89

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes;
- Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
- Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1, II. 2, 8; III. 2, 3, 4, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 3, 5; 3. 1,3, 4, 6.


MBLEDHJA DHE ZBRITJA E NUMRAVE DERI NË 100

LIDHJA E MBLEDHJES ME ZBRITJEN

1 Analizojmë figurën dhe njehsojmë.

70
40 30

40 + 30 = ☐
30 + 40 = ☐

70 – 30 = ☐
70 – 40 = ☐

2 Me numrat 46, 7 dhe 53, shkruajmë:

dy barazi me mbledhje: 46 + 7 = 53; ☐ + ☐ = ☐

dy barazi me zbritje: 53 – 46 = 7; ☐ – ☐ = ☐

3 Nga barazia me mbledhje, shkruajmë dy barazi me zbritje.

78 + 15 = ☐; ☐ – ☐ = ☐; ☐ – ☐ = ☐

65 + 9 = 74
74 – 65 = 9
74 – 9 = 65

45 + 28 = ☐; ☐ – ☐ = ☐; ☐ – ☐ = ☐

4 Nga barazia me zbritje, shkruajmë dy barazi me mbledhje.

93 – 9 = ☐; ☐ + ☐ = ☐; ☐ + ☐ = ☐

72 – 13 = 59
59 + 13 = 72
13 + 59 = 72

84 – 16 = ☐; ☐ + ☐ = ☐; ☐ + ☐ = ☐

5 Numërojmë dhe plotësojmë:

39 € 78 c		1	1	1	2		1	1		1	1	1
47 € 86 c												
24 € 41 c												
72 € 57 c												
65 € 94 c												

MËSOJMË

5

Njësia mësimore: Lidhja e mbledhjes me zbritjen

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Formon barazime që shprehin shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Plotëson detyrat duke u bazuar në modelet në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me barazime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen nga tri etiketa me numra dhe kërkohet nga ata të formojnë barazime të shprehura si shumë ose ndryshim i numrave duke përdorur vetëm numrat e dhënë në etiketë. (Numrat në etiketat e shpërndara duhet të jenë në lidhje me njëri-tjetrin në mënyrë që nxënësit ta kenë më të lehtë punën dhe të mund të formojnë barazime, p.sh.: 12, 24, 36; 12+24=36; 36- 12=24.)

12 24 36

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë dhe t'i analizojnë numrat në detyrën 1.



Nxënësit pyeten:

70	
40	30

- Çfarë vëreni në figurë?
- Cilët numra janë paraqitur?
- Çfarë paraqesin këta numra?

Udhëzohen t'i plotësojnë barazimet në detyrën 1 dhe të njehsojnë shumën.

- Sa barazime u formuan me numrat: 70, 30, 40?

Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet që detyrat 2, 3 dhe 4 t'i plotësojnë të pavarur.

Detyra 2: Të formojnë dy barazime me mbledhje dhe dy barazime me zbritje me numrat: 46, 7 dhe 53.	Detyra 3: Nga barazia me mbledhje të shkruajnë dy barazi me zbritje.	Detyra 4: Të njehsojnë ndryshimin dhe më pas të formojnë nga dy barazime me mbledhje.

Hapi 4: Nxënësit numërojnë dhe plotësojnë tabelën duke e krijuar me të holla shumën që duhet.

Hapi 5: Në detyrën 6 u kërkohet që për një barazi me mbledhje të shkruajnë dy barazi me zbritje. Shembulli i parë plotësohet bashkë me nxënësit, kurse detyrat e tjera i plotësojnë të pavarur.

Hapi 6: Nxënësit udhëzohen që mbledhorin në detyrën 7 ta paraqesin si ndryshim të shumës dhe të mbledhorit, duke u bazuar në modelin në libër.
Gjithashtu, nxënësve u jepen sqarime që nëse nga shuma zbritet njëri mbledhor, fitohet mbedhori tjetër.

VEPRIMTARI SHTESË:
Nxënësve u shpërndahen fletëza sipas modelit dhe u kërkohet që të plotësojnë trekëndëshin me barazime, ku fillimishit në kënde të trekëndëshit shkruajnë numra që formojnë një barazim që shpreh shumën e dy numrave. Pjesa me të verdhë janë mbledhorët, kurse në pjesën me ngjyrë të kaltër shënohet shuma.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në formimin e barazimeve.

Detyrë:
Detyra 8 (faqe 6).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 90

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Formon barazi me numrat e dhënë;
- Gjen numrin e panjohur në barazimet e dhëna.


1 Sa barazi mund t'i shkruajmë me numrat 27, 5 dhe 32?
Përgjigjja: Me numrat e dhënë mund t'i shkruajmë këto barazi:
27 + 5 = ☐ 5 + 27 = ☐ 32 – ☐ = 5 32 – ☐ = ☐
2 Me numrat e dhënë, shkruajmë 4 barazi.
30, 25, 55
30 + 25 = ☐ 55 – ☐ = ☐
☐ + ☐ = ☐ ☐ – ☐ = ☐
48, 20, 68
48 + 20 = ☐ 68 – ☐ = ☐
☐ + ☐ = ☐ ☐ – ☐ = ☐
3 Për çdo barazi me mbledhje, formojmë dy barazi me zbritje.
9 + 16 = 25
25 – ☐ = ☐
25 – ☐ = ☐
20 + X = 48
48 – ☐ = ☐
48 – ☐ = ☐
4 Ta gjejmë mbledhorin e panjohur.
a + 33 = 51
a = 51 – 33
a = ☐
18 + a = 70
a = ☐ – ☐
a = ☐
5 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelat.

x	8		20	73
y		12		
x + y	40	72	60	73

x	18	76		
y			37	17
x – y	0	28	35	26

USHTROJMË
7

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Formon barazi me numrat e dhënë;
- Gjen numrin e panjohur në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në projektor paraqitet problema: Era dhe Mali po luanin pikado. Era grumbulloi 56 pikë dhe Mali grumbulloi 23 pikë. Sa pikë grumbulluan së bashku?
Nxënësit shprehin mendimet e tyre dhe më pas zgjidhja e saktë shkruhet në tabelë:
56 + 23 = 79. Pra, Era dhe Mali së bashku grumbulluan 79 pikë.

Më pas, mbledhorëve u ndërrohen vendet. Gjithashtu, ndërrohen edhe anët e barazimeve.

23 + 59 = 79, 79 = 23 +59, 79 = 59 + 23.

U sqarohet nxënësve se nëse mbledhorëve u ndërrohen vendet, shuma nuk ndryshon. Me numrat e lartshënuar mund të formohen katër barazime.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen të formojnë barazitë e mundshme me numrat 27, 5 dhe 32.



1 Sa barazi mund t'i shkruajmë me numrat 27, 5 dhe 32?
Përgjigjja: Me numrat e dhënë mund t'i shkruajmë këto barazi:

27 + 5 = ☐ 5 + 27 = ☐ 32 – ☐ = 5 32 – ☐ = ☐

2 Me numrat e dhënë, shkruajmë 4 barazi.

30, 25, 55

30 + 25 = ☐ 55 – ☐ = ☐

☐ + ☐ = ☐ ☐ – ☐ = ☐

48, 20, 68

48 + 20 = ☐ 68 – ☐ = ☐

☐ + ☐ = ☐ ☐ – ☐ = ☐

3 Për çdo barazi me mbledhje, formojmë dy barazi me zbritje.

9 + 16 = 25

25 – ☐ = ☐

25 – ☐ = ☐

20 + X = 48

48 – ☐ = ☐

48 – ☐ = ☐

4 Ta gjejmë mbledhorin e panjohur.

a + 33 = 51
a = 51 – 33
a = ☐

18 + a = 70
a = ☐ – ☐
a = ☐

5 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelat.

x	8		20	73
y		12		
x + y	40	72	60	73

x	18	76		
y			37	17
x – y	0	28	35	26

USHTROJMË

7

Njëjtë veprohet edhe me detyrën 2.

Hapi 3: U sqarohet nxënësve lidhshmëria mes shumës dhe ndryshimit, duke analizuar dhe plotësuar tabelën e mëposhtme. Numri 70 është ndarë në dy mbledhorë.

70	
40	30

- Çfarë ndodh nëse mbledhorëve ua ndërrojmë vendet?
  30 + 40 = 70, 40 + 30 = 70, shuma nuk ndryshon.
- Çfarë ndodh nëse nga shuma zbresim njërin nga mbledhorët?
  70 – 30 = 40, 70 – 40 = 30, fitohet mbledhori tjetër.

Detyra 5: Pas sqarimeve/shpjegimeve të dhëna në detyrat paraprake, nxënësit plotësojnë në mënyrë të pavarur detyrën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në formimin e barazimeve dhe gjetjen e numrave të panjohur.

Detyrë:
Detyrat 3 dhe 4 (faqe 7).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 91

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes;
Gjen vlerën e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.7, III.2, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Detyra me dy veprime (+ dhe -)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson rezultatin e shprehjeve me dy veprime;
- Formulon barazime me dy veprime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


DETYRA ME DY VEPRIME (+ DHE -)

1 Ta njehsojmë vlerën e shprehjes.

60 – 35 + 24 –18.

Për ta lehtësuar njehsimin, bëjmë shoqërimin:

1. (60 – 35) + (24 – 18) = _____
2. (60 + 24) – 35 – 18 = _____
3. (60 – 18) – 35 + 24 = _____
4. (60 + 24) – (35 +18) = _____
5. (60 + 24) – 18 – 35 = _____

2 Njehsojmë shumën e numrave të dhënë, sipas shigjetave në figurë.

18 16 28 5 38
14 2 34 22 35

18 + 16 + 2 + 14 = _____
16 + 28 + 34 + 2 = _____
28 + 5 + ___ + ___ = _____
5 + ___ + ___ + ___ = _____

3 Shtëpitë e një fshati janë shënuar me numrat nga 1 deri në 100. Sa herë gjatë shënimit është shkruar shifra 7?

7 87

Shifra 7 është shkruar gjithsej ___ herë.

4 Për të fituar barazi të sakta, në rrathët e zbrazët shkruajmë njërën nga shenjat + ose -, kurse në drejtkëndëshat e zbrazët shkruajmë numrat e duhur.

27 ○ □ = 62 60 ○ □ = 32 70 ○ □ = 95
39 ○ □ = 21 100 ○ □ = 55 □ ○ 20 = 60
43 ○ □ = 20 12 ○ □ = 48 □ ○ 32 = 47

MËSOJMË

8

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten në tabelë numrat: 60 – 35 + 24 – 18. Nxënësit pyeten:
- Cilët numra janë në shprehjen numerike?
- Cilat veprime ndodhin në shprehjen numerike?
- Si mund ta lehtësojmë të njehsuarit? (I përdorim kllapat.)
  (60 – 35) + (24 – 18) = 25 + 6 = 31

Njehsohen rezultatet e shprehjeve numerike të dhëna në detyrën 1.

Hapi 2: Detyra 2 – Sipas shigjetave të dhëna, njehsohet shuma e katër mbledhorëve, duke i përdorur kllapat.
18 + 16 + 2 + 14 = (18 + 2) + (16 + 14) = 20 + 30 = 50



DETYRA ME DY VEPRIME (+ DHE -)

1 Ta njehsojmë vlerën e shprehjes.

60 − 35 + 24 −18.

Për ta lehtësuar njehsimin, bëjmë shoqërimin:

1. (60 − 35) + (24 − 18) = _____
2. (60 + 24) − 35 − 18 = _____
3. (60 − 18) − 35 + 24 = _____
4. (60 + 24) − (35 +18) = _____
5. (60 + 24) − 18 − 35 = _____

2 Njehsojmë shumën e numrave të dhënë, sipas shigjetave në figurë.

18 →	16 →	28 →	5 →	38
14 ←	2 ←	34 ←	22 ←	35

18 + 16 + 2 + 14 = _____

16 + 28 + 34 + 2 = _____

28 + 5 + ___ + ___ = _____

5 + ___ + ___ + ___ = _____

3 Shtëpitë e një fshati janë shënuar me numrat nga 1 deri në 100. Sa herë gjatë shënimit është shkruar shifra 7?

7 ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ 87 ☐

Shifra 7 është shkruar gjithsej ___ herë.

4 Për të fituar barazi të sakta, në rrathët e zbrazët shkruajmë njërën nga shenjat + ose -, kurse në drejtkëndëshat e zbrazët shkruajmë numrat e duhur.

27 ○ ☐ = 62	60 ○ ☐ = 32	70 ○ ☐ = 95
39 ○ ☐ = 21	100 ○ ☐ = 55	☐ ○ 20 = 60
43 ○ ☐ = 20	12 ○ ☐ = 48	☐ ○ 32 = 47

MËSOJMË

8

16 + 28 + 34 + 2 = (16 + 34) + (28 + 2) = 50 + 30 = 80
28 + 5 + 22 + 34 = (28 + 22) + (5 + 34) = 50 + 39 = 89
5 + 38 + 35 + 22 = (5 + 35) + (38 + 22) = 40 + 60 = 100

Hapi 3: Detyra 3 – Lexohet detyra nga nxënësit dhe gjejnë se sa herë është shënuar shifra 7.
7, 17, 27, 37, 47, 57, 67, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 87, 97.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të formulojnë dy barazime me dy veprime.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e shprehjeve numerike me dy veprime dhe formulimin e tyre.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 8).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 92

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III. 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën dhe ndryshimin me numra dyshifrorë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me nga tre numra dhe u kërkohet të formojnë barazime të mbledhjes dhe të zbritjes me numrat e dhënë (sipas shembullit në vijim):

78, 35, 43

35+43=78
78- 43=35
78- 35=43

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë shumën dhe ndryshimin në detyrën 1 duke njehsuar fillimisht me dhjetëshe, pastaj me njëshe. P.sh.:

34+17 → 34+10 → 44+7 51

83-26 → 83-20 → 63-6 → 57



Detyra 2. Nxënësit udhëzohen të njehsojnë shumën dhe ndryshimin e numrave dyshifrorë.
Detyra 3. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë shumën dhe ndryshimin dhe t'i krahasojnë ato.
Detyra 4. Nxënësit udhëzohen të gjejnë vlerën e ndryshores x.
Detyra 5. Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë modelin e dhënë, të formojnë shprehje numerike dhe të njehsojnë vlerën e tyre.
Detyra 6. Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë skemat e dhëna duke njehsuar. Njehsimi kryhet me veprimin e mbledhjes, duke filluar prej bazës nga kulmi, ose me veprimin e zbritjes nëse fillohet prej kulmit nga baza.
Në detyrën 7, nxënësit udhëzohen të njehsojnë me njësitë matëse të gjatësisë (cm) duke formuar barazime të shumës që japin rezultatin 1 m p.sh.: 50 cm+50 cm=1 m, si dhe duke ndarë njësitë matëse në cm në dhjetëshe dhe njëshe, p.sh.: 13 cm=10 cm +3 cm.

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të njehsojnë të pavarur detyrën 8 në libër, ku duhet të gjejnë shumën dhe ndryshimin dhe të plotësojnë tabelat e paraqitura në detyrë.

Tabelat e plotësuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e shumës dhe të ndryshimit të numrave dyshifrorë.

Detyrë:
Detyra 9 (faqe 10).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 93

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zgjidh probleme me fjalë nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1.3, II.2,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2 ; 2.1,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbatojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen barazi me mbledhje dhe zbritje;
- Lidh me shigjetë barazitë me rezultatet e sakta.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në një shportë vendosen etiketa me ngjyrë të kaltër ku janë të shënuara barazime të ndryshe. (54 + 12; 41 + 22; 29 - 25; 66 - 13). Udhëzohen nxënësit të marrin nga një etiketë, ta shënojnë në fletore dhe ta gjejnë rezultatin.

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 1, në libër. Diskutohen këto pyetje: Çfarë po shohim në figurë? (Ngjyra, gërshërë, libër, laps, kalkulator, ëmbëlsirë). Sa e ka çmimin ngjyra? (19€.) Po gërshërët? (11€.) Po ëmbëlsira sa e ka çmimin?(17€.) Çfarë duhet të bëjmë? (Duhet mbledhur.)

Hapi 3: Nxënësit punojnë të pavarur detyrat 2 dhe 3, në libër. (Jepen disa udhëzime, së pari mblidhen numrat dhe pastaj lidhen me anë të shigjetave).



Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë detyrën 4. Në rrathët ku janë të vendosura figurat gjeometrike duhet të vendosen numrat që shuma e tre numrave të jetë 26. Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë detyrën. Diskutohet rreth këtyre pyetjeve: Cilët numra duhet të mblidhen së pari? (8+6=14) Edhe sa duhet t'i shtojmë numrit 14, që të fitohet shuma 26?(12).
(→ 12, → 15, → 1,
→ 10, → 16).

Hapi 5: Nxënësve në grupe u shpërndahen fletë A4 dhe u kërkohet që t'i lidhin me shigjetë barazimet me rezultatet. Ata e tregojnë punën e bërë para grupeve të tjera.
1+2+3+4+5+6+7+8+9+10+9+8+7+6+5+4+3+2+1=
*82
3 + 5 + 7 + 9 + 10 + 1 + 12 + 15 + 20 =
*100
10+20+1+5+30+4+6=
*76

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen duke bërë zgjidhjen e saktë të barazimeve me mbledhje dhe zbritje.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 12).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 94

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes deri në 100;
- Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III. 2, 3, 4, 7;

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 3; 3. 3, 6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson numrat deri në 100;
- Gjen dhe rrethon përgjigjen e saktë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që detyrat e dhëna në libër t'i plotësojnë në mënyrë të pavarur, meqënëse planifikohet vlerësimi i të kuptuarit të detyrave të mësuara.
Nga nxënësit kërkohet që në detyrat 1 dhe 2 të rrethojnë njërën nga përgjigjet.

Detyra 1: Numrin 75 paraqiteni si shumë të dy numrave.

Detyra 2: Numrin 7 paraqiteni si ndryshim të dy numrave.



Hapi 2:

- Detyra 3: Nxënësit udhëzohen që fillimisht të lexojnë kërkesën e detyrës dhe të gjejnë shumën e gjatësive të segmenteve e më pas të rrethojnë njërën nga përgjigjet.
- Detyra 4: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë numrat dhe të gjejnë numrin që duhet të shkruhet në drejtkëndëshin e fundit, ndërsa në detyrën 5 duhet të vendosin njërën nga shenjat: <, =, >.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen që t'i lexojnë me vëmendje kërkesat e detyrave dhe t'i plotësojnë ato.

- Detyra 6: Të vendosin njërin nga numrat: 75, 30, 65 në fushën e zbrazët.
- Detyra 7: Njërin nga numrat duhet ta shkruajnë në drejtkëndëshin e zbrazët.
- Detyra 8: Të njehsojnë, dhe njërin nga numrat e dhënë ta shkruajnë në rreth.
- Deryra 9: T'i mbledhin numrat e njëpas-njëshëm dhe të rrethojnë njërën nga përgjigjet.

Hapi 4: Detyrat e përfunduara nga nxënësit vlerësohen në mënyrë individuale dhe diskutohet zgjidhja e tyre në nivel klase.

Hapi 5: Pas vlerësimit, për t'u zbavitur, bashkë me nxënësit mund të punohet detyra 2 në faqen 14. Udhëzohen ata t'i shikojnë katrorët magjikë dhe të përpiqen të zbulojnë rregullën.

Në katrorin magjik, shuma e numrave në çdo rresht, shtyllë dhe diagonal është e barabartë.

24	3	18
9	15	21
12	27	6

Ky katror e jep numrin magjik 45.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e numrave dhe rrethimin e përgjigjeve të sakta.

Detyrë:
Detyra 1 (faqe 14).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 95

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përcakton peshën e objekteve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 1.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kilogrami

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Llogarit masën e përbashkët të trupave të dhënë në libër;
- Krahason masën e trupave të dhënë;
- Gjen masën e panjohur në shprehjet e dhëna që të fitohet baraspeshë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në projektor, përmes fotove paraqiten mjete matëse të masës, pra disa lloje të peshoreve (peshorja me sustë, me shigjetë, peshorja elektronike). Pastaj pyeten nxënësit:
- Çfarë do të thotë të matësh masën e një objekti?
- Cilat njësi për matjen e masës i dini?

Pastaj nxënësve u sqarohet se njësitë bazë për matjen e masës janë grami dhe kilogrami dhe simbolikisht shënohen me g, përkatësisht kg.

Hapi 2: Detyra 2: Nxënësve u sqarohet se të tria peshoret e dhëna në detyrë janë në balancë, meqë krahët e peshores janë në të njëjtin drejtim, pra janë në vijë horizontale.
Detyra 3. Nxënësit udhëzohen të krahasojnë peshat e dhëna dhe të argumentojnë përgjigjen e dhënë.

Hapi 3: Detyra 1: Nxënësit plotësojnë fushat e zbrazëta me numra në mënyrë që të fitohet baraspeshë. Pyeten nxënësit:

- A është në baraspeshë peshorja e parë? Pse? (Sigurisht që jo, krahu i djathtë i peshores qëndron lart, ndërsa krahu i majtë i peshores ka rënë poshtë.)
- Po peshorja e dytë? (Jo, pesha më e rëndë ka rënë poshtë.)

Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që të gjejnë masën e panjohur në mënyrë që të fitojnë barazi të saktë.

Shembull: 16kg = 7kg + 9kg, 9kg meqë ana e majtë duhet të jetë e barabartë me anën e djathtë

18kg = 10kg + 8kg...

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e masës së përbashkët të trupave, krahasimin e tyre dhe gjetjen e masës që mungon në barazitë e dhëna.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 16).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 96

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Bën lidhje ndërmjet numrave dhe matjeve;
- Përcakton peshën e objekteve (kg).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, 4, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3.1, 4.1.



4 Analizojmë figurat dhe plotësojmë barazitë:

1kg — ☐ kg

5kg 2kg 1kg — ☐ kg + ☐ kg + ☐ kg = ☐ kg

5kg 1kg — ☐ kg + ☐ kg = ☐ kg

5 Të njehsojmë:

5kg 3kg 1kg — ☐ kg + ☐ kg + ☐ kg = ☐ kg

22 kg + 6 kg = ☐ kg
35 kg + 7 kg = ☐ kg
47 kg + 5 kg = ☐ kg

6 kg + 5 kg + 7 kg + 4 kg = ☐ kg
7 kg + 4 kg + 6 kg + 5 kg = ☐ kg
4 kg + 5 kg + 8 kg + 3 kg = ☐ kg

6 kg + 8 kg + 3 kg + 1kg = ☐ kg
9 kg + 5 kg + 1 kg + 3 kg = ☐ kg
4 kg + 7 kg + 8 kg + 7 kg = ☐ kg

6 Plotësojmë tabelat.

	2 kg	1 kg	3 kg
10 kg	II	X	II
15 kg			
20 kg			

	5 kg	3 kg	2 kg
20 kg			
25 kg			
30 kg			

7 Të njehsojmë:

12 kg + 8 kg = ☐ kg
14 kg + 7 kg = ☐ kg
11 kg + 6 kg = ☐ kg

19 kg – 8 kg = ☐ kg
39 kg – 7 kg = ☐ kg
77 kg – 17 kg = ☐ kg

USHTROJMË

17

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përcakton peshën e objekteve të dhëna;
- Njehson peshën e objekteve të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të vështrojnë figurat e dhëna në detyrën 1 dhe të gjejnë peshën e dhuratave.

1 kg	5kg + 2kg + 1kg = 8kg	5kg + 1kg = 6kg

- Cila dhuratë është më e rënda?
- Cila dhuratë është më e lehta?

Hapi 2: Detyra 2 – Njehsohet shuma e kg të dhënë.
(5kg + 3kg + 1kg = 9kg).
Detyra 3 – Njehsohet shuma dhe ndryshimi i kg të dhënë.
(12kg + 8kg = 20kg; 19kg – 8kg = 11kg)

USHTROJMË

8 Njehsojmë dhe plotësojmë:



___ kg + ___ kg = 70 kg



___ kg + ___ kg + ___ kg = 90 kg

9 Njehsojmë dhe plotësojmë:

11 kg + 3 kg + 6 kg = ☐ kg
9 kg + 1 kg + 6 kg = ☐ kg
16 kg + ☐ kg + 2 kg = 20 kg
20 kg − 7 kg − 3 kg = ☐ kg
15 kg − 5 kg − 6 kg = ☐ kg
20 kg − ☐ kg − 2 kg = 12 kg

10 Ta gjejmë masën e përbashkët të bostanit, të domateve dhe të bananeve.

5 kg

2 kg

1 kg

Njehsojmë: ___ kg + ___ kg + ___ kg = ___ kg.

Pra, masa e përbashkët e bostanit, e domateve dhe e bananeve është ___ kg.

11 Bora peshon 29 kg. Babai i saj peshon 38 kg më shumë se ajo. Gjejmë masën e babait të Borës. Sa është masa e përbashkët e Borës dhe e babait të saj?

Masa e babait të Borës është:

29 kg + ___ kg = ___ kg.

Masa e përbashkët e Borës dhe e babait të saj është:

___ kg + 67 kg = ___ kg.

18

Hapi 3: Detyra 1 (faqe18) – Nxënësit në dyshe udhëzohen të gjejnë peshën e kuboideve të dhëna.

Kuboidi portokalli = 35kg 35kg + 35kg = 70 kg
Kuboidi kaltër = 24 kg; Kuboidi portokalli = 42kg 24kg + 24kg + 42kg = 90kg

Detyra 3 (faqe 18)
Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën e dhënë dhe të gjejnë masën e pemëve dhe perimeve së bashku.
5 kg + 2 kg + 1 kg = 8 kg

Detyra 4 (faqe 18)
Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën e dhënë me fjalë dhe t'iu përgjigjen pyetjeve.
Babai i Borës peshon 29 kg + 38 kg = 67 kg
Masa e përbashkët e Borës dhe babait të saj është: 29 kg + 67 kg = 96 kg.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 3 (faqe 17) në mënyrë individuale.

	2 kg (mjaltë)	*1 kg (bukë)*	*3 kg (kanaçe)*
10 kg	II	X	II
15 kg	III	X	III
20 kg	II	I	IIIII

	5 kg (thesi)	*3 kg (kanaçe)*	*2 kg (mjaltë)*
20 kg	III	I	II
25 kg	II	III	III
30 kg	III	X	IIIII

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin dhe njehsimin e peshave.

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 18).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 97

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.1.3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjejmë mbledhorin e panjohur

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen mbledhorin e panjohur.


BARAZIMET DHE JOBARAZIMET

GJEJMË MBLEDHORIN E PANJOHUR

1 Rikujtojmë se shprehjet shkronjore janë shprehje që përbëhen nga shkronjat dhe numrat.
Për shembull,
$x + 2$, $x - 4$, $x + y - 2$
janë shprehje shkronjore.

2 Plotësojmë tabelën.

X	7	11	18	22	35	64	78	87
X + 6	13						84	

3 Për zgjidhjen e problemave matematikore, përveç numrave përdoren edhe shkronjat. Shkronjat përdoren si vendndodhje e numrave. Pra, kur në një problemë përdorim një shkronjë, e mendojmë se në vend të saj duhet të vendoset një numër.

X	31	33	35	37	39

Shkronja X paraqet njërin nga numrat tek të dhjetëshes së _____.

Y	12	14	16	18	20

Shkronja Y paraqet njërin nga numrat çift të dhjetëshes së _____.

4 Cilin numër duhet mbledhur me numrin 39, që të fitohet numri 46?
Zgjidhim detyrën:
Numrin e panjohur e shënojmë me shkronjën X.

Shkruajmë barazimin: 39 + X = 46 (mbledhori i panjohur)
Njehsojmë: X = 46 – 39
Zgjidhja: X = 7
Prova: 39 + ☐ = 46
Shkruajmë përgjigjen: _____

MËSOJMË

19

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet lojë matematikore me nxënësit (Gjej numrin.) U kërkohet atyre të gjejnë numrin e menduar duke u dhënë kriterin: Nëse numrit të menduar i shtohet 10, fitoj numrj 35. Cili është numri i menduar? (25.)

Përsëritet loja edhe për disa numra të tjerë.

Hapi 2: Nxënësve u tregohet që për zgjidhjen e problemeve matematikore, përveç numrave, përdoren edhe shkronjat. Udhëzohen të vëzhgojnë shprehjet me shkronja të dhëna në detyrën 1 në libër.
Nxënësit e plotësojnë tabelën në detyrën 2, duke zëvendësuar mbledhorin e panjohur për të gjetur shumën.
Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë tabelat me shkronja që zëvendësojnë numrat në detyrën 3. Parashtrohen pyetjet: Cilët numra paraqet shkronja X? Cilët numra paraqet shkronja Y?
Detyra 4. Diskutohet me nxënës: Cilin numër duhet mbledhur me 39 që të fitohet numri 47?



Sqarohet veprimtaria e gjetjes së mbledhorit të panjohur X në detyrën 2 në libër. Tregohet se X është mbledhori i panjohur. Nxënësit e plotësojnë tabelën në detyrën 3, duke zëvendësuar mbledhorin e panjohur për të gjetur shumën.

Sqarohet gjetja e mbledhorit të panjohur në detyrën 4, duke u bazuar në boshtin numerik. Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 5, duke gjetur mbledhorin e panjohur duke përdorur boshtin numerik sipas modelit të sqaruar ne detyrën 4.
Sqarohet paraqitja në boshtin numerik e gjetjes së mbledhorit të panjohur në detyrën 6 në libër.

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të gjejnë mbledhorin e panjohur. Disa nga detyrat e mundshme për nxënësit mund të jenë:

32+X=69 25+X=85 13+X=66

37+X=59 11+X=54 22+X=58

15+X=77

42+X=89

Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e mbledhorit të panjohur.

Detyrë:
Detyra 7 (faqe 20).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 98

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3, II. 2,7, III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2 , 2.1,3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Tregon mbledhorin e panjohur në problemin e dhënë;
- Gjen mbledhorin e panjohur përmes zbritjes;
- Arsyeton rezultatet e fituara në detyrat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shkruhet në tabelë detyra me fjalë: Arta mendoi një numër, nëse nga numri i menduar i shtoj 15, fitohet numri 37. Barazimi shënohet në tabelë: X+15=37. Diskutohen pyetjet: Për fjalën "shtoj" ci-lin veprim duhet përdorur? (+); Si quhet numri i parë? (Mbledhori i parë - numër i panjohur); Sa është mbledhori i dytë? (15); Kur mblidhen dy numra çka fitojmë? (Shumën); Sa është shuma? (37); Si duhet të zgjidhet barazimi? (E panjohura X vendoset në një anë të barazimit, të njohurat në anën tjetër të barazimit); A ndryshon shenja, nëse numri 15 del nga ana tjetër e barazimit? (Po); Cilin numër mendoi Arta? (19). **X+18=37** **Prova: 19+18=37**
X=37-18
X=19



Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 1 në libër. Lexohet fillimisht kërkesa e detyrës, më pas diskutohen këto pyetje: Sa është mbledhori i parë? (22); Sa është mbledhori i dytë? (Numër i panjohur); Cili numër fitohet? (34); Si duhet shënuar barazimi?

22+X=34
X=34-22
X=12
Prova: 22+12=34

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të gjejnë mbledhorin e panjohur duke njehsuar sipas formës. 38+X=54. Diskutohen këto pyetje: Cila është dhjetëshja më e afërt e numrit 38? (40); Sa i duhet shtuar numrit 38, që të fitohet numri 40? (2); Si mund ta ndajmë numrin 54? (50+4); Sa hapa duhet t'i bëjmë prej numrit 40-50?(10 hapa). Fitohet numri 50. Sa i duhet shtuar numrit 50 që të fitohet numri 54? (4). X=2+10+4=16

19+X=65 49+X=98
X=1+40+5=46 X=1+40+8=49
37+X=83
X=3+40+3=46

Hapi 4: Nxënësit gjejnë mbledhorin e panjohur duke u orientuar në boshtin numerik. Diskutohen këto pyetje: Prej cilit numër fillon boshti numerik? (0); Te cili numër mbaron? (17); Shigjeta me ngjyrë të kuqe prej cilit numër fillon dhe te cili numër mbaron? (0-8); Si mund ta shënojmë barazimin? 8+X=17 9-X=17
X=17-8 X=17-9
X=9 X=8

Hapi 5: Nxënësve u shpërndahen etiketa të ndryshme me barazime dhe u kërkohet t'i plotësojnë ato. Puna është individuale.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e mbledhorit të panjohur përmes zbritjes.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 21).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 99

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Gjejmë të zbritshmin e panjohur

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen të zbritshmin e panjohur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në projektor paraqitet barazimi 84 – 12 = 72. Nxënësit pyeten:
- Si emërtohet numri 84 në barazimin e dhënë? (Numri 84, i zbritshmi);
- Si emërtohet numri 12 në barazimin e dhënë? (Numrin 12 emërtohet si zbritësi);
- Po numri 72? (Numri 72 emërtohet si ndryshim).

Hapi 2: Detyra 1: Në projektor paraqitet shprehja:





Nxënësve u sqarohet se numrin e panjohur e shënojmë me X. Zgjidhet barazimi i dhënë: X = 43 + 18, X = 61, pastaj për të vërtetuar saktësinë e zgjidhjes së barazimit duhet bërë provën. Numrin e panjohur, në këtë rast, e zëvendësojmë me numrin 61, me ç'rast fitojmë barazi të saktë.

Hapi 3: Detyra 2: Nxënësit udhëzohen të zgjidhin barazimet e dhëna duke gjetur të zbritshmin e panjohur.
Njëjtë veprohet edhe me detyrën e tretë.

Hapi 4: Problemë: Nga cili numër duhet të zbresim numrin 26, që të fitohet numri 40?
Nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavarur ta zgjidhin detyrën. Pastaj zgjidhja e detyrës paraqitet në tabelë dhe u tregohet se numri i kërkuar/i panjohur shkruhet me X, nga X zbritet numri 26.
Pra, fitohet barazimi: X − 26 = 40, nga kjo vetëm X = 40 + 26, rrjedhimisht X = 66. Pra, numri i kërkuar është numri 66.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e të zbritshmit të panjohur.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 22).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 100

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton të zbritshmin e panjohur (numra deri në 100);
Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, 8; III. 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1. 3, 4; 3. 4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen të zbritshmin e panjohur;
- Formon barazime dhe gjen zgjidhjen e tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shkruhet në tabelë detyra me fjalë.

Nëse nga një numër zbresim numrin 17, fitojmë numrin 32. Cili është ai numër?
✓ Kërkoni nga nxënësit të gjejnë zgjidhjen e detyrës dhe të shkruajnë në tabelë barazimin.



1 Me të hollat që i kishte, Vesa bleu një xhaketë për 32 euro dhe i mbetën edhe 18 euro. Sa euro kishte në fillim Vesa?

Vesa kishte X euro, shpenzoi 32 euro dhe i kanë mbetur edhe 18 euro.
Në bazë të kësaj, formojmë barazimin:

X – 32 = 18
X = □ + □
X = □

Pra, Vesa në fillim kishte ___ euro.

2 Analizojmë figurën, formojmë barazime dhe gjejmë zgjidhjen.

X	
8	32

X – 32 = □
X = □ + □
X = □

X – □ = □
X = □ + □
X = □

3 T'i zgjidhim barazimet.

X – 60 = 40
X = □ + 40
X = □
Prova: _____

X – 18 = 35
X = □ + □
X = □
Prova: _____

X – 74 = 20
X = □ + □
X = □
Prova: _____

4 Nëse nga një numër zbresim numrin 24, fitohet ndryshimi 58. Cili është ai numër?

Numrin e panjohur e shkruajmë me X.
Fitojmë barazimin:

X – 24 = 58

Nëse një numër zvogëlohet për 15, fitohet numri 78. Cili është ai numër?

Numrin e panjohur e shkruajmë me X.
Fitojmë barazimin:

X – 15 = 78

USHTROJMË

23

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të lexojnë problemin me fjalë në detyrën 1 në libër. Bisedohet me ata:

- Sa euro shpenzoi Vesa?
- Sa euro i mbetën Vesës?
- Sa euro kishte Vesa në fillim?

Nxënësit udhëzohen të plotësojnë barazimin.

X – 32 = 18
X = _____ + _____
X = _____

Hapi 3: Kërkohet të analizojnë figurën e paraqitur në detyrën 2 dhe të formojnë barazime për të gjetur zgjidhjen e barazimit.

X	
8	32

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen t'i zgjidhin barazimet dhe të gjejnë numrat e panjohur, pastaj barazimeve të zgjidhura t'u bëhet prova.

Hapi 5: Nga nxënësit kërkohet të plotësojnë të pavarur detyrën 4 dhe të gjejnë numrin e panjohur. U rikujtohet që numri i panjohur shkruhet me x dhe që numri i panjohur vendoset në fillim të detyrës.

VEPRIMTARI SHTESË
Kërkohet nga nxënësit të formojnë barazim me numrat 14, 35 dhe ndryshoren X, ku X është i zbritshmi i panjohur, si dhe të zgjidhin barazimin.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në formimin, zgjidhjen dhe gjetjen e të zbritshmit në barazime.

Detyrë:
Krijon barazime ku i zbritshmi është i panjohur.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 101

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton zbritësin e panjohur;
Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1.3, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Gjejmë zbritësin e panjohur

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen zbritësin e panjohur;
- Formon barazi, ku duhet gjetur zbritësin e panjohur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me detyrën me fjalë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


GJEJMË ZBRITËSIN E PANJOHUR

1 Cilin numër duhet zbritur nga numri 43, që të fitohet numri 31?

Zgjidhim detyrën:
Numrin e panjohur e shënojmë me shkronjën X.

Shkruajmë barazimin: 43 – X = 31 (zbritësi i panjohur)
Njehsojmë: X = 43 – 31
Zgjidhja: X = 12
Prova: 43 – ___ = 31
Përgjigjja: _____

2 Nëse nga numri 82 zbresim një numër, fitojmë numrin 55. Cili është ai numër?
Nëse me X e shënojmë numrin e panjohur, merret barazimi:

82 – X = 55
X = 82 – 55
X = □
Prova: □ – □ = □

3 57 – X = 25

20 25 30 40 50 57 60

57 – 7 – 50 – 20 – 30 – 5 – 25
X = 7 + 20 + 5 = □

89 – X = 57

50 60 65 70 80 90

89 – □ – 80 – □ – 60 – □ – 57
X = □ + □ + □ = □

MËSOJMË

24

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me detyrën të shprehur me fjalë:
Elina kishte 45 euro. Ajo bleu në librari 2 libra dhe i mbetën 36 euro.
Sa euro kushtuan librat?
Diskutohen përgjigjet dhe barazimet e formuara.

45 – X = 36
X = 45 – 36
X = 9
Librat kushtuan 9 euro.

Hapi 2: Detyra 1 – Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën e dhënë dhe diskutohet gjetja e X.
Detyra 2 – Lexohet detyra e dhënë dhe gjendet X.
82 – X = 55
X = 82 – 55
X = 27

1 Cilin numër duhet zbritur nga numri 43, që të fitohet numri 31?

Zgjidhim detyrën:
Numrin e panjohur e shënojmë me shkronjën X.

Shkruajmë barazimin: 43 – X = 31 (zbritësi i panjohur)

Njehsojmë: X = 43 – 31

Zgjidhja: X = 12

Prova: 43 – ___ = 31

Përgjigjja: _____

2 Nëse nga numri 82 zbresim një numër, fitojmë numrin 55. Cili është ai numër?
Nëse me X e shënojmë numrin e panjohur, merret barazimi:

82 – X = 55
X = 82 – 55
X = ☐

Prova: ☐ – ☐ = ☐

3 57 – X = 25



57 – 7 – 50 – 20 – 30 – 5 – 25

X = 7 + 20 + 5 = ☐

89 – X = 57



89 – ☐ – 80 – ☐ – 60 – ☐ – 57

X = ☐ + ☐ + ☐ = ☐

Prova: 82 – 27 = 55

Hapi 3: Detyra 3 – Gjejmë X edhe në këtë mënyrë.

57 – X = 25

57	-	7	=	50	-	20	=	60	-	3	=	57

X	=	7	+	20	+	5	=	32

89 – X = 57

89	-	9	=	80	-	20	=	60	-	3	=	57

X	=	9	+	20	+	3	=	32

Hapi 4: Nxënësit në mënyrë individuale gjejnë zbritësin e panjohur në detyrat e dhëna:

45 – X = 29
78 – X = 65
81 – X = 18

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e zbritësit të panjohur.

Detyrë:
Formon pesë barazime, ku zbritësi është i panjohur. Gjen zbritësin.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 102

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 1.3.3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen zbritësin e panjohur.


1 Ta gjejmë zbritësin e panjohur.

54 – X = 23
X = 4 + 20 + 7 = 31

74 – X = 39
X = ... + ... + ... = ...

92 – X = 54
X = ... + ... + ... = ...

91 – X = 46
X = ... + ... + ... = ...

2 Ta gjejmë zbritësin e panjohur.

36 – X = 12
X = 36 – ...
X = ...

63 – a = 51
a = ... – ...
a = ...

71 – y = 30
y = ... – ...
y = ...

3
Të gjejmë zbritësin, nëse i zbritshmi është 78 dhe ndryshimi 52.
Zbritësi është i panjohur. E shkruajmë atë me shkronjën X.
Fitojmë barazimin:
78 – X = 52

Cilin numër duhet zbritur nga numri 51 që të fitohet numri, i cili i ka tri dhjetëshe dhe 4 njëshe?
Numrin e panjohur e shkruajmë me X.
Fitojmë barazimin:
51 – X = 34

4 T'i zgjidhim barazimet.

60 – X = 40
X = ... – 40
X = ...

80 – X = 35
X = ... – ...
X = ...

74 – X = 20
X = ... – ...
X = ...

USHTROJMË
25

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto (monedha, kartëmonedha euro), TV, internet, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve situata problemore: Në klasën e dytë janë 29 nxënës. Disa prej tyre kanë marrë pjesë në garën e vrapimit, ndërsa 16 nxënësit e mbetur kanë luajtur me top në oborrin e shkollës. Sa nxënës kanë marrë pjesë në garën e vrapimit? Si mund ta gjejmë numrin e nxënësve që kanë marrë pjesë në garë? Përgjigjet që japin nxënësit për zgjidhjen e detyrës shënohen në tabelë. Orientohen ata të arrijnë te parashtrimi i duhur i barazimit dhe gjetja e e zgjidhjes. 29-X=16

X=29-16 X=13

Hapi 2: Sqarohet gjetja e zbritësit të panjohur sipas modelit:

35-X= 14

X=5+ 10+ 6=21

Fillimisht, duke zbritur njëshet për të formuar dhjetëshen e plotë (35-5=30) dhe pastaj duke zbri-



1 Ta gjejmë zbritësin e panjohur.

54 – X = 23
X = 4 + 20 + 7 = 31

74 – X = 39
X = ___ + ___ + ___ = ___

92 – X = 54
X = ___ + ___ + ___ = ___

91 – X = 46
X = ___ + ___ + ___ = ___

2 Ta gjejmë zbritësin e panjohur.

36 – X = 12
X = 36 – ___
X = ___

63 – a = 51
a = ___ – ___
a = ___

71 – y = 30
y = ___ – ___
y = ___

3

Të gjejmë zbritësin, nëse i zbritshmi është 78 dhe ndryshimi 52.

Zbritësi është i panjohur. E shkruajmë atë me shkronjën X.
Fitojmë barazimin:
78 – X = 52

Cilin numër duhet zbritur nga numri 51 që të fitohet numri, i cili i ka tri dhjetëshe dhe 4 njëshe?

Numrin e panjohur e shkruajmë me X.
Fitojmë barazimin:
51 – X = 34

4 T'i zgjidhim barazimet.

60 – X = 40
X = ___ – 40
X = ___

80 – X = 35
X = ___ – ___
X = ___

74 – X = 20
X = ___ – ___
X = ___

USHTROJMË

25

tur dhjetëshet (30-10 = 20), për të vijuar me zbritjen e njësheve (20-6=14). Kryhet mbledhja 5+10+6=21, prandaj zbritësi i panjohur është 21.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 1 duke gjetur zbritësin e panjohur si në modelin e sqaruar në hapin 2.
Detyrat 2 dhe 3: Udhëzohen të gjejnë zbritësin e panjohur sipas mënyrës:
36-X=12
X=36-12
X=24

Hapi 4: Kërkohet nga ata të gjejnë zbritësin e panjohur në detyrat e dhëna:

67-X=12	45-X=20	38-X=13
77-X= 24	56-X=22	80-X=20
36-X=15	40-X=10	53-X=21

Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e zbritësit të panjohur.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 25).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 103

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen bashkësinë e zgjidhjeve të inekuacioneve (numra deri në 100).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3, II. 2, 7, III.1, 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2 , 2.1, 3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zgjidhja e jobarazimeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon barazimin nga jobarazimi;
- Gjen zgjidhjet për të cilat jobarazimet janë të sakta;
- Zgjidh jobarazimet me më shumë se një zgjidhje.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë, shportë, etiketa.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutohen pyetjet bazuar në shënimet në tabelë: Cili veprim matematikor është? (Mbledhja); Si quhet numri i parë te mbledhja?; Si quhet numri i dytë?; Kur mblidhen dy numra, çka fitojmë?; -Kur kemi shenjë të barazimit çka fitojmë? (Barazim); Kur e kemi shenjën më të madhe ose më të vogël, çka fitojmë? (Jobarazim). Shkruani në tabelë një barazim dhe një jobarazim.
12+X =24 është barazim **25+X=37** është jobarazim
* Diskutohet me nxënësit: Ku dallon barazimi nga jobarazimi ? (Barazimi ka një zgjidhje, jobarazimi ka një ose më shumë zgjidhje, dallon edhe nga shenjat =,> ose <).

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 1. Diskutohen këto pyetje: Sa shporta janë? (2); Cilët numra janë në shportën e parë? (3,2,9,0,1,6,8,4,5,7); Cilët numra janë në shportën e dytë? (4,5,3,0,2,1); Cili është jobarazim? (38+X<44); Cilën shenjë e ka jobarazimi?;



Çfarë duhet të bëjmë tani? (Numri 38 duhet të mblidhet me një numër nga shporta e parë që të fitohet një numër i cili është më i vogël se shuma 44. Numrat në vend të X-it i merrni nga numri më i vogël deri te më i madhi).

38+X<44 38+X<44

38+0<44 38+1<44

38<44 – e saktë 39<44 – e saktë

*(Numrat që na tregojnë jobarazi të saktë janë : 0,1,2,3,4,5. Numrat që tregojnë jobarazi të saktë vendosen në shportën e dytë).

38+X<44

38+6<44

44<44 – e pasaktë

*(Numrat që tregojnë jobarazi të pasakta janë: 6,7,8,9.)

Hapi 3: Nxënësve në grupe u shpërndahen etiketa të ndryshme. U kërkohet të gjejnë zgjidhjen e jobarazimit:

22+X<27	10+X<13	54+X<58	89+X<91

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjet ku jobarazimi është i saktë.

Detyrë:

Detyra 2 (faqe 26).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 104

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen zgjidhjet në libër për të cilat jobarazimet janë të sakta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.


1 Numrat nga shporta e parë, për të cilët jobarazimi X - 18 < 6 shndërrohet në jobarazi të saktë, i vendosim në shportën e dytë.

shporta I

shporta II

X – 18 < 6

Vlera e ndryshores X në jobarazimin e dhënë nuk mund të jetë më e vogël se 18. Pse?

18 → 18 – 18 = 0 < 6 e saktë
→ – 18 = 1 < 6
→ – 18 = 2 < 6
→ – 18 = 3 < 6
→ – 18 = 4 < 6
→ – 18 = 5 < 6
24 → – 18 = 6 < 6 e pasaktë
→ – 18 = 7 < 6

Pra, bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit X - 18 < 6, është:
{__, __, __, __, __, __}.

2 Numrat nga shporta e parë, për të cilët jobarazimi i dhënë shndërrohet në jobarazi të saktë, i vendosim në shportën e dytë.

35 – X > 27

shporta I

shporta II

Pra, bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit 35 - X > 27, është:
{__, __, __, __, __, __, __, __}.

3 Zgjidhjet e jobarazimeve i ngjyrosim me të kuqe.

X – 30 < 32 → 55 56 57 58 59 60 61 62 63 64 65
45 – X > 38 → 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15
39 < X < 48 → 40 41 42 43 44 45 46 47 48 49 50

USHTROJMË

27

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë shkruhet jobarazimi X + 8 < 20. Më pas vendosen etiketa me numra nga 1 deri në 15. Kërkohet nga nxënësit të gjejnë zgjidhjet e jobarazimit duke provuar numrat në etiketat e vendosura në tabelë.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të gjejnë bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimit, duke provuar numrat e dhënë në shportën e parë për të cilën jobarazimi X – 18 < 6, shndërrohet në jobarazi të saktë. Në fund, konkludohet se bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit të dhënë është: {18, 19, 20, 21, 22,23}.

Hapi 3: Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavarur të gjejnë bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimit 35 – X > 27. Konkludohet se bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit është: {1, 2, 3, 4, 5,6, 7}.

Hapi 4: Në tabelë shkruhen jobarazimet X – 10 < 6 dhe X - 12 > 2. Nxënësve u kërkohet të gje-



jnë bashkësinë e zgjidhjeve të jobarazimeve të dhëna. Pastaj bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimeve diskutohet në nivel klase.

Jobarazimi i parë: X – 10 < 6
X < 16,
pra bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit është {1,2,3…15}.

Jobarazimi i dytë : X - 12 > 2
X > 14,
pra bashkësia e zgjidhjeve të jobarazimit është {15,16,17…}.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e zgjidhjeve për të cilat jobarazimet janë të sakta.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 27).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 105

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur (numra deri në 100);
- Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2, 8; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 3, 4.


PËRSËRISIM

1 Ta gjejmë mbledhorin e panjohur.

28 + X = 54
2 + 20 + 4
X = 26

37 + X = 83
□ + □ + □
X = □

49 + X = 96
□ + □ + □
X = □

53 + X = 86
□ + □ + □
X = □

43 + □ = 67
28 + □ = 54

38 + □ = 67
75 + □ = 96

64 + □ = 96
77 + □ = 92

2 Ta gjejmë zbritësin e panjohur.

54 – X = 28
2 + 20 + 4
X = 26

91 – X = 56
□ + □ + □
X = □

83 – X = 37
□ + □ + □
X = □

64 – X = 28
□ + □ + □
X = □

93 – □ = 28
76 – □ = 19

53 – □ = 16
97 – □ = 63

88 – □ = 36
52 – □ = 28

3 T'i zgjidhim barazimet.

X + 28 = 89

X+ 42 = 91

14 + X = 82 – 15

28

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen mbledhorin dhe zbritësin e panjohur;
- Zgjidh barazimet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që të shikojnë ushtrimin e parë në detyrën 1. Pastaj nga nxënësit kërkohet që të gjejnë mbledhorin e panjohur dhe atë ta shprehin si shumë të tre numrave.
- Njëjtë veprohet edhe me shembujt e tjerë në detyrën e parë.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen që të shikojnë ushtrimin e parë në detyrën 2. Pastaj u kërkohet që të gjejnë zbritësin e panjohur dhe atë ta shprehin si shumë të tre numrave.



Diskutohet me nxënësit:

- Cili nga numrat duhet të gjendet?
- Sa duhet t'i shtojmë numrit 28 për t'u bërë dhjetëshe e plotë?
- Po numrit 30, sa duhet t'i shtojmë për t'u bërë 50?
- Po numrit 50, për t'u bërë 54?
- Cili numër fitohet në qoftë se i mbledhim këta numra?
- Me cilin numër është i barabartë X ose zbritësi i panjohur?
- Njëjtë veprohet edhe me shembujt e tjerë në detyrën e dytë.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen që të pavarur t'i zgjidhin barazimet dhe të gjejnë mbledhorin e panjohur.

X + 28 = 89

_____

_____

_____

Hapi 4: Bashkë me nxënësit analizohet figura dhe gjendet vlera e shkronjave x dhe y në detyrën 2, në faqen 29.

y	
x	28
19	19

Y është i barabartë me 38 sepse x është baraz me 10 dhe kështu 10 + 28 = 38

X është i barabartë me 10 sepse 28 + x = 38

Mblidhen numrat 19 + 19 = 38

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e barazimeve dhe gjetjen e mbledhorit dhe zbritësit të panjohur.

Detyrë:
Detyra 1 (faqe 29).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 106

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë; Ekuacionet dhe inekuacionet lineare; Njësitë matëse

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes;
Përcakton mbledhorin, të zbritshmin dhe zbritësin e panjohur;
Përcakton peshën e objekteve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III. 2, 3, 4, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 3. 4, 6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen shumën dhe ndryshimin e numrave;
- Gjen mbledhorin dhe zbritësin e panjohur;
- Njehson vlerën e shprehjeve të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë jepen numrat 30, 25 dhe 55. Shënohen dy barazime me mbledhje dhe dy barazime me zbritje me numrat e dhënë.
30 + 25 = 55; 25 + 30 = 55; 55 – 25 = 30; 55 – 30 = 25

Hapi 2: Detyra 2: Të përcaktohet pesha e figurave të dhëna.
1kg + 2kg = 3kg; 5kg + 2kg + 2kg = 9kg; 5kg + 5kg = 10kg

Hapi 3: Të gjendet numri i panjohur (X).



Detyra 3: 47 + X = 93 18 + X = 55
X = 3 + 40 + 3 = 46, X = 2 + 30 + 5 = 37

Detyra 4: X + 35 = 95
X = 95 – 35
X = 60

Detyra 5: 95 – X = 26 74 – X = 49
X = 5 + 60 + 4 = 69, X = 4 + 20 + 1 = 25

Hapi 4: Detyra 6

92 – 36

92	-30	62	-6	56

43 + 13

43	+10	53	+3	56

Hapi 5: Njehsohet vlera e shprehjeve të dhëna.

Detyra 7: 24 + 57 + 16 = (24 + 16) + 57 = 40 + 57 = 97
3 + 29 + 57 = (3 + 57) + 29 = 60 + 29 = 89

Diskutohen zgjidhjet dhe rezultatet e secilës detyrë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e shumës dhe të ndryshimit, gjetjen e numrit të panjohur.

Detyrë:
Detyra 8 dhe 9 (faqe 30).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 107

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.6; 6.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Simetria ndaj drejtëzës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton figurën simetrike në lidhje me drejtëzën e dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura (me forma të ndryshme).

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Shpërndahen për nxënës figura me forma të ndryshme të prera në dy pjesë dhe u kërkohet të gjejnë dhe të bashkojnë dy pjesët që formojnë të njëjtën figurë. Figurat mund të jenë katrorë, trekëndësha, drejtkëndësha etj. të ndara në dy pjesë.



Hapi 2: Paraqiten para nxënësve videot nga linqet:
https://www.youtube.com/watch?v=YFzktJNmnPU
https://www.youtube.com/watch?v=3MLAlngTnhg.

Bisedohet me nxënësit për figurat simetrike në video.



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të vizatojnë figurën simetrike me figurën e dhënë në lidhje me drejtëzën e simetrisë në detyrat 2 dhe 3 në libër.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen figura të ndryshme (petëza) dhe kërkohet nga ata të vendosin një vizore mbi bankë dhe të formojnë figura simetrike ndaj drejtëzës së simetrisë (vizores) me figurat e dhëna (modeli në foto).

Hapi 5: Nxënësve u shpërndahen modele të përgatitura (p.sh., modelet në foto) dhe u kërkohet të vizatojnë figurën simetrike me figurën e dhënë në lidhje me drejtëzn e simetrisë.
Modelet përgatiten nga mësimdhënësit apo merren të gatshme nga linku:
https://www.math-salamanders.com/symmetry-worksheets.html.





Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin e figurës simetrike me figurën e dhënë në lidhje me drejtëzën e simetrisë.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 31).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 108

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie;
Vizaton drejtëzën/drejtëzat e simetrisë si dhe përcakton sa drejtëza simetrie ka figura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1,2, III.1,2,6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1, 3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Drejtëza e simetrisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton drejtëzën e simetrisë;
- Përcakton numrin e dejtëzave të simetrisë në figura të ndryshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë, ngjyra temper.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Aktivitet: Nxënësve u shpërndahet nga një fletë. Fletën që kanë në duar duhet ta palosin. Pasi ta kenë palosur, do t'i fusin dy gjysma të barabarta me drejtëzën e simetrisë në mes. Në njërën anë të fletës së palosur do t'i bëjnë 3 pika me ngjyra temper të cilën do ta palosin derisa nuk janë tharë ngjyrat. Pasi ta kenë palosur mirë dhe ta mbajnë të palosur për disa sekonda, do të fitohet simetria e një figure.

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet ta vëzhgojnë dhe ta punojnë detyrën 1 në libër. Diskutohen këto pyetje: Çfarë figura janë vizatuar? (Lapsa); Çfarë duhet të bëjmë në mes të lapsave? (Drejtëzën e simetrisë); Si duhet ta bëjmë drejtëzën e simetrisë në figurën e parë? (Vertikalisht); Po në figurën e dytë, si duhet të vendoset drejtëza e simetrisë? (Horizontalisht); Në figurën e tretë? (Pjerrtas); -Në figurën e fundit? (Vertikalisht).



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 2, në libër. Tregohet se ka figura që mund të kenë më shumë se një drejtëz simetrie. Diskutohen këto pyetje: Figura e parë sa palosje mund t'i ketë? (Një palosje, fitohet një drejtëz simetrie). Figura e dytë është e plotësuar, këtu janë dy drejtëza simetrie, ku mund t'i bëni dy palosje. Në figurën e tretë, te trekëndëshi, sa palosje mund të jenë? (Një palosje). Po te gjashtëkëndëshi sa drejtëza simetrie mund të jenë? (4 drejtëza simetrie).

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet të punojnë të pavarur detyrën 3 në libër, ku do të vendosen se nga sa drejtëza të simetrisë kanë figurat e dhëna.

Hapi 5: Nxënësve u shpërndahen figura të punuara me letra (mund të punohen së bashku me nxënësit) dhe u kërkohet t'i palosin ato në mënyrë që të dyja anët e figurës të jenë simetrike ndaj vijës së palosjes. Pas palosjes mund të ngjyrosin me ngjyrat e njëjta si në gjysmën tjetër të fletës.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin e drejtëzës së simetrisë; për përcaktimin e numrit të dejtëzave të simetrisë në figura të ndryshme.

Detyrë:
Kërkohet nga nxënësit të formojnë figura simetrike me letra me ngjyra sipas dëshirës dhe të dallojnë drejtëzën e simetrisë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 109

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie;
Vizaton drejtëzën/drejtëzat e simetrisë

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton drejtëzën e simetrisë në figurat e dhëna;
- Vizaton dhe ngjyros figurat simetrike me figurat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u drejtohen pyetje:
- Çfarë ju bie ndërmend kur përmendet fjala simetri?
- Çështë simetria? (Simetria është përputhje e plotë mes dy gjysmave të një figure.)
- Çështë drejtëza e simetrisë? (Vijë e drejtë, që e ndan figurën në dy pjesë të barabarta.)

Hapi 2: Në tabelë paraqiten mendimet e dhëna nga nxënësit ose fakte lidhur me simetrinë.



Për mësuesin/en



Hapi 3: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të ngjyrosin figurat në mënyrë që ato të jenë simetrike.
Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që, pasi të kenë vizatuar figurat simetrike me figurat e dhëna, t'i ngjyrosin ato.
Detyra 3: Udhëzohen që të ngjyrosin figurat simetrike me figurat e dhëna.

Hapi 4: Nxënësit marrin nga një fletë dhe e palosin në dysh. Në njërën anë caktojnë pikë. E shpojnë letrën e palosur me majën e një stilolapsi. Pastaj e hapin letrën dhe e vizatojnë drejtëzën e simetrisë. Bashkojnë pikat me vizore dhe masin gjatësinë e secilës pikë nga drejtëza e simetrisë. Vërejnë se distanca e pikave nga drejtëza e simetrisë është e njëjtë. Çfarë do të thotë kjo? Pikat simetrike ndodhen njësoj larg nga drejtëza e simetrisë.
Detyra 4: Nxënësit i vizatojnë pikat simetrike me pikat e dhëna në lidhje me drejtëzën e simetrisë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatim dhe ngjyrosje të figurave simetrike, për vizatimin e drejtëzës së simetrisë në figurat e dhëna në libër.

Detyrë:
Detyrat 5 dhe 6 (faqe 34).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 110

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III. 1, 2, 7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6. 1, 2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton figurën simetrike në lidhje me drejtëzën e dhënë;
- Ngjyros figurat simetrike me figurat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Vizore, ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë ose projektor paraqitet disa figura simetrike dhe kërkohet nga nxënësit që të gjejnë drejtëzat e simetrisë te këto figura.



Hapi 2: Nxënësit udhëzohen që të shikojnë figurat në detyrën 1. Nga ata kërkohet ata që të gjejnë drejtëzat e simetrisë dhe të ngjyrosin figurat në mënyrë që ato të mbeten simetrike.

Hapi 3: Nxënësit në detyrën 2 vizatojnë dhe ngjyrosin figurat simetrike me figurat e dhëna.



Hapi 4: Nxënësit udhëzohen që individualisht duke ngjyrosur në detyrën 3 të formojnë figura simetrike.



VEPRIMTARI SHTESË

Nxënësit udhëzohen që në fletoret e tyre të vizatojnë figura të ndryshme dhe atyre figurave t'ua vizatojnë figurën simetrike.

Po ashtu, mund të gjenden fletë të gatshme në linkun e mëposhtëm dhe t'u shpërndahen nxënësve:

https://es.dreamstime.com/p%C3%A1gina-que-colorea-con-la-casa-abstracta-juego-educativo-para-los-ni%C3%B1os-actividad-imprimible-de-dibujo-aprendiendo-simetr%C3%ADa-image121428264

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin dhe ngjyrosjen e figurave simetrike me figurat e dhëna.

Detyrë:

Vizaton figura të ndryshme dhe përbri tyre vizaton figurën simetrike.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 111

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.) për ta gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2, II.2, III.2, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3; 3.1, 4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Prodhimi si shumë e mbledhorëve të barabartë



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan shumën e numrave si prodhim dhe anasjelltas;
- Emërton kufizat e prodhimit (faktori i parë, faktori i dytë, prodhimi).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Petëza me ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secilit grup i shpërndahen nga 12 petëza me ngjyra të njëjta. Detyra e secilit grup është t'i rendisë petëzat, në mënyra të ndryshme.
2 + 2 + 2 + 2 + 2 = 12
3 + 3 + 3 + 3 = 12
4 + 4 + 4 = 12
1 + 1 + 1 + 1 +1 +1 +1 +1 +1 +1 +1 +1 = 12

- Sa mbledhorë janë kur petëzat i renditim nga 2? Po kur petëzat janë nga 3, 4 dhe 1?

Hapi 2: Vështrohet figura e dhënë në tekst dhe diskutohen mënyrat e radhitjes së kubeve nga fëmijët.



Sara: 6 + 6 + 6 = 18
Era: 9 + 9 = 18
Dreni: 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 = 18
Lisi: 3 + 3 + 3 + 3 + 3 +3 = 18

Sara: 6 + 6 + 6 = 18 ose 3 · 6 = 18
Era: 9 + 9 = 18 ose 2 · 9 = 18
Dreni: 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 + 2 = 18
ose 9 · 2 = 18
Lisi: 3 + 3 + 3 + 3 + 3 +3 = 18 ose 6 · 3 = 18

Shumëzimi është mbledhje e përsëritur.
9 + 9 + 9 = 27 ose



Hapi 3: Detyra 2 – Shuma e mbledhorëve shënohet si prodhim i dy numrave.

Sa lule ka një saksi? (4) Sa saksi janë? (5) 4 + 4 + 4 + 4 + 4 = 20 4 · 5 = 20
Sa qershi ka një kalavesh? (2) Sa kalaveshë me qershi janë? (5) 2 + 2 + 2 + 2 + 2 = 10 2 · 5 = 10

Hapi 4: Detyra 3 – prodhimi i numrave shënohet si shumë e mbledhorëve. (4 · 4 = 4 + 4 + 4 + 4).
Detyra 4 – shuma e mbledhorëve shënohet si prodhim i dy numrave. (2 + 2 + 2 = 3 · 2).

Hapi 5: Detyra 5 – Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë detyrën 5. Figurat e dhëna shënohen si shumë dhe prodhim i numrave.

8 + 8 = 16	6 + 6 + 6 = 18	5 + 5 + 5 = 15
2 · 8 = 16	3 · 6 = 18	3 · 5 = 15

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shkrimin e shumës së mbledhorëve si prodhim dhe prodhimin si shumë të mbledhorëve.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 37).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 112

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.) për ta gjetur prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2.III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1.


USHTROJMË

1 Shumën e shkruajmë si prodhim.

□ + □ + □ + □ = □
□ • 2 = □

□ + □ + □ = □
□ • 4 = □

2 Analizojmë figurën dhe plotësojmë.

3 + □ + □ + □
□ • 3 = □

4 + □ + □
□ • 4 = □

3 Shumën e mbledhorëve të barabartë e shkruajmë si prodhim.

6 + 6 = 2 • 6
6 + 6 + 6 = □ • 6
6 + 6 + 6 + 6 = □ • 6
6 + 6 + 6 + 6 + 6 = □ • 6

7 + 7 = 2 • 7
7 + 7 + 7 = □ • 7
7 + 7 + 7 + 7 = □ • 7
7 + 7 + 7 + 7 + 7 = □ • 7

4 Analizojmë figurën dhe plotësojmë.

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15

3 + □ + □ + □ + □ = □ • 3 = □

38

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan shumën e mbledhorëve të barabartë si prodhim dhe njehson.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten para nxënësve tri bashkësi me elemente dhe u kërkohet të shprehin shumën e elementeve të bashkësive si prodhim.

4+4+4= 3 • 4=12

Sa elemente ka secila bashkësi? Sa bashkësi janë? Sa elemente janë gjithsej?

Hapi 2: Paraqiten para nxënësve figura (si në foto) dhe udhëzohen që t'i shprehin ato si shumë e mbledhorëve të barabartë. Pasi nxënësit t'i shprehin si shumë, u kërkohet t'i paraqesin si prodhim



dhe të njehsojnë prodhimin.



Hapi 3: Nxënësit i plotësojnë detyrat 1dhe 2 në libër duke shprehur si prodhim shumën në bazë të figurave.
Detyra 3. Udhëzohen të shprehin si prodhim shumën e mbledhorëve të barabartë.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen fletë pune të përgatitura (sipas modelit në foto) dhe lipset nga ata të paraqesin si prodhim shumën e mbledhorëve të barabartë dhe të njehsojnë prodhimin. Në mungesë të fletëve të punës, mund të shkruhen në tabelë detyra me shumë të mbledhorëve të barabartë dhe kërkohet nga nxënësit t'i shkruajnë ato si prodhim dhe të njehsojnë prodhimin.



3+3+3+3= 4+4+4+4+4=

5+5+5+5+5+5= 2+2+2+2+2+2=

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shkrimin e shumës së mbledhorëve të barabartë si prodhim dhe njehsimin e prodhimit.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 38).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 113

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor vetitë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1,2, III. 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2; 2.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ndërrimi i vendeve të faktorëve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon vetinë e ndërrimit të vendeve të faktorëve;
- Zbaton vetinë e ndërrimt të vendeve të faktorëve;
- Ndërron vendet e faktorëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet që 8 prej tyre të dalin para tabelës. Ndahen ata në 4 grupe me nga 2 nxënës Diskutohen këto pyetje: Sa nxënës janë në tabelë? (8); Në sa grupe janë të ndarë? (4); Secili grup sa nxënës ka? (2); Si mund ta shënojmë këtë me anë të shumëzimit? (4 grupe me nga 2 nxënës: 4·2=8); Kur shumëzojmë dy numra, cilin veprim matematikor duhet vendosur? (Shumëzimin); Si quhet numri i parë te shumëzimi? Si quhet numri i dytë te shumëzimi? Nxënësit e njëjtë ndahen në 2 grupe me nga 4 nxënës. Pyeten ata: Në sa grupe janë të ndarë? (2); Secili grup sa nxënës ka? (4); Si mund ta shënojmë me anë të barazimit? (2·4=8); Çfarë po vëreni këtu? (Prodhimi nuk do të ndryshojë kur faktori i parë dhe faktori i dytë i ndërrojnë vendet: 4·2=2·4.)



Hapi 2: Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë detyrën 1 në libër. Diskutohen këto pyetje: Çfarë vëreni në figurë? Si i kanë rreshtuar dy fëmijët petëzat? (Njëri 3 kolona me nga 5 rreshta 3·5 dhe fëmija tjetër 5 kolona me nga 3 rreshta 5·3); Sa petëza janë gjithsej? A ka ndryshuar prodhimi? (Jo); Tregoni se nëse u ndërroni vendet faktorëve, prodhimi nuk ndryshon.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë rreshtimet e paraqitura në figurat në detyrën 2 dhe t'i plotësojnë barazimet. Diskutohen këto pyetje: Sa rreshta janë me rrathë të kaltër? (4); Po sa kolona? (2); Si shënohet barazimi 4·2=8; Po në anën tjetër? Sa rreshta janë me rrathë të kaltër? (2); Sa kolona? (4); Si shënohet barazimi (2·4=8).

Hapi 4: Kërkohet nga nxënësit të punojnë detyrën 3 në libër. 24 duhet të paraqitet si prodhim i dy numrave. Parashtrohen këto pyetje: Sa kolona janë me kube ngjyrë të kuqe? (4); Secila kolonë sa kube ka? (6); Si mund ta shënojmë? 24=4·6 (24=3·8; 24=6·4;24=8·3).

Hapi 5: Nxënësve, të ndarë në çifte, u shpërndahen fletë. Kërkohet nga ata t'i paraqesin si prodhime dhe faktorëve t'ua ndërrojnë vendet.



___ · ___ = ___

___ · ___ = ___

3 · 7 = ___ · ___ = 21

5 · 4 = ___ · ___ = ___

___ · ___ = ___

___ · ___ = ___

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në dallimin dhe ndërrimin e vendeve të mbledhorëve.

Detyrë:

Ndërron vendet e faktorëve: 4·3; 8· 3; 5·2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 114

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 5.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Zbaton vetinë e ndërrimit të vendeve të faktorëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë vizatohet figura e mëposhtme. Pyeten nxënësit:
- Sa kolona ka figura e parë? Sa topa ka një kolonë në këtë figurë? Sa topa bëjnë gjithsej?
- Nga sa kolona përbëhet figura e dytë? Sa topa ka secila kolonë? Sa topa bëjnë gjithsej?



3 • 2 = 6



2 • 3 = 6

Nxënësve u shpjegohet se edhe nëse faktorët i ndërrojnë vendet, prodhimi i tyre nuk ndryshon.



Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të analizojnë figurat e dhëna, pastaj plotësojnë në atë mënyrë që të marrin barazi të saktë. P.sh. 5 kolona me nga 4 topa bëjnë 20, anasjelltas edhe 4 kolona me nga 5 topa japin prodhimin 20.

Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që të numërojnë sa fusha përmbajnë numrin 5 dhe sa fusha numrin 3.

5	5	5

3	3	3	3	3

3 • 5 → 3 • 5 = 5 • 3 ← 5 • 3

Kokludohet se 3 • 5 = 5 • 3. Njëjtë veprohet edhe në rastin tjetër, ku faktorët 6 dhe 3 ndërrojnë vendin.

Hapi 3: Detyra 3: Zbatojnë vetinë e ndërrimit të vendeve të faktorëve në bosht numerik. Pra, shkruhet

4 • 2 = 2 • 4 dhe rasti tjetër 7 • 1 = 1 • 7

Detyra 4: Nxënësit udhëzohen që në kolonën e tretë dhe të katërt të shumëzojnë numrat a dhe b, që janë dhënë në kolonën e parë dhe të dytë. Njëjtë veprohet edhe me tabelën tjetër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zbatimin e vetisë së ndërrimit të vendeve të faktorëve.

Detyrë:

Detyra 2 dhe 3 (faqe 41).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 115

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes së numrave, si dhe shumëzimit të numrave deri në 100;
- Gjen prodhimin e numrave (≤50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II. 2; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.3; 6.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Shumëzimi me faktorin 2

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy numrave kur njëri faktor është 2;
- Analizon figurat dhe plotëson detyrat duke u bazuar në modelet në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë muzikore, Njeriu dhe natyra.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Diskutohet bashkë me nxënësit: Çfarë kemi nga 2 (ose nga 2 palë) në trupin tonë? Përgjigjet e tyre mund të paraqiten në këtë formë në tabelë.

Për mësuesin/en



Hapi 2: Bisedohet me nxënësit për figurën në detyrën 1.

- Çfarë po shihni?
- Cilët numra mbajnë dy balonat e parë?
- A duhet që në balonat e tjerë të shkruajmë numra sipas një rregulle?
- Cila është ajo?

Nxënësve u kërkohet që të plotësojnë balonat me numrat që duhet.

Hapi 3: Nxënësit vëzhgojnë dhe analizojnë figurat në detyrën 2 në libër dhe pastaj bisedohet me ata:

- Sa palë këpucë shihni në fotografi?
- Nga sa këpucë ka secila palë?
- Atëherë sa këpucë janë gjithsej në fotografi?
- Si e gjetët?
- Cilët janë faktorët në barazimin: $5 \cdot 2 = 10$?
- Po 10, çka është?

Ngjashëm pyeten edhe për shembuj të tjerë të kësaj detyre.

Hapi 4: Nxënësve u sqarohet tabela e shumëzimit me shumëzuesin 2. Pastaj udhëzohen që të plotësojnë të pavarur detyrën 3 duke gjetur shumën e mbledhorëve të barabartë me 2.

VEPRIMTARI SHTESË:
Kërkohet nga nxënësit të paraqesin në fletore prodhimin me faktorin 2.
Mund të shfrytëzohen ide edhe sipas modelit në foto.

Për ta bërë mësimin më tërheqës dhe për të mësuar përmes lojës mund të shihet kjo video dhe të përsëritet tabela e shumëzimit me faktorin 2 bashkë me nxënësit.
https://www.youtube.com/watch?v=8hN9Ur_xdm0

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e prodhimit të numrave me faktorin 2.

Detyrë:
Shkruan barazime me prodhim ku njëri faktor është 2.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 116

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përdor strategji të ndryshme (*mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.*) për të gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3; 3.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e numrave me njërin faktor 2;
- Shkruan barazi me shumëzimin e numrave me njërin faktor 2.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Biçikleta ka 2 rrota. Sa rrota kanë 4, 6, 3 dhe 5 biçikleta?
Nxënësit shkruajnë përgjigjet e tyre në fletore dhe diskutohen ato.
4 biçikleta – $4 \cdot 2 = 8$
6 biçikleta – $6 \cdot 2 = 12$
3 biçikleta – $3 \cdot 2 = 6$
5 biçikleta $5 \cdot 2 = 10$

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të shikojnë kërcimin e bretkosës dhe të gjejnë në cilët katrorë kërcen ajo.

2	4	6	8	10	12	14	16	18	20



1 Njehsojmë dhe plotësojmë:

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19 20

2 4

2

5 • 2 = 1 • 2 = 6 • 2 =

3 Të njehsojmë:

7 • 2 = 1 • 2 = 6 • 2 = 8 • 2 =
2 • 2 = 3 • 2 = 9 • 2 = 5 • 2 =
4 • 2 = 10 • 2 =

4 < = > ?

2 • 2 3 + 2 2 • 5 5 • 2 6 • 2 6 + 2
4 • 2 3 + 4 9 5 • 2 6 • 2 5
4 • 2 2 • 5 2 • 7 7 • 2 6 • 2 4 • 2

5 Plotësojmë dhe formojmë barazi të sakta.

10 = • 2 12 = • 2 16 = • 2 4 = • 2
14 = • 2 8 = • 2 20 = • 2 6 = • 2

USHTROJMË

43

Hapi 3: Detyra 2 – 3: Nxënësit udhëzohen të gjejnë prodhimin e numrave të dhënë duke lexuar rezultatet e fituara.

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet që në dyshe të gjejnë rezultatin dhe t'i krahasojnë ato <, =, >.
$2 \cdot 2 < 3 + 2$
$4 \cdot 2 > 3 + 4$

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të shkruajnë në fletore pesë barazime me shumëzimin e numrave me faktorin 2.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të prodhimit me faktorin 2.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 43).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 117

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III. 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1; 3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Shumëzimi me faktorin 3

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin me faktorin (shumëzuesin) 3.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve situata problemore: Gjyshja Verë ka dy mbesa. Ajo ka dëshirë që secilës mbesë t'i dhurojë nga dy libra për ditëlindje. Sa libra duhet të blejë gjyshja Verë?
Sa libra duhet të blejë ajo po të kishte tri mbesa, katër mbesa ose pesë mbesa?
Shënohen në tabelë zgjidhjet që tregojnë nxënësit për situatën e paraqitur.

Hapi 2: Udhëzohen të plotësojnë detyrën 1 në libër duke plotësuar balonat me numra që u përgjigjen atyre në boshtin numerik (3,6,9,12,15,18,21,24,27,30).

Kërkohet nga nxënësit t'i lexojnë barazimet me shumë të mbledhorëve të barabartë në detyrën 2 dhe të shkruajnë prodhimin.

Tregohet se është paraqitur shumëzimi me faktorin 3.



Në detyrën 3, lexohet dhe sqarohet tabela e shumëzimit me faktorin 3.

Detyra 4. Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat me dy veprime.
(4•3) +15=12+15=27
(9•3)- (6•3)= 27-18=9
(7•3) +19= 21+19=40
(10•3)- (5•3) =30-15=15

Hapi 3: Nxënësve u shpërndahen etiketa me detyra (prodhimi me faktroin 3) dhe kërkohet nga ata të gjejnë prodhimin për detyrën e paraqitur në etiketë.

3 • 4=	3 • 3=
8 • 3=	6 • 3=

Detyrat e plotësuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e prodhimit me faktorin 3.

Detyrë:
Shkruan disa barazime të shumëzimit me faktorin 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 118

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor vetitë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.1,2, III. 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,3; 2.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy numrave ku njëri faktor është 3;
- Njehson prodhimin me faktorin 3.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, dardha, petëzat, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Me anë të projektorit paraqitet para nxënësve një grup i dardhave. Diskutohen këto pyetje: Çfarë janë këto? Sa dardha kemi? (3); Ne duhet të dyfishojmë sasinë. (*Sa herë që dëgjoni fjalën dyfishojmë ju duhet të dini që është veprimi i shumëzimit). Atëherë 3 dardhave u shtojmë edhe 3 dardha të tjera, sa është sasia e dardhave? (3+3=6). Dardhat do t'i shprehim në veprim të shumëzimit. Sa vende i kemi me dardha? (2); Me nga sa vende? (3).

3+3=6 –si shumë , 2·3=6- si shumëzim

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 1 në libër. Diskutohen pyetjet: Sa akullore shihni në figurën e parë? (4); Nga sa topa ka secila? (3); Atëherë sa topa me akullore janë gjithsej? (12). Si e gjetët? (4 · 3 = 12); Cilët janë faktorët në barazimin 4 · 3 = 12 ? (4 dhe 3). Po



1 Analizojmë figurat dhe plotësojmë barazitë.

□ • 3 = □ □ • 3 = □ □ • 3 = □

2 Njehsojmë dhe plotësojmë:

1 • 3 = 3 | 3 + 3 = □ 2 • 3 = 6 | 3 + 3 + 3 = □ 3 • 3 = 9 | 3 + 3 + 3 + 3 = □ 4 • 3 = 12

5 • 3 = □ | 6 • 3 = □ | 7 • 3 = □ | 8 • 3 = □

3 Njehsojmë:

5 • 3 = □ 6 • 3 = □ 3 • 3 = □ 2 • 3 = □
7 • 3 = □ 4 • 3 = □ 1 • 3 = □ 8 • 3 = □

4 Njehsojmë:

(6 • 3) + 10 = ___ + 10 = □ 28 + (8 • 3) = ___ + ___ = □
(10 • 3) – 25 = ___ – ___ = □ 9 • 3 – 5 • 3 = ___ – ___ = □

5 < = > ?

5 • 3 ○ 3 • 5 7 • 3 ○ 5 • 3 1 • 3 ○ 3 • 3
8 • 3 ○ 3 • 7 10 • 3 ○ 3 • 10 6 • 3 ○ 3 • 9

USHTROJMË

45

12 çka është ? (Prodhimi). Pyetje të ngjashme bëhen edhe për shembuj të tjerë të kësaj detyre.

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të punojnë detyrën 2 në libër. Parashtrohen këto pyetje:- Në sa vende janë të ndarë rrathët me ngjyrë të kaltër? (2); Në të dy vendet janë nga 3 rrathë. Si mund ta shënojmë si shumë? (3+3=6); Po si prodhim si duhet shënuar? (Janë 2 vende me nga 3 rrathë 2·3=6). Shuma me prodhimin, rezultatin e kanë të njëjtë. Vazhdohet me pyetjet e njëjta me shembuj të tjerë.

Hapi 4: Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 3.

Hapi 5: Udhëzohen të punojnë detyrën 4 në libër. Diskutohen këto pyetje: Sa veprime matematikore kemi? (2 shumëzimin me mbledhjen). Çfarë duhet të bëjmë së pari? (Lirohemi prej kllapave, duhet shumëzuar 6·3, më pas prodhimi mblidhet me numrin 10).

(10·3)-25=30-25=5; 28+(8·3)=28+24=52; 9·3-5·3=27-15=12.

Hapi 6: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen fletë. Udhëzohen të punojnë në dyshe dhe u kërkohet të zgjidhin problemin:

Albi grupoi petëzat në 5 grupe me nga 3 petëza. Sa petëza kishte Albi?

_____ ·_____ = _____

Plotësoni tabelën:

3 · 1	3 · 4	3 · 7	3 · 10
3 · 3	3 · 6	3 · 8	2 · 3
3 · 5	3 · 2	3 · 9	1 · 3

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen dhe njehsimin e prodhimit të dy numrave, ku njëri prej faktorëve është 3.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 45).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 119

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Argumenton lidhjen mes mbledhjes dhe prodhimit të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi me faktorin 4

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy numrave kur njëri faktor është 4.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në projektor paraqitet barazimi 2 • 4 = 8. Pyeten nxënësit:

- Si quhen numrat që marrin pjesë në shumëzim?



Hapi 2: Në projektor paraqitet figura që përban 4 elemente. Shembull:

Dyfishojmë sasinë e luleshtrydheve.



E shprehim me veprimin e mbledhjes:
4 + 4 =8o se 2 • 4 = 8
Trefishojmë sasinë e luleshtrydheve.

Fitohet 4+4+4=12 ose 3 • 4 = 12. Vazhdohet me 4,5,…10.

Hapi 3: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë balonat me numrat që u përgjigjen atyre në bosht numerik. Pastaj pyeten:

- Me cilën rregull keni plotësuar balonat e zbrazura? (Duke rritur me nga 4, secilen balonë pasardhëse).

Detyra 2: Udhëzohen që të gjejnë shumën e mbledhorëve të dhënë. Pastaj pyeten:

- Numri 4 sa katërshe ka? (1)
- Paraqitni si prodhim të dy faktorëve (4 · 1=4)
- Numri 8 sa katërshe ka ? (2)
- Paraqitni si shumë e dy mbledhorëve të barabartë (4 + 4 = 8). Po si prodhim? (2 · 4 = 8).

Vazhdohet me udhëzime të njëjta derisa të arrihet në numrin 40.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e prodhimit kur njëri nga faktorët është numri 4.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 46).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 120

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes së numrave, si dhe shumëzimit të numrave deri në 100;
- Gjen prodhimin e numrave (≤50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II. 2; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.3; 6.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi me faktorin 5

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy numrave ku njëri faktor është 5;
- Analizon figurat dhe plotëson detyrat duke u bazuar në modelet në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të gjejnë zgjidhjen e problemit: Blendi e mendoi numrin 5, kurse Shpati e mendoi numrin 6 herë më të madh se numri 5.

- Cilin numër e mendoi Shpati?

✓ Pasi ata të jenë menduar, u kërkohet të paraqesin zgjidhjet e bëra.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vrojtojnë boshtin numerik në detyrën 1 dhe bisedohet me ata:



- Dy balonat e para cilët numra mbajnë? (5, 10).
- A duhet në balonat e tjerë të shkruajmë numra sipas një rregulle? (Po).
- Cila është ajo? (Duhet rritur me nga 5).

Nxënësve u kërkohet të plotësojnë balonat me numrat e caktuar.

Hapi 3: Udhëzohen ta shikojnë figurën në detyrën 2.

Bisedohet me nxënësit:

- Numri 5 sa pesëshe ka? (1);
- Paraqitni si prodhim të dy faktorëve. ($5 \cdot 1 = 5$);
- Numri 10 sa pesëshe ka? (2);
- Paraqitni si shumë me dy mbledhorë të barabartë (5+5=10), po si prodhim? ($2 \cdot 5 = 10$).
- Numri 15 sa pesëshe ka? (3) .
- Paraqitni si shumë me mbledhorë të barabartë (5+5+5=15), po si prodhim? ($3 \cdot 5 = 15$).

✓ Vazhdohet me udhëzime të njëjta derisa të arrihet në numrin 50.

Hapi 4: Nxënësve u sqarohet tabela e shumëzimit me faktorin 5.

Faktori i parë	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Faktori i dytë	5	5	5	5	5	5	5	5	5	5
Shumëzimi	5	10	15	20	25	30	35	40	45	50

Hapi 5: Nga nxënësit kërkohet të njehsojnë prodhimin e numrave në detyrën 4.

VEPRIMTARI SHTESË - Për ta bërë mësimin më tërheqës dhe për të mësuar përmes lojës mund të shikohet kjo video dhe të përsëritet tabela e shumëzimit me faktorin 5.
https://www.youtube.com/watch?v=TFcwMi8l040

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e prodhimit të numrave me faktorin 5.

Detyrë:
Shkruan barazime dhe gjen prodhimin me faktorin 5.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 121

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.) për të gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.2, III.3, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 3.4, 6.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin e numrave me faktorët 4 dhe 5.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketat me numrat:

4 – 8 – 12 – 16 – 20 – 24 – 28 – 32 – 36 – 40 dhe 5 – 10 – 15 – 20 – 25 – 30 – 35 – 40 – 45 – 50 .

Thuhet një barazi: 5 · 4, dhe nxënësi që ka etiketën me numrin 20 e ngre lart (sepse 5 · 4 = 20).
Vazhdohet edhe me barazimet e tjera kështu.

Hapi 2: Vështrohen figurat e dhëna ne detyrën 1 (faqe 48 dhe 49).
Sa rreshta janë me rrathë të gjelbër? (6);
Sa kolona janë me rrathë të gjelbër? (5);
Sa janë gjithsej? (6 · 5 = 30).



6 Analizojmë figurat dhe plotësojmë.

4 • 3 = ☐ 4 • 2 = ☐ 4 • 1 = ☐

7 Të njehsojmë:

2 • 5 € = ☐ € 3 • 5 € = ☐ € 9 • 5 € = ☐ €
5 • 5 € = ☐ € 6 • 5 € = ☐ € 7 • 5 € = ☐ €
8 • 5 € = ☐ € 10 • 5 € = ☐ € 1 • 5 € = ☐ €

7 fëmijë kanë sjellë në kooperativën bujqësore nga 4 kg kërpudha. Sa kilogramë kërpudha grumbulluan ata së bashku?

Njehsojmë: ___ • ___ = ___ .

Pra, fëmijët kanë grumbulluar ___ kilogramë kërpudha.

8 Lidhim shprehjet numerike me vlerat e tyre.

4 • 1 4 • 12 4 • 3 4 • 8 4 • 9 4 • 10

0 4 8 12 16 20 24 28 32 36 40 44 48

4 • 4 4 • 5 4 • 7 4 • 11 4 • 6 4 • 2

9 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelat.

x	4	5	6	7
5 • x + 3				

x	4	5	6	7	8
4 • x – 5					

USHTROJMË

49

Vazhdohet njëjtë edhe me rrathët me ngjyrë të kuqe (5 · 4 = 20), rrathët me ngjyrë të kaltër (8 · 4 = 32), rrathët me ngjyrë portokalli (10 · 5 = 50).
Sa saksi me lule janë? (4);
Sa lule ka një saksi? (3);
Sa lule janë gjithsej? (4 · 3 = 12);
Vazhdohet njëjtë edhe me saksitë e tjera (4 · 2 = 8, 4 ·1 = 4).

Hapi 3: Detyra 2 (faqe 48) – Plotësohet tabela: rreshti i parë – gjej shumën (4 + 5 = 9; 5 + 5 = 10), rreshti i dytë – gjej prodhimin (5 · 4 = 20; 5 · 5 = 25).
Detyra 3 (faqe 48) – Gjej faktorin për të fituar barazi të sakta.

Hapi 4: Detyra 3 (faqe 48) – Gjej faktorin që mungon, për të fituar barazi të sakta.

Detyra 4 (faqe 48) – Krahaso numrat e dhënë, prodhimin e numrave (6 · 2 < 15).

Detyra 2 (faqe 49) – Gjej prodhimin e numrave të dhënë.

Hapi 5: Lexohen problemet me fjalë dhe zgjidhen ato.

(Detyra 5, faqe 48 – 4 · 5 € = 20 €).

(Detyra 3, faqe 49 – 7 · 4kg = 28 kg).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e gjetjes së prodhimit të numrave.

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 48); Detyra 3 dhe 4 (faqe 49).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 122

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike. Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie;
Gjen prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton figurën simetrike me figurën e dhënë;
- Njehson prodhimin e numrave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Balona.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.



Faktori i parë	3	5	7		3	7	7	5		
Faktori i dytë			3	6			5		8	2
Prodhimi	15	10		24	24	28		50	40	18

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Zhvillohet me nxënës lojë me balona. Në secilën balonë duhet shënuar nga një detyrë me shumëzim (3•5; 4•2; 3•9; 5•5; 6•4 etj.). Kërkohet nga nxënësit të formojnë një rreth dhe balonat lëshohen në drejtim lart. Ata mundohen të marrin nga një balonë. Secili nxënës që merr balonën lexon detyrën që është shënuar aty dhe tregon prodhimin (p.sh. 3•5=15). Loja përsëritet disa herë duke u dhënë mundësi të gjithë nxënësve të marrin balonë dhe të njehsojnë nga një detyrë.

Hapi 2: Shfaqen para nxënësve disa figura simetrike dhe josimetrike (modeli në foto), të cilat vizatohen në tabelë ose paraqiten me projektor. Kërkohet nga nxënësit të tregojnë se cilat figura janë simetrike, si dhe të tregojnë drejtëzën e simetrisë për secilën figurë.



PËRSËRISIM

1 Vizatojmë dhe ngjyrosim figurën simetrike me figurën e dhënë, në lidhje me drejtëzën e dhënë.

drejtëza e simetrisë drejtëza e simetrisë drejtëza e simetrisë

2 Mjellma është 8 vjeçe, kurse vëllai i saj Lisi është dy herë më i madh për nga mosha. Sa vjeç është Lisi?

Njehsojmë: 2 • ___ = ___.

Përgjigjja: _____.

3 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

Faktori i parë	3	5	7		3	7	7	5		
Faktori i dytë			3	6			5		8	2
Prodhimi	15	10		24	24	28		50	40	18

4 Ngjyrosim balonat me numra, me të cilët mund të formohen barazi me shumëzim.

2 • 10 = 20

50

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat në libër.
Detyra 1. Të vizatojnë figurën simetrike me figurën e dhënë.
Detyra 2. Të zgjidhin problemin e shprehur me fjalë dhe të japin përgjigjen.
Detyra 3. Të plotësojnë tabelën duke njehsuar prodhimin e numrave.

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet që të vëzhgojnë detyrën 4 dhe të formojnë barazimet me prodhim në bazë të numrave të paraqitur në balona në detyrën në libër. Barazimet i shkruajnë në fletore.

Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin e figurës simetrike dhe për njehsimin e prodhimit.

Detyrë:
Formon 5 barazime me prodhim të numrave dhe vizaton një figurë simetrike.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 123

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zbaton mbledhjen, zbritjen, mbledhjen, zbritjen, shumëzimin;
Gjen zgjidhjen e barazimeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.1,2, III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2;2.1; 3.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton drejtëzën e simetrisë;
- Gjen zgjidhjet për të cilat barazimi është i saktë;
- Plotëson tabelat me dy veprime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: U shpërndahen nxënësve fletëza dhe u kërkohet t'i vizatojnë figurat simetrike ndaj drejtëzës së dhënë.



Hapi 2: Nxënësit vëzhgojnë dhe punojnë detyrën 1. Diskutohen pyetjet: Cilin veprim matematikor kemi? Si quhet numri i parë? Si quhet numri i dytë? (E panjohura X). Çka fitojmë? (Shumën). Si duhet zgjidhur barazimi? (E panjohura qëndron në njërën anë të barazimit dhe të njohurat në anën tjetër të barazimit). Vazhdohet me pyetje të ngjashme edhe për shembujt e tjerë.



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 2, në libër. Parashtrohen pyetjet:–Sa veprime matematikore kemi? (Shumëzim, mbledhje dhe zbritje). -Çfarë duhet të bëjmë këtu?

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet të punojnë të pavarur detyrën 3 në libër.

Hapi 5: Udhëzohen të punojnë detyrën 4, në libër, ndërsa boshti numerik shkruhet në tabelë. Diskutohen këto pyetje: -Cilin veprim matematikor ka barazimi? (Zbritjen); –Cili është numër i panjohur? (Zbritësi); -Si duhet ta gjejmë detyrën përmes boshtit? –Cila është dhjetëshja më e afërt e numrit 96? (90). -Sa duhet t'i heqim nga numri 96 që të fitojmë 90? (6). -Sa hapa duhet bërë nga numri 90 deri te numri 60? (30); - Sa duhet hequr 60, që të fitojmë ndryshimin 54? (6). (90-6=90-30=60-6=54).

Hapi 6: Nxënësve u kërkohet të punojnë detyrën 5, në libër. Në vend të figurave duhet shënuar numrat. Diskutohen pyetjet: -Sa vende janë me pica? (3); - Sa është çmimi i tri picave? (15€); - Sa euro kushton një picë? (5€); - Sa vende janë me sallatë? (3); - Sa është çmimi i tri sallatave? (12€); - Sa euro kushton një sallatë? (4€); - Dy pica kanë çmimin 10€, një sallatë ka çmimin 4€, ne duhet t'i paguajmë 17€. - Sa euro keni harxhuar? (14€); - Sa euro ju kanë mbetur? (3€). Atëherë akullorja ka çmimin 3€. Kemi 8€, dy vende me akullore kushtojnë 6€. - Sa euro kushton hamburgeri? (2€).

Hapi 7: Nxënësve u shpërndahet nga një fletë. U kërkohet të plotësojnë tabelat. E panjohura X duhet të zëvendësohet me numra. Së pari kryhet veprimi i shumëzimit, më pas kryhet mbledhja ose zbritja.

X	3	2	4	5
5·X+2				

X	4	5	6	7
3·X-3				

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë duke vizatuar drejtëzën e simetrisë dhe duke plotësuar saktë tabelat me dy veprime.

Detyrë:
Detyrat 1 dhe 2 (faqe 52).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 124

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.) për të gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Shumëzimi me faktorin 10



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin e numrave, kur njëri nga faktorët është numri 10;
- Gjen faktorin e panjohur në barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare(shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Problemë: Një libër kushton 10 euro. Sa euro kushtojnë dy libra?
Nxënësve u jepet hapësirë të zgjidhin problemën në mënyrë të pavarur. Pastaj u shpjegohet fakti se kur shumëzohet një numër me 10, shtohet një zero në fund të atij numri.
Shembull: 2 x 10

Dhjetëshe	Njëshe	
	2	
2	0	2 x 10 = 20

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë balonat e zbrazëta me numrat që u përgji-



gjen atyre në boshtin numerik. Pastaj pyeten:

- Cilën rregull keni zbatuar për plotësimin e balonave të zbrazëta?

Detyra 2: Nxënësit analizojnë figurat dhe plotësojnë barazitë. Pastaj pyeten:

- Sa dhjetëcentësha shihni në shembullin e parë? 10c + 10c, 2 dhjetëcentësha.

Nxënësve u kërkohet që të paraqesin si shumë dhe prodhim, pra si 10c +10c =20 dhe si 2 x 10c = 20c

- Sa dhjetëcentësha shihni në shembullin e dytë? 10c + 10c + 10c + 10c, 4 dhjetëcentësha.

Zgjidhja e kërkesës paraqitet si shumë dhe prodhim, pra: 10c + 10c + 10c + 10c = 40c dhe 4 x 10c = 40c, vazhdohet me pyetje të ngjashme edhe për shembujt e mbetur të detyrës.

Hapi 3: Detyra 3: Shpjegohet shumëzimi me numrin 10.
Detyra 4: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fushat e zbrazëta me faktorin që mungon.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të prodhimit të numrave me numrin 10, gjetjen e faktorit që mungon në barazimet e dhëna.

Detyrë:
Shkruan 5 barazime ku do të njehsojë prodhimin e numrave me faktorin 10.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 125

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes së numrave si dhe shumëzimit të numrave deri në 100;
- Gjen prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II. 2; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.3; 6.4.


USHTROJMË

1 Numrat e dhënë i renditim në boshtin numerik.

10, 30, 50, 90, 70, 60, 40, 80, 20, 100

0 30

2 Njehsojmë:

2 • 10 = 1 • 10 = 10 • 10 = 10 • 5 =
3 • 10 = 5 • 10 = 9 • 10 = 10 • 6 =
4 • 10 = 6 • 10 = 8 • 10 = 7 • 10 =

3 Paraardhësin e numrit 9 e rrisim 10 herë. Cili numër merret?

Paraardhësi i numrit 9 është numri ____.
Njehsojmë: ____ • ____ = ____.
Pra, merret numri ____.

4 Të njehsojmë:

3 • 10 + 7 = 30 + 7 = 37
7 • 10 + 9 = ___ + ___ = ___
6 • 10 + 5 = ___ + ___ = ___
4 • 10 – 6 = ___ – ___ = ___
5 • 10 – 8 = ___ – ___ = ___
7 • 10 – 5 = ___ – ___ = ___

5 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

X	1	2	3	4	5	6	7	8	9
X • 10 + 3									

54

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy numrave ku njëri faktor është 10;
- Zbaton prodhimin e numrave në detyra me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë boshtin numerik në detyrën 1 në libër. Bisedohet me ta:

- Cili numër është i paraqitur në boshtin numerik?
- Si duhet të bëjmë renditjen e numrave të tjerë? Pse?

Gjithashtu nxënësve u kërkohet të plotësojnë kutitë duke renditur numrat dhe të lexojnë numrat e renditur.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë prodhimet në detyrën 2 në libër.

2 x 10 = ☐



USHTROJMË

1 Numrat e dhënë i renditim në boshtin numerik.

10 30 50 90 70 60 40 80 20 100

0 30

2 Njehsojmë:

2 • 10 = 1 • 10 = 10 • 10 = 10 • 5 =
3 • 10 = 5 • 10 = 9 • 10 = 10 • 6 =
4 • 10 = 6 • 10 = 8 • 10 = 7 • 10 =

3 Paraardhësin e numrit 9 e rrisim 10 herë. Cili numër merret?

Paraardhësi i numrit 9 është numri ____.
Njehsojmë: ____ • ____ = ____.
Pra, merret numri ____.

4 Të njehsojmë:

3 • 10 + 7 = 30 + 7 = 37
7 • 10 + 9 = ___ + ___ = ___
6 • 10 + 5 = ___ + ___ = ___
4 • 10 – 6 = ___ – ___ = ___
5 • 10 – 8 = ___ – ___ = ___
7 • 10 – 5 = ___ – ___ = ___

5 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

X	1	2	3	4	5	6	7	8	9
X • 10 + 3									

54

Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet që ata të lexojnë kërkesën e detyrës 3.

- Cili është paraardhësi i numrit 9? (8);
- Cili është numri 10 herë më i madh se pararadhësi i numrit? (80, sepse 8·10=80).

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë prodhimin e numrave në detyrën 4.

✓ U sqarohet që në një barazim ku ka mbledhje dhe shumëzim ose zbritje dhe shumëzim, shumëzimi duhet të njehsohet në fillim.

VEPRIMTARI SHTESË:
Nxënësve u kërkohet që të bashkohen në dyshe dhe dyshet e formuara të zgjidhin problemin:

- Një laps kushton 10 centë. Sa kushtojnë 4, 6, 3 dhe 5 lapsa?

✓ Nxënësit i paraqesin zgjidhjet e bëra.

VEPRIMTARI SHTESË - Për ta bërë mësimin më tërheqës dhe për të mësuar përmes lojës, mund të shikohet kjo video dhe të përsëritet tabela e shumëzimit me faktorin 10.

https://www.youtube.com/watch?v=VlVJhAIruCc

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin dhe zbatimin e prodhimit të numrave me faktorin 10.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 54).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 126

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor strategji të ndryshme (*mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.*) për të gjetur prodhimin e numrave (*prodhimi ≤ 50*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.1, 3, 6.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
0 dhe 1 si faktorë



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin e numrave me faktorët 0 dhe 1

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me figura.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketat me grupe figurash (ose vizatohen në tabelë).
- Sa kolona me katrorë janë? (5) (trekëndësha – 3; drejtkëndëshi portokalli 0);
- Sa rreshta me katrorë janë? (1) (trekëndësha – 1; drejtkëndëshi portokalli 1);
- Si e shënojmë si prodhim? (5 · 1 = 5) (3 · 1 = 3) (0 · 1 = 0).

Hapi 2: Vështrohen figurat e dhëna në detyrën e parë.
- Sa pjata janë me mollë? (1)
- Sa molla janë në pjatë? (4)



- Sa molla janë gjithsej? (1 · 4 = 4)
- Sa pjata janë? (1)
- Sa molla janë në pjatë? (0)
- Sa molla janë gjithsej? (1 · 0 = 0)

Kështu vazhdohet edhe me shembujt e tjerë. Shënohen rezultatet.

Lexohen rregullat e shumëzimit me faktorin 0 dhe 1 (rregullat mund të shënohen në fletë dhe të vendosen në një kënd të klasës).

Hapi 3: Detyra 2 – Njehsohet prodhimi i numrave të dhënë. Barazimet lexohen nga nxënësit.

Hapi 4: Nxënësit në mënyrë individuale gjejnë prodhimin e numrave.

2 · 1 =	7 · 2 =	0 · 10 =	1 · 9 =	6 · 3 =
5 · 0 =	1 · 4 =	4 · 3 =	1 · 1 =	8 · 0 =

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për sakësinë në llogaritjen e prodhimit të numrave me faktorin 0 dhe 1.

Detyrë:
Shkruan pesë barazime me faktorin 0 dhe pesë barazime me faktorin 1.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 127

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1; 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin e numrave me faktorët zero dhe një.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra 1-100, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.


USHTROJMË

1 Të njehsojmë:

1 + 1 + 1 = 3 • 1 = ☐
1 + 1 + 1 + 1 + 1 + 1 = ☐ • ☐ = ☐
1 + 1 + 1 + 1 + 1 + 1 + 1 = ☐ • ☐ = ☐

4 • 1 = 1 + 1 + 1 + 1 = ☐
5 • 1 = _____ = ☐
8 • 1 = _____ = ☐

2 Shkruajmë barazime me shumëzim.

Njehsojmë dhe plotësojmë:

3 < = > ?

4 • 1 ◯ 1 • 4 0 • 1 ◯ 1 • 0 10 • 1 ◯ 12 + 0
3 • 5 ◯ 5 • 1 8 • 0 ◯ 0 • 8 7 • 0 ◯ 17 + 0
2 • 0 ◯ 1 • 1 3 • 1 ◯ 0 • 4 1 • 6 ◯ 7 • 0

4 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

a	6	12	9	7	5	3	2	20	10	50	33	40
1 • a												
a • 1												

56

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me numra nga 0 deri 100. U kërkohet atyre që të tregojnë etiketën, numri i së cilës tregon prodhimin e numrave të shfaqur në projektor (ose në tabelë), p.sh. 2·0; 1·6; 0· 8; 3·4 etj.
Aktiviteti përsëritet disa herë. Në raste të rezultateve jo të sakta, përsëritet detyra në mënyrë që nxënësit të orientohen te rezultati i saktë.

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet që t'i shprehin si prodhim shumat e mbledhorëve të barabartë:
1+1= 1+1+1+1+1= 1+1+1+1= 1+1+1=
1+1+1+1+1+1+1= 1+1+1+1+1+1+1+1+1+1=

Hapi 3: Udhëzohen ata t'i plotësjnë detyrat në libër.
Detyra 1. Nxënësit të shprehin si prodhim shumën e mbledhorëve të barabartë dhe anasjelltas.
Detyra 2. Nxënësit t'i plotësojnë kutizat në modelet e dhëna duke shkruar barazime me prodhim



USHTROJMË

1 Të njehsojmë:

1 + 1 + 1 = 3 • 1 = ☐
1 + 1 + 1 + 1 + 1 + 1 = ☐ • ☐ = ☐
1 + 1 + 1 + 1 + 1 + 1 + 1 = ☐ • ☐ = ☐

4 • 1 = 1 + 1 + 1 + 1 = ☐
5 • 1 = _____ = ☐
8 • 1 = _____ = ☐

2 Shkruajmë barazime me shumëzim.

Njehsojmë dhe plotësojmë:

3 < = > ?

4 • 1 ○ 1 • 4 | 0 • 1 ○ 1 • 0 | 10 • 1 ○ 12 + 0
3 • 5 ○ 5 • 1 | 8 • 0 ○ 0 • 8 | 7 • 0 ○ 17 + 0
2 • 0 ○ 1 • 1 | 3 • 1 ○ 0 • 4 | 1 • 6 ○ 7 • 0

4 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën.

a	6	12	9	7	5	3	2	20	10	50	33	40
1 • a												
a • 1												

56

dhe duke njehsuar prodhimin. 3• 0=0; 5•0=0 etj.
Detyra 3. Nxënësit të njehsojnë prodhimet dhe të krahasojnë ato duke vendosur shenjën: >,< ose =.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen fletë pune si model (ose në mungesë të fletëve paraqitet në tabelë modeli) dhe u kërkohet t'i plotësojnë fletët dhe në fletore t'i formojnë barazimet e shumëzimit me faktorin 0 dhe 1 p.sh., 2• 0=0; 3• 1=3 etj.).



Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në llogaritjen e saktë të prodhimit të numrave me faktorët 0 dhe 1.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 56).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 128

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Shumëzimi me faktorin 6

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy numrave ku njëri faktor është 6;
- Zbaton prodhimin e numrave në detyra me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurën në detyrën 1 në libër dhe u parashtrohen pyetje të tilla, si: Çfarë po shihni? (Boshtin numerik); Dy balonat e para, cilët numra mbajnë? (6,12); Si duhet ta bëjmë renditjen e numrave të tjerë?; Cila është ajo renditje? (Duhet rritur nga 6).

Nxënësve u kërkohet të përcaktojnë vlerën e balonave varësisht prej shigjetës së vendosur në bosht.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen t'i analizojnë figurat dhe të plotësojnë detyrën 2 në libër. Diskutohet me ata: Sa vende janë me balona? (1); Një vend sa balona ka?(6); Si shënohet barazimi (1·6=6).

Sa vende janë me libra? (6); Një vend sa libra ka ?(6); Si shënohet barazimi? (6·6=36).
Sa vende janë me kube? (6); Një kub sa pika të kuqe ka? (7); Si shënohet barazimi? (6·7=42).



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur ku duhet njehsuar prodhimin e numrave në detyrën 4.
6·4=□

Hapi 4: U kërkohet të bashkohen në dyshe dhe dyshet e formuara ta zgjidhin problemin:
- Në një raft ka nga 6 libra. Sa libra janë në 5, 8, 9, 3 dhe 4 rafte?

VEPRIMTARI SHTESË:
Për të mësuar përmes lojës mund të shikohet kjo video dhe ta përsëritet tabela e shumëzimit me faktorin 6.

https://www.youtube.com/watch?v=X6veF-fX_cFw

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e saktë ku njëri prej faktorëve është 6.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 57).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 129

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.) për të gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.12, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Shumëzimi me faktorin 7



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin e numrave kur njëri nga faktorët është 7.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë paraqitet shprehja 7 x 5, dhe pyeten nxënësit:
- Si mund ta gjejmë prodhimin e numrave 7 dhe 5?
- Si i quajmë kufizat që marrin pjesë në prodhim? (Faktor).

U shpjegohet se shumëzimi është mënyra më e shpejtë për të mbledhur një numër disa herë.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurën në detyrë dhe pyeten:

- Çfarë po shihni? (Boshtin numerik);
- Cilën rregull duhet të ndjekim për t'i plotësuar balonat e zbrazëta? (Duhet rritur me nga 7).

Më pas udhëzohen që t'i plotësojnë balonat me numra, që u përgjigjen atyre në bosht numerik.



Hapi 3: Detyra 2: Nxënësve u kërkohet që pasi të kenë numëruar grupet e pesëkëndëshave (secili grup mban 7 pesëkëndësha), të plotësojnë fushat e zbrazëta. Pyeten ata:



- Sa pesëkëndësha pëmban një grup? (7 pesëkëndësha);
- Sa grupe ka në figurën e parë? (4 grupe me nga shtatë pesëkëndësha);
- Sa pesëkëndësha kemi gjithsej? (28 pesëkëndësha);
- Si paraqitet si shumë e mbledhorëve të barabartë? (7+7+7+7);
- Si paraqitet si prodhim i dy faktorëve? (4 grupe me nga 7 pesëkëndësha, 7x4).

Hapi 4: Detyra 3: Në tabelë, nxënësve u sqarohet shumëzimi me 7.
Detyra 4: Nxënësit udhëzohen që të gjejnë prodhimin e numrave ku njëri nga faktorët është 7.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e prodhimit të numrave kur njëri nga faktorët është 7.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 58).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 130

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes së numrave, si dhe shumëzimit të numrave deri në 100;
Gjen prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II. 2; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3; 3.3; 6.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë



1 Njehsojmë dhe plotësojmë:

18 = 3 • 6 24 = ___ • 6 49 = 7 • 7 63 = ___ • 7
36 = ___ • 6 42 = ___ • 6 56 = ___ • 7 70 = ___ • 7
60 = ___ • 6 30 = ___ • 6 35 = ___ • 7 28 = ___ • 7

2 Problema të shprehura me fjalë:

1. Njehsojmë prodhimin e numrit më të madh njëshifror me numrin 7.
Numri më i madh njëshifror është numri ___.
Njehsojmë: ___ • ___ = ___.

2. Endrita është 6 herë më e vjetër se vëllai i saj. Sa vjeçe është Endrita, nëse vëllai i saj është 3 vjeç?
Njehsojmë: ___ • ___ = ___.
Përgjigjja: Endrita është ___ vjeçe.

3. Nëse në një pako janë 5 lëngje qershie. Sa lëngje janë në 6 pako dhe sa në 7 pako?
Njehsojmë: 6 • ___ = ___.
7 • ___ = ___.
Pra, në 6 pako janë ___ lëngje, kurse në 7 pako janë ___ lëngje.

3 Të njehsojmë:

7 • 2 – 9 = 14 – ___ = ___ 6 • 4 – 8 = ___ – ___ = ___
7 • 4 + 9 = ___ + ___ = ___ 6 • 7 + 8 = ___ + ___ = ___
7 • 5 – 7 = ___ – ___ = ___ 6 • 8 – 8 = ___ – ___ = ___.

4 Plotësojmë tabelat:

X	1	2	3	4	5	6
6 • X – 5	1				25	

X	1	2	3	4	5	6
7 • X + 3	10				38	

USHTROJMË

59

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy numrave ku njëri faktor është 6 ose 7;
- Zbaton prodhimin e numrave në detyra me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 1 në libër dhe të gjejnë faktorin që mungon.
Bisedohet me ta:

18 = ☐ x 3 → Nëse prodhimi është 18 dhe njëri faktor është 6, sa është faktori tjetër?

Më pas, nga nxënësit kërkohet të rikujtojnë tabelën e shumëzimit me 6 dhe 7; gjithashtu udhëzohen që të vazhdojnë t'i plotësojnë detyrat e tjera.

Hapi 2: Nxënësit lexojnë problemet e shprehura me fjalë në detyrën 2 në libër.

Për mësuesin/en



1 Njehsojmë dhe plotësojmë:

18 = 3 • 6 24 = ☐ • 6 49 = 7 • 7 63 = ☐ • 7
36 = ☐ • 6 42 = ☐ • 6 56 = ☐ • 7 70 = ☐ • 7
60 = ☐ • 6 30 = ☐ • 6 35 = ☐ • 7 28 = ☐ • 7

2 Problema të shprehura me fjalë:

1. Njehsojmë prodhimin e numrit më të madh njëshifror me numrin 7.
Numri më i madh njëshifror është numri ___.
Njehsojmë: ___ • ___ = ___.

2. Endrita është 6 herë më e vjetër se vëllai i saj. Sa vjeçe është Endrita, nëse vëllai i saj është 3 vjeç?
Njehsojmë: ___ • ___ = ___.
Përgjigjja: Endrita është ___ vjeçe.

3. Nëse në një pako janë 5 lëngje qershie. Sa lëngje janë në 6 pako dhe sa në 7 pako?
Njehsojmë: 6 • ___ = ___.
7 • ___ = ___.
Pra, në 6 pako janë ___lëngje, kurse në 7 pako janë ___lëngje.

3 Të njehsojmë:

7 • 2 − 9 = 14 − ___ = ___ 6 • 4 − 8 = ___ − ___ = ___
7 • 4 + 9 = ___ + ___ = ___ 6 • 7 + 8 = ___ + ___ = ___
7 • 5 − 7 = ___ − ___ = ___ 6 • 8 − 8 = ___ − ___ = ___.

4 Plotësojmë tabelat:

X	1	2	3	4	5	6
6 • X − 5	1				25	

X	1	2	3	4	5	6
7 • X + 3	10				38	

USHTROJMË

59

Bisedohet për kërkesën e problemit të parë:

Njehsojmë prodhimin e numrit më të madh njëshifror me numrin 7.

- Cili është nnumri më i madh njëshifror? (9)
- Sa është prodhimi i numrit më të madh njëshifror me numrin 7? (63).

Nxënësit zgjidhin të pavarur problemet e tjera.

Hapi 3: Udhëzohen të njehsojnë detyrat me dy veprime. U rikujtohet atyre që veprimi i shumëzimit kryhet i pari.

Hapi 4: Nxënësit e plotësojnë detyrën 4 në çifte, njëri e plotëson tabelën e parë, kurse tjetri të dytën.

x	1	2	3	4	5	6
6 • x - 5	1				25	

VEPRIMTARI SHTESË:

1. Nxënësve u shpërndahen etiketa me numrat: 6, 12, 18, 24, 30, 36, 42, 48, 54, 60, 7, 14, 21, 28, 35, 42, 49, 56, 63, 70 dhe u kërkohet të ngrenë lart etiketën e cila tregon prodhimin e numrave që u thuhet nxënësve, p.sh. 5·6 (30), 7·9 (63). Kështu vazhdohet edhe me prodhimet e tjera.
2. Për ta bërë mësimin më tërheqës dhe për të mësuar përmes lojës mund të shikohet kjo video dhe të përsëritet tabela e shumëzimit me faktorët 6 dhe 7:

https://www.youtube.com/watch?v=IL4Lx-xXCAw

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin dhe zbatimin e prodhimit të numrave me faktorët 6 dhe 7.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 131

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përdor strategji të ndryshme (mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.) për të gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 3.1, 3, 6.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi me faktorin 8

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin e numrave me faktorin 8.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë shënohet vargu: Zbulo rregullën e vargut!
8 – 16 – 24 – 32 – 40 – 48 – 56 – 64 – 72 – 80
Nxënësit i japin përgjigjet e tyre, secili numër që vjen rritet për 8.

$8 = 1 \cdot 8 = 8$
$8 + 8 = 2 \cdot 8 = 16$
$8 + 8 + 8 = 3 \cdot 8 = 24$
$8 + 8 + 8 + 8 = 4 \cdot 8 = 32$
$8 + 8 + 8 + 8 + 8 = 5 \cdot 8 = 40$
$8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 = 6 \cdot 8 = 48$
$8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 = 7 \cdot 8 = 56$

$8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 = 8 \cdot 8 = 64$
$8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 = 9 \cdot 8 = 72$
$8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 + 8 = 10 \cdot 8 = 80$

Hapi 2: Vështrohet boshti numerik dhe plotësohen balonat me numrin që u përgjigjet.
Detyra 2 – Vështrohen figurat:

- Sa rreshta me kapela janë? (4) (5);
- Sa kapela ka një rresht? (8) (8);
- Sa kapela janë gjithsej? (4 · 8 = 32) (5 · 8 = 40).

Hapi 3: Detyra 3 – Komentohet tabela.
Numri 8 – sa tetëshe ka? (1), numri 16 – sa tetëshe ka? (2),
numri 24 – sa tetëshe ka? (3), numri 32 – sa tetëshe ka? (4),
numri 40 – sa tetëshe ka? (5), numri 48 – sa tetëshe ka? (6),
numri 56 – sa tetëshe ka? (7), numri 64 – sa tetëshe ka? (8),
numri 72 – sa tetëshe ka? (9), numri 80 – sa tetëshe ka? (10).

Hapi 4: Lexohet kërkesa e detyrës, e rritim numrin për 8 herë (·), e zvogëlojmë numrin për 8 (–).

	E rritim 8 herë		E zvogëlojmë për 8	
5	5 · 8	40	40 - 8	32
6	6 · 8	48	48 - 8	40
7	7 · 8	56	56 - 8	48
8	8 · 8	64	64 - 8	56
9	9 · 8	72	72 - 8	64

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e prodhimit të numrave me faktorin 8.

Detyrë:
Shkruan pesë barazime, duke u bazuar në detyrën e 4 (faqe 60).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 132

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1;3.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi me faktorin 9

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin e dy faktorëve ku njëri faktor është 9.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve situata problemore: Nxënësit e klasës së dytë kanë organizuar piknik në natyrë. Ata kanë marrë me vete 4 shporta me pako me ushqime. Secila shportë ka 9 pako me ushqime. Sa pako me ushqime ka në 4 shportat?

Shënohen në tabelë përgjigjet dhe zgjidhjet që tregojnë nxënësit.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen ta vëzhgojnë figurën në detyrën 1 dhe bisedohet me ata: Çfarë po shihni në figurë? (Boshtin numerik); Cilët numra janë paraqitur në dy balonat e parë në boshtin numerik? (9,18); A duhet në balonat e tjerë të shkruajmë numra sipas një rregulle? (Po); Cila është rregulla për të plotësuar numrat e tjerë me balona ? (Duhet rritur me nga 9).

U kërkohet të plotësojnë balonat me numrat e caktuar.



Detyra 2. Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë rreshtimet e paraqitura në figurat e dhëna, të numërojnë dhe të plotësojnë barazimet.

Detyra 3. Sqarohet tabela e shumëzimit me faktorin 9. Tregohen faktorët dhe prodhimi.

Hapi 3: Pyeten nxënësit: Numri 9 sa nëntëshe ka? (1). Kërkohet ta paraqesin si prodhim të faktorëve (1 · 9=9). Numri 18 sa nëntëshe ka? (2). Kërkohet ta paraqesin si prodhim (2 · 9 = 18). Vazhdohet me numra të tjerë: 27, 36 etj.

Nxënësit formojnë në fletore barazimet e prodhimit me njërin faktor 9 dhe i njehsojnë ato.

Barazimet e njehsuara kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e prodhimit me faktorin 9.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 61).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 133

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes së numrave, si dhe shumëzimit të numrave deri në 100;
Gjen prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,II.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2; 2.1, 2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen prodhimin me faktorët 8 dhe 9;
- Njehson prodhimin e numrave me faktorët 8 dhe 9;
- Plotëson tabelën me dy veprime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të punojnë në dyshe dhe ta zgjidhin problemin: - *Ana ka 8 mollë, kurse Petriti ka 6 herë më shumë molla se Ana.* Bisedohet me nxënësit: - Kur kemi fjalën herë, cilin veprim matematikor kemi? (Shumëzimin). - Si do të shënohet barazimi? (8·6=__); - Po nëse Ana ka ka 9 mollë dhe Petriti ka 6 herë më shumë mollë se Ana, si do ta shënoni barazimin? (9·6=___). - Ku dallojnë këto barazi? (Te faktori i parë).

Hapi 2: U kërkohet t'i analizojnë figurat në detyrën 1 në libër dhe t'i plotësojnë barazimet. Pyeten



ata: Sa vende kemi me rrathë? (6); Një vend sa rrathë ka? (9); Si duhet shkruar barazimi? (6·9=___).

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur duke i plotësuar barazimet në detyrën 2, për të gjetur faktorin që mungon. Diskutohet: Nëse prodhimi është 80 dhe njëri faktor është 8, sa është faktori që mungon?

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet të plotësojnë detyrën 3 në libër për të gjetur prodhimin dhe për t'i krahasur prodhimet.
*Sqarohet: Së pari kryhet shumëzimi pastaj vendosen shenjat <, >, =.

Hapi 5: Nxënësit punojnë detyrën 5. Diskutohen këto pyetje: Kur themi e rritim kaq herë, cilin veprim matematikor kemi? (Shumëzimin). Kur themi e rritim për një numër, cili veprim matematikor kemi? (Mbledhjen). 5 · 9 = 45 + 8 = 53

Hapi 6: Kërkohet nga nxënësit që në dyshe ta plotësojnë tabelën.

X	1	3	6	7	8	9
X·8+2						
X·9+3						

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e saktë të prodhimit të numrave me faktorët 8 dhe 9.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 62).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 134

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri në 100;
Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3.6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen veprime matematikore me numrat e dhënë në libër;
- Gjen faktorin që mungon në barazimet e dhëna;
- Krahason rezultatet e detyrave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë, zare.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit do të zhvillojnë një aktivitet në dyshe. Një fletë paloset në gjysmë, pastaj e palosin edhe dy herë të tjera. Kur hapet fleta, duken tetë hapësira. Në secilën hapësirë shkruhet një numër nga një deri në nëntë. Njëri nxënës hedh zarin me numra nga 1 – 6, nxënësi tjetër shkruan numrin në kutinë e parë, duke gjetur prodhimin e numrit që është në kuti me numrin që ka rënë nga hedhja e zarit. Vazhdon veprimtaria duke këmbyer rolet, derisa të plotësohen të gjitha kutizat në fletë. Lojën e fiton dyshja e cila e mbaron më shpejt/saktë plotësimin e të gjitha hapësirave. Shembull:

6 x 2 = 12	6	8	2
3	6	5	7



Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që në mënyrë të pavaruar të llogarisin prodhimin e numrave të dhënë, duke lidhur pastaj rezultatin e fituar me gjethen që u përgjigjet.

Detyra 2: Nxënësit gjejnë faktorin që mungon në barazimet e dhëna.

Detyra 3: Llogarisin prodhimin e numrave të dhënë më pas gjejnë dy çifte numrash të tjerë që japin po të njëjtin prodhim. Shembull:
3x6 =18 → 18 = 2x9; 4x6=24 → 24 = 3x8;

Hapi 3: Detyra 4: Kryejnë veprime matematikore (zbritje dhe shumëzim) me numrat e dhënë për të gjetur sa gjatë mund të jetojë lepuri.

Detyra 5: Vlerën e shprehjes me numra e shkruajnë si prodhim i dy numrave.

Detyra 6: Llogarisin vlerën e shprehjes së dhënë dhe më pas i krahasojnë rezultatet e tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e detyrave me dy veprime, gjetjen e faktorit që mungon në barazimet e dhëna, krahasimin e rezultateve të detyrave.

Detyrë:
Detyrat 7 dhe 8 (faqe 64).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 135

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Gjen prodhimin e numrave;
- Zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II. 2; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3; 3.3; 6.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbatojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehsojnë prodhimin e numrave;
- Formojnë barazi me shumëzim.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Top, ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Bashkë me nxënësit formohet një rreth. Merret një top, i cili i hedhet njërit prej nxënësve dhe po të njëjtit nxënës i parashtrohet një detyrë (pyetje) me prodhim të numrave: p.sh., 4 • 5 = …
Pastaj ai nxënës ia gjuan topin një nxënësi tjetër dhe ia parashtron një pyetje. Kështu vazhdon edhe me të tjerët.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen që të njehsojnë dhe të ngjyrosin me ngjyrat përkatëse fushat me zgjedhje në detyrën 1.



Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet që në detyrën 2 të shkruajnë faktorët e numrit të dhënë.



Bisedohet me nxënësit:

- Cilët faktorë duhet të shumëzohen që të fitohet numri 12?
- Po për të fituar prodhimet: 40, 16, 14, 30, 24; cilët numra duhet të shumëzohen?

Hapi 4: U kërkohet të formojnë barazi të sakta me shumëzim në fletoret e tyre me këta numra.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin dhe formimin e barazive të sakta me shumëzim.

Detyrë:
Formon 5 barazi me shumëzim.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 136

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Identifikon shprehjet: faktorët, prodhimin, të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin e numrave natyrorë deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2.III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1.



•	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2	2	4	6	8	10	12	14	16	18	20
3	3	6	9	12	15	18	21	24	27	30
4	4	8	12	16	20	24	28	32	36	40
5	5	10	15	20	25	30	35	40	45	50
6	6	12	18	24	30	36	42	48	54	60
7	7	14	21	28	35	42	49	56	63	70
8	8	16	24	32	40	48	56	64	72	80
9	9	18	27	36	45	54	63	72	81	90
10	10	20	30	40	50	60	70	80	90	100

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Tabela e shumëzimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton kufizat e shumëzimit;
- Gjen prodhimet me faktorë të ndryshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa, laptop, internet.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me barazime me dy faktorë (p.sh., 4•5 =; 3•6 =; etj.) dhe disa të tjerëve etiketa me numra që janë prodhime të barazimeve nga etiketat. U kërkohet të lëvizin në klasë dhe të gjejnë prodhimin (duke u bashkuar me nxënësin që ka etiketën me numrin që shpreh prodhimin). P.sh.:

4 • 5 =	20

Hapi 2: Zhvillohen me nxënësit lojëra për njehsimin e prodhimit. Lojërat mund të organizohen nga linqet:

https://www.mathsisfun.com/timestable.html



•	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2	2	4	6	8	10	12	14	16	18	20
3	3	6	9	12	15	18	21	24	27	30
4	4	8	12	16	20	24	28	32	36	40
5	5	10	15	20	25	30	35	40	45	50
6	6	12	18	24	30	36	42	48	54	60
7	7	14	21	28	35	42	49	56	63	70
8	8	16	24	32	40	48	56	64	72	80
9	9	18	27	36	45	54	63	72	81	90
10	10	20	30	40	50	60	70	80	90	100

https://www.timestables.com/1-times-table.html.

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë detyrën 1 dhe të tregojnë faktorët dhe prodhimin. Nxiten të emërtojnë kufizat e shumëzimit duke përmendur fjalët *faktor* dhe *prodhim*.

Paraqitet para nxënësve modeli i tabelës së shumëzimit i përgatitur si modeli që është në libër dhe zhvillohen ushtrime për gjetjen e prodhimit. Pra, kërkohet të gjenë prodhimin aty ku priten faktorët në rreshta dhe shtylla.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen që, duke përdorur tabelën e shumëzimit, të formojnë nga dhjetë barazime me prodhimin e numrave.

Pasi t'i formojnë barazimet, kërkohet t'i emërtojnë kufizat: faktor dhe prodhim.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e prodhimit dhe emërtimin e kufizave të shumëzimit

Detyrë:
Formon disa barazime me prodhimin e numrave.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 137

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Shumëfishon numrat njëshifrorë

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,II.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëfishi i një numri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan shumëfishat e numrave të dhënë;
- Gjen shumëfishin e përbashkët të numrave të ndryshëm;
- Krijon situata të thjeshta problemore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve të ndarë në grupe u shpërndahen fletët dhe u kërkohet t'i shkruajnë numrat sipas kërkesave të dhëna.
Grupi 1: Shkruani numrat nga 3 deri në 30, duke shtuar nga 3. Grupi 2: Shkruani numrat nga 5 deri në 50, duke shtuar nga 5. Grupi 3: Shkruani numrat nga 6 deri në 60, duke shtuar nga 6. Grupi 4: Shkruani numrat nga 8 deri në 80, duke shtuar nga 8.
Pas përfundimit i lexojnë rezultatet dhe fletët i vënë në tabelë.

Hapi 2: Nga nxënësit kërkohet ta plotësojnë detyrën 1 në libër, dhe më pas të lexohen kërkesat. Pyeten ata: Sa vende me sheqerka kemi? Një vend sa sheqerka ka? Si shënohet barazimi? (3·3=9); Numri 9 sa herë është më i madh se numri 3? (3 herë); Trefishi i cilit numër është numri 9? (3). (4·3=12).



1 Njehsojmë dhe plotësojmë:

1 • 3 = 3 | 3 • ☐ = ☐ | 4 • ☐ = ☐ | ☐ • ☐ = 15

Numri 9 është ___ herë më i madh se numri ___. | Numri ___ është ___ herë më i madh se numri ___. | Numri ___ është ___ herë më i madh se numri ___.

Numri 9 është trefishi i numrit ___. | Numri 12 është katërfishi i numrit ___. | Numri 15 është pesëfishi i numrit ___.

2 Shënojmë shumëfishat e numrave.

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Është shumëfish i numrit 2.				✓									
Është shumëfish i numrit 5.										✓			

	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
Është shumëfish i numrit 2.													
Është shumëfish i numrit 5.													

Shkruajmë shumëfishat e përbashkët të numrave 2 dhe 5: _____.

3 Vesa është 5 vjeçe, kurse nëna e saj është 6 herë më e vjetër se ajo. Sa vjeçe është nëna e Vesës?

Njehsojmë: ___ • ___ = ___.

Përgjigjja: Nëna e Vesës është ___ vjeçe.

SHUMËFISHI I NJË NUMRI

MËSOJMË

67

Numri 12 është 4 herë më i madh se numri 3	Numri 12 është katërfishi i numrit 12

Hapi 3: Nxënësit në dyshe i gjejnë shumëfishat e numrave që tregojnë shumëfishat e përbashkët mes numrave 2 dhe 5, dhe numrave 3 dhe 5. Ftohen nxënësit t'i gjejnë shumëfishat e përbashkët, duke i shënuar me ngjyrë të kuqe dhe të kaltër.

Pas plotësimit, dyshet i lexojnë detyrat dhe bëhen korrigjimet e nevojshme.

Hapi 4: Nxënësve të ndarë në dyshe u shpërndahen fletët. Kërkohet të bëjnë zgjidhjen e problemit:
Arta kishte 50€, kurse motra e saj kishte 2 herë më shumë se ajo. Sa euro kishte e motra?
Njehsojmë: 50€·2=100€
Përgjigjja: Motra e Artës kishte 100 €.

VEPRIMTARI SHTESË:
Kërkohet nga nxënësit të krijojnë një problemë të ngjashme me fjalë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e shumëfishit të përbashkët të numrave të ndryshëm dhe për krijimin e problemeve të thjeshta.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 67).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 138

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Krahason një numër me një tjetër për sa është më i madh dhe sa herë më i madh.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Kuptimet: për sa më i madh dhe sa herë më i madh


KUPTIMET: PËR SA MË I MADH DHE SA HERË MË I MADH

MËSOJMË

1 Kush ka më shumë topa?

Artani ka ___ topa. Anita ka ___ topa. Lisi ka ___ topa.

Duke analizuar figurat, mund të themi:
Anita ka 3 herë më shumë topa se Artani, sepse 3 • 4 = ___.
Lisi ka 3 topa më shumë se Artani, sepse 3 + 4 = ___.

Lisi ka 7 topa. Numri 7 është për 3 më i madh se numri 4.

4 —(për 3 më shumë / + 3)→ 7

Anita ka 12 topa. Numri 12 është 3 herë më i madh se numri 4.

4 —(3 herë më shumë / • 3)→ 12

2 Përshkruajmë me fjalë barazitë:

3 • ___ = 12
Numri ___ është 3 herë më i madh se numri 4.
Numri ___ është 4 herë më i madh se numri 3.
Numri ___ është trefishi i numrit 4.
Numri ___ është katërfishi i numrit 3.

5 + 4 = ___
Numri ___ është për 4 më i madh se numri 5.
Numri ___ është për 5 më i madh se numri 4.

3 Anjesa është 5 vjeçe. Nëna e saj është 7 herë më e vjetër, kurse vëllai, Besiani, është 4 vjet më i vjetër se Anjesa. Sa vjeçe është nëna e Anjesës dhe sa vëllai, Besiani?

Njehsojmë: ___ • 5 = ___.
___ + 4 = ___.

Përgjigjja: Nëna e Anjesës është ___ vjeçe, kurse vëllai, Besiani, është ___vjeç.

68

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Krahason numrat për sa është më i madh dhe sa herë më i madh.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të vështrojnë figurat në detyrën 1 dhe të bëjnë plotësimet e nevojshme duke përdorur shprehjet " herë më shumë " e " më shumë ". Pyeten:
- Sa topa ka Artani? (4 topa); Po Anita? (12 topa).
- Sa herë numri 12 është më i madh se numri 4? (3 herë); Për sa numri 12 është më i madh se numri 4? (Për 8).

Nxënësve u sqarohen kuptimet: për sa më i madh dhe sa herë më i madh.

Hapi 2: Klasa ndahet në grupe me nga katër nxënës. Nxënësit me numër 1 do të zgjidhin problemën numër 1. Në këtë mënyrë nxënësit me nr. 2, 3 dhe 4 do të zgjidhin problemat me nr. 2, 3 dhe 4. Pasi zgjidhin problemat sipas kësaj ndarjeje, ata do të grupohen në këtë mënyrë: nxë-nësit me nr. 1 do të grupohen në një tavolinë, nxënësit me nr. 2 në një tavolinë tjetër. Nxënësit e secilit


KUPTIMET: PËR SA MË I MADH DHE SA HERË MË I MADH

1 Kush ka më shumë topa?

Artani ka ___ topa. Anita ka ___ topa. Lisi ka ___ topa.

Duke analizuar figurat, mund të themi:
Anita ka 3 herë më shumë topa se Artani, sepse 3 • 4 = ___.
Lisi ka 3 topa më shumë se Artani, sepse 3 + 4 = ___.

Lisi ka 7 topa. Numri 7 është për 3 më i madh se numri 4.

4 —(për 3 më shumë / + 3)→ 7

Anita ka 12 topa. Numri 12 është 3 herë më i madh se numri 4.

4 —(3 herë më shumë / • 3)→ 12

2 Përshkruajmë me fjalë barazitë:

3 • ___ = 12
Numri ___ është 3 herë më i madh se numri 4.
Numri ___ është 4 herë më i madh se numri 3.
Numri ___ është trefishi i numrit 4.
Numri ___ është katërfishi i numrit 3.

5 + 4 = ___
Numri ___ është për 4 më i madh se numri 5.
Numri ___ është për 5 më i madh se numri 4.

3 Anjesa është 5 vjeçe. Nëna e saj është 7 herë më e vjetër, kurse vëllai, Besiani, është 4 vjet më i vjetër se Anjesa. Sa vjeçe është nëna e Anjesës dhe sa vëllai, Besiani?

Njehsojmë: ___ • 5 = ___.
___ + 4 = ___.

Përgjigjja: Nëna e Anjesës është ___ vjeçe, kurse vëllai, Besiani, është ___vjeç.

MËSOJMË

68

Hapi 3: Detyra 2: Nxënësit në mënyrë të pavarur zgjidhin në libër barazitë e dhëna.

grup, p.sh.: njëshat do të diskutojnë në lidhje me zgjidhjen e problemës nr. 1. Më poshtë paraqitet zgjidhja e problemës nr. 3. Në të njëjtën mënyrë zgjidhen të gjitha problemat. Pas zgjidhjes së tyre, nxënësit kthehen në grupet fillestare. Secili prej tyre argumenton mënyrën e zgjidhjes së problemave nga nr. 1 deri në nr. 4. Në përfundim, diskutohet me të gjithë klasën për mënyrën e zgjidhjes së problemave.

Të dhënat/kërkesa	Zgjidhja
1. Mali ka 2 topa. Era ka 4 herë topa më shumë se Mali. Sa topa ka Era?	1. 2x4=8, Era ka 8 topa.
2. Lisi ka 7 libra. Anita ka 3 libra më shumë. Sa libra ka Anita?	2. 7+3=10, Anita ka 10 libra.
3. Anjesa është 5 vjeç. Nëna e Anjesës është 7 herë më e vjetër se Anjesa. Sa vjet ka nëna e Anjesës?	3. 5x7=35, nëna e Anjesës ka 35 vjet.
4. Vesa është 5 vjeç. Lisi është për tri vjet më i madh se Vesa. Sa vjet ka Lisi?	4. 5 +3=8, Lisi ka 8 vjet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e numrave (sa më i madh dhe sa herë më i madh).

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 68).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 139

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Shumëfishon numrat njëshifrorë dhe krijon vargje numerike (≤ 50);
- Demonstron shkathtësi dhe shprehi për zgjidhje të problemave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; II. 2, 8; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3; 3. 4.



1 Ta zgjidhim problemën:

	7 herë më i madh		për 7 më i madh	
5	→		→	
6	→		→	
7	→		→	
8	→		→	
9	→	63	→	70

2 1. Shkruajmë shumëfishat e numrit 7, të cilët janë më të vegjël se 53.

2. Shkruajmë shumëfishat e numrit 8, të cilët janë më të vegjël se 75.

3 Plotësojmë tabelën.

Numri	5	6	7	8	9	10
5 herë më i madh	25					
Për 5 më i madh	10					
Për 5 më i vogël	0					

4 Numrin, i cili është për 2 më i madh se numri 7, e rritim 7 herë. Cili numër fitohet?

Njehsojmë: _____

_____

Përgjigjja: Fitohet numri ____.

5 Hana i ka 5 balona, Zana ka 3 herë më shumë balona se Hana dhe Erseni ka 6 balona më shumë se Zana. Sa balona i ka Zana dhe sa Erseni?

Zana i ka: ___ • ___ = ___ balona.
Erseni i ka: ___ + ___ = ___ balona.

Përgjigjja: Zana i ka ____ balona, kurse Erseni ____ balona.

USHTROJMË

69

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton kuptimet *për sa më i madh* dhe *sa herë më i madh;*
- Krahason numrat *për sa është më i madh* dhe *sa herë më i madh;*
- Zgjidh problemat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë me tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen fletë me tabela dhe u kërkohet t'i bëjnë plotësimet dhe t'i gjejnë zgjidhjet në çifte.
Pas plotësimit diskutohet bashkë me nxënësit për zgjidhjet e detyrave.

	4	5	6	7
3 herë më i madh				
3 më i madh				

Për mësuesin/en



1 Ta zgjidhim problemën:

	7 herë më i madh		për 7 më i madh	
5	→		→	
6	→		→	
7	→		→	
8	→		→	
9	→	63	→	70

2 1. Shkruajmë shumëfishat e numrit 7, të cilët janë më të vegjël se 53.

2. Shkruajmë shumëfishat e numrit 8, të cilët janë më të vegjël se 75.

3 Plotësojmë tabelën.

Numri	5	6	7	8	9	10
5 herë më i madh	25					
Për 5 më i madh	10					
Për 5 më i vogël	0					

4 Numrin, i cili është për 2 më i madh se numri 7, e rritim 7 herë. Cili numër fitohet?

Njehsojmë: _____

_____

Përgjigjja: Fitohet numri _____.

5 Hana i ka 5 balona, Zana ka 3 herë më shumë balona se Hana dhe Erseni ka 6 balona më shumë se Zana. Sa balona i ka Zana dhe sa Erseni?

Zana i ka: ___ • ___ = ___ balona.

Erseni i ka: ___ + ___ = ___ balona.

Përgjigjja: Zana i ka _____ balona, kurse Erseni _____ balona.

USHTROJMË

69

Hapi 2: Analizohet detyra 1 dhe plotësohet në dyshe. Pas plotësimit dyshet e nxënësve i lexojnë zgjidhjet.

Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet të numërojnë 1 dhe 2. Ata që kanë numrin 1, zgjidhin shembullin 1 dhe nxënësit që kanë numrin 2, zgjidhin shembullin 2 të detyrës 2.

✓ Pas përfundimit ia arsyetojnë njëri-tjetrit zgjidhjet.

Hapi 4: Nxënësit zgjidhin individualisht detyrën 3 dhe e plotësojnë tabelën, e më pas i krahasojnë zgjidhjet me shokun e bankës.

Hapi 5: Bashkë me nxënësit plotësohen detyrat 4 dhe 5, e më pas diskutohen përgjigjet e detyrave.

VEPRIMTARI SHTESË:
Kërkohet nga nxënësit në grup të krijojnë tabela të ngjashme me ato të detyrës 3, duke përdorur fjalët: "herë më shumë", "më shumë" dhe "më pak".

Grupet i prezantojnë detyrat.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e numrave "për sa më i madh" dhe "për sa herë më i madh" dhe zgjidhjen e problemave.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 140

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë; Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përdor strategji të ndryshme (*mbledhjen e përsëritur, rreshtimet etj.*) për të gjetur prodhimin e numrave (prodhimi ≤ 50);
- Ngjyros figurën simetrike dhe krijon figura simetrie.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.2, III. 5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4; 3.3, 4, 5, 6.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton figurat simetrike;
- Njehson shumën, ndryshimin dhe prodhimin e numrave;
- Zgjidh problemet me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësi shënon emrin e vet, me shkronja të mëdha në fletë.
Gjen cilat shkronja janë simetrike? Vizaton drejtëzën e simetrisë. (E L I N A)

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vështrojnë figurat e dhëna në detyrën e parë, dhe të vizatojnë dhe ngjyrosin figurat simetrike.



Hapi 3: Lexohen kërkesat e detyrës së dytë, dhe shënohen barazitë.
1) $7 \cdot 6 = 42$ – Numri 7 herë më i madh se numri 6, është numri 42.
2) $8 \cdot 3 = 24$ – Numri 8 herë më i madh se numri 3, është numri 24.

Detyra tre: Zëvendëson frutat me numra.

🍐	8	🍓	1

Hapi 4: Detyra 4 – Njehson prodhimin dhe ndryshimin e numrave.

Hapi 5: Plotëson piramidën duke kryer veprimin e mbledhjes dhe të zbritjes. (9 + 6 = 15; 7 – 6 = 1)



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të shumës, ndryshimit dhe prodhimit të numrave, vizatimin e figurave simetrike, zgjidhjen e problemeve.

Detyrë:
Formulon 5 detyra sikurse në detyrën 2 (faqe 70).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 141

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përdor vetinë komutative dhe asociative për të gjetur shumën dhe prodhimin e numrave.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III. 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1; 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Shoqërimi i faktorëve (vetitë e shumëzimit)



Njësia mësimore:
Shoqërimi i faktorëve (vetitë e shumëzimit)

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson prodhimin duke zbatuar vetinë e shoqërimit të faktorëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura, kube.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten para nxënësve modele me kube si në foto.
Zhvillohet bisedë me nxënësit rreth modeleve të përgatitura dhe u kërkohet të tregojnë se çfarë shohin. Si është bërë renditja e kubeve në dy rastet? Zhvillohen ushtrime të ngjashme me kube.



Hapi 2: Paraqiten në tabelë barazimet: (4•2) • 3=
4•(2 • 3)=
Plotësohen së bashku me nxënësit dy barazimet dhe sqarohet vetia e shoqërimit të faktorëve.

Për mësuesin/en



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë figurat dhe barazimet në detyrën 1 dhe kërkohet nga ata të tregojnë numrin e gotave në të dyja rastet.

Nxënësit e plotësojnë detyrën 2 dhe tregojnë si i kanë plotësuar barazimet.

Për konkretizim mund të paraqitet edhe videoja nga linku në vijim:
https://www.youtube.com/watch?v=g2b6bkN_LBs

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahen nga tri etiketa me numra (faktorë) dhe kërkohet të formojnë barazime duke zbatuar vetinë e shoqërimit të faktorëve dhe të njehsojnë prodhimin. P.sh.

3	4	5

(3•4) • 5=
3•(4 • 5)=

Detyrat e plotësuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të prodhimit duke zbatuar vetinë e shoqërimit të faktorëve.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 71).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 142

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,II.1,2,III. 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2 ,3;2.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Radha e veprimeve + dhe ·

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Shkruan detyra me dy veprime (+ dhe ·) sipas radhës;
- Zgjidh detyra sipas radhës së veprimeve;
- Plotëson tabelën me dy veprime (+ dhe ·).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.


RADHA E VEPRIMEVE + DHE ·

MËSOJMË

1 Sa pemë janë në kopsht?

shuma
5 + 3 · 4
mbledhori i parë, mbledhori i dytë

5 + 3 · 4 = ?

Përshkruajmë: Në anën e majtë të shtëpizës janë 5 pemë, kurse në të djathtën janë 3 rreshta me nga 4 pemë.
3 · 4 = 12
5 + 12 = 17
Shkruajmë: 5 + ___ · ___ = 5 + ___ = ___ pemë.

Në detyrat me më shumë veprime, kur nuk përdoren kllapat, në fillim kryejmë shumëzimin e pastaj mbledhjen dhe zbritjen.
5 · 4 + 28 = ___ + ___ = ___
18 + 6 · 5 = ___ + ___ = ___
6 · 7 – 28 = ___ – ___ = ___
88 – 8 · 7 = ___ – ___ = ___

1. Mbledhori i parë është 37, kurse i dyti prodhimi i numrave 7 dhe 6. Njehsojmë shumën.
Shuma është: ___ + ___ · ___ = ___ + ___ = ___.

2. Mbledhori i parë është prodhimi i numrave 8 dhe 6, kurse mbledhori i dytë 28. Njehsojmë shumën.
Shuma është: ___ · ___ + ___ = ___ + ___ = ___.

2 Të njehsojmë: sa këmbë kanë së bashku 3 mace dhe 1 zog?
Njehsojmë: _____
Përgjigjja: _____

72

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Gjatë kryerjes së dy veprimeve matematikore, rëndësi të veçantë i kushtohet radhës së veprimeve.
Vizatohen në tabelë:



Bisedohet me nxënësit: -Sa kolona kemi me zemra? -Sa rreshta? –Po sa rrathë janë? -Si shënohet barazimi? (4·2+3).
*Së pari kryhet shumëzimi pastaj mbledhja (4·2+3=8+3=11).

*Sqarim: Asnjëherë nuk kryhet mbedhja dhe pastaj shumëzimi.


RADHA E VEPRIMEVE + DHE •
MËSOJMË
1 Sa pemë janë në kopsht?
shuma
5 + 3 • 4
mbledhori i parë
mbledhori i dytë
5 + 3 • 4 = ?
Përshkruajmë: Në anën e majtë të shtëpizës janë 5 pemë, kurse në të djathtën janë 3 rreshta me nga 4 pemë.
3 • 4 = 12
5 + 12 = 17
Shkruajmë: 5 + ___ • ___ = 5 + ___ = ___ pemë.
Në detyrat me më shumë veprime, kur nuk përdoren kllapat, në fillim kryejmë shumëzimin e pastaj mbledhjen dhe zbritjen.
5 • 4 + 28 = ___ + ___ = ___
18 + 6 • 5 = ___ + ___ = ___
6 • 7 – 28 = ___ – ___ = ___
88 – 8 • 7 = ___ – ___ = ___
1. Mbledhori i parë është 37, kurse i dyti prodhimi i numrave 7 dhe 6. Njehsojmë shumën.
Shuma është: ___ + ___ • ___ = ___ + ___ = ___.
2. Mbledhori i parë është prodhimi i numrave 8 dhe 6, kurse mbledhori i dytë 28. Njehsojmë shumën.
Shuma është: ___ • ___ + ___ = ___ + ___ = ___.
2 Të njehsojmë: sa këmbë kanë së bashku 3 mace dhe 1 zog?
Njehsojmë: _____
Përgjigjja: _____
72

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet ta analizojnë figurën e dhënë në detyrën 1 dhe të bëhen plotësimet e kërkuara. Nxiten të përmendin fjalët *mbledhori i parë, mbledhori i dytë, prodhimi i numrave, rradha e veprimeve.*

5·4+28=20+28=48
18+6·5=18+30=48
6·7-28=42-28=14
88-8·7=88-56=32

Hapi 3: Nxënësit punojnë detyrën 1: Diskutohen këto pyetje: Sa është mbledhori i parë? (37); Sa është mbledhori i dytë? (Prodhimi i numrave 7 dhe 6); Si shënohet barazimi? (37+7·6=37+42=79).

Hapi 4: Nxënësve në grupe u shpërndahen fletë A4. U kërkohet t'i plotësojnë saktë zgjidhjet e barazimit.

3·7+34=
80-5·6=
8·6-28=
56-5·7=
37+6·6=

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e detyrave me dy veprime (+ dhe ·) sipas radhës.

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 72).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 143

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (shumën, ndryshimin dhe prodhimin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2,III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.3,1.4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Zgjidh detyrat sipas radhës së veprimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë shkruhet shprehja 6 + 4 x 3 =…. dhe nga nxënësit kërkohet të gjejnë zgjidhjen. U jepet hapësirë të gjejnë zgjidhjen dhe më pas diskutohet për zgjidhjen e saktë duke sqaruar radhën e veprimeve gjatë zgjidhjes së detyrave.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që të zgjidhin kërkesat e detyrës duke respektuar radhën e veprimeve.

6x8 + 32 = 48 + 32 = 80, pra u sqarohet se shumëzimi në secilin rast kryhet përpara mbledhjes.

Njëjtë veprohet edhe me detyrën e dytë.



1 Të njehsojmë:

6 • 8 + 32 = □ 9 • 8 + 28 = □ 9 • 7 − 52 = □
5 • 9 + 12 = □ 9 • 9 − 12 = □ 5 • 8 − 26 = □
3 • 6 + 41 = □ 2 • 7 + 55 = □ 4 • 8 − 32 = □

2 Të njehsojmë:

7 • 8 − 28 = □ − □ = □ 78 − 6 • 5 = □ − □ = □
6 • 7 − 11 = □ − □ = □ 87 − 7 • 7 = □ − □ = □
9 • 6 − 22 = □ − □ = □ 38 − 4 • 3 = □ − □ = □

3 1. I zbritshmi është 75, kurse zbritësi është prodhimi i numrave 7 dhe 8. Njehsojmë ndryshimin.
Ndryshimi është: ___ − ___ • ___ = ___ − ___ = □.

2. I zbritshmi është prodhimi i numrave 6 dhe 9, kurse zbritësi 46. Njehsojmë ndryshimin.
Ndryshimi është: ___ • ___ − ___ = ___ − ___ = □.

4 Të njehsojmë:

9 • 6 − 23 = □ 8 • 6 − 33 = □ 6 • 7 − 42 = □
7 • 5 − 21 = □ 9 • 7 − 34 = □ 5 • 7 − 26 = □
75 − 6 • 6 = □ 48 − 7 • 4 = □ 68 − 6 • 7 = □

5 Analizojmë figurat, njehsojmë dhe plotësojmë.

□ → 4 € △ → 2 €

12 € □ € □ € □ € □ € □ € □ €

USHTROJMË

73

Hapi 3: Detyra 3: Nxënësit në mënyrë të pavarur njehsojnë ndryshimin e shprehjes, duke kryer shumëzimin e 7x8 :
75 – 7x8 = 75 – 56 = 19

Më pas pyeten:

- Cili quhet numri 75 në shprehjen 75 – 7x8? (I zbritshmi);
- Po numri 56? (Zbritësi);
- Si quhet numri 19? (Ndryshim).

Hapi 4: Detyra 4: Nxënësit llogarisin ndryshimin e shprehjeve të dhëna duke respektuar radhën e veprimeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e detyrave sipas radhës së veprimeve.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 73).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 144

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Zbaton mbledhjen dhe shumëzimin në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 1; II. 2, 8; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4; 3.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i shumës


SHUMËZIMI I SHUMËS

1 Sa balona janë?

4 • (2 + 3) = ?

2 + 3 = 5
4 • 5 = 20
Shkruajmë: 4 • (2 + 3) = 4 • 5 = 20

Gjatë njehsimit të vlerës numerike të një shprehjeje, në fillim, njehsojmë atë që ndodhet brenda kllapave, pastaj kryejmë veprimet e tjera.

5 • (2 + 6) = 5 • 8 = 40
(2 + 4) • (9 − 5) = 6 • 4 = 24
3 • (7 − 2) = 3 • 5 = 15

2 Të njehsojmë:

6 • (1 + 3) = ___ • 4 = ☐ 7 • (3 + ___) = ___ • 5 = ☐
6 • 1 + 6 • 3 = ___ + ___ = ☐ 7 • 3 + 7 • 2 = ___ + ___ = ☐

3 Në 6 kuti janë nga 2 shkumësa të kuq dhe nga 7 të gjelbër. Sa shkumësa janë në 6 kuti?

Njehsojmë: ___ • (___ + ___) = ___ • ___ = ___.
Përgjigjja: Në 6 kuti janë ___shkumësa.

4 Të njehsojmë: sa këmbë kanë së bashku 2 mace dhe 3 zogj.

Njehsojmë: _____
Përgjigjja: _____

MËSOJMË

74

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen shumëzimin e numrave me dy mbledhorët brenda kllapave;
- Analizon dhe zgjidh situata të thjeshta problemore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë të përgatitura.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen në grup fletë të përgatitura me detyra si më poshtë dhe kërkohet të gjejnë zgjidhjet dhe të krahasojnë barazimet mes vete.

3 x 2 + 3 =	3 x (2 + 3) =

Një përfaqësues i secilit grup lexon zgjidhjet dhe diskuton rreth tyre. Të pranohen të gjitha zgjidhjet e mundshme dhe më pas të diskutohet për zgjidhjen e saktë duke sqaruar radhën e veprimeve dhe përdorimin e kllapave.

Bisedohet me nxënësit:
- Cili është dallimi mes këtyre dy barazimeve?
- Pse nuk është rezultati i njëjtë?



5 Sa trekëndësha janë?

6 • 3 = | 3 • 3 =

Trekëndësha të kuq janë 6 • 3. Trekëndësha të kaltër janë 3 • 3. Gjithsej trekëndësha janë:

6 • 3 + 3 • 3 = ___ + ___ = ___

(6 + 3) • 3 =

Janë 6 shtylla me nga 3 trekëndësha të kuq dhe 3 shtylla me nga 3 trekëndësha të kaltër. Pra, janë 6 + 3 shtylla me nga 3 trekëndësha. Gjithsej trekëndësha janë:

(6 + 3) • 3 = ___ • ___ = ___

(6 + 3) • 3 = 6 • 3 + 3 • 3 ose 3 • (6 + 3) = 3 • 6 + 3 • 3

6 Të njehsojmë:

2 • 5 + 4 • 5 = (10, 20)

5 • 6 + 4 • 6 =

4 • 7 + 5 • 7 =

6 • 5 =

9 • 6 =

9 • 7 =

7 Një lodër për fëmijë kushton 15 €. Sa kushtojnë 6 lodra të tilla?

Njehsojmë: numrin 15 e shkruajmë si shumë 15 = 10 + 5.

6 • 15 = 6 • (10 + 5) = 6 • ___ + ___ • ___ = ___ + ___ = ___

Përgjigjja: 6 lodra kushtojnë ___ €.

8 Të njehsojmë:

3 • 15 =
2 • 14 =
6 • 12 =
5 • 19 =
5 • 16 =
4 • 17 =
9 • 11 =
3 • 13 =
5 • 12 =

MËSOJMË

75

- Cili veprim kryhet së pari kur nuk janë kllapat?
- Cili veprim kryhet së pari kur janë kllapat?

Bashkë me nxënësit, nga detyra e zgjidhur definohen vetitë e "Shumëzimit të shumës ".

Hapi 2: Analizohet figura e dhënë në detyrën 1 dhe përshkrimet e zgjidhjes së detyrës. Nxiten nxënësit të tregojnë se së pari kryhet veprimi brenda kllapave.

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të zgjidhin detyrat 2, 3 dhe 4 në dyshe. U sqarohet që numri jashtë kllapave shumëzohet me dy numrat brenda kllapave: 3 x (4 + 5) = (3 x 4) + (3 x 5). Pas zgjidhjes ia arsyetojnë njëri - tjetrit zgjidhjet dhe një çift i nxënësve i lexon detyrat më zë.

Hapi 4: Udhëzohen që të analizojnë figurat dhe të zbulojnë se sa trekëndësha janë. U kërkohet të zgjidhin detyrën në dy mënyra.

(6 + 3) •3 = 6 • 3 + 3 • 3 ose 3 • (6 + 3) = 3 • 6 + 3 • 3

Hapi 5: Nxënësit njehsojnë dhe plotësojnë detyrat 6 dhe 7. Në detyrën 7 udhëzohen që të lexojnë me vëmendje kërkesën e detyrës dhe të njehsojnë se sa kanë kushtuar lodrat.

VEPRIMTARI SHTESË:
Nga nxënësit kërkohet që në grup të krijojnë detyra me fjalë të ngjashme me detyrën 3 në libër. Grupet i prezantojnë detyrat dhe diskutojnë rreth tyre.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në shumëzimin e shumës dhe zgjidhjen e detyrave.

Detyrë:
Detyra 8 (faqe 75).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 145

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (*shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 2.1, 3.3, 4, 5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shumëzimi i ndryshimit


SHUMËZIMI I NDRYSHIMIT

1 Sa trekëndësha kanë mbetur?

9 – 4 = ☐ 9 – 4 = ☐ 9 – 4 = ☐

Largojmë nga 4 trekëndësha në çdo bashkësi. Në çdo bashkësi kanë mbetur nga 9 - 4 trekëndësha. Numri i trekëndëshave të mbetur është:

3 • (9 – 4) = ___ • ___ = ___.

Ndryshe: në tri bashkësitë ishin 3 · 9 trekëndësha. Janë larguar 3 · 4 trekëndësha. Numri i trekëndëshave të mbetur është:

3 • 9 – 3 • 4 = ___ – ___ = ___.

3 • (9 – 4) = 3 • 9 – 3 • 4 ose (9 – 4) • 3 = 9 • 3 – 4 • 3

2 Duke zbatuar rregullën për shumëzimin e ndryshimit, njehsojmë prodhimin në dy mënyra.

7 • (8 – 2) = ___ • ___ = ___.

7 • (8 – 2) = ___ • 8 – 7 • ___ = ___ – ___ = ___.

8 • (6 – 3) = _____

8 • (6 – 3) = _____

3 Njehsojmë dhe plotësojmë:

4 • 10 3 • 2 + 5 • 10 6 • 3 –

4 Merita, në kopshtin e saj, i mbolli 6 rreshta me nga 7 lule. Pas një kohe, në secilin rresht, u thanë nga 2 lule. Sa lule kanë mbetur në kopshtin e Meritës?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Në kopshtin e Meritës kanë mbetur ____lule.

MËSOJMË

76

Njësia mësimore: Shumëzimi i ndryshimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson rezultatin e shprehjeve me dy veprime (· dhe -) duke respektuar radhën e veprimeve;
- Zgjidh problema me fjalë;
- Formulon problem me fjalë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet që të formojnë grupe me nga 6 nxënës dhe secili nxënës të marrë nga 4 ngjyra.
Më pas secili i largon nga 2 ngjyra.
Udhëzohen nxënësit që në fletë të shkruajnë barazimet dhe të gjejnë zgjidhjet. 6 · (4 – 2) = 6 · 2 = 12; 6 · (4 – 2) = 6 · 4 – 6 · 2 = 24 – 12 = 12

Sa nxënës jeni në grup? Sa ngjyra kishit në fillim? Sa i hoqët?

Hapi 2: Vështrohen figurat e dhëna në detyrën 1.
- Sa bashkësi me trekëndësha janë? (3);
- Sa trekëndësha ka një bashkësi? (9);
- Nga sa trekëndësha janë larguar nga secila bashkësi? (4).



Diskutohen mënyrat e llogaritjes së barazimeve.

Detyra 2 – Llogaritet vlera e shprehjeve në dy mënyra, duke kryer së pari veprimin brenda kllapave dhe duke zbatuar vetinë e shpërndarjes.

$7 \cdot (8 - 2) = 7 \cdot 6 = 42$
$7 \cdot (8 - 2) = 7 \cdot 8 - 7 \cdot 2 = 56 - 14 = 42$

Hapi 3: Nxënësit në mënyrë individuale lexojnë detyrën e katërt dhe gjejnë zgjidhjen e saj. $6 \cdot (7 - 2) = 6 \cdot 7 - 6 \cdot 2 = 42 - 12 = 30$ (Në kopshtin e Meritës kanë mbetur 30 lule).

Hapi 4: Formulojnë një problem me fjalë, duke u bazuar në detyrën e katërt.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e detyrave me dy veprime, zgjidhjen dhe formulimin e problemave.

Detyrë:
Njehson rezultatin në dy mënyra: a) $4 \cdot (5 - 1)$;
b) $9 \cdot (6 - 3)$.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 146

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (*shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1;3.1;3.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson detyra me dy veprime;
- Respekton radhën e veprimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


1 Analizojmë figurat dhe njehsojmë.

3 • (3 + ___) = ___ • ___ = ___

4 • (1 + ___) = ___ • ___ = ___

2 Analizojmë figurat dhe njehsojmë.

2 • (6 – ___) = ___ • ___ = ___

4 • (4 – ___) = ___ • ___ = ___

3 Njehsojmë:

4 • (3 + 5) = _____
5 • (2 + 4) = _____
2 • (9 – 2) = _____

4 Njehsojmë:

5 • 3 + 8 • 4 = _____
9 • 7 – 3 • 2 = _____
8 • 4 – 7 • 3 = _____

5 Njehsojmë:

1. Shumën e numrave 4 dhe 3 e rritim 8 herë.
_____
2. Ndryshimin e numrave 12 dhe 3 e rritim 7 herë.
_____

USHTROJMË

77

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten para nxënësve detyrat:
- Shumën e numrave 2 dhe 4 rrite 5 herë.
- Ndryshimin e numrave 12 dhe 8 rrite 6 herë.

U kërkohet të formojnë barazimet për zgjidhjen e këtyre detyrave.
Barazimet janë: 5• (2+4)=
6• (12-8)=

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të plotësjnë detyrat në libër:
Detyra 1. Të analizojnë figurat dhe të njehsojnë. Parashtrohen pyetje për nxënës:
Sa rreshta me balona janë? (3).



USHTROJMË

6 Nëse një libër kushton 12 €, sa kushtojnë 5 libra?

5 libra kushtojnë: 5 • 12 €.

Njehsojmë: Numrin 12 e shkruajmë si shumë të dy numrave: 12 = 10 + 2.

5 • 12 = 5 • (10 + 2) = _____

Përgjigjja: 5 libra kushtojnë ____ €.

7 Një vizore është e gjatë 15 cm. Sa është gjatësia e 5 vizoreve të vendosura njëra pas tjerës?

Njehsojmë: 5 • (10 + 5) = _____

Përgjigjja: Gjatësia e 5 vizoreve të vendosura njëra pas tjetrës është ___ cm.

8 Njehsojmë prodhimet me diagram.

5 • 16 = ☐

16 + 10 +6 •5 50 +30 + 80

4 • 17 = ☐

17 + 10 •4 +

7 • 14 = ☐

14 + •7 +

6 • 15 = ☐

15 + •6 +

9 Njehsojmë dhe plotësojmë:

8 • 9 + ☐ = 90 6 • 5 + ☐ = 50 4 • 3 + ☐ = 40

9 • 7 – ☐ = 60 8 • 8 – ☐ = 40 5 • 4 – ☐ = 10

10 Të shkruajmë numrin i cili është 9 herë më i madh se ndryshimi i numrave 23 dhe 16.

Njehsojmë: _____

78

Sa balona të kuq dhe të gjelbër ka në secilin rresht? (3+4).

Si mund të gjejmë numrin e balonave?

3• (3+4)=

Vazhdohet në të njëjtën mënyrë për shembullin tjetër.

Detyra 2. Kërkohet nga nxënësit të analizojnë figurën dhe të njehsojnë. Parashtrohen pyetje:

Sa bashkësi me balona janë? (2); Sa balona ka secila bashkësi? (6); Nga sa balona janë larguar prej secilës bashkësi? (3);

Si mund të gjejmë numrin e balonave të mbetur?

2• (6-3)=

Vazhdohet në të njëjtën mënyrë me shembullin tjetër në detyrën 2.

Detyrat 3 dhe 4. Nxënësit udhëzohen të njehsojnë detyrat duke respektuar radhën e veprimeve.

Kërkohet nga nxënësit që të lexojnë detyrat e shprehura me fjalë në detyrën 5, të formojnë barazimet dhe të njehsojnë.

Detyrat 6 dhe 7. Nxënësit udhëzohen të lexojnë problemet e shprehura me fjalë, të njehsojnë dhe të japin përgjigjet.

Detyra 8. U kërkohet të plotësojnë të pavarur detyrën sipas modelit të paraqitur.

Detyra e njehsuar nga nxënësit kontrollohet dhe vlerësohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e detyrave me dy veprime dhe respektimin e radhës së veprimeve.

Detyrë:

Detyrat 9 dhe 10 (faqe 78).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 147

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (*shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,II.1,2,III. 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1,2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Analizon detyrat e dhëna në libër;
- Shkruan vlerën numerike si prodhim i dy numrave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


1 Njehsojmë dhe plotësojmë duke ndjekur radhën e veprimeve:

9 • 6 – 23 = □ 8 • 6 – 33 = □ 6 • 7 – 42 = □
7 • 5 – 21 = □ 9 • 5 – 34 = □ 5 • 7 – 26 = □
75 – 6 • 6 = □ 48 – 7 • 4 = □ 68 – 6 • 7 = □

2 Shumën e numrave 8 dhe 2 e shumëzojmë me ndryshimin e tyre. Cili numër fitohet?
Njehsojmë: (___ + ___) • (___ – ___) = ___ • ___ = ___.
Përgjigjja: Fitohet numri___.

3 Njehsojmë dhe plotësojmë:

73 = 10 • 7 + 3 38 = □ • 6 + □ 26 = □ • 4 + □
35 = 8 • 5 – □ 72 = 10 • □ – 8 37 = □ • 5 + □
54 = 5 • □ – 1 17 = 5 • 4 – 3 39 = □ + 6 • □

4 Vlerën numerike të shprehjes e shkruajmë si prodhim të dy numrave.

21 + 18 + 6 = □ • 5 64 – 30 – 9 = □ • □
29 + 18 +25 = □ • □ 98 – 40 – 2 = □ • □

5 Ta zgjidhim problemën:

9 herë më i madh	për 7 më i madh
5 →	→
6 →	→
7 →	→
8 →	→

PËRSËRISIM

79

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të punojnë detyrën 1 në libër. Pyeten ata: - Sa veprime matematikore kemi? - Çfarë duhet të bëjmë së pari? (Kryhet veprimi i shumëzimit dhe pastaj i zbresim). 9 · 6 – 23 = 31; 7· 5 – 21 = 14 ; 75-6·6=39.

Hapi 2: Nxënësit vlerësohen për saktësinë në të shkruarit dhe të punuarit e detyrës 2. Diskutohen këto pyetje: - Si duhet shënuar shuma e numrave 8 dhe 2? (8+2); - Po si duhet shënuar ndryshimi i numrave 8 dhe 2? (8-2); - Si duhet shkruar barazimi? (8+2)·(8-2)=10·6=60.

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të zgjidhin detyrën 3 në dyshe. Pas zgjidhjes i arsyetojnë ato. (35=8·5-5 , 54=5·11-1;



38=6·6+2; 72=10·8-8; 26=6·4+2; 37=7·5+2; 39=3+6·6).

Hapi 4: Nxënësit punojnë të pavarur detyrën 4. (*21+18+6= 9·5 -45)

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 5. Pyeten: - Cilin veprim matematikor kemi kur themi herë më i madh? (Shumëzimin);
- Cilin veprim matematikor kemi kur themi më i madh? (Mbledhjen).-Çfarë duhet të bëjmë? (5·9=45+7=52).

Hapi 6: Nxënësit punojnë detyrën 8. Pyeten ata: - Si duhet shënuar numrin i cili është 3 herë më i madh se numri 18? – Si duhet ta ndajmë numrin 18? (10+8). *(3·18=3·(10+8)=3·10+3·8 =30+24=54).

Hapi 7: Nxënësve u shpërndahen në dyshe fletët. Në njërën anë duhet të shkruajnë barazimin dhe ta zgjidhin, e në anën tjetër të shkruajnë me fjalë si e zgjidhën detyrën.

4 x 15 = 4x (10 + 5) = 4 x 10 + 4 x 5 = 40 + 20 = 60	Faktori i parë është 4, faktori i dytë është 15. Faktorin e dytë e zbërthej si shumë e dy mbledhorëve dhe faktorin e parë e shumëzoj me secilin mbledhor. Prodhimi është 60.



VEPRIMATRI SHTESË: Ngjyros sipas zgjidhjeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për të shkruarit e vlerës numerike si prodhim i dy numrave.

Detyrë:
Detyrat 6 dhe 7 (faqe 80).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 148

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (*shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3, 3.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbatojmë



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson vlerën e shprehjeve të përbëra numerike në libër duke respektuar radhën e veprimeve;
- Zgjidh problemat e dhëna në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Problemë: Prodhimin e numrave 3 dhe 5 rrite për 20.
Nxënësve u kërkohet që ta gjejnë zgjidhjen e problemës së dhënë. Pastaj pyeten:
- Cilat janë të dhënat e problemës?
- Çfarë kërkohet në problemë? Si mund ta gjejmë zgjidhjen? Çfarë veprimi do të përdorim?

Në tabelë shkruhet zgjidhja 3•5+20=15+20=35 .

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen që ta gjejnë vlerën e shprehjes së përbërë numerike duke respektuar radhën e veprimeve.

Detyra 2: Nxënësit, në mënyrë individuale, njehsojnë vlerën e shprehjes numerike.



Hapi 3: Detyra 3: Udhëzohen që në mënyrë të pavarur t'i zgjidhin problemat, duke zëvendësuar figurat me numra që i përgjigjen asaj. Pastaj zgjidhja e problemës diskutohet në nivel klase.

36 =

36 =

48 =

Pyeten nxënësit:

- Sa është vlera e figurës së gjelbër? Si e gjetët?
- Po vlera e figurës së kuqe dhe e figurës së verdhë?

Vlera e është 6, meqë numri 6 është i vetmi numër që kur shumëzohet me vetveten jep 36.

Vlera e është 2, ndërsa vlera e është 3.

Njëjtë veprohet edhe me problemën tjetër.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e vlerës së shprehjeve të përbëra numerike, si dhe për zgjidhjen e problemave të dhëna në libër.

Detyrë:
Krijon dy probleme të ngjashme me detyrën 3.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 149

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin;
- Gjen zgjidhjen e barazimeve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.1,2, III.1,2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2;2.1;3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson dhe i plotëson detyrat;
- Zgjidh barazimet.


VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

1 < = > ?

4 • 5 + 21 ☐ 8 • 9 – 41 — 3 • 5 + 59 ☐ 9 • 9 – 17

2 Njehsojmë dhe plotësojmë:

8 + 15 + 7 = ☐ • 5 — 88 – 35 – 8 = ☐ • 5

3 Duke i shoqëruar mbledhorët, njehsojmë.

44 + 25 + 16 + 15 = _____

4 Njehsojmë dhe plotësojmë:

	për 3 më i vogël	9 herë më i madh	për 5 më i madh
10			
8			
7		4	
5			

5 Njehsojmë dhe plotësojmë:

8 • 7 – 26 = ☐ — 10 • 6 – 35 = ☐ — 9 • 9 – 21 = ☐
8 • 5 – 23 = ☐ — 9 • 7 – 33 = ☐ — 7 • 7 – 19 = ☐
65 – 6 • 7 = ☐ — 98 – 6 • 8 = ☐ — 100 – 6 • 9 = ☐

6 Njehsojmë dhe plotësojmë:

9 • 9 + ☐ = 100 — 7 • 8 + ☐ = 80 — 7 • 9 + ☐ = 90
9 • 6 – ☐ = 20 — 8 • 9 – ☐ =30 — 5 • 8 – ☐ = 10

VLERËSOJMË

82

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që detyrat e dhëna në libër t'i plotësojnë në mënyrë të pavarur, meqënëse planifikohet vlerësimi i të kuptuarit të detyrave të mësuara.

Detyra 1- Nga nxënësit kërkohet që në detyrën 1 të njehsojnë dhe të vendosin njërën nga shenjat: <, =, >.
Diskutohen pyetjet: Sa veprime matematikore kemi?
Çfarë duhet të bëjmë këtu?

Hapi 2: Nxënësve u kërkohet të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 2. Diskutohen pyetjet:
- Cilin veprim matematikor kemi?
- Si duhet zgjidhur barazimi?



Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 3 në libër dhe, duke i shoqëruar mbledhorët, të njehsojnë.

Hapi 4: U kërkohet të njehsojnë dhe të punojnë të pavarur detyrën 4 në libër dhe të gjejnë numrat që janë: për 3 më i vogël, 9 herë më i madh dhe për 5 më i madh.

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrat 4 dhe 5 në libër. Diskutohen këto pyetje:

- Cilat veprime matematikore paraqiten në detyrat 5 dhe 6?
- Si mund ta gjejmë zgjidhjen e këtyre barazimeve?
- Cili veprim duhet të kryhet i pari në këto detyra?

Hapi 6: Detyrat e përfunduara nga nxënësit vlerësohen në mënyrë individuale dhe diskutohet zgjidhja e tyre në nivel klase.

Hapi 7: Pas vlerësimit, për t'u zbavitur, bashkë me nxënësit mund të punohet detyra 1, faqe 83. Udhëzohen të njehsojnë dhe të plotësojnë të pavarur detyrën 1 dhe t'i gjejnë emrat e vajzave me balona.

16	*90*	*49*	*42*
N	*O*	*R*	*A*

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin dhe zgjidhjen e detyrave.

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 83).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 150

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Emërton figurat gjeometrike siç është katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.7, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1, 2, 3, 4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Disa lloje të figurave gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton figurat gjeometrike (katrorin, drejtkëndëshin, trekëndëshin, rrethin);
- Dallon figurat gjeometrike;
- Analizon figurat gjeometrike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Katror, trekëndësh, drejtkëndësh dhe rreth nga letra me ngjyra; fletë ushtrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë vendosen figurat gjeometrike dhe nxënësve u kërkohet që t'i emërtojnë ato dhe të gjejnë të paktën një objekt që ngjason me figurën gjeometrike.

Katrori (dritarja) Trekëndëshi (kulmi) Drejtkëndëshi (tabela) Rrethi (ora)

Hapi 2: Detyra 1 – Emërtohen figurat gjeometrike.



Detyra 2 - Gjenden të përbashkëtat dhe dallimet e katrorit dhe të trekëndëshit.

Emërtimi: Katror	Emërtimi: Trekëndësh
figurë gjeometrike	figurë gjeometrike
katër kulme	tri brinjë
katër brinjë	tri kulme

Detyra 3 – Plotësohet vargu me figurat gjeometrike.

Hapi 3: Detyra 4 – Analizohen kafshët e ndërtuara nga figurat gjeometrike, duke iu përgjigjur pyetjeve të dhëna në tekst.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahet fletë ushtrimi, ku figurat gjeometrike i ngjyrosin me ngjyrat e caktuara (ose ndërtojnë objekte të ndryshme me figurat gjeometrike).



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin, dallimin dhe analizimin e figurave gjeometrike.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 85).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 151

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Emërton figurat gjeometrike (katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.3, III.1; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 6.1; 6.2.


DREJTKËNDËSHI DHE SIPËRFAQJA DREJTKËNDËSHE

MËSOJMË

1 Figurat në formë të drejtkëndëshit i ngjyrosim me të kuqe.

2 Drejtkëndëshi dhe sipërfaqja drejtkëndëshe.

Drejtkëndëshi

D brinja C

kulmi A këndi B

Drejtkëndëshi është një vijë e thyer e mbyllur, me kënde të barabarta, që përbëhet prej katër segmenteve.

Segmentet që e formojnë drejtkëndëshin quhen brinjë të drejtkëndëshit. I shënojmë: AB, ___, ___, ___.

Pikat e përbashkëta të brinjëve të drejtkëndëshit quhen kulme të drejtkëndëshit. I shënojmë: A, ___, ___, ___.

Këndet e drejtkëndëshit formohen nga brinjët që e kanë një kulm të përbashkët. I shënojmë: ABC, ___, ___, ___.

Sipërfaqja drejtkëndëshe

Sipërfaqja e kufizuar me drejtkëndëshin, së bashku me pikat e vijës, quhet sipërfaqe drejtkëndëshe.

Të mbajmë mend:

Brinjët e drejtkëndëshit janë dy nga dy të barabarta, d.m.th.:

$AB = CD$ dhe $BC = DA$.

86

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Drejtkëndëshi dhe sipërfaqja drejtkëndëshe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon drejtkëndëshin dhe sipërfaqen drejtkëndëshe;
- Përshkruan drejtkëndëshin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura gjeometrike (drejtkëndësh, katror etj.), internet, televizor ose projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen figura gjeometrike (katrorë, drejtkëndësha, trekëndësha dhe rrethorë). U kërkohet t'i grupojnë ato sipas formës dhe t'i emërtojnë. Parashtrohet pyetja: Cilat sende në klasë e kanë formën e figurave gjeometrike që treguat?

Hapi 2: Paraqitet para nxënësve drejtkëndëshi dhe jepet sqarim se çfarë është ai. U tregohet atyre se sa brinjë dhe kulme ka drejtkëndëshi, si janë brinjët e tij (dy nga dy brinjë të barabarta) dhe përshkruhet sipërfaqja drejtkëndëshe.



Për konkretizim mund të përdoren video nga linqet:

https://www.youtube.com/watch?v=aUYOo-XsGw-0;
https://www.youtube.com/watch?v=beS-jR7oQCcM.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë detyrat në libër.

Detyra 1. Nxënësit ngyrosin me ngjyrë të kuqe figurat në formë të drejtkëndëshit.

Detyra 2. Udhëzohen të plotësojnë detyrën, duke shënuar brinjët e drejtkëndëshit.

Hapi 4: Kërkohet nga nxënësit të vizatojnë në fletore drejtkëndëshin dhe të ngjyrosin sipërfaqen drejtkëndëshe. Pasi ta kryejnë detyrën, kërkohet nga ata të përshkruajnë drejtkëndëshin dhe të tregojnë sipërfaqen drejtkëndëshe.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përshkrimin e drejtkëndëshit.

Detyrë:
Vizaton drejtkëndëshin ose e punon me letra me ngjyra.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 152

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3, II.3,4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1;3.4;4.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Katrori dhe sipërfaqja katrore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen objekte që ngjasojnë me katror dhe drejtëkëndësh;
- Përshkruan katrorin dhe karakteristikat e tij;
- Krijon figura gjeometrike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fletë, fije shkrepëse.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë në klasë figura që u ngjasojnë me katërkëndësh. Me anë të projektorit paraqitet para nxënësve katrori. Pyeten ata: Çfarë vije është katrori? (Vijë e thyer e mbyllur); Prej sa segmentesh përbëhet?; Katrori a i ka brinjët e barabarta? Nëse e dimë gjatësinë e një brinje të katrorit, a mund t'i dimë brinjët e tjera? (Po); Me çfarë shkronje shënohen kulmet? (Të madhe të shtypit); Segmentet që e formojnë katrorin si quhen? (Brinjë). (*Brinjët i shënojmë me shkronja të vogla).

Hapi 2: Kërkohet nga nxënësit ta vëzhgojnë dhe ta punojnë detyrën 1, në libër. Udhëzohen që ta ngjyrosin me ngjyrë të kuqe formën e katrorit.



Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit që në fletore të klasës të vizatojnë një katror. Udhëzohen ta ngjyrosin atë. Pas ngjyrosjes, tregohet se pjesa e ngjyrosur quhet sipërfaqe katrore.



Hapi 4: Nxënësve në grupe u shpërndahen fletë. Kërkohet nga ta që figurat gjeometrike t'i mbushin me materiale të ndryshme, ose me fletë me ngjyra.

VEPRIMTARI SHTESË:
Nxënësit udhëzohen që me fije shkrepëse të formojnë katrorin dhe drejtkëndëshin, trekëndëshin etj. U kërkohet që t'i shënojnë kulmet.

Për të mësuar më shumë rreth katrorit, mund ta shikoni këtë video:
https://www.youtube.com/watch?v=H_xRaDQ-75A

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e figurave gjeometrike, si dhe për përshkrimin e katrorit me karakteristikat e tij.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 87).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 153

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Vizaton figura të ndryshme gjeometrike;
Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e katrorit, të drejtkëndëshit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 6.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Vizaton figurën gjeometrike të drejtkëndëshit dhe katrorit, sipas kërkesave të dhëna në libër;
- Dallon katrorin dhe drejtkëndëshin sipas vetive të tyre;
- Gjen gjatësitë e brinjëve të katrorit dhe të drejtkëndëshit duke i matur ato.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gërshërë, karton (letër e fortë), ngjyra, vizore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen që të vizatojnë figurën e katrorit dhe të drejtkëndëshit në karton dhe ta presin atë. Pastaj secili nga ta i paraqet të dhënat për këto dy figura gjeometrike në tabelën e koncepteve.

Figura gjeometrike	Brinjë		Lloji i figurës
Katrori	4 brinjë të barbarta; Brinjët përballë të barabarta dhe paralele	4 kënde të drejta	Figurë 2-përmasore e rregullt
Drejtkëndëshi	4 brinjë, 2 nga 2 para-lele dhe të barabarta	Këndi	Figurë 2-përmasore e rregullt



Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit ngjyrosin me ngjyrë të kuqe drejtkëndëshat dhe me të gjelbër katrorët.

Detyra 2: Udhëzohen që të vizatojnë drejtkëndëshin dhe katrorin me gjatësitë e brinjëve të dhëna si në figurat e dhëna në detyrë.

Njëjtë veprohet edhe me detyrën 3.

Detyra 4: Masin gjatësitë e brinjëve të katrorit dhe të drejtkëndëshit me vizore.

Hapi 3: Detyra 5: Nxënësit udhëzohen që të plotësojnë vizatimet që të marrin katrorë dhe drejtkëndësha.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në vizatimin e katrorit dhe drejtkëndëshit, dallimet ndërmjet tyre dhe për gjetjen e gjatësive të brinjëve të tyre.

Detyrë:
Detyrat 6 dhe 7 (faqe 89).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 154

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Emërton figurat gjeometrike siç është trekëndëshi;
- Përcakton brinjët, kulmet dhe këndet e trekëndëshit;
- Vizaton figura të ndryshme gjeometrike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 1, 3; III. 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3. 4; 6. 1, 2.


TREKËNDËSHI DHE SIPËRFAQJA TREKËNDËSHE

MËSOJMË

1 Figurat në formë të trekëndëshit i ngjyrosim me ngjyrë të kuqe.

2 Trekëndëshi dhe sipërfaqja trekëndëshe.

Trekëndëshi

C
brinja
kulmi
A
këndi
B

Trekëndëshi është një vijë e thyer e mbyllur që përbëhet prej tri segmenteve.

Segmentet që e formojnë trekëndëshin quhen brinjë të trekëndëshit. I shënojmë: AB, ____, ____.

Pikat e përbashkëta të brinjëve të trekëndëshit quhen kulme të trekëndëshit. I shënojmë: ____, ____, ____.

Këndet e trekëndëshit formohen nga brinjët që e kanë një kulm të përbashkët. I shënojmë: ABC, ____, ____.

Sipërfaqja trekëndëshe

Sipërfaqja e kufizuar me trekëndëshin, së bashku me pikat e vijës, quhet sipërfaqe trekëndëshe.

3 T'i shkruajmë të gjithë trekëndëshat, që i vërejmë në figurë.

C
A
D
B

D
C
O
A
B

90

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Trekëndëshi dhe sipërfaqja trekëndëshe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan trekëndëshin dhe karakteristikat e tij;
- Identifikon dhe ngjyros sipërfaqen trekëndëshe.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Vizatohet në tabelë një trekëndësh, emërtohet ai dhe bisedohet me nxënësit për karakteristikat e tij.





Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vizatojnë në fletore një trekëndësh. U kërkohet ta ngjyrosin tërë sipërfaqen që gjendet brenda vijave. U sqarohet se ajo është sipërfaqja trekëndëshe.

Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet të ngjyrosin me të kuqe figurat në formë trekëndëshi në detyrën 1.

Hapi 4: Lexohen informacionet për figurën e trekëndëshit dhe bashkë me nxënësit diskutohet rreth këtyre informacioneve.

Nxënësve u jepen sqarime për brinjët, kulmet dhe sipërfaqen trekëndëshe.



Hapi 5: Nxënësit udhëzohen që në dyshe të gjejnë dhe të shkruajnë të gjithë trekëndëshat që i vërejnë në figurë.

VEPRIMTARI SHTESË:
Numëron numrin e figurave gjeometrike që gjenden në figurën e dhënë dhe i ngjyros ato sipas dëshirës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin, ngjyrosjen dhe kuptimin e karakteristikave të trekëndëshit.

Detyrë:
Vizaton një trekëndësh, e emërton dhe e ngjyros atë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 155

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Emërton figurat gjeometrike, siç është katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi;
Vizaton figura të ndryshme gjeometrike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1, 2, 3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Rrethi dhe sipërfaqja rrethore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Përshkruan rrethin dhe elementet e tij (qendra e rrethit, vija rrethore, sipërfaqja rrethore);
- Identifikon figurat në formë rrethore;
- Vizaton rrathë duke shfrytëzuar objekte në formë rrethore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gotë plastike, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Para nxënësve paraqitet një orë në formë rrethore (ose në tabelë vendoset një orë rrethore e printuar në letër).

- Çfarë objekti është? (ora);
- Çfarë forme ka? (rrethore);
- Cilat janë elementet e rrethit? (qendra e rrethit, vijat e rrethit, sipërfaqja rrethore).

Hapi 2: Detyra 1 – Ngjyros figurat në formë të rrethit me ngjyrë të gjelbër.



Detyra 2 – Dallon pjesët e rrethit:
qendrën e rrethit
vijën rrethore
sipërfaqen rrethore.

Hapi 3: Me vizore, nxënësit i bashkojnë pikat e figurave gjeometrike sipas ngjyrave të dhëna.

Hapi 4: Në fletë udhëzohen që të vizatojnë rrathë duke përdorur gotë plastike, apo objekte të ndryshme që kanë formë rrethore.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit, vizatimit dhe emërtimit të elementeve të rrethit.

Detyrë:
Vizaton 3 rrathë me madhësi të ndryshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 156

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Emërton figurat gjeometrike (katrori, drejtkëndëshi, trekëndëshi dhe rrethi).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.3; III.1; III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 6.1;6.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Paraqet figurat gjeometrike në tabelat gjeometrike;
- Zhvendos figurat gjeometrike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Tabelë gjeometrike, internet, kompjuter.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të vizatojnë në fletore figura gjeometrike (drejtkëndëshin, katrorin, trekëndëshin) në madhësi të ndryshme. Më pas u kërkohet atyre që në dyshe t'i shkëmbejnë fletoret me shokun/shoqen dhe të diskutojnë rreth figurave gjeometrike të vizatuara.

Hapi 2: Nxënësit e plotësojnë detyrën 1 në libër, po ashtu edhe vizatimet që kanë filluar për të formuar katrorë dhe drejkëndësha.

Hapi 3: Demonstrohet para nxënësve paraqitja e figurave gjeometrike në tabelën gjeometrike, po ashtu zhvillohen edhe ushtrime.

Për aktivitete të tjera mund të shfrytëzohen linqet:
https://www.mathplayground.com/geoboard.html



Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrën 2 në libër, duke i zhvendosur sipas udhëzimeve figurat e paraqitura në libër.

Hapi 5: Nxënësit i paraqesin në fletoren e tyre figurat gjeometrike dhe bëjnë zhvendosjen e tyre.

Ato mund t'i zbatojnë edhe në tabela gjeometrike nëse mund të shfrytëzohen për të gjithë nxënësit në klasë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e figurave gjeometrike në tabela gjeometrike dhe për zhvendosjen e tyre.

Detyrë:
Detyra 3 (faqe 92).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 157

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Figurat gjeometrike

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen shumën e brinjëve të katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.3, II.4, III.2, VI.2.
Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 4, 5.1, 6.1, 2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Perimetri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson perimetrin e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit.
- Gjen gjatësitë e brinjës së katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit, nëse dihet perimetri i tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Lojë – Nxënësit ndahen në tri grupe, rreshtohen njëri pas tjetrit. Tre nxënësve të fundit në rresht iu jepen udhëzimet që të vizatojnë me gisht në shpinën e shokut/shoqes figurat gjeometrike: rreshti i parë – katrori; rreshti i dytë – drejtkëndëshi; rreshti i tretë – trekëndëshi. Nxënësi i fundit në rresht vizaton në tabelë figurën që i ka vizatuar shoku/shoqja në shpinë.
Figurat gjeometrike: katrori, drejtkëndëshi dhe trekëndëshi, analizohen për numrin e brinjëve që ka secila figurë.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të shikojnë figurat e dhëna në detyrën e parë, dhe të analizojnë formulat për llogaritjen e perimetrit të figurave gjeometrike.

Hapi 3: Detyra 2. Duke shfrytëzuar formulën për njehsimin e perimetrit të katrorit, njehsohet perimetri i katrorëve me gjatësinë e brinjëve 7 cm (P = 28 cm) dhe 3 m (P = 12 m).


USHTROJMË

1 Gjejmë brinjën e katrorëve.

P = 24 cm

a

P = 20 m

a

P = 24 cm
4 · a = 24
a = ____

a =

2 Gjejmë brinjën e panjohur të drejtkëndëshit.

b

P = 26 cm

8 cm

26 cm = 2 · 8 + 2 · b
26 cm = ___ cm + 2 · b
26 cm - ___ cm = 2 · b
___ cm = 2 · b
___ cm = b

3 Gjejmë brinjën e panjohur të drejtkëndëshit nëse perimetri i tij është 20 cm dhe b = 6 cm.

6 cm

P = 20 cm

4 Gjejmë brinjën e panjohur të trekëndëshit.

c

5 cm

P = 17 cm

6 cm

6 cm + 5 cm + c = 17 cm

7 m

5 m

P = 18 m

a

94

Detyra 2. Duke shfrytëzuar formulën për njehsimin e perimetrit të drejtkëndëshit, njehsohet perimetri i drejtkëndëshave me gjatësitë e brinjëve 7 cm dhe 4 cm (P = 22 cm) dhe 3 m dhe 7 m (P = 20 m).

Detyra 3. Duke shfrytëzuar formulën për njehsimin e perimetrit të trekëndëshit, njehsohet perimetri i trekëndëshave me gjatësitë e brinjëve 5 cm, 7 cm dhe 8 cm (P = 20 cm) dhe 3 m, 6 m dhe 7 m (P = 16 m).

Hapi 4:
Në detyrat 1, 2, 3 dhe 4 gjenden gjatësitë e brinjëve të katrorit (a = 6 cm; a = 5 m),
të drejtkëndëshit (a = 8 cm dhe b = 5 cm), (a = 4 cm dhe b = 6 cm) dhe
të trekëndëshit (a = 6 cm, b = 5 cm, c = 6 cm), (a = 6 m, b = 5 m, c = 7 m).

Hapi 5:
Nxënësit udhëzohen të vizatojnë një katror me gjatësitë e brinjës 5 cm; një drejtkëndësh me gjatësitë e brinjës 7 cm dhe 9 cm; një trekëndësh me gjatësitë e brinjëve 7 cm, 8 cm dhe 9 cm.
Njehso perimetrin e katrorit, drejtkëndëshit dhe trekëndëshit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të perimetrit të katrorit, të drejtkëndëshit dhe të trekëndëshit dhe gjetjen e gjatësisë së brinjës së katrorit, të drejtkëndëshit dhe të trekëndëshit, nëse dihet perimetri i tyre.

Detyrë:
Njehso perimetrin e tavolinës në formë katrori ose drejtkëndëshi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 158

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Sipërfaqja

Rezultatet e të nxënit të temës:
Dallon sipërfaqen brenda, jashtë dhe në figurë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 2.1, 3.1, 4, 5.1, 6.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pozitat e pikës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Tregon pozitën e pikës në vijë, pikë e brendshme apo pikë e jashtme.
- Përcakton vendndodhjen e pikave të dhëna, duke u bazuar në figurën e dhënë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Para nxënësve paraqiten në tabelë ose projektor figurat gjeometrike:

Emërtohen figurat (katror, trekëndësh, rreth, drejtkëndësh).
Vizatohet një pikë në vijë të rrethit, një brenda rrethit dhe një jashtë rrethit.
Pyeten nxënësit: Si quhen pikat e vizatuara?





Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të lexojnë dhe analizojnë figurat dhe pikat e dhëna në detyrën e parë.

Hapi 3: Detyra 2. Analizohen figurat gjeometrike dhe lexohen dy kërkesat e detyrës për caktimin e pikave, sipas kërkesave të dhëna.

Detyra 3. Caktohet vendndodhja e pikave A, B, C, D, dhe E.
Pika B ndodhet brenda katrorit, trekëndëshit, drejtkëndëshit dhe rrethit.
Pika C ndodhet brenda trekëndëshit dhe drejtkëndëshit, por jashtë rrethit dhe katrorit.
Pika D ndodhet brenda katrorit, por jashtë drejtkëndëshit, trekëndëshit dhe rrethit.
Pika E ndodhet jashtë drejtkëndëshit, rrethit, trekëndëshit dhe katrorit.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen që, në grupe me nga katër nxënës, të vizatojnë katër figurat gjeometrike dhe të shkruajnë katër pika të cilat ndodhen në pozita të ndryshme.
Punimet ndërrohen mes grupeve dhe caktohen pozitat e pikave (brenda/jashtë figurave gjeometrike).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në përcaktimin e pozitës së pikës në vijë, pikë e brendshme apo pikë e jashtme, dhe përcaktimin e vendndodhjes së pikave të dhëna, duke u bazuar në figurën e dhënë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 159

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Sipërfaqja

Rezultatet e të nxënit të temës:
Njehson syprinën e figurave të paraqitura në sipërfaqe me katror.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 4, 5.1, 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llogaritja e sipërfaqes katrore



Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson syprinën e sipërfaqes së paraqitur në sipërfaqe me katror.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të shkruajnë çfarë dinë për katrorin.
Katrori është figurë gjeometrike.
Ka katër brinjë. Të gjitha brinjët janë të barabarta.
Pasi lexohen disa nga shkrimet e nxënësve, ata udhëzohen të vizatojnë katror me gjatësi të brinjës 1 cm.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën e parë me sqarimet për syprinën e sipërfaqes së një figure me njësi katrore.
Detyra 2: Analizohet katrori i dhënë i ndarë në katrorë të vegjël dhe formula për njehsimin e syprinës së sipërfaqes së katrorit.

1 Për ta matur syprinën e sipërfaqes së një figure, në fillim duhet ta përcaktojmë njësinë matëse.
Njësinë për matjen e sipërfaqes e quajmë njësi katrore. Zakonisht në praktikë njësi matëse për syprinë të sipërfaqes merret katrori me gjatësi të brinjës 1 cm. Quhet centimetër katror.



2 Shikojmë katrorin e madh të ndarë në katrorë të vegjël:



Syprina e katrorit në figurë është 36 cm².

S = a · a

Mbajmë mend se syprinën e katrorit e njehsojmë duke e shumëzuar gjatësinë e brinjës me vetveten.

3 Njehsojmë syprinat e sipërfaqeve katrore.

S = 4 cm · 4 cm
= 16 cm²



S = _____
= _____



S = _____
= _____

Hapi 3: Detyra 3: Për katrorët e dhënë njehsohet syprina e sipërfaqes katrore.

$S = 4 \text{ cm} \cdot 4 \text{ cm} = 16 \text{ cm}^2$
$S = 7 \text{ cm} \cdot 7 \text{ cm} = 49 \text{ cm}^2$
$S = 8 \text{ cm} \cdot 8 \text{ cm} = 64 \text{ cm}^2$

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të vizatojnë katër katrorë me gjatësitë e brinjëve a = 2 cm, a = 4 cm, a = 6 cm dhe a = 10 cm.
Njehso syprinën e sipërfaqes katrore dhe perimetrin e katrorëve.



$S = a \cdot a = 2 \text{ cm} \cdot 2 \text{ cm} = 4 \text{ cm}^2$
$P = 4 \cdot a = 4 \cdot 2 \text{ cm} = 8 \text{ cm}$

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e syprinës së sipërfaqes së paraqitur në sipërfaqe me katror.

Detyrë:

_____

_____

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 160

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,II.1,2,III. 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,3;2.1,2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Pjesëtimi si zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Tregon rregullën e ndarjes në pjesë të barabarta;
- Kupton pjesëtimin si zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë;
- Zbaton pjesëtimin me shembuj nga jeta e përditshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet të rikujtojnë se cilat veprime matematikore janë mësuar.



Me fjalën pjesëtim kuptojmë ndarje. Vizatohen në tabelë 2 vende me nga 5 topa. Pyeten nxënësit: Çfarë kam vizatuar? Sa grupe me nga 5 topa mund të formosh? Sa topa janë gjithsej?




PJESËTIMI

1 Të kujtojmë:

27 – 3 = 18 – 3 = 9 – 3 =
24 – 3 = 15 – 3 = 6 – 3 =
21 – 3 = 12 – 3 = 3 – 3 =

Në tavolinë ndodhen 12 tiketa me pyetje. Secili nxënës duhet t'i përgjigjet një numri të barabartë të pyetjeve.
Sa pyetjeve duhet t'u përgjigjet secili nxënës?

T'i ndajmë 12 tiketa me pyetje.

Në fillim secili nga ne marrim nga një tiketë.
12 – 4 = 8
Kanë mbetur edhe 8 tiketa. Si të veprojmë?
Përsëri, të gjithë do të marrim nga një tiketë.
8 – 4 = 4
Kanë mbetur edhe 4. Në fund po e marrim të gjithë edhe nga një tiketë.
4 – 4 = 0
Tash, nuk kanë mbetur tiketa të tjera.

12 – 4 = 8
8 – 4 = 4
4 – 4 = 0

Secili nxënës do t'u përgjigjet tri pyetjeve.

Shkruajmë shkurt:
12 : 4 = 3.

Secili nxënës në të tria herët merr nga një tiketë.

Lexojmë: 12 pjesëtuar me 4 është e barabartë me 3.
Ky është pjesëtimi.

–4 –4 –4
0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12

12 – 4 = 8
8 – 4 = 4
4 – 4 = 0

ose 12 : 4 =3.

i pjesëtueshmi pjesëtuesi herësi
12 : 4 = 3

Pjesëtimi është zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë.

PJESËTIMI SI ZBRITJE E NJËPASNJËSHME E NUMRIT TË NJËJTË
MËSOJMË

97

i pjesëtueshmi ← 10 : 2 = 5 → ndryshimi
pjesëtuesi

*Lexojmë: 10 pjesëtuar me 2 është 5.

Hapi 2: Nxënësit do të punojnë detyrën 1, duke kryer zbritje të njëpasnjëshme me numër të njëjtë.

Hapi 3: Nxënësve u kërkohet të lexohet problema e dhënë në detyrën 2 dhe ta gjejnë zgjidhjen. Ata do të udhëzohen që nga libri të gjejnë me zbritje të njëpasnjëshme e më pas me pjesëtim. Diskutohet rreth tyre.

Hapi 4: Nxënësve u shpërndahet nga një fletë. Kërkohet nga ata ta zgjidhin detyrën në dyshe.

Nëna kishte gatuar një ëmbëlsirë të cilën e ndau në 18 pjesë. Secilit anëtar të familjes i dha nga 6 pjesë. Sa pjesë të ëmbëlsirës mbetën? Si mund ta shkruajmë në gjuhën e matematikës? 18:6=3, sepse 6·3=18

AKTIVITET SHTESË:

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në ndarjen e pjesëve të barabarta.

Detyrë:
Shkruan 5 barazime me veprimin e pjesëtimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 161

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50); Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave si dhe të shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Lidhja ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton kufizat e pjesëtimit;
- Përcakton ngjashmërinë dhe ndryshimet ndërmjet shumëzimit e pjesëtimit;
- Shkruan barazime të pjesëtimit nga shumëzimi, për të treguar lidhjen mes këtyre veprimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Situatë problemore: Mali kishte 12 makina lodër. Ai ua ndau në mënyrë të barabartë 2 shokëve. Sa makina mori secili shok?
Diskutohet dhe nxirret përfundimi: 12:2=6, secili shok mori nga 6 makina.
Nxënësve u sqarohet se te barazimi i mëposhtëm, kufizat që marrin pjesë në pjesëtim i emërtojmë kësisoj:

12 : 2 = 6
I pjesëtueshmi — Pjesëtuesi — Herësi



Hapi 2: Nxënësve u sqarohet se shumëzimi dhe pjesëtimi janë veprime të kundërta matematikore.
Për çdo shumëzim shkruhen dy pjesëtime, si për shembull:

$7 \times 3 = 21 \rightarrow 21 : 7 = 3$, $21 : 3 = 7$

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen rreth detyrës që do të plotësojnë: "Zgjidh një tabelë shumëzimi që njeh mirë dhe shkruaj pjesëtimet për çdo shumëzim pa e parë tabelën".
Pas zgjidhjes së detyrës, diskutohet bashkërisht.

Hapi 4: Nxënësit do të punojnë në grup për të treguar ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit.

Ngjashmëritë: Veprime matematikore; zbatohen në ushtrime e problema.	Dallimet: Shumëzimi është mbledhje e përsëritur e numrit, ndërsa pjesëtimi është ndarja e së tërës në pjesë të barabarta.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e emërtimit të kufizave të pjesëtimit, përcaktimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit, shkrimin e barazimeve.

Detyrë:
Shkruan dhjetë barazime me veprimin e pjesëtimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 162

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Gjen herësin e numrave (≤50);
- Gjen vlerën (*prodhimin dhe herësin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 3, 4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Zbulon rregullën e ndarjes në pjesë të barabarta;
- Kupton pjesëtimin si zbritje e njëpasnjëshme e numrit të njëjtë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë me tabela.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

:	6	21	24	27	30
3					
:	4	8	16	24	32
4					

Hapi 1: Klasa ndahet në grupe me nga pesë nxënës. Ata udhëzohen t'i plotësojnë tabelat njëri pas tjetrit për 1 minutë.



USHTROJMË

4 Njehsojmë herësin.

10 : 2 =	12 : 3 =	24 : 4 =	30 : 5 =
14 : 2 =	18 : 3 =	12 : 4 =	45 : 5 =
18 : 2 =	24 : 3 =	32 : 4 =	35 : 5 =

5 Plotësojmë tabelat e pjesëtimit.

:	4	8
24		
16		
48		

:	2	6
18		
6		
36		

:	9	6
54		
18		
36		

:	3	9
27		
45		
18		

6 Njehsojmë dhe plotësojmë:

48 : 8 =	: 6 = 5	42 : = 7
42 : 7 =	: 8 = 4	48 : = 8
63 : 9 =	: 5 = 9	54 : = 9

7 < = > ?

21 : 7 5	7 35 : 5	64 : 8 40 : 5
28 : 4 11	10 45 : 5	63 : 7 3 • 4
9 : 3 2 • 3	12 : 3 3 • 4	18 : 3 16 : 2

8 Në figurë është dhënë paraqitja grafike e herësit të dy numrave. Shkruajmë barazinë.

: = =

100

Hapi 2: Nxënësit i plotësojnë detyrat 1, 2, 3, i analizojnë figurat dhe i plotësojnë barazitë. Më pas lexohen barazimet dhe bëhen korrigjmet nga nxënësit e tjerë.

Hapi 3: Kërkohet që në dyshe të zgjidhin detyrat 4, 5 , 6 dhe të njehsojnë herësin. Pas plotësimit dyshet i lexojnë zgjidhjet.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të zgjidhin detyrën 7. Barazimet zgjidhen në fletore e më pas vendosen shenjat <, > , = , për të krahasuar dy anët e barazimeve, në libër. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

Hapi 5: Nxënësit vëzhgojnë paraqitjen grafike të herësit të dy numrave në detyrën 8 dhe shkruajnë barazinë.



VEPRIMTARI SHTESË:
Dy nxënës luajnë me zar. Ata lëvizin aq sa tregon numri i zarit dhe thonë zgjidhjen.
Nxënësi që e di zgjidhjen vazhdon, ai që nuk e di zgjidhjen kthehet aq numra pas, sa tregon numri i zarit. Fitues është nxënësi që shkon deri në fund.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e herësit dhe plotësimin e detyrave.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 163

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Argumenton lidhjen ndërmjet mbledhjes dhe zbritjes së numrave, si dhe shumëzimit dhe pjesëtimit të numrave deri në 100;
Identifikon shprehjet: faktorët, prodhimin, të pjesëtueshmin, pjesëtuesin dhe herësin e numrave natyrorë deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4, 3.4.


9 Numërojmë dhe shkruajmë barazi.

2 · 8 =
8 · 2 =
16 : 8 =
16 : 2 =

10 T'i gjejmë numrat që janë zëvendësuar me fruta.

5 · = 10
24 : =

11 Duke zbatuar lidhjen e shumëzimit me pjesëtimin, plotësojmë tabelën.

I pjesëtueshmi		10		6		8	12		
Pjesëtuesi	2		2	3	8			7	2	9
Herësi	2	2	9		2	4	6	2	10	3

12 I pjesëtueshmi është numri më i madh çift i dhjetëshes së dytë, kurse pjesëtuesi është numri 3. Gjeni herësin.
Numri më i madh çift i dhjetëshes së dytë është numri _____.
Njehsojmë: _____

13 Në figurë është dhënë paraqitja grafike e herësit të dy numrave. Shkruajmë barazinë.

2 kg → kg
2 kg → kg

USHTROJMË
101

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Kryen veprimin e shumëzimit dhe të pjesëtimit;
- Emërton kufizat e pjesëtimit;
- Shkruan barazime me pjesëtim dhe shumëzim, duke treguar lidhjen e tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me numra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen në çifte fletë me nga tre numra, ku ata do të krijojnë dy barazime me shumëzim dhe dy barazime me pjesëtim.

3	8	24

8 · 3 = 24 24 : 3 = 8
3 · 8 = 24 24 : 8 = 3



USHTROJMË

14 Plotësojmë trekëndëshat. Shkruajmë barazi me shumëzim dhe pjesëtim.

21 : 3 · 7 — 3 • 7 = 21

45 : 5 · 5 — _____ _____ _____ _____

15 Njehsojmë herësin dhe bëjmë provën.

32 : 4 = 8	dhe	32 : 8 =	Prova:	8 • 4 = 32
40 : 5 =	dhe	: 8 =		• =
63 : 7 =	dhe	: =		• =
80 : 8 =	dhe	: =		• =

16 Analizojmë figurën dhe përshkruajmë me fjalë atë që vërejmë.

5 • 4 =

0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10 11 12 13 14 15 16 17 18 19 20

20 : 4 =

17 Zbatojmë lidhjen ndërmjet shumëzimit e pjesëtimit dhe plotësojmë tabelat.

Shumëzimi	Pjesëtimi
6 • 7 =	42 : 6 = 42 : 7 =
5 • 8 =	40 : 8 = 40 : =
9 • 4 =	: = : =

Pjesëtimi	Shumëzimi
48 : 6 = 48 : 8 =	6 • 8 =
56 : 7 = 56 : =	• 8 =
: = : =	9 • 8 =

102

Hapi 2: Detyra 9 – Rrathët e dhënë i shënojmë si prodhim dhe si herës.

- Sa rreshta me rrathë janë? (2)
- Sa rrathë ka një rresht? (8)
- Sa rrathë janë gjithsej? (2 · 8 = 16)
- Sa rrathë janë gjithsej? (16)
- Nëse i ndajmë në dy pjesë, sa rrathë ka njëri grup? (16 : 2 = 8)
- Nëse i ndajmë në tetë pjesë, sa rrathë ka njëri grup? (16 : 8 = 2)

(2 · 7 = 14; 7 · 2 = 14; 14 : 2 = 7; 14 : 7 =2
2 · 11 = 22; 11 · 2 = 22; 22 : 2 = 11; 22 : 11 = 2)
Detyra 10 – Numrat që i zëvendësojnë frutat janë.

2 12

Detyra 11 – Plotëso tabelën duke gjetur të pjesëtueshmin, pjesëtuesin ose herësin.

Hapi 3: Detyra 12 – Lexohet detyra. Numri më i madh çift i dhjetëshes së dytë është 18; 18 : 3 = 6.
Detyra 13 - 1 kg (3kg : 3kg = 1kg)
4 kg (4kg : 4kg = 1kg).

Hapi 4: Nxënësit në mënyrë individuale plotësojnë detyrat 14 dhe 15.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit të prodhimit dhe të herësit.

Detyrë:
Detyrat 16 dhe 17 (faqe 102).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 164

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (*shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2.III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson vlerën e shprehjeve numerike me dy veprime;
- Zbaton lidhjen ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u përcaktohen nga tre numra (p.sh., 48, 6, 8) dhe kërkohet nga ata të formojnë barazime të njehsimit të prodhimit dhe herësit me numrat e dhënë.
Njehsimet me numrat 48, 6, 8 janë:
6•8= 48 48 : 8=6
8•6= 48 48 : 6=8

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë detyrat në libër.
Detyrat 1 dhe 2. Kërkohet të njehsojnë detyrat me dy veprime: mbledhje dhe zbritje.
Detyra 3. Kërkohet nga nxënësit të njehsojnë herësin dhe prodhimin e numrave të dhënë.
Detyra 4. Udhëzohen që për çdo barazim me shumëzim të dhënë në detyrë të formojnë nga dy



barazime me pjesëtim.
P.sh., 5• 3=15
15: 5=3
15:3=5
Detyra 5. Nxënësit për çdo barazim me pjesëtim paraqesin nga dy barazime me shumëzim.
P.sh., 56:7=8
7 • 8=56
8 • 7=56

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të plotësojnë tabelat e paraqitura në detyrën 6 në libër, duke njehsuar prodhimin dhe herësin e numrave. Barazimet i shkruajnë në hapësirat përkatëse në libër.

Nxënësit i njehsojnë detyrat me shumëzim, mbledhje dhe pjesëtim.

Detyrat e plotësuara kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e detyrave me dy veprime dhe për zbatimin e lidhjes ndërmjet shumëzimit dhe pjesëtimit.

Detyrë:
Detyrat 8 dhe 9 (faqe 104).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 165

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (*shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin*) e shprehjeve numerike të përbëra (*dy veprime*).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,II.1,2,III. 2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2 ,3; 2.1, 2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Kuptimet: për sa më i vogël dhe sa herë më i vogël

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton numrat *për sa është më i vogël dhe sa herë më i vogël;*
- Përshkruan me fjalë barazitë;
- Njehson herësin dhe ndryshimin në detyra të dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Pyeten nxënësit: Cilën shenjë duhet shënuar kur themi *për sa është më i vogël* (-); Cilën shenjë duhet shënuar kur themi *për sa herë më i vogël?* (:). Në tabelë u kërkohet nxënësve që t'i punojnë detyrat.

	12		24	30	36
6 më i vogël					
6 herë më i vogël					

Hapi 2: Nxënësit e vëzhgojnë dhe e punojnë detyrën 1 në libër. Diskutohen këto pyetje: Sa topa ka



Artani? (18); Sa topa ka Anita? (6); Sa topa ka Lisi? (3); Anita ka 3 herë më pak topa se Artani, si duhet shënuar barazimi? (18:3=6); Lisi ka 3 topa më pak se Anita, si duhet shënuar barazimi? (6-3=3).

* Nxiten nxënësit t'i përdorin fjalët *disa herë më e vogël dhe më e vogël.*

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të përshkruajnë me fjalë barazitë.

30:____=5, Numri 5 është 6 herë më i vogël se numri 30.

30-6=_____, Numri 24 është për 6 më i vogël se numri 30.

Hapi 4: Nxënësit, të ndarë në grupe me nga 5 veta, do të njehsojnë herësin dhe ndryshimin, duke kaluar fleta zinxhirore nga një nxënës te tjetri.

X	14	7	49	42	28
: 7					

X	12	20	8	98	59
-8					

Në përfundim të punës, grupet lexojnë punën e bërë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin dhe përshkrimin e numrave *për sa më i vogël dhe për sa herë më i vogël.*

Detyrë:
Detyra 2 (faqe 104).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 166

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 2.2, 3.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjysma dhe çereku

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton gjysmën dhe çerekun e një sasie;
- Gjen gjysmën dhe çerekun e numrave të dhënë.



Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Situata: Jeni 2 shokë në restorant dhe keni një picë.
- Në sa pjesë duhet ta ndani picën? (Në dy pjesë);
- Sa tregon njëra pjesë e picës? (Gjysmën);
- Nëse jeni 4 shokë, në sa pjesë duhet ta ndani picën? (Në katër pjesë);
- Sa tregon (si quhet) njëra pjesë e picës? (Çereku).

Nxënësve u sqarohet se numri që është dy herë më i vogël se një numër, paraqet gjysmën e atij numri. Ndërsa numri që është katër herë më i vogël se një numër paraqet çerekun e atij numri.

Hapi 2: Nxënësve u shpërndahet një tabelë në fletë A4 për të gjetur gjysmën dhe çerekun e disa numrave. Shembull:



Numri	Gjysma	Çereku
4	2	1
8	4	2
16	8	4
24	12	6
40	20	10

Hapi 3: Detyra 1: Nxënësit e gjejnë gjysmën e numrit 18.

Detyra 2: Nxënësit e gjejnë çerekun e numrit 12.

Hapi 4: Detyra 3 dhe 4: Udhëzohen që të paraqesin në fletore gjysmën dhe çerekun në figurat e dhëna.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e gjysmës së çerekut të numrave të dhënë.

Detyrë:
Zgjidh pesë numra dyshifrorë dhe gjen gjysmën dhe çerekun e atyre numrave.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 167

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Zbaton zbritjen dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme;
- Përcakton gjysmën dhe çerekun e tërësisë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I. 3; II. 2, 8; III. 2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1. 4; 3. 4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton numrat *për sa më i vogël* dhe *sa herë më i vogël;*
- Krahason numrat *për sa më i vogël* dhe *sa herë më i vogël;*
- Zgjidh situata të ndryshme problemore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kalendar, etiketa me shenjën minus dhe shumëzim.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Njeriu dhe natyra, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë paraqitet një kalendar ku shihen qartë muajt e vitit dhe diskutohen bashkë me nxënësit.
- Sa muaj ka viti?
- Ndaj përgjysmë muajt e vitit.

Nxënësit udhëzohen të punojnë në fletore skema të ndryshme dhe t'i shkruajnë barazimet si shumë dhe prodhim. Pranohen të gjitha zgjidhjet duke i diskutuar dhe shkruar në tabelë: $6 + 6 = 12$ $2 \cdot 6 = 12$ $12 : 2 = 6$

Për mësuesin/en



USHTRIMJË

5 T'i shkruajmë të gjithë numrat më të vegjël se 31, që pjesëtohen me numrin 4. Fillojmë nga më i madhi.

Numrat e kërkuar janë: _____

6 Prodhimin e numrave 7 dhe 8 e zvogëlojmë për herësin e numrave 72 dhe 8. Cili numër fitohet?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Fitohet numri_____.

7 Prodhimin e numrave 6 dhe 10 e rritim për prodhimin e numrave 3 dhe 7. Rezultatin e fituar e zvogëlojmë 9 herë. Cili numër fitohet?

Njehsojmë: _____

_____

Përgjigjja: Fitohet numri ____.

8 Shenjojmë të saktat me ✓, kurse të pasaktat me X.

Numri 27 është 3 herë më i madh se numri 9. ☐
Numri 12 është për 3 më i madh se numri 4. ☐
Numri 8 është 3 herë më i vogël se numri 38. ☐
Numri 8 është për 3 më i vogël se numri 12. ☐
Numri 6 është 2 herë më i madh se numri 12. ☐
Numri 5 është për 5 më i madh se numri 10. ☐
Numri 7 është 6 herë më i vogël se 42. ☐

9 Muratori ka radhitur 72 tulla në mur. Në çdo rend ai ka vendosur nga 8 tulla. Sa rende ka ndërtuar ai?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Janë ndërtuar ____ rende.

Edhe sa rende mund t'i ndërtojë muratori, nëse i kanë mbetur pa i muruar edhe 32 tulla?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Mund t'i ndërtojë edhe_____rende.

108

Vazhdon diskutimi me këto pyetje:

- Sa stinë ka viti?
- Sa muaj ka një stinë?

Udhëzohen nxënësit të ndajnë me skema të ndryshme dhe barazime 12 muajt e vitit në 4 pjesë të barabarta dhe zgjidhjet e dhëna nga nxënësit shkruhen po ashtu në tabelë.

$3 + 3 + 3 + 3 = 12$ $4 \bullet 3 = 12$ $12 : 4 = 3$

Diskutohet për gjysmën dhe çerekun.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të lexojnë kërkesën e detyrës së parë dhe të tregojnë se sa euro kanë Hana dhe Zana. Po ashtu, i plotësojnë fjalitë dhe i shkruajnë barazitë.

Nxënësit nxiten të bëjnë dallimin në mes të termave: herë më i vogël dhe më i vogël.

Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet të njehsojnë dhe të plotësojnë detyrën 3 dhe të gjejnë numrat për 4 më i vogël dhe 3 herë më i vogël, kurse në detyrën 4 shumën e numrave 42 dhe 14 ta zvogëlojnë për 7 herë.

Hapi 4: Nxënësit i lexojnë detyrat me fjalë dhe i zgjidhin detyrat 5, 6, dhe 9 në dyshe. Pas plotësimit, dyshet i lexojnë zgjidhjet e detyrave.

Hapi 5: Detyra 8 zgjidhet individualisht. Puna e nxënësve kontrollohet dhe vlerësohet.

VEPRIMTARI SHTESË:
Luani me nxënës, duke kërkuar nga ata të ngrenë etiketën me shenjën e pjesëtimit ose të zbritjes, varësisht nga fjalët që përmenden. Kur u thuhet "herë më e vogël", ata duhet të ngrenë shenjën e pjesëtimit, ndërsa "më e vogël", e ngrenë shenjën e zbritjes. Përsëritet kjo veprimtari disa herë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin dhe krahasimin e numrave për "sa më i vogël" dhe "për sa herë më i vogël".

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 168

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50);

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.2, III.2, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 4, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Numri 1 dhe 0 në pjesëtim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson herësin e numrave me 1 dhe 0;
- Zbaton rregullat e njehsimit të herësit me 1 dhe 0.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me detyra me fjalë, letër tualeti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u shpërndahen etiketa me problemet me fjalë.

Era ka 5 mollë. Të gjitha mollët një nga një i dha vëllait të saj. Sa mollë ka vëllai i Erës? 5 : 1 = 5	Lisi nuk ka asnjë mollë. Ato i ndan me 5 shokë. Nga sa mollë kanë shokët e Lisit? 0 : 5 = 0

Diskutohen të gjitha idetë për zgjidhjen dhe shënimin e barazimeve.

Hapi 2: Detyra 1 – Lexohen kërkesat e detyrave të dhëna. Diskutohen rezultatet.
Lexohen rregullat e pjesëtimit me numrin 1 dhe 0. (Rregullat mund të shënohen dhe të vendosen në një kënd të klasës.)



Plotësohen barazimet e dhëna në detyrën 1.

Hapi 3: Nxënësit në dyshe plotësojnë barazimet e dhëna në detyrën 2.

Hapi 4: Nxënësit marrin letër tualeti me 4 pjesë dhe në secilën prej tyre shënojnë një barazi me pjesëtimin e numrave me 1 dhe 0. Pas shënimeve, letrat vendosen në një shportë.
Lexohen barazimet një nga një dhe diskutohet për saktësinë e shënimit dhe të rezultatit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e njehsimit dhe zbatimit të rregullave të herësit me numrat 1 dhe 0.

Detyrë:
Shkruan nga 3 barazime të pjesëtimit me numrin 1 dhe 0.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 169

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50);

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III. 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 3.1; 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Pjesëton numrat me 1;
- Pjesëton 0 me një numër.


USHTROJMË

1 Njehsojmë:

4 : 1 =	0 : 7 =	= 6 : 1	= 0 : 7
3 : 1 =	0 : 3 =	= 2 : 1	= 0 : 3
5 : 1 =	0 : 5 =	= 8 : 1	= 0 : 5
9 : 1 =	0 : 9 =	= 9 : 1	= 0 : 9

2 Shkruajmë njërin nga simbolet · ose : dhe fitojmë barazi të sakta.

5 1 = 5	12 1 = 12	5 5 = 1
6 1 = 6	0 8 = 0	1 4 = 4
0 5 = 0	0 9 = 0	7 1 = 7
8 1 = 8	17 1 = 17	7 7 = 1

3 < = > ?

4 : 1 4 • 1	7 • 0 0 : 9	4 + 0 4 • 0
0 : 18 18 – 0	61 – 61 73 • 0	36 – 0 36 : 1
7 • 1 28 : 4	0 : 6 10 • 6	19 – 10 0 : 9

4 Shkruajmë njërin nga simbolet +, -, · ose : dhe fitojmë barazi të sakta.

6 1 = 6	4 0 = 4	7 1 = 8	9 1 = 8
5 0 = 5	8 8 = 0	0 3 = 0	1 1 = 0

5 Me numrat e dhënë, shkruajmë shprehje matematikore, vlera e së cilave është numri në rreth.

1 + 0 — 1 — 5 – 0 — 5

110

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Internet, TV.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqitet para nxënësve situata problemore:
Zana ka 10 lapsa me ngjyra. Të gjithë lapsat ia dha vëllait të saj, Andit. Sa lapsa ka Andi?
Parashtrohen pyetje: Si mund të gjejmë sa lapsa ka Andi?
Shënohet në tabelë zgjidhja që tregohet nga nxënësit për situatën e dhënë.

Hapi 2: Paraqitet videoja (linku në vijim) ku sqarohet numri 0 dhe numri 1 në pjesëtim.

https://www.youtube.com/watch?v=LHllElsO9bU
Meqenëse videoja nuk është në gjuhën shqipe, duhet të sqarohet për nxënësit.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë detyrat në libër.
Detyra 1. Kërkohet nga ata t'i njehsojnë detyrat, duke i pjesëtuar numrat e dhënë me 1 dhe duke pjesëtuar 0 me numrat e dhënë.



USHTRIMË

1 Njehsojmë:

4 : 1 = ☐	0 : 7 = ☐	☐ = 6 : 1	☐ = 0 : 7
3 : 1 = ☐	0 : 3 = ☐	☐ = 2 : 1	☐ = 0 : 3
5 : 1 = ☐	0 : 5 = ☐	☐ = 8 : 1	☐ = 0 : 5
9 : 1 = ☐	0 : 9 = ☐	☐ = 9 : 1	☐ = 0 : 9

2 Shkruajmë njërin nga simbolet · ose : dhe fitojmë barazi të sakta.

5 ☐ 1 = 5	12 ☐ 1 = 12	5 ☐ 5 = 1
6 ☐ 1 = 6	0 ☐ 8 = 0	1 ☐ 4 = 4
0 ☐ 5 = 0	0 ☐ 9 = 0	7 ☐ 1 = 7
8 ☐ 1 = 8	17 ☐ 1 = 17	7 ☐ 7 = 1

3 < = > ?

4 : 1 ◯ 4 • 1	7 • 0 ◯ 0 : 9	4 + 0 ◯ 4 • 0
0 : 18 ◯ 18 – 0	61 – 61 ◯ 73 • 0	36 – 0 ◯ 36 : 1
7 • 1 ◯ 28 : 4	0 : 6 ◯ 10 • 6	19 – 10 ◯ 0 : 9

4 Shkruajmë njërin nga simbolet +, -, · ose : dhe fitojmë barazi të sakta.

6 ◯ 1 = 6	4 ◯ 0 = 4	7 ◯ 1 = 8	9 ◯ 1 = 8
5 ◯ 0 = 5	8 ◯ 8 = 0	0 ◯ 3 = 0	1 ◯ 1 = 0

5 Me numrat e dhënë, shkruajmë shprehje matematikore, vlera e së cilave është numri në rreth.

110

Detyra 2. Kërkohet të vendosin në kutiza simbolet • ose : për të fituar barazime të sakta.

Detyra 3. Nxënësit i njehsojnë detyrat me shumëzim dhe pjesëtim dhe më pas i krahasojnë ato duke vendosur shenjën >, < ose =.

Detyra 4. Udhëzohen të plotësojnë kutizat me simbolet +, - ose • për të fituar barazime të sakta.

Detyrat e plotësuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në pjesëtimin me 1 dhe pjesëtimin e 0 me një numër.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 110).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 170

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin, herësin) e shprehjeve numerike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,II.1,2,III. 2 ,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2,3; 2.1, 2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Radha e veprimeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Tregon radhën e veprimeve në detyra;
- Zgjidh detyra sipas radhës së veprimeve;
- Plotëson tabelat me detyrat e dhëna.



RADHA E VEPRIMEVE

1 Të kujtojmë:

Në shprehjet numerike pa kllapa, ku, përveç veprimeve mbledhje e zbritje, figuron edhe veprimi i shumëzimit, në fillim kryhet veprimi i shumëzimit e pastaj veprimet e tjera.

Kështu:

13 + 12 • 4 = ___ + ___ = ___.

32 – 7 • 4 = ___ – ___ = ___.

2 Nëse shprehja numerike pa kllapa, përveç veprimeve mbledhje e zbritje, përmban edhe veprimin e pjesëtimit, për njehsimin e vlerës së saj zbatohet rregulla:

Në shprehjet numerike pa kllapa, ku përveç veprimeve mbledhje e zbritje figuron edhe veprimi i pjesëtimit, në fillim kryhet veprimi i pjesëtimit e pastaj veprimet e tjera.

Kështu:

66 + 18 : 6 = ___ + ___ = ___.

47 – 18 : 6 = ___ – ___ = ___.

3 Ta njehsojmë vlerën e shprehjeve:

72 : 8 – 4 = _____

4 + 45 : 5 = _____

45 : (5 + 4) = _____

(100 – 36) : 8 = _____

4 Ta njehsojmë vlerën e shprehjeve me kllapa:

(9 • 4) : (42 :7) = _____

(35 : 7) • (2 • 5) = _____

27 : (2 + 7) + 12 = _____

7 • (3 + 2) – 4 = _____

24 : (17 – 14) + 5 = _____

25 : (43 – 38) + 79 = _____

(24 – 6) : 3 + 84 = _____

5 Si duhet t'i vendosim kllapat, që të fitojmë barazi të sakta?

(18 – 6) • 3 = 36 5 • 8 – 7 = 5 3 • 6 – 3 = 9

75 – 10 + 5 = 70 12 + 24 : 4 = 9 16 – 5 • 2 = 22

MËSOJMË

111

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet që t'i kujtojnë se cilat janë veprimet matematikore. Shkruhet në tabelë: 22 - 5·4 (Cili veprim duhet kryer në fillim? 22-5·4=22-20=2) dhe 47 + 36 : 6 (Cili veprim matematikor duhet kryer së pari? 47+36:6=47+6=53).
Nxënësit e gjejnë zgjidhjen. Pranohen të gjitha zgjidhjet e mundshme. Diskutohet për zgjidhjen e saktë duke sqaruar radhën e veprimeve në zgjidhjen e detyrave.

Hapi 2: Nxënësit e vëzhgojnë dhe e punojnë detyrën 1 në libër. Pyeten ata: Në detyrat ku gjenden veprimet matematikore: mbledhja, zbritja dhe shumëzimi, cili veprim kryhet i pari? Po në detyrat kur kemi kllapa, cili veprim kryhet në fillim?
13+12·4=13+48=61;
32-7·4=32-28=4.

RADHA E VEPRIMEVE

MËSOJMË

1 Të kujtojmë:

Në shprehjet numerike pa kllapa, ku, përveç veprimeve mbledhje e zbritje, figuron edhe veprimi i shumëzimit, në fillim kryhet veprimi i shumëzimit e pastaj veprimet e tjera.

Kështu:

13 + 12 • 4 = ___ + ___ = ___.

32 – 7 • 4 = ___ – ___ = ___.

2 Nëse shprehja numerike pa kllapa, përveç veprimeve mbledhje e zbritje, përmban edhe veprimin e pjesëtimit, për njehsimin e vlerës së saj zbatohet rregulla:

Në shprehjet numerike pa kllapa, ku përveç veprimeve mbledhje e zbritje figuron edhe veprimi i pjesëtimit, në fillim kryhet veprimi i pjesëtimit e pastaj veprimet e tjera.

Kështu:

66 + 18 : 6 = ___ + ___ = ___.

47 – 18 : 6 = ___ – ___ = ___.

3 Ta njehsojmë vlerën e shprehjeve:

72 : 8 – 4 = _____

4 + 45 : 5 = _____

45 : (5 + 4) = _____

(100 – 36) : 8 = _____

4 Ta njehsojmë vlerën e shprehjeve me kllapa:

(9 • 4) : (42 :7) = _____

(35 : 7) • (2 • 5) = _____

27 : (2 + 7) + 12 = _____

7 • (3 + 2) – 4 = _____

24 : (17 – 14) + 5 = _____

25 : (43 – 38) + 79 = _____

(24 – 6) : 3 + 84 = _____

5 Si duhet t'i vendosim kllapat, që të fitojmë barazi të sakta?

(18 – 6) • 3 = 36 5 • 8 – 7 = 5 3 • 6 – 3 = 9

75 – 10 + 5 = 70 12 + 24 : 4 = 9 16 – 5 • 2 = 22

111

Hapi 3: Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë detyrën 2 në libër. U parashtrohen këto pyetje: Në detyrat ku janë veprimet matematikore: mbledhja, zbritja dhe pjesëtimi, cili veprim kryhet i pari?

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të punojnë detyrën 3.
72:8-4=9-45, 4+45:9=4+5=9,
45:(5+4)=45:9=5, (100-36):8=64:8=8

Hapi 5: Nxënësve u kërkohet të punojnë detyrën 5. 5·(8-7)=5; 3·(6-3)=9;
(75-10)+5=70; (12+24):4=9;
(16-5)·2=22

Hapi 6: U shpërdahen në grupe etiketa me detyra të ndryshme. U kërkohet t'i plotësojnë tabelat me detyrat e dhëna.

7·(3+3)+10	(8-4)·8-12

25:(20-15)+18	(4·5) : (45:9)	(35:7)·(3·3)

AKTIVITET SHTESË:

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e detyrës, sipas radhës së veprimeve.

Detyrë:
Detyra 4 (faqe 111).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 171

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë


USHTROJMË

1 Njehsojmë:

49 + 3 • 8 = ☐ + ☐ = ☐ 8 • 4 + 43 = ☐ + ☐ = ☐
91 – 6 • 7 = ☐ – ☐ = ☐ 9 • 8 – 72 = ☐ – ☐ = ☐
81 : 9 + 25 = ☐ + ☐ = ☐ 75 – 24 : 4 = ☐ – ☐ = ☐
54 : 6 – 7 = ☐ – ☐ = ☐ 47 + 16 : 4 = ☐ + ☐ = ☐

2 Njehsojmë:

39 + 32 : 8 = _____ 42 : 6 + 25 = _____
41 – 36 : 9 = _____ 56 : 7 + 49 = _____
81 – 24 : 3 = _____ 63 : 7 – 4 = _____
54 + 32 : 4 = _____ 35 : 5 – 2 = _____

3 Njehsojmë:

42 : 7 + 3 • 8 = _____
4 + 72 : 9 – 3 = _____
20 : 4 – 3 + 18 : 3 = _____
48 : 6 – 40 : 8 = _____
54 : 9 + 7 – 3 • 3 = _____

4 Sa qershi janë?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Janë gjithsej ____ qershi.

5 Në një paketë janë 5 topa të verdhë dhe 4 të gjelbër. Sa topa janë në 7 paketa të tilla?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Në 7 paketa janë ____ topa.

112

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson vlerën e shprehjeve të përbëra numerike, duke respektuar radhën e veprimeve;
- Zgjidh situatat e thjeshta problemore të dhëna në libër.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në projektor paraqitet problema: Në një dyqan kishte 5 pako me nga 4 mollë. 3 mollë ishin të verdha, kurse të tjerat ishin të kuqe. Zana bleu vetëm mollë të verdha. Sa mollë të kuqe mbetën në dyqan? Nxënësve u jepet hapësirë të mendojnë dhe të gjejnë zgjidhjen, më pas zgjidhja e detyrës paraqitet edhe në projektor.

Fillimisht gjenden sa mollë ishin gjithsej në dyqan. 5x4=20, nga 20 zbresim vetëm mollët e verdha. Pra, fitohet barazia 20 – 3 = 17. Por duke respektuar radhën e veprimeve mund të zgjidhet edhe në këtë mënyrë:

USHTROJMË

1 Njehsojmë:

49 + 3 • 8 = ☐ + ☐ = ☐
91 – 6 • 7 = ☐ – ☐ = ☐
81 : 9 + 25 = ☐ + ☐ = ☐
54 : 6 – 7 = ☐ – ☐ = ☐

8 • 4 + 43 = ☐ + ☐ = ☐
9 • 8 – 72 = ☐ – ☐ = ☐
75 – 24 : 4 = ☐ – ☐ = ☐
47 + 16 : 4 = ☐ + ☐ = ☐

2 Njehsojmë:

39 + 32 : 8 = _____
41 – 36 : 9 = _____
81 – 24 : 3 = _____
54 + 32 : 4 = _____

42 : 6 + 25 = _____
56 : 7 + 49 = _____
63 : 7 – 4 = _____
35 : 5 – 2 = _____

3 Njehsojmë:

42 : 7 + 3 • 8 = _____
4 + 72 : 9 – 3 = _____
20 : 4 – 3 + 18 : 3 = _____
48 : 6 – 40 : 8 = _____
54 : 9 + 7 – 3 • 3 = _____

4 Sa qershi janë?



Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Janë gjithsej ____ qershi.

5 Në një paketë janë 5 topa të verdhë dhe 4 të gjelbër. Sa topa janë në 7 paketa të tilla?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: Në 7 paketa janë ____ topa.

5x4-3=20-3=17, pra në dyqan mbetën 17 mollë të kuqe.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit e gjejnë vlerën e shprehjeve të përbëra numerike duke respektuar radhën e veprimeve. Njësoj veprohet edhe me detyrën e dytë dhe të tretë.

Hapi 3: Detyra 3: Nxënësve u kërkohet ta gjejnë numrin total të qershive. Pastaj shkruhet dhe zgjidhet barazimi kësisoj:

2x2 + 2x3 + 3x1

2 vende me nga dy qershi, 2 vende me nga tri qershi, 3 vende me nga një qershi

4 + 6 + 3
13

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e vlerës së shprehjeve të përbëra numerike dhe zgjidhjen e situatave të dhëna problemore.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 112).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 172

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Identifikon dhe zgjidh problema të thjeshta bazuar në modelet e paraqitura;
- Zbaton mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin në problema nga jeta e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II. 2, 8; III.2, 3, 4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 4; 3.1.



1 Në vresht fluturuan 48 dallëndyshe. Sa fole nevojiten që të strehohen këto dallëndyshe, nëse në një fole mund të strehohen 6 dallëndyshe?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

2 Në shtatë pemë janë 42 zogj. Sa zogj janë në një pemë, nëse numri i zogjve në çdo pemë është i njëjtë?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

3 Në ndërkohë, në secilën pemë fluturuan edhe nga 2 zogj. Sa zogj janë tani në të gjitha pemët?

Njehsojmë: _____

Përgjigjja: _____

4 Njehsojmë dhe plotësojmë:

3 •10 :5 •1 •10 •0 +20
:10 −20 +4 +50 :2
•3 :10 •10 •2 :10 •5

5 Arta dhe Beni kanë një shportë me disa mollë. Secili do të marrë numër të barabartë të mollëve. Rrethoni se në cilat shporta mund t'i marrin të gjitha mollët?

Përfundimi: Nëse numri i mollëve është numër çift, atëherë mund t'i ndajnë të gjitha mollët që kanë. Kurse, nëse numri i mollëve është tek, nuk është e mundur.

ZBATOJMË

113

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zbatojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Zgjidhin problemat me fjalë;
- Njehsojnë dhe plotësojnë ushtrimet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të lexojnë kërkesat e detyrave me fjalë në ushtrimet 1, 2 dhe 3, të njehsojnë dhe të gjejnë përgjigjet.
Problemë: Në vreshtë fluturuan 48 dallëndyshe. Sa fole janë të nevojshme për strehimin e këtyre dallëndysheve, nëse në një fole mund të strehohen 6 dallëndyshe?
Diskutohet bashkë me nxënës:
- Cili veprim duhet të kryhet që të gjejmë përgjigjen?
- Cilët numra duhet t'i njehsojmë?

Për mësuesin/en


ZBATOJMË

6 Flutura ka 35 €, Nora ka 5 € më pak se Flutura, kurse Alma 5 herë më pak se Flutura. Sa euro ka Nora dhe sa Alma?

Njehsojmë:

Përgjigjja: Nora ka ___ €, kurse Alma ___ €.

7 Gjallesat zëvendësojnë shifrat. Cilat shifra zëvendësojnë ato?

1 100 : 10 = 10

0 1

114

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë dhe të plotësojnë në dyshe detyrën 4, duke ndjekur shigjetat me ngjyrë të kuqe. Rezultatet e detyrave lexohen dhe kontrollohen.

Hapi 3: Nga nxënësit kërkohet të lexojnë problemën dhe, duke njehsuar, të gjejnë përgjigjen.

Flutura ka 35 €, Nora ka 5 € më pak se Flutura, kurse Alma 5 herë më pak se Flutura. Sa euro ka Nora dhe sa Alma?

Diskutohet me nxënësit:

- Si duhet ta gjejmë se sa euro ka Nora?
- Po Alma?
- Cilin veprim duhet ta kryejmë?
- Duhet të zbresim apo të shumëzojmë?

Hapi 4: Gjallesat i zëvendësojnë shifrat. Cilat shifra i zëvendësojnë ato?

Pyeten nxënësit:

- Çfarë vlere ka figura e bretkosës?
- Si e gjetët?
- Çfarë vlere ka figura e ketrit?

Kështu veprohet edhe me vlerën e figurave të kafshëve të tjera.

Pasi t'i kenë gjetur nxënësit vlerat e figurave të kafshëve, mund të diskutohen rreth kurioziteteve dhe njohurive që nxënësit mund t'i kenë rreth këtyre kafshëve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e detyrave me fjalë.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 113).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 173

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë; Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet e mbledhjes dhe të zbritjes, si dhe i krahason numrat natyrorë deri në 100;
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤50);
Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4, III.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 3, 3.3, 4.1, 6.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin e numrave të dhënë;
- Njehson vlerën e shprehjeve duke respektuar radhën e veprimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë shënohen pyetjet, përgjigjet e të cilave diskutohen bashkë me nxënësit.

Cilat janë veprimet themelore matematikore? (+, -, ·, :)	Në shprehjen e dhënë, cili veprim kryhet i pari? 2 · (2 + 2) (mbledhja, më pas shumëzimi).	Cilat janë figurat gjeometrike? (katrori, trekëndëshi, drejtkëndëshi, rrethi).



1 Shkruajmë faktorët që mungojnë, në mënyrë që barazitë të jenë të sakta:

5 • 8 = ☐ • 5 28 : 7 = ☐ : 2
3 • X = X • ☐ 9 : 3 = 24 : ☐

2 Sa trekëndësha dhe sa katërkëndësha janë në figurë?

☐ - trekëndësha
☐ - katërkëndësha

3 Shenjojmë numrat:

Numri	6	8	10	12	14	18	20	25
Pjesëtohet me 2						X		
Pjesëtohet me 3						X		
Pjesëtohet me 5								

4 Njehsojmë:

29 + 6 • 8 = _____ 94 – 72 : 8 = _____
5 • 4 – (32 : 4) = _____ 40 : (12 – 8) = _____

5 Plotësojmë trekëndëshat. Shkruajmë barazi me shumëzim dhe me pjesëtim.

72 : 8 = 9
72 : 9 = 8

21 : 3 = 7
21 : 7 = 3

6 Zbulojmë rregullën dhe plotësojmë.

32 25 30 23

VLERËSOJMË TË KUPTUARIT

VLERËSOJMË

115

Hapi 2: Detyra 1 – Të gjendet numri që mungon.

5 · 8 = 8 · 5 3 · X = X · 3	28 : 7 = 7 : 28 24 : 3 = 3 : 24

Detyra 2 – Trekëndësha 10; katërkëndësha 7.

Detyra 3 – Të gjendet se me cilin numër pjesëtohen numrat e dhënë.

Numri	6	8	10	12	14	18	20	25
Pjesëtohet me 2	X	X	X	X	X	X	X	
Pjesëtohet me 3	X			X		X		
Pjesëtohet me 5			X				X	X

Detyra 4 – Të njehsohet vlera e shprehjeve.
29 + 6 · 8 = 29 + 48 = 77
5 · 4 – (32 : 4) = 20 – 8 = 12
94 – 72 : 8 = 94 – 9 = 85
40 : (12 – 8) = 40 : 4 = 10

Detyra 5 – Të formohen barazi me shumëzim dhe pjesëtim.

8 · 9 = 72	3 · 7 = 21
9 · 8 = 72	7 · 3 = 21
72 : 8 = 9	21 : 3 = 7
72 : 9 = 8	21 : 7 = 3

Detyra 6 – Të njehsohet vlera e shprehjeve.
Në fletore nxënësit e njehsojnë vlerën e shprehjeve, duke e zëvendësuar X me numrin e dhënë.
X = 0; 7 · (X + 2) = 7 · (0 + 2) = 7 · 2 = 14
X = 1; 7 · (X + 2) = 7 · (1 + 2) = 7 · 3 = 21
X = 7; 4 · (X – 3) = 4 · (7 – 3) = 4 · 4 = 16
X = 4; 4 · (X – 3) = 4 · (4 – 3) = 4 · 1 = 4

Detyra 7 – Zbulojmë rregullin.

+5	+5	+5	+5						
32	25	30	23	28	21	26	19	24	17
-7	-7	-7	-7	-7					

Hapi 3: Në dyshe, nxënësit i plotësojnë katrorët magjikë.

15	11	39	10	75
34	17	18	6	
16	38	7	14	
10	9	11	45	

7	10	42	34	93
10	60	16	7	
26	16	15	36	
50	7	20	16	

20	26	13	23	82
19	21	28	14	
36	1	2	43	
7	34	39	2	

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për njehsimin e saktë të rezultateve të detyrave të dhëna.

Detyrë:
Të plotësohen kërkesat në faqen 116.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 174

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Shprehjet shkronjore

Rezultatet e të nxënit të temës:
Kryen veprimet themelore me shprehje shkronjore;
Gjen vlerën (numerike) e shprehjes shkronjore për vlera të caktuara të ndryshoreve.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 4, 5.1, 6.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Shprehjet shkronjore

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon shprehjet shkronjore nga ato numerike.
- Njehson vlerën e shprehjeve shkronjore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


SHPREHJET SHKRONJORE

1 Shprehjet shkronjore janë shprehjet që përbëhen nga shkronjat dhe numrat, të lidhura me veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit.

Shprehje shkronjore
x + y - 2
2 • x + y - 2
x + 3 (y + 3) - 2
x • y - 2 • x
x : y - 2

Shprehje numerike
7 • 8 - 2
48 : (8 - 2)
4 • (8 - 2) - 12 : 4

2 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën. Duke lexuar tabelën, shkruajmë zgjidhjen e barazimit.

x	7	4	6	3	5
4 • (x – 3)					

4 • (x – 3) = 12 x=

x	0	1	2	3	4
7 • (x + 2)					

7 • (x + 2) = 21 x=

3 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën. Duke lexuar tabelën, shkruajmë zgjidhjen e barazimit.

x	5	3	2	4	1	6	3
y	5	4	6	7	3	8	7
2 • x + y - 2							
x • (y + 2) - 2 • x							

MËSOJMË

117

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë ose projektor paraqiten shprehjet:

14 + 6	a + 4 – b · 7	13 · 6 – 56 : 8	x – 33 + 2 · y

Nxënësit pyeten: Çfarë dallojnë shprehjet e dhëna? (vetëm numra – shprehje numerike, numra dhe shkronja – shprehje shkronjore).



1 Shprehjet shkronjore janë shprehjet që përbëhen nga shkronjat dhe numrat, të lidhura me veprimet e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit.

Shprehje shkronjore

x + y - 2
2 • x + y - 2
x + 3 (y + 3) - 2
x • y - 2 • x
x : y - 2

Shprehje numerike

7 • 8 - 2
48 : (8 - 2)
4 • (8 - 2) - 12 : 4

2 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën. Duke lexuar tabelën, shkruajmë zgjidhjen e barazimit.

x	7	4	6	3	5
4 • (x – 3)					

4 • (x – 3) = 12 x=

x	0	1	2	3	4
7 • (x + 2)					

7 • (x + 2) = 21 x=

3 Njehsojmë dhe plotësojmë tabelën. Duke lexuar tabelën, shkruajmë zgjidhjen e barazimit.

x	5	3	2	4	1	6	3
y	5	4	6	7	3	8	7
2 • x + y - 2							
x • (y + 2) - 2 • x							

SHPREHJET SHKRONJORE

MËSOJMË

117

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të lexojnë detyrën e parë dhe të gjejnë dallimin e shprehjeve shkronjore nga ato numerike.

Hapi 3: Detyra 2: Në fletore nxënësit udhëzohen të njehsojnë vlerën e shprehjeve shkronjore, duke ditur vlerën e ndryshores.

4 · (x – 3)	X = 7	4 · (7 – 3) = 4 · 4 = 16
4 · (x – 3)	X = 4	4 · (4 – 3) = 4 · 1 = 4
4 · (x – 3)	X = 6	4 · (6 – 3) = 4 · 3 = 12
4 · (x – 3)	X = 3	4 · (3 – 3) = 4 · 0 = 0
4 · (x – 3)	X = 5	4 · (5 – 3) = 4 · 2 = 8

Hapi 4: Njehsohet vlera e shprehjes numerike, kur shprehja ka dy ndryshore.

2 · x + y – 2	x = 5, y = 5	2 · 5 + 5 – 2 = 10 + 5 – 2 = 15 – 2 = 13
2 · x + y – 2	x = 3, y = 4	2 · 3 + 4 – 2 = 6 + 4 – 2 = 10 – 2 = 8
2 · x + y – 2	x = 2, y = 6	2 · 2 + 6 – 2 = 4 + 6 – 2 = 10 – 2 = 8

Njëjtë vazhdohet edhe me vlerat tjera të ndryshoreve x dhe y.

x · (y + 2) – 2 · x	x = 5, y = 5	5 · (5 + 2) – 2 · 5 = 5 · 7 – 10 = 35 – 10 = 25
x · (y + 2) – 2 · x	x = 3, y = 4	3 · (4 + 2) – 2 · 3 = 3 · 6 – 6 = 18 – 6 = 12
x · (y + 2) – 2 · x	x = 2, y = 6	2 · (6 + 2) – 2 · 2 = 2 · 8 – 4 = 16 – 4 = 12

Njëjtë vazhdohet edhe me vlerat tjera të ndryshoreve x dhe y.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e faktorit, të pjesëtuesit dhe të pjesëtueshmit të panjohur, si dhe për përgatitjen e provave.

Detyrë:
Detyra 2, tabela 2 (faqe 117).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 175

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Përcakton faktorin, pjesëtuesin dhe të pjesëtueshmin e panjohur.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1;3.1; 3.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Barazimet me shumëzim dhe pjesëtim


BARAZIMET ME SHUMËZIM DHE PJESËTIM

MËSOJMË

1 Cilin numër duhet shumëzuar me numrin 4, që të fitohet numri 24?
Zgjidhim detyrën:
Numrin e panjohur e shënojmë me shkronjën X.
Shkruajmë barazimin: 4 • X = 24 (faktori i panjohur)
Gjejmë vlerën e shkronjës X.

24 : 4 = X

4 • X = 24
X = 24 : 4
4 = 24 : X
→ X = 24 : 4 → X = 6

Themi se X = 6 është zgjidhje e barazimit 4 • X = 24.
Prova: 4 • 6 = 24
Shkruajmë përgjigjen: Numri që duhet shumëzuar me numrin 4, që të fitohet numri 24, është numri 6.
Shkronja X paraqet faktor (faktor të panjohur) në prodhimin 4 • X = 24.

Vlera e faktorit të panjohur në një prodhim është e barabartë me herësin ndërmjet prodhimit dhe faktorit të njohur.
a • X = b → X = b : a

2 T'i zgjidhim barazimet.
X • 3 = 27
X = 27 : 3
X = ☐
Prova: ☐ • ☐ = ☐

X • 6 = 54
X = ☐ : ☐
X = ☐
Prova: ☐ • ☐ = ☐

3 T'i zgjidhim barazimet.
5 • X = 45
X = 45 : 5
X = ☐

7 • X = 42
X = ☐ : ☐
X = ☐

8 • X = 16
X = ☐ : ☐
X = ☐

118

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Gjen faktorin, pjesëtuesin dhe të pjesëtueshmin e panjohur.
- Bën provën e zgjidhjeve të ekuacioneve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Paraqiten para nxënësve barazimet: 10+X= 20 dhe 6 ·X= 18. U parashtrohen pyetje: Ku dallojnë mes vete këto barazime? Çfarë tregon X? Si gjendet mbledhori i panjohur?

Zgjidhja që tregojnë nxënësit për mbledhorin e panjohur shënohet në tabelë. Kërkohet nga ata ta arsyetojnë zgjidhjen.

Si e gjejmë faktorin e panjohur?

Hapi 2: Sqarohet për nxënësit zgjidhja e barazimit ku faktori është i panjohur:



4 Me cilin numër duhet pjesëtuar numrin 63, që të fitohet numri 7?
Zgjidhim detyrën:

Numrin e panjohur e shënojmë me shkronjën X.
Shkruajmë barazimin: 63 : X = 7 — pjesëtuesi i panjohur
Gjejmë vlerën e shkronjës X.

63 : X · 7

7 · X = 63
63 : X = 7
63 : 7 = X → X = 63 : 7 → X = 9

Themi se X = 9 është zgjidhje e barazimit 63 : X = 7.
Prova: 63 : 9 = 7.
Shkruajmë përgjigjen: Numri me të cilin duhet pjesëtuar numrin 63, që të fitohet numri 7, është numri 9.
Shkronja X paraqet pjesëtuesin (pjesëtuesin e panjohur) në pjesëtimin 63 : X = 7.

Vlera e pjesëtuesit të panjohur në një pjesëtim njehsohet duke pjesëtuar të pjesëtueshmin me herësin.
a : X = b → X = a : b

5 Nëse një numër e pjesëtojmë me 7, fitojmë herësin 10. Cili është ai numër?
Zgjidhim detyrën:

Numrin e panjohur e shënojmë me shkronjën X.
Shkruajmë barazimin: X : 7 = 10 — i pjesëtueshmi i panjohur
Gjejmë vlerën e shkronjës X.

X : 7 · 10

7 · 10 = X → X = 7 • 10 → X = 70
X : 7 = 10
X : 10 = X

Themi se X = 70 është zgjidhje e barazimit X : 7 = 10
Shkruajmë përgjigjen: Numri, i cili kur pjesëtohet me numrin 7 e jep numrin 10, është numri 70.

Shkronja X paraqet të pjesëtueshmin e panjohur në pjesëtimin X : 7 = 10.

Vlera e të pjesëtueshmit të panjohur në një pjesëtim është e barabartë me prodhimin e herësit dhe të pjesëtuesit.
X : a = b → X = a • b

MËSOJMË

119

6• X= 18
X=18: 6
X=3

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të vëzhgojnë detyrën 1 në libër. Jepen sqarimet e duhura për zgjidhjen e barazimit të paraqitur. Sqarime jepen edhe për provën e zgjidhjes së barazimit.
Detyrat 2 dhe 3. U kërkohet t'i zgjidhin barazimet dhe të bëjnë provën.

Hapi 4: Sqarohet gjetja e pjesëtuesit dhe të pjesëtueshmit të panjohur përmes sqarimeve në detyrat 4 dhe 5 në libër. Jepen sqarime edhe për provën e zgjidhjes së barazimit.

Hapi 5: Nxënësve u kërkohet ta gjejnë faktorin e panjohur, pjesëtuesin dhe të pjesëtueshmin e panjohur në detyrat e dhëna (paraqiten në tabelë) dhe të bëjnë zgjidhjet e njehsimit të barazimeve.

5• X= 45 9•X= 63 X: 4= 8

8 •X= 48 7•X-49 X: 3=9

Detyrat e njehsuara nga nxënësit kontrollohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në gjetjen e faktorit, të pjesëtuesit dhe të pjesëtueshmit të panjohur, si dhe për përgatitjen e provave.

Detyrë:
Përcaktohet nga një barazim për njehsimin e faktorit, të pjesëtuesit dhe të pjesëtueshmit të panjohur.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 176

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen zgjidhjen e barazimeve të numrave deri në 100.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1, II.1,2, III.2,3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1,2; 3.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Dallon të pjesëtueshmin dhe pjesëtuesin e panjohur;
- Zgjidh detyra me të panjohurën;
- Bën provën në detyrat e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).


USHTROJMË

1 T'i zgjidhim barazimet.

X : 3 = 9
X = 9 • 3
X = □
Prova: □ : □ = □

X : 8 = 7
X = □ • □
X = □
Prova: □ : □ = □

2 T'i zgjidhim barazimet.

X : 8 = 5 X : 6 = 6 X : 7 = 5

3 T'i zgjidhim barazimet.

72 : X = 8
X = □ : □
X = □
Prova: □ : □ = □

54 : X = 6
X = □ : □
X = □
Prova: □ : □ = □

4 T'i zgjidhim barazimet.

56 : X = 8 72 : X = 9 64 : X = 8

5 T'i zgjidhim barazimet.

7 • X = 36 + 13
7 • X = □
X = □ : 7
X = □

27 + 27 = X • 6
□ = X • 6
X = □ : 6
X = □

X • 5 = 100 – 55
X • 5 = □
X = □ : □
X = □

6 Learti e mendoi një numër. Numrin e menduar e rriti 7 herë dhe si rezultat fitoi numrin i cili është për 14 më i vogël se numri 70. Cilin numër e mendoi Learti?

Njehsojmë: _____ Përgjigjja: _____

120

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Me anë të projektorit paraqitet detyra. *Andi e ka ditëlindjen. Ai mendoi që në festën e ditëlindjes t'i ftojë 25 shokë, të cilët do të uleshin nga 5 veta në një tavolinë.* Sa tavolina duhet të përgatiten për ditëlindjen e Andit? Bisedohet me nxënësit: Sa shokë mendoi t'i ftonte Andi? (25); Sa tavolina duhet t'i përgatiste? (X). Nga sa shokë mendoi t'i ulte në një tavolinë? (5); Si duhet shkruar barazimi: 25:X=5

X=25:5

Prova: X=5

25:5=5

Hapi 2: Kërkohet nga nxënësit të vëzhgojnë dhe të punojnë detyrën 1, në libër. (Kur mungon i pjesëtueshmi, atëherë herësi dhe pjesëtuesi duhet të shumëzohen mes vete). Bisedohet me nx-



USHTROJMË

1 T'i zgjidhim barazimet.

X : 3 = 9
X = 9 • 3
X = ☐
Prova: ☐ : ☐ = ☐

X : 8 = 7
X = ☐ • ☐
X = ☐
Prova: ☐ : ☐ = ☐

2 T'i zgjidhim barazimet.

X : 8 = 5 _____ _____

X : 6 = 6 _____ _____

X : 7 = 5 _____ _____

3 T'i zgjidhim barazimet.

72 : X = 8
X = ☐ : ☐
X = ☐
Prova: ☐ : ☐ = ☐

54 : X = 6
X = ☐ : ☐
X = ☐
Prova: ☐ : ☐ = ☐

4 T'i zgjidhim barazimet.

56 : X = 8 _____ _____

72 : X = 9 _____ _____

64 : X = 8 _____ _____

5 T'i zgjidhim barazimet.

7 • X = 36 + 13
7 • X = ☐
X = ☐ : 7
X = ☐

27 + 27 = X • 6
☐ = X • 6
X = ☐ : 6
X = ☐

X • 5 = 100 – 55
X • 5 = ☐
X = ☐ : ☐
X = ☐

6 Learti e mendoi një numër. Numrin e menduar e rriti 7 herë dhe si rezultat fitoi numrin i cili është për 14 më i vogël se numri 70. Cilin numër e mendoi Learti?

Njehsojmë: _____ Përgjigjja: _____

120

ënësit: Sa është i pjesëtueshmi? (X); Sa është pjesëtuesi? (3); Po herësi?(9). X:3=9
X=9·3
Prova: X=27
27:3=9

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të punojnë të pavarur detyrën 2.

Hapi 4: Kërkohet nga ta të punojnë detyrën 3 në libër. (Pjesëtuesin e gjejmë kur të pjesëtueshmin e pjesëtojmë me herësin). Pyeten nxënësit: Sa është i pjesëtueshmi? (72); Sa është pjesëtuesi? (X); Po, herësi? (8). 72:X=8
X=72:8 Prova:
X=9 72:9=8

Hapi 5: Nxënësit e punojnë detyrën 6.
X·7=70-14
X·7=56
X=56:7 X=8

Hapi 6: Nxënësve në dyshe u shpërndahen fletët. Kërkohet nga ta që ta zgjidhin detyrën me fjalë:

Vesa shkroi një numër në fletoren e tij. Atë numër e shumëzoi me numrin 8 dhe e fitoi rezultatin 56.
Cilin numër e shënoi Vesa në fletore?
X·8=56
X=56:8 Prova:
X=7 7·8=56
Cilin numër duhet ta zvogëlojmë 9 herë që të fitohet numri 6?
X:9=6
X=6·9 Prova:

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për zgjidhjen e detyrave me të panjohur.

Detyrë:
Detyra 5 (faqe 120).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 177

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);
Gjen faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1, 6.2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kubi dhe kuboidi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton trupat gjeometrikë;
- Dallon trupat gjeometrikë sipas vetive të tyre (kubin dhe kuboidin).

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Trupa gjeometrikë të punuar prej kartoni.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Para nxënësve paraqiten gjashtë trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, piramida, koni, sfera dhe cilindri), të punuar më parë nga kartoni. Emërtohet secili trup. Pastaj kërkohet nga nxënësit të gjejnë sende nga mjedisi rrethues që kanë formën e tyre.

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit emërtojnë trupat e vizatuar. U sqarohet se:

Trupat gjeometrikë ndahen në → Trupa me qoshe
Trupat gjeometrikë ndahen në → Trupa të rrumbullakët

Trupat me qoshe janë: kubi, kuboidi dhe piramida.
Trupat e rrumbullakët janë: koni, sfera dhe cilindri.



TRUPAT GJEOMETRIKË

KUBI DHE KUBOIDI

MËSOJMË

1 Emërtojmë trupat e vizatuar. Cilët trupa kanë veti të përbashkët?

kuboidi

koni

cilindri

Kubi, kuboidi dhe piramida kanë qoshe, prandaj emërtohen edhe si trupa me qoshe.
Koni, sfera dhe cilindri janë trupa rrotullues. Vërejmë se koni ka një qosh.

2 Kubi (faqet, brinjët dhe kulmet).

faqja

faqja

faqja

Kubi ka:
___ faqe
___ brinjë
___ kulme

kulmi

brinja

3 Kuboidi (faqet, brinjët dhe kulmet).

faqja

faqja

Kuboidi ka:
___ faqe
___ brinjë
___ kulme

brinja

kulmi

121

Hapi 3: Detyra 2: Në saje të vizatimeve dhe të sqarimeve të dhëna në detyrë, dallohen kulmet, faqet dhe brinjët e kubit dhe kuboidit. Ndaj, nxënësit i plotësojnë fushat e zbrazëta:



Kubi		
Kulme	Brinjë	Faqe
8	12	6

Kuboidi		
Kulme	Brinjë	Faqe
8	12	6

Kubi i ka të gjitha brinjët e barabarta, ka faqe të sheshta dhe katrore.
Kuboidi nuk i ka të gjitha brinjët e barabarta, ka faqe të sheshta dhe drejtkëndëshe.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në emërtimin dhe dallimin e trupave gjeometrikë (kubin dhe kuboidin).

Detyrë:

Emërton pesë objekte që kanë formën e kuboidit dhe pesë objekte që kanë formën e kubit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 178

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Emërton trupat gjeometrikë;
- Gjen faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë;

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1,3; III.1,6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6. 1, 2.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton trupat gjeometrikë;
- Identifikon numrin e brinjëve, faqeve dhe kulmeve të një trupi gjeometrik;
- Gjen shembuj të trupave gjeometrikë nga mjedisi rrethues.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kub dhe kuboid të punuar nga letra, ngjyra, objekte që kanë formën e tyre.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Bëhet përmbledhje e shkurtër nga ora e kaluar për njohuritë rreth kubit dhe kuboidit.



Hapi 2: Nga nxënësit kërkohet paraprakisht të sjellin në klasë gjëra/sende që kanë formën e kubit dhe kuboidit dhe t'i vendosin mbi bankë sendet që i kanë sjellë nga shtëpia dhe në grup t'i klasifikojnë ato dhe t'i formojnë dy bashkësi:

- bashkësinë e objekteve që kanë formë të kubit;
- bashkësinë e objekteve që kanë formë të kuboidit.

Nxënësve u kërkohet të lëvizin nëpër grupe duke shikuar bashkësitë e formuara.

Hapi 3: Udhëzohen të vizatojnë figurat gjeometrike detyrën 1 dhe 3.

Hapi 4: Nxënësit i emërtojnë elementet kryesore të kuboidit.



Gjatësia, gjerësia dhe lartësia paraqesin dimensionet e kuboidit.

Hapi 5: Nga nxënësit kërkohet të numërojnë kubet në figurat e dhëna, në detyrën 4.

VEPRIMTARI SHTESË
Nxënësit punojnë me letër, plastelinë ose shkopinj kubin dhe kuboidin.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin dhe emërtimin e kubit dhe kuboidit dhe elementeve të tyre.

Detyrë:
Të vizatojë në fletore një kub dhe një kuboid.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 179

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Emërton trupat gjeometrikë (kubi, kuboidi, sfera, cilindri, koni, piramida);
Gjen faqet, brinjët dhe kulmet e trupave gjeometrikë (përmasat e tyre);
Identifikon objekte të ngjashme me trupat gjeometrikë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.3, III.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 6.1, 2, 3, 4.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Piramida, koni, sfera dhe cilindri

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Emërton trupat gjeometrikë;
- Identifikon faqet, kulmet, brinjët dhe bazën e trupave gjeometrikë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë-shabllone me piramidën, konin dhe cilindrin.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Në tabelë vendosen fletë-shabllone me piramidën, konin dhe cilindrin. Emërtohen figurat gjeometrike, të cilat i shohim (trekëndëshi, rrethi, katrori). Figurat gjeometrike bashkohen dhe kështu formohen trupat gjeometrikë: piramida, cilindri, koni.



Hapi 2: Detyra 1 - Dallohen dhe emërtohen elementet e piramidës



(baza, faqet, brinjët, kulmet).

Detyra 2 – Dallohen dhe emërtohen elementet e konit, të sferës dhe të cilindrit.

Hapi 3: Ngjyrosen trupat gjeometrikë: piramida - rozë, sfera - kaltër, cilindri - kafe, koni - verdhë, kubi - gjelbër; kuboidi - portokalli.

Hapi 4: Nxënësit në dyshe gjejnë cilat figura kanë formë të njëjtë sikur trupat gjeometrikë (faqe 119).

Kuboidi	Kubi
3, 12, 14, 16	1, 9, 15, 20

Cilindri	Sfera	Koni
5, 7, 18, 19	2, 8, 10, 11	4, 6, 13, 17

Hapi 5: Nxënësve u shpërndahen fletë shabllone me trupat gjeometrikë, të cilat duhet t'i ngjyrosin, t'i presin dhe të formojnë trupin gjeometrik.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit, emërtimit të trupave gjeometrikë, dallimin e elementeve të trupave gjeometrikë.

Detyrë:
Punon nga kartoni njërin nga trupat gjeometrikë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 180

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Trupat gjeometrikë

Rezultatet e të nxënit të temës:
Krahason trupat gjeometrikë (përmasat e tyre).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 4, 5.1, 6.1

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Edhe matematika është zbavitje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Krahason përmasat e trupave të ndryshëm (e lehtë, e rëndë).
- Gjen objekte në natyrë që ngjasojnë me trupa gjeometrikë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: balona, enë të ndryshme.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.



METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Loja me balona
Nxënësit udhëzohen të marrin balonat (mundësisht me madhësi të ndryshme) dhe ato t'i mbushin me ujë.
Me ujë mbushen edhe tri-katër enë me madhësi të ndryshme.
Krahasohen cilat zënë më shumë ujë, balonat apo enët.
Loja mund të luhet në oborrin e shkollës.

Hapi 2: Nxënësit udhëzohen të vështrojnë tri enët e dhëna në figurë, detyra 2. Plotësohen fjalitë me fjalët më e lehtë – më e rëndë.
Gota është më *e lehtë.*
Kova është më *e rëndë.*
Shishja është më *e rëndë* se gota.



1 Aktivitet për nxënësit:

Kërkohet nga nxënësit të marrin disa balona të madhësive të ndryshme dhe t'i mbushin me ujë.

Krahasojmë sasinë e ujit që zënë balonat në krahasim me enët e tjera.

2 Krahasoni se cila enë zë më shumë ujë.

Gota Shishja Kova

1. Gota është ena më e lehtë.
2. Kova është ena më e _____.
3. Shishja është më e _____ se gota.

3 Rrethoni se në cilin rast këmbësori e sheh më heret veturën.

Vërejmë se kodra e parë ngjason më shumë me një trup me qosh, kurse i dyti i ngjason më shumë një trupi të rrumbullakët.

EDHE MATEMATIKA ËSHTË ZBAVITJE

ZBAVITEMI

125

Hapi 3: Detyra 3: Nxënësit komentojnë dy figurat e dhëna.
Përgjigjen në kërkesën e detyrës.

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen të vizatojnë objektet që shohin rrugës për në shkollë, duke i ndarë në objekte që u takojnë trupave me qosh dhe trupave të rrumbullakët.
Punimet vendosen në një kënd të klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në krahasimin e përmasave të trupave të ndryshëm (e lehtë, e rëndë) dhe gjetjen e objekteve në natyrë që ngjasojnë me trupa gjeometrikë.

Detyrë:

_____

_____

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

_____

_____

Mësimi 181

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Puna me të dhëna

Rezultatet e të nxënit të temës:
Grumbullon të dhënat në klasë apo diku tjetër dhe paraqet në tabelë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2; IV.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1;4.2;7.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Grumbullimi dhe paraqitja e të dhënave

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Grumbullon të dhëna në bazë të një cilësie;
- Përdorë diagramin dhe grafikun për të paraqitur të dhënat.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë shqipe, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.



PUNA ME TË DHËNAT

GRUMBULLIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE

MËSOJMË

1 Suksesi i nxënësve të klasave të dyta në fund të vitit shkollor është paraqitur në formë të kësaj tabele.

Klasa	shkëlqyeshëm	shumë mirë	mirë	mjaftueshëm	gjithsej
II-1	10	8	6	4	28
II-2	8	12	7	3	30
II-3	9	14	3	5	31
Gjithsej	27	34	16	12	89

Tabela e suksesit të nxënësve të klasave të dyta – tabela e të dhënave.
Të dhëna janë: numri i paraleleve, numri i nxënësve të shkëlqyeshëm, shumë të mirë dhe të mjaftueshëm.
Të dhënat në një rresht formojnë rreshtin e tabelës.
Të dhënat e rreshtit të dytë janë: _____

2 Piktogrami na mundëson t'i paraqesim të dhënat duke përdorur fotografi ose objekte. Në këtë piktogram në shtylla janë paraqitur të dhënat për muajin e lindjes së nxënësve të një klase.

Të dhënat e paraqitura me diagram i paraqesim në formë tabele.

Muaji	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nëntor	dhjetor
Numri i nxënësve												

Pyetje:

1. Sa nxënës i ka klasa?
2. Sa nxënës kanë lindur në qershor?
3. Në cilin muaj kanë lindur më së shumti nxënës të klasës?
4. Në cilët muaj kanë lindur më së paku nxënës të klasës dhe nga sa?

Paraqitni të dhënat e tilla për klasën tuaj.

126

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësve u kërkohet që në një letër të vizatojnë frutin që u pëlqen më shumë. Më pas udhëzohen të grupojnë vizatimet sipas llojit të frutit (p.sh. fletët me mollën e vizatuar e kështu me radhë). Kërkohet të tregojnë se sa nxënës kanë përzgjedhur një frut të caktuar. Mund të diskutohet se cili frut pëlqehet me shumë ose cili më pak nga nxënësit.
Aktiviteti mund të realizohet edhe me numrin e shkronjave të emrit. Secili nxënës shkruan emrin në një fletë dhe sa shkronja ka emri. Pastaj, udhëzohen të grupojnë emrat në bazë të numrit të shkronjave. Mund të diskutohet me nxënës sa prej tyre kanë emrin me 4 shkronja, 5 shkronja e kështu me radhë.

Hapi 2: Udhëzohen të vëzhgojnë tabelën në detyrën 1 në libër. Jepen sqarime për të dhënat e paraqitura (klasa, numri i nxënësve sipas suksesit të arritur sipas paraleleve, numri i nxënësve nga tri paralelet për secilin sukses të paraqitur).



3 Rezultatet e testit kontrollues nga lënda e matematikës janë dhënë me tabelë, si më poshtë. Këto të dhëna i paraqesim me piktogram:

Nota	5	4	3	2	1
Nr. i nxënësve	8	10	6	3	2

Nga tabela lexojmë: Nota të shkëlqyeshme kanë marrë ___ nxënës, shumë mirë ___ nxënës.
Më së paku nxënës kanë marrë nota të _____ .

Më shumë nxënës kanë marrë nota _____ .

5 4 3 2 1

legjenda: paraqet një nxënës

4 Gjyshi i Artanit ka matur sasinë e qumështit që ka marrë nga lopa gjatë një jave. Matjet i bëri çdo ditë dhe të dhënat i shënoi në tabelë.

Ditët e javës	H	M	M	E	P	Sh	D
Sasia e qumështit në libra	9	8	11	10	9	7	10

Duke ngjyrosur, të dhënat nga tabela i paraqesim me piktogram.

H M M E P Sh D

legjenda: paraqet një litër

Pyetje:

Çfarë sasie të qumështit ka marrë gjyshi për një javë?

MËSOJMË

127

Në detyrën 2 jepen sqarime për diagramin me shtylla ku janë paraqitur të dhënat për muajin e lindjes. Udhëzohen nxënësit që të dhënat nga diagrami t'i paraqesin në tabelë.

Detyra 3. Nxënësit udhëzohen që të dhënat e paraqitura në tabelë t'i paraqesin në diagramin me shtylla.
Detyra 4. Duke lexuar të dhënat në tabelë, plotësohet piktogrami.
Detyra 5. Duke analizuar diagramin, nxënësit u përgjigjen pyetjeve dhe plotësojnë tabelën me të dhënat.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të grumbullojnë të dhëna në klasë (p.sh., numri i mjeteve mësimore: lapsa, fletore, libra dhe vizore apo të dhëna të tjera) dhe t'i paraqesin ato të dhëna me diagram dhe me tabelë.

Të dhënat e paraqitura nga nxënësit kontrollohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në paraqitjen e të dhënave me diagram dhe tabelë.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 128).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 182

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Puna me të dhëna

Rezultatet e të nxënit të temës:
Analizon të dhënat e grumbulluara nga tabela dhe i paraqet në grafik.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1,3, II.2,7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,2; 2.1,3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Ushtrojmë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Grumbullon të dhënat për një kërkesë të caktuar;
- Paraqet në tabelë të dhënat e grumbulluara;
- Diskuton rezultatet e të dhënave të grafikut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, fletë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Shoqëria dhe mjedisi, Edukatë figurative.


1 Në shkollë janë matur se sa të gjatë janë nxënësit e klasave të dyta. Në një fletë të bardhë janë shënuar rezultatet e matjeve në këtë mënyrë.

12 dm
11 dm
10 dm
– shënon 5 njësi

Plotësojmë tabelën:

Gjatësia deri në	12 dm	11 dm	10 dm
Numri i nxënësve	21		

Duke ngjyrosur, të dhënat nga tabela i paraqesim me piktogram.

12 dm 11 dm 10 dm

legjenda: dy nxënës

Duke analizuar paraqitjen e mësipërme të të dhënave për gjatësinë e nxënësve të klasave të dyta, formuloni disa pyetje dhe shkruani përgjigjet.

1. _____
Përgjigjja: _____
2. _____
Përgjigjja: _____
3. _____
Përgjigjja: _____

USHTROJMË

129

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Tre nxënës të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, hedhin zarin nga tri herë. Në tabelë mbahen shënime për numrat që u bien secilit prej tyre. Ndërtohet një tabelë me të dhëna për secilin nxënës e, më pas, i paraqesin ato në diagram. Diskutohen dhe analizohen të dhënat e paraqitura.

Vajza	Djem

Aktiviteti sportiv	noti	futbolli	çiklizimi	tenisi	rolingu
Numri i nxënësve	19	8	13	2	8



Hapi 2: Udhëzohen të punojnë detyrën 1 në libër.

Gjatësia deri në	15 dm	14 dm	13 dm	12 dm
Numri i nxënësve	9	19	23	21

- Sa nxënës janë deri në 13 dm? (23)
- Sa nxënës janë deri në 14 dm? (19)
- Sa nxënës janë deri në 15 dm? (9)

Hapi 3: Detyra 2: Nxënësit udhëzohen që, duke analizuar të dhënat e paraqitura në grafik, t'u përgjigjen pyetjeve:

- Sa libra ka lexuar Luana gjatë një viti? (70 libra);
- Sa libra ka lexuar Blearti? (75 libra);
- Sa libra ka lexuar Blearti më shumë se Lisi? (Blearti ka lexuar 10 libra më shumë se Lisi);
- Kush ka lexuar 5 libra më shumë se Guri? (Rrona);
- Kush ka lexuar më shumë libra? (Blearti);
- Kush ka lexuar më pak libra? (Guri).

Hapi 4: Detyra 3: Nxënësit zgjidhin në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë, më pas u përgjigjen pyetjeve të dhëna në detyrë. Pyeten:

- Sa peshq kapën Lisi, Guri, Learti dhe Lindi së bashku?
- Lisi kapi 12 peshq, Guri 16, Learti 4 dhe Lindi 14 (12 + 16 + 4 + 14 = 46, së bashku ata kapën 46 peshq);
- Kush kapi më shumë peshq? (Guri);
- Kush kapi më pak peshq? (Learti).

Hapi 5: U shpërndahen grupeve të nxënësve nga një fletë e vogël me madhësi të njëjtë. Aty është shkruar një detyrë: Petriti në fundjavë shkoi në piknik me shokë. Me vete ai mori: 2 thika, 4 pirunë, 5 gota, 7 pjata, 1 tavolinë dhe 6 karrige. U kërkohet t'i regjistrojnë të dhënat në tabelë dhe t'i paraqesin në diagrame.

Furnizimet	thika	pirunë	gota	pjata	tavolinë	karrige
Numri i furnizimeve						

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në grumbullimin dhe paraqitjen e të dhënave.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 183

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Probabiliteti

Rezultatet e të nxënit të temës:
Parashikon mundësinë (me dallime të mëdha);
Bën provën, e mundshme, e pamundshme;
Përdor probabilitetin në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 3.1, 4, 5.1, 6.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:
Probabiliteti

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Parashikon mundësinë për të ndodhur një ngjarje.
- Provon mundësinë për një ngjarje si e mundshme ose e pamundshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: zar, monedhë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe).

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Lojë
Nxënësit, në dyshe, udhëzohen të luajnë lojën: *Gjej në cilën dorë është?*
Dy nxënësit rrinë përballë njëri-tjetrit.
Njëri nxënës mban në dorë një objekt të vogël (gomë, pullë). Vendos duart pas shpine, fsheh objektin në njërën nga duart dhe nxënësi tjetër duhet të gjejë se në cilën dorë është objekti.
Mundësitë për fshehjen e objektit janë dy: dora e djathtë ose dora e majtë.
Loja përsëritet disa herë, duke u përqendruar se sa mundësi janë të fshehet objekti.



MËSOJMË

5 Aktivitet në klasë:

E hedhim një zar tri herë dhe i mbledhim rezultatet.

A mund ta fitojmë shumën 20?

Po shumën 2?

I shënojmë shumat e fituara dhe shikojmë se cila shfaqet më së shumti.

Shuma															
Numri i nxënësve															

6 E hedhim monedhën dy herë. Mundësitë janë: dy herë kokë, dy herë pilë, një herë kokë e një herë pilë. Përdorim fjalët **çerek** dhe **gjysmë** në hapësirat e zbrazëta:

_____ e herëve bien anë të ndryshme.

_____ e herëve bien anë të njëjta.

_____ e herëve bie kokë dy herë.

kokë pilë

7 Aktivitet në klasë

E hedhim monedhën tri herë. E shënojmë numrin e nxënësve që kanë marrë kokë 0 herë, 1 herë, 2 herë dhe 3 herë.

Kokë				
Numri i nxënësve				

132

Hapi 2: Detyra 1: Nxënësit udhëzohen të lexojnë të dhënat në piktogram dhe të analizojnë se cilën nga pemët ka më shumë mundësi që e ka ngrënë Darsi, e cilën më pak.

Detyra 2, 3 dhe 4: Nxënësit iu përgjigjen pyetjeve të dhëna, duke arsyetuar përgjigjet e tyre.

Hapi 3: Detyra 7: Marrim një monedhë dhe nxënësit me radhë gjuajnë tri herë monedhën.

Kokë	0 herë	1 herë	2 herë	3 herë
Numri i nënësve				

Hapi 4: Detyra 5: Nxënësit udhëzohen të formojnë një rreth dhe me radhë të hedhin zarin tri herë dhe të gjejnë shumën e rezultateve, p.sh. 2 + 3 + 1 = 6

Shuma	6		
Numri i nxënësve			

Nëse e hedhim zarin tri herë, shumat 20 dhe 2 janë të pamundshme.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në parashikimin e mundësisë për të ndodhur një ngjarje dhe përcaktimin e një ngjarjeje si e mundshme ose e pamundshme.

Detyrë:
Detyra 6 (faqe 132).

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

Mësimi 184

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë, Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
- Gjen vlerën (shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin) e shprehjeve numerike të përbëra (dy veprime).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4, III.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1; 2, 4; 3.1.



1 Prodhimin e numrave 5 dhe 6 e rritim për prodhimin e numrave 3 dhe 8. Rezultatin e zvogëlojmë 9 herë.

Njehsojmë: _____

2 Njehsojmë dhe plotësojmë:

	7 herë më i vogël	8 herë më i madh	për 9 më i vogël
28	→	→	→
42	→	→	→
63	→	→	→
70	→	→	→

3 Njehsojmë:

90 – 72 : 8 = _____
6 • 4 – 32 : 8 = _____
48 + (17+37) : 6 = _____

4 T'i zgjidhim barazimet.

7 • X = 63
X = ☐ : ☐
X = ☐
Prova: ☐ • ☐ = ☐

42 : X = 6
X = ☐ : ☐
X = ☐
Prova: ☐ : ☐ = ☐

8 • X = 43 + 29
8 • X = ☐
X = ☐ : ☐
X = ☐

5 Ta gjejmë vlerën e shkronjës X në barazimet e mëposhtme:

9 • X = 39 + 6 • 4
9 • X = 39 + 24
9 • X = 63
X = 63 : 9
X = ☐

7 • X = 100 – 44
X = ☐

PËRSËRISIM

133

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përsërisim

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson vlerën e shprehjeve të dhëna;
- Përcakton numrin e panjohur;
- Plotëson tabelat dhe rrathët e zbrazët.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit udhëzohen të lexojnë dhe ta zgjidhin detyrën e parë me fjalë.
Diskutohet bashkërisht:
- Cili veprim është prodhimi i numrave?
- Cilat shenja duhet t'i përdorim për të gjetur zgjidhjen e detyrës?

Hapi 2: Nga nxënësit kërkohet të njehsojnë dhe të plotësojnë e të gjejnë numrat që janë: 7 herë më i vogël, 8 herë më i madh, për 9 më i vogël.

Hapi 3: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë dhe të gjejnë rezultatin e detyrave me dy veprime. Diskutohet bashkërisht se cili veprim ka përparësi dhe duhet të kryhet i pari.



ZBATOJMË

1 Plotësojmë tabelat.

+			
64	93		
42		74	
26			60

+		15	
43			71
		56	
27	46		

2 Etleva e mendoi një numër. Nga ky numër ajo zbriti numrin 6 dhe fitoi si rezultat numrin i cili është për 4 më i vogël se numri 12. Cilin numër e mendoi Etleva?

Njehsojmë: _____ Përgjigjja: _____

3 Vesa e mendoi një numër. Nga ky numër ajo zbriti herësin e numrave 72 dhe 8 dhe si rezultat fitoi prodhimin e numrave 6 dhe 8. Cilin numër e mendoi Vesa?

Njehsojmë: _____ Përgjigjja: _____

4 Plotësojmë tabelat.

·			
3	15		
6		24	
8			56

·			
6			30
4	24		
9		63	

5 Plotësojmë rrathët e zbrazët. Shuma e numrave në çdo brinjë të jetë sa numri i dhënë.

134

Hapi 4: Nxënësve u kërkohet t'i zgjidhin barazimet në detyrën 4 dhe ta gjejnë vlerën e shkronjës në barazimet e detyrës 5.

Hapi 5: Nxënësit udhëzohen të njehsojnë dhe të plotësojnë tabelat në detyrën 1 dhe në detyrën 4, në faqen 126. Në tabelat e detyrës 1 duhet të mbledhin, kurse në tabelat e detyrës 4 duhet të shumëzojnë.

Hapi 6: Kërkohet që në dyshe të njehsojnë dhe t'i gjejnë përgjigjet e detyrave me fjalë në ushtrimet 2, 3 dhe 5.

Hapi 7: Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë rrathët e zbrazët, ku shuma e numrave të çdo brinje të jetë sa numri i dhënë.



Diskutohet me nxënësit:
- Sa bëjnë 4 + 7? Edhe sa duhet t'ia shtojmë që të bëhen 19?
- Sa bëjnë 4 + 5? Cili numër mungon në rrethin tjetër?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në njehsimin e vlerës së shprehjes dhe përcaktimit të numrave të panjohur.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi 185

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Matematikë
Lënda: Matematikë
Shkalla e kurrikulës: 1 **Klasa:** II
Tema: Numrat natyrorë, Ekuacionet dhe inekuacionet lineare

Rezultatet e të nxënit të temës:
Gjen prodhimin dhe herësin e numrave (≤ 50); Përcakton faktorin e panjohur (numra deri në 100).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.2, III.4, III.5.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1. 1, 2, 4, 3.1.



ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Vlerësojmë të kuptuarit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:
- Njehson vlerën e shprehjeve të dhëna;
- Përcakton numrin e panjohur;
- Krahason barazimet e dhëna.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Zare.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
Gjuhë amtare (shqipe), Edukatë figurative, Njeriu dhe natyra.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Hapi 1: Nxënësit në treshe i gjuajnë zaret dhe me numrat e qëlluar formojnë barazi me dy veprime të ndryshme.
3 · 2 – 4 = 6 – 4 = 2

Hapi 2: Detyra 1 – Të gjendet vlera e X.

10 · X = 56 – 18: 3 10 · X = 56 – 6 10 · X = 50 X = 50 : 10 X = 5	X : 7 = 6 X = 6 · 7 X = 42	36 : X = 9 X = 36 : 9 X = 4



I plotësojnë edhe detyrat 2 dhe 3.

Hapi 3: Detyra 4 - Të gjendet numri i gjallesave**.**



3	7	10	2

Detyra 5 – Të krahasohen prodhimet dhe herësit e numrave të dhënë.
Lexohen dhe komentohet rezultatet e secilës detyrë.
Për detyrat e zgjidhura saktë nxënësit vlerësohen me apo

Hapi 4: Nxënësit udhëzohen t'i plotësojnë detyrat në libër, duke njehsuar shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin e numrave të dhënë. Kërkohet nga ta të respektojnë radhën e veprimeve dhe të veprojnë sipas shigjetave për të filluar njehsimin e detyrave. Te detyrat me katrorë, nxënësit udhëzohen që në secilin rresht dhe kolonë, numri i përgjithshëm duhet të jetë në bazë të numrit magjik të përcaktuar, nëse numri magjik është 15, atëherë njehsimi është 8 + 4 + 3 = 15. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe për katrorin tjetër. Te detyrat me dy veprime, nxënësit udhëzohen të respektojnë radhën e veprimeve.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në zgjidhjen e detyrave të dhëna.

Detyrë:
Shkruan pesë barazi me shumëzim dhe pjesëtim.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore: